UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI, VLORË

RAPORTI I VETËVLERËSIMIT PËR AKREDITIMIN INSTITUCIONAL

GRUPI I VETËVLERËSIMIT :

1.	Prof. As Majlinda Zahaj	Kryetar
2.	Dr. Blerina Dervishaj	Anëtar
3.	Dr. Entela Avdulaj	Anëtar
4.	Dr. Glodiana Sinanaj	Anëtar
5.	Dr. Eljona Proko	Anëtar
6.	Sonila Bështika	Anëtar
7.	Harikla Beduli	Anëtar
8.	Besmira Xhaferaj	Anëtar
9.	Rezarta Sinanaliaj	Anëtar
10.	Kristi Metushi	Anëtar (Student)
11.	Leandro Grabova	Anëtar (Student)

Data: 20/Shkurt/2026

PËRMBAJTJA

Hyrje në procesin e Vetëvlerësimit 3

Historiku i UV-së 4

Plotësimi i rekomandimeve 2020..... 5

Standardi I – IAL, Menaxhimi, Autonomia dhe Sigurimi i Cilësisë..... 17

Standardi II – Burimet dhe Partneriteti 38

Standardi III – Programet e Studimit, Mësimdhënia dhe Vlerësimi 67

Standardi IV – Aktiviteti Shkencor / Artistik dhe Inovacioni 98

Standardi V – Studentët dhe mbështetja e tyre 141

Përfundimet dhe Vlerësimi i përgjithshëm 166

Lista e Evidencave 170

Hyrje në procesin e Vetëvlerësimit

Universiteti “Ismail Qemali” i Vlorës hyn në procesin e akreditimit institucional si një vazhdimësi e një eksperience të mëparshme të suksesshme. Institucioni është akredituar nga Bordi i Akreditimit i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) me Vendimin nr. 50, datë 27.11.2020, për një periudhë 5-vjeçare. Procesi aktual i akreditimit synon konsolidimin e mëtejshëm të kulturës së cilësisë dhe përmbushjen e standardeve institucionale të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe aktet nënligjore për arsimin e lartë.

Universiteti “Ismail Qemali” i Vlorës e konsideron procesin e akreditimit institucional si një instrument të rëndësishëm për përmirësimin e vazhdueshëm të funksionimit akademik, administrativ dhe organizativ, si dhe për rritjen e performancës dhe transparencës në veprimtarinë e tij. Në këtë kuadër, për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin e standardeve të cilësisë, u hartua Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm (RVB), në përputhje me kriteret dhe standardet e përcaktuara nga ASCAL.

Hartimi i raportit është realizuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB), i ngritur me *Urdhër Rektori nr. 221, datë 22.12.2025*. Në përzgjedhjen e anëtarëve të GVB-së, Rektorati ka marrë parasysh eksperiencën e mëparshme të tyre në procese të vlerësimit të brendshëm, si dhe rezultatet e kënaqshme të arritura në proceset e mëparshme të akreditimit. Në grup janë përfshirë zëvendësrektorja akademike, zëvendësdekanet e gjithë fakulteteve, specialistët e Sektorit të Sigurimit të Cilësisë & Akredititmit, specialistja e Projekteve dhe dy studentë: Kryetari i Këshillit Studentor dhe përfaqësuesi i studentëve në Senatin Akademik.

Në shkrimin e Raportit të Vetëvlerësimit të UV-së dhe mbledhjen e evidencave janë angazhuar përgjegjësit e disa sektorëve, si Sektorit të Karrierës, Shërbimit për Studentët dhe Alumni, Sektorit të Marrdhënieve me Jashtë, Sektorit të Bibliotekës & Botimeve, Sektorit të Kërkimit Shkencor & Projekteve etj., duke garantuar një përfaqësim të gjerë dhe gjithëpërfshirës në procesin e vetëvlerësimit.

Në argumentimin e analizës narrative të standarteve të vetëvlerësimit janë përdorur gjerësisht evidenca elektronike nga dokumentacioni dhe informacionet autentike, të pasqyruara në faqen zyrtare dhe platformat e Universitetit ‘Ismail Qemali’, të cilat mund të aksesohen edhe në gjuhët angleze, gjermane dhe italiane. Evidencat shkresore janë skanuar pas fotokopjimit me vulën e njomë institucionale dhe janë përkthyer në gjuhën angleze në pjesën më të madhe të tyre.

Në përfundim, ky raport reflekton në mënyrë të qartë dhe të integruar veprimtarinë e Universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës, duke evidentuar arritjet dhe potencialet për zhvillim të mëtejshëm, si dhe angazhimin e tij të vazhdueshëm për cilësi dhe standarde të larta akademike.

HISTORIKU I UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI"

Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës u themelua më 10 tetor 1994, me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.105, duke u shndërruar shpejt në një nga institucionet më të rëndësishme të arsimit të lartë në Shqipëri. Themimi i tij ishte rezultat i një pune disa mujore për përgatitjen e planeve, programeve dhe stafit akademik, me mbështetjen e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe fakulteteve të Ekonomisë dhe Mjekësisë në Tiranë.

Universiteti filloi aktivitetin me tre fakultete: Tregtisë (degët Biznes dhe Turizëm), Inxhinierisë Detare dhe Infermierisë, duke u bazuar në traditat e hershme të qytetit. Që prej vitit 1919, Vlora kishte Shkollën e Mesme Tregtare, ndërsa më vonë u hap filiali i Universitetit të Tiranës për degën e Ekonomikut. Fakulteti i Inxhinierisë Navale u zhvillua mbi bazën e Shkollës së Lartë të Marinës, ndërsa Fakulteti i Infermierisë u ngrit mbi traditën e Shkollës së Mesme Mjekësore, e vetmja në vend.

Në themelimin e universitetit, një rol vendimtar luajti Dr. Sezai Bazaj, i cili drejtoi grupin e punës për organizimin e gjithë procesit dhe më pas u emërua Rektor. Fillimi ishte modest: dy godina, 162 studentë, 10 pedagogë të brendshëm dhe 31 të jashtëm. Megjithatë, këta pionierë të parë vunë themelet e një misioni të përkushtuar akademik dhe profesional. Fillimisht i quajtur "Universiteti Teknologjik Ismail Qemali Vlorë", që nga viti 2007 mban emrin aktual.

Që nga viti akademik 1994-1995, Universiteti ka njohur një rritje të vazhdueshme, si sasiore ashtu edhe cilësore. Oferta e programeve studimore u zgjerua, stafi akademik u rrit dhe u kualifikua, ndërsa studentët e rinj u rekrutuan nga të gjithë rajonet e Shqipërisë. Sot, UV ofron 84 programe në të tre ciklet e studimit, duke përfshirë edhe programe të përbashkëta dhe në gjuhë të huaja, të strukturuara sipas Procesit të Bolonjës dhe krediteve ECTS.

Stafi akademik ka arritur të përbëhet nga mbi 198 pedagogë me kohë të plotë, përfshirë 7 Profesor Doktor, 39 Profesor të Asociuar dhe 92 Doktor Shkencash. Kualifikimi i tyre është i vazhdueshëm, brenda dhe jashtë vendit, me mbështetjen e Universitetit Politeknik dhe Universitetit të Tiranës.

UV ka organizuar që nga fillimi konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, duke u bërë një qendër e rëndësishme e shkencës dhe kërkimit në rajon. Bashkëpunimet ndërkombëtare me universitete në Itali, Greqi, Bullgari, Mal të Zi, Norvegji, Gjeorgji dhe vende të tjera kanë mundësuar shkëmbime studentësh, vizita akademike dhe projekte kërkimore të përbashkëta.

Nga një fillim modest me vetëm një kabinet fizike, disa kabinete infermierie dhe një kompjuter, Universiteti sot ka laboratorë të pajisur për Informatikë, Infermieristikë, Navigacion, Inxhinieri Detare, Fizikë, Kimikë, Biologji dhe Studime Ambientale, si dhe teknologji audio-vizive për mësimdhënie. Universiteti tërheq studentë nga e gjithë Shqipëria dhe synon të zhvillohet si një Universitet 4.0, me kapacitete cilësore të avancuara dhe pjesëmarrje aktive në projekte dhe aleanca ndërkombëtare.

Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës është më shumë se një institucion arsimor; ai është një rrugëtim i vazhdueshëm drejt përmirësimit, inovacionit dhe kontributit në zhvillimin e shoqërisë dhe komunitetit akademik, duke ruajtur me krenari traditat e tij dhe duke i dhënë një vizion modern dhe ndërkombëtar arsimit të lartë në Shqipëri.

https://univlora.edu.al/historiku-i-universitetit-ismail-qemali-vlore

REKOMANDIMET E BORDIT TË AKREDITIMIT MBËSHTETUR NË VENDIMIN NR.50, DATË 27.11.2020, "PËR AKREDITIMIN PERIODIK TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË", JANË SI VIJON:

1. Institucioni të mbështesë zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit akademik me metodat më të fundit të mësimdhënies dhe trajnimin e personelit të punësuar rishtazi për pedagogjinë dhe psikologjinë e mësimdhënies.
2. Institucioni të reduktojë ngarkesën teorike dhe të krijojë mundësinë e aftësimit praktik të studentëve në programet e studimit që ofron duke i përshtatur ato me kërkesat e tregut të punës.
3. Institucioni, të përmirësojë strukturën financiare të tij duke diversifikuar burimin e të ardhurave.
4. Institucioni të marrë masa për alokimin e një buxheti specific për kërkimin shkencor dhe përmirësimin e infrastrukturës fizike të Qendrës së Kërkimit Shkencor.
5. Institucioni, të bashkëpunojë më mirë me grupet e interesit për të rritur ndikimin në rajon.
6. Institucioni, të shtojë përpjekjet për ndërkombëtarizim duke aplikuar në projekte kërkimore ndërkombëtare dhe duke ofruar programe studimi në bashkëpunim me IAL Europiane.
7. Institucioni të hartojë një rregullore specifike për Alumni-t, në mënyrë që të forcohet bashkëpunimi me ta.

PLOTËSIMI I REKOMANDIMEVE NGA UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË:

I. Institucioni të mbështesë zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit akademik me metodat më të fundit të mësimdhënies dhe trajnimin e personelit të punësuar rishtazi për pedagogjinë dhe psikologjinë e mësimdhënies.

Në përmbushje të këtij rekomandimit, UV së pari ka identifikuar nevojat dhe së dyti ka ndërmarrë masa konkrete dhe të qëndrueshme për realizimin e tyre gjatë periudhës 2020 e në vazhdim. Konkretisht:

- Janë identifikuar nevojat për trajnime dhe kualifikime të mëtejshme të stafit, të cilat janë përcjelle përmes kërkesave buxhetore të Njësive Bazë dhe atyre Kryesore. Lidhur me këtë kërkesë është parashikuar në buxhet një fond specifik çdo vit për trajnim të stafit brenda dhe jashtë Shqipërisë.
- Nevojat per trajnime lidhur metodat bashkëkohore të mësimdhënies janë identifikuar edhe nëpërmjet pyetësorëve që, plotësojnë studentët në fund të çdo semestri për secilën lëndë dhe janë hartuar rekomandimet përkatëse si dhe planet e veprimit për plotësimin e tyre.

Masat konkrete të ndërmarra nga institucioni për realizimin e këtij rekomandimi:

- Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, ka lidhur mbi 120 marrëveshje ndërinstitucionale me IAL të ndryshme europiane, në kuadër të programit *Erasmus* + KA1 (https://univlora.edu.al/marreveshje-nderinstitucionale). Si rezultat i këtyre marrëveshjeve, një numër i konsiderueshëm i stafit akademik ka kryer mobilitetie për aktivitete *teaching* dhe *training* në këto universitete. Praktikat dhe metodat bashkëkohore të mësimdhënies të fituara gjatë këtyre mobiliteteve janë ndarë me kolegët pas kthimit dhe janë reflektuar në procesin e mësimdhënies (**E.61**). Githashtu, në kuadër të marrëveshjeve ndërinstitucionale të përmendura më sipër janë realizuar seminare, work-shope dhe konferenca të ndryshme me focus edhe në metodat dhe kompetencat e mësimdhënies.

- Në Departamentin e Edukimit është hapur dhe vijon çdo vit kursi për formimin e vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, në të cilin janë trajnuar anëtarë të stafit akademik të UV-së, duke kontribuar në rritjen e kompetencave profesionale, pedagogjike dhe didaktike të tyre **(E.95).**
- UV ka miratuar Strategjinë për Kërkuesit e Rinj (**E.34**) dhe në kuadër të implementimit të saj, janë fituar dhe janë zbatuar projekte kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, përfshirë programe të tilla si (AADF dhe COST Action).

  Workshop: "Bridging ecology and molecular science - to train the next generation of scientists", në kuadër të projektit READ.
  https://univlora.edu.al/njoftime/workshop-ne-kuader-te-projektit-read
- UV ka lidhur marrveshje me Institutin 'Jeta e re' LiderImpakt për trajnimin e stafit akademik dhe administrativ për zhvillim profesional

  https://univlora.edu.al/media/dokument/instituti-jeta-e-re.pdf
  Trajnimi "Public Speaking Sprint", i udhëhequr nga Josh Meakly
  https://univlora.edu.al/njoftime/trajnimi-public-speaking-sprint
- UV është pjesë e rrjetit prestigjioz ETEN "European Teacher Education Network", i fokusuar specifikisht në metodat e mësimdhënies dhe simpoziumi ETEN i këtij viti do të mbahet në Universitetin 'Ismail Qemali' (https://univlora.edu.al/njoftime/eten-symposium-2026---vlore-albania).
- Universiteti gjithashtu siguron mentorimin dhe mbështetjen për pedagogët e rinj, si dhe trajnime, seminare, workshop-e dhe programe për avancim profesional të pedagogëve, duke përfshirë metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies, përdorimin e teknologjive digjitale dhe qasjet inovative në mësimdhënie (**E.61**).

Aktivitete për rritjen e kapaciteteve të personelit akademik dhe jo-akademik të UV-së:

Workshop: "Optimizimi i programeve të studimit të mësuesisë. Sfidat për një edukim cilësor afatgjatë".
https://univlora.edu.al/njoftime/workshop-me-teme-optimizimi-i-programeve-te-studimit-te-mesuesise-sfidat-per-nje-edukim-cilesor-afatgjate;
Takim këshillues në kuadër të projektit "Bologna Hub Peer Support": Zhvillimi i Kurrikukalave; Qasjet Invovative në Mësimdhënie e Mësimnxënie; Mobilitetet dhe Ndërkombëtarizimi.
https://univlora.edu.al/njoftime/takimi-i-pare-keshillues-ne-kuader-te-projektit-bologna-hub-peer-support
Kurs trajnimi shkrim projekti FSHH
https://univlora.edu.al/njoftime/trajnimi-mbi-shkrimin-e-nje-projekt-cilesor-prane-qendres-kerkimore-shkencore-ne-fakultetin-e-shendetit-publik
Minikurse IA FSHTN, me profesorat amerikan dhe diasporë
https://univlora.edu.al/njoftime/nis-mini-course-on-data-sciences-and-ai-ne-universitetin-e-vlores
Trajnim Linnux,
https://univlora.edu.al/njoftime/komandat-e-linux-dhe-hyrje-ne-bash-scripting
Trajnim me specialistë dhe drejtoren e AKKSHI
https://univlora.edu.al/njoftime/programet-nderkombetare-te-kerkimit-dhe-inovacionit
Trajnim për përdorimin e teknologjisë IT
https://classroom.google.com/c/ODE2NTcxNzQ3NjQ2
Manual përdorimi UNVIMAS për pedagogët
https://univlora.edu.al/media/dokument/manual-perdorimi-unvimas-pedagog-2026.pdf

II. Institucioni të reduktojë ngarkesën teorike dhe të krijojë mundësinë e aftësimit praktik të studentëve në programet e studimit që ofron duke i përshtatur ato me kërkesat e tregut të punës.

Në zbatim të këtij rekomandimi, njësitë bazë në Universitetn "Ismail Qemali" kanë ndërmarrë procesin e rishikimit të planeve mësimore për programet që ofrojnë. Si rezultat, është realizuar reduktimi i ngarkesës teorike dhe rritja e komponentit praktik, në përputhje me specifikat e secilit program studimi (**E.106**). Procesi i rishikimit është zhvilluar në konsultim me palë të interesuara të jashtme, përfshirë përfaqësues të tregut të punës dhe Alumnin.

Programet e studimit në UV përfshijnë module praktike, laboratorë dhe praktika profesionale, të cilat janë të strukturuara në mënyrë të qartë në planet mësimore dhe kurrikulat e miratuara.

- Të gjitha programet e fushës së Infermierisë, në të gjitha ciklet e studimit, kanë praktikë laboratorike dhe klinike 50-60% të orëve totale në auditor (**E.110)**.
- Të gjitha programet mësuesisë zhvillojnë praktika profesionale në shkollat e mesme dhe 9-vjeçare (**E.111)**.
- Programi Arkitekturë në Trashëgimi zhvillon një pjesë të konsiderueshme orësh në zona historike, arkeologjike të Vlorës dhe zonave përreth. https://univlora.edu.al/njoftime/nje-dite-te-zakonshme-mesimi-per-studentet-e-programit-shkrenca-arkitekturore-per-trashegimine
- Programet e Navigacionit dhe Infermierisë kanë laboratorë simulatorë në dispozicion (**E.108)**.
- Për programet e Drejtësisë këtë vit është parashikuar krijimi i një salle gjyqi imituese.
- Programet e inxhinierive, veçanërisht MSc në Inxhinieri Armatimi do të kenë mundësi të përdorin Laboratorin e Testimit të Goditjeve, financuar nga MM në ambientet e ish-Shkollës së Aviacionit.
- Për studentët e UV-së nga institucionet bankare, vendore etj, ka pasur ofertë për ofrimin e praktikave me pagesë (**E.85**).

Aktivitetet praktike janë të lidhura ngushtë me përmbajtjen teorike, duke mundësuar që studentët të përforcojnë njohuritë, të zhvillojnë aftësi të zgjidhjes së problemeve, të krijojnë projektim profesional dhe të fitojnë përvojë konkrete në fushën e tyre të specializimit.

E.112: Syllabysi i modulit të Praktikës Profesionale në programin Cikli i Ulët
E.113: Projekt klase në programin BSc në Shkenca Kompiuterike
E.114: Vlerësimi i Praktikës Profesionale: Procesverbal vlerësimi i vazhduar në praktikë; Vërtetimi i shefave të pavioneve për periudhën e praktikës në programet master; Procesverbal vlerësimi në provimin e praktikës profesionale, Tezë provimi e praktikës profesionale.

Po kështu, në funksion të përmbushjes së këtij rekomandimi, institucioni ka zgjeruar rrjetin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione publike dhe private për zhvillimin e praktikave mësimore dhe profesionale. (https://univlora.edu.al/marreveshjet-me-institucionet-brenda-vendit). Ky bashkëpunim kontribuon në përshtatjen e programeve me kërkesat reale të tregut të punës, siguron mundësi për praktikë profesionale dhe projektim të moduleve të aplikimit praktik, si dhe përforcon lidhjen ndërmjet mësimdhënies dhe nevojave profesionale dhe kërkimore të komunitetit.

Universiteti 'Ismail Qemali' ndjek procedura të formalizuara për identifikimin e mundësive të bashkëpunimit me aktorë të fushave të programeve akademike dhe për integrimin e tyre në programe, duke përfshirë:

marrëveshje bashkëpunimi, për zhvillimin e praktikës profesionale – disa prej të cilave janë:

- Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Fier;
- Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Lushnje;

- Shkolla e Drejtorëve të Arsimit Parauniversitar;
- Gjykata e Shkallës së Parë, Vlorë;
- Gjykata Administrative Lushnje;
- Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë Tiranë;
- OST – Operatori i Sistemit të Transmetimit;
- Qendra e Kontrollit Teknik;
- Nasto Inxhiniering Vlorë;
- Shoqëria "TechnoPlastic" shpk;
- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes;
- Drejtoria e Ujësjellës & Kanalizime Vlorë;
- OSHEE – Dega Vlorë;
- Porti Detar Vlorë;
- UBA Bank – Dega Vlorë
- Raiffeizen Bank – Dega Vlorë
- Balfin grup
- Vlora Marina
- Shoqëria "Green Coast Hotel" sh.p.k
- Hotel "Regina Group" sh.p.k;
- Hotel Kral;
- Hotel Partner;
- Drejtoria Rajonale e Operatorit të Kujdesit Shëndetësor, DROKSH
- Spitali Rajonal Vlorë
- Spitali Rajonal Fier
- Spitali Memorial Fier
- Spitali Psikiatrik Vlorë;

III. Përmirësimi i strukturës financiare të institucionit përmes diversifikimit të burimeve të të ardhurave

Në zbatim të këtij rekomandimi, UV ka formalizuar ofrimin dhe shfrytëzimin e rezultateve kërkimore dhe ekspertizës akademike ndaj palëve të treta përmes *Rregullores për shërbimet e ofruara ndaj të tretëve* (**E.11**), e cila disiplinon procedurat e ofrimit të shërbimeve, marrëdhëniet kontraktuale, tarifimin, administrimin financiar dhe shpërndarjen e të ardhurave të gjeneruara. Ky mekanizëm krijon një bazë të qëndrueshme për përdorimin ekonomik të rezultateve kërkimore dhe pronësisë intelektuale në funksion të zhvillimit ekonomik dhe financiar të universitetit sanksionuar dhe në Rregulloren financiare të UV-së (**E.7**: neni 19) si dhe vendimet e Bordit të Administrtimit për miratimin e tarifave për shërbimet ndaj të tretëve (VBA 22/2022; VBA 57/2025). Me synim forcimin e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e pronësisë intelektuale dhe patentimit, UV ka përfshirë në strukturën organizative një specialist të dedikuar për çështjet e pronësisë intelektuale dhe patentave (**E.23**: fq. 86–90).

Në kuadër të forcimit të dimensionit të tretë të universitetit – inovacionit dhe transferimit të njohurive – Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës ka konsoliduar infrastrukturën e nevojshme teknike dhe organizative për nisjen e prodhimit dhe komercializimit të produkteve me markën institucionale UniVlora, në formën e iniciativave *spin-off*.

- Qendra Kërkimore Shkencore e Shkencave të Aplikuara ka nisur bashkëpunimin me biznese italiane për testimin dhe prodhimin në laboratorët e UV të Kremrave Kozmetikë UniVlora, bazuar në bimë mjekësore të kultivuara në Rajonin e Jugut të Shqipërisë.
- Departamenti i Kimisë, UV ka nisur procedurat për prodhimin e Vajrave Esencialë UniVlora, si produkte farmakologjike dhe estetike, si zbatim praktik i Dizertacionit të pedagoges së Departamentit të Kimisë, Dr.Jonida Salihila: "Karakterizimi kimik i

ekstrakteve të disa bimëve mjekësore të vendit tonë me teknika kromatografike" (https://plus-legacy.cobiss.net/cobiss/al/en/bib/2048437545) **(E.175).**

Zbatimi praktik i këtij kuadri dëshmohet gjithashtu dhe përmes iniciativave konkrete si:

- **Nisja e procedurave për mbrojtjen ligjore dhe patentimin e sistemit informatik UNVIMAS (UNiversity VIrtual MAnagement System)** gjatë vitit 2025, si praktikë e parë e dokumentuar e mbrojtjes së pronësisë intelektuale të një produkti inovativ të zhvilluar brenda institucionit **(E.77);**
- **Nisja e procedurave për licencimin e shërbimeve laboratorike dhe kërkimore** nga qendrat kërkimore-shkencore dhe laboratorët e universiteteve, përfshirë procedurat e akreditimit të shërbimeve në Qendrën Kërkimore Shkencore të FSHTN, në funksion të garantimit të cilësisë dhe njohjes formale të shërbimeve të ofruara ndaj të tretëve **(E.123).**
- Paralelisht, UniVlora Scientific Journal (https://uvjournals.univlora.edu.al/), në vijim të procesit të rritjes së cilësisë dhe ndërkombëtarizimit, synon pas indeksimit në platforma prestigjioze ndërkombëtare të aplikojë një tarifë publikimi (Article Processing Charge – APC) për artikujt e pranuar. Ky hap përbën një praktikë të zakonshme në revistat e indeksuara dhe do të kontribuojë në garantimin e qëndrueshmërisë financiare, rritjen e standardeve editoriale dhe forcimin e pozicionimit të revistës në hapësirën akademike ndërkombëtare.

Aktualisht, shfrytëzimi ekonomik dhe financiar i rezultateve kërkimore nuk realizohet ende përmes patentave të regjistruara, pasi institucionit ndodhet në fazën e licencimit/patentimit dhe ndjekjes së procedurave për mbrojtjen ligjore të produkteve inovative. Megjithatë, Universiteti gjeneron përfitim ekonomik konkret përmes ofrimit të shërbimeve ndaj palëve të treta, të bazuara në ekspertizën akademike dhe kapacitetet kërkimore, si:

- Shërbime profesionale për verifikimin e plagjiaturës për subjekte të treta **(E.153)**
- Aktivitete trajnuese LLL me mikrokredenciale me pagesë **(E.96);**
  - trajnime profesionale (*trajnim Linnux*), https://univlora.edu.al/njoftime/komandat-e-linux-dhe-hyrje-ne-bash-scripting
  - konferenca me kredite të çertifikuara nga institucione vlerësuese kombëtare (*konferencë infermier, mësues*) https://univlora.edu.al/njoftime/konferenca-i-nderkombetare-shkencore-epidemia-e-heshtur-e-semundjeve-jo-te-transmetueshme https://univlora.edu.al/njoftime/konferenca-nderkombetare-me-temen-ndertimi-i-kompetencave-mikrokreditet-per-rritjen-dhe-ekselencen-ecred4teach-mesuesve
  - **E.95:** Modul çertifikimi për formimin e vazhduar në fushën psiko-pedagogjike + plani mësimor DE-FSHH; shkolla e Drejtorëve FSHH,
  - module me mikrokredenciale (*Credits for Teachers (https://cred4teach.univlora.edu.al/)*

të përshtatura sipas kërkesave të tregut të punës dhe tendencave aktuale akademike.

Si rezultat i menaxhimit më të mirë të mbledhjes së të ardhurave dhe diversifikimit të burimeve të të ardhurave institucionale, në fund të vitit buxhetor 2025 Universiteti 'Ismail Qemali' arkëtoi mbi 10% të ardhura më tepër se viti paraardhës.

IV. Marrja e masave për alokimin e një buxheti specifik për kërkimin shkencor dhe përmirësimin e infrastrukturës fizike të qendrës së kërkimit shkencor.

Në zbatim të rekomandimit të katërt të Bordit të Akreditimit, Universiteti i Vlorës ofron mbështetje të qëndrueshme për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore dhe artistike, nëpërmjet:

- sigurimit të financimeve kombëtare (AKKSHI) dhe ndërkombëtare për realizimin e projekteve shkencore të stafit të UV-së;
- mbështetjes financiare të brendshme (**E.26,** fq.47) për projekte kërkim-zhvillimi të financuara nga UV (PKZHUV). Theksojmë se financimi është rritur nga 14 milionë ALL në vitin 2025 në 19.2 milionë ALL në vitin 2026. Shpërndarja e buxhetit bëhet e specifikuar për çdo departament, qendër kërkimore-shkencore, si dhe për QZHR-në;
- mbështetjes financiare për shkrim projektesh, botim artikujsh në revista Scopus/WoS, botime në buletinet shkencore të UV-së dhe tarifa pjesëmarrjeje në konferenca të rregulluar sipas vendimeve të Senatit akademik VSA 17/2021, VBA 45/2025, VSA 75/2017 i ndryshuar me VSA 2/2024 dhe VSA 66/2024;
- mbështetjes institucionale dhe financiare për përfshirje në rrjete institucionale dhe organizime, të cilat krijojnë mundësi për pjesëmarrje në projekte (ETEN, UNIMED, CMU, EUCEN, ASECU) **(E.135)**
- mbështetjes financiare për ngritje, pasurim dhe mirëmbajtje laboratorësh kërkimorë. Infrastruktura kërkimore përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme përmes investimeve dhe rialokimeve buxhetore. Për periudhën 2021–2025, UV ka realizuar investime në pajisje/materiale laboratorike në vlerën *15,861,870 lekë*, ndërsa investimet e siguruara në kuadër të projekteve jashtë buxhetit të UV-së janë në vlerën *79,717,624 lekë* **(E.131), (E.132).**

  Universiteti ka siguruar financime shtesë për përmirësimin e infrastrukturës kërkimore përmes fitimit të disa projekteve infrastrukturore të financuara nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), si dhe përmes projekteve me fonde të Bashkimit Europian, të cilat synojnë modernizimin dhe forcimin e kapaciteteve infrastrukturore të qendrave kërkimore shkencore në nivel fakulteti.

Mbështetja financiare për veprimtarinë kërkimore shkencore (2021–2025)

Nr	*Emërtimi*	(2021-2025)
	Shpenzime për kërkimin shkencor me financim të brendshëm	ALL
1	Finacim Projekte UV	46,000,000
2	Udhëtim jashtë shtetit	12,000,000
3	Bashkëfinancim për Projektet me Finacim të huaj	34,168,294
4	Shpenzime për organizim konferenca kërkimore shkencore	54,679,834
5	Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca, rimbursim artikujsh	18,200,000
6	Bashkëfinancim për Projektet me Finacim nga AKKSHI	2,000,000
7	Shkrim Hartim Projektsh	16,521,800
	Totali	**183,569,928**
	Shpenzime për kërkimin shkencor me financim të huaj	
1	Projektet me financim të huaj	157,584,986
2	Projekte të financuara nga AKKSHI	14,107,998
	Totali	**171,692,984**
	Financimi i kërkimit shkencor në UV gjatë 2021-2025	**355,262,912**

V. Forcimi i bashkëpunimit të institucionit me grupet e interesit, me qëllim rritjen e ndikimit në nivel rajonal.

Në zbatim të rekomandimit të pestë të Bordit të Akreditimit, Universiteti 'Ismail Qemali' ka intensifikuar bashkëpunimin me grupet e interesit në nivel rajonal, me synim rritjen e rolit të tij si pasuri komunitare dhe Qendër Zhvillimi Rajonal. Në këtë kuadër, institucioni ka lidhur marrveshje (https://univlora.edu.al/marreveshjet-me-institucionet-brenda-vendit) dhe ka organizuar tryeza të rrumbullakëta dhe takime konsultative me përfaqësues të grupeve të interesit, të fokusuara në identifikimin e problematikave që kërkojnë ndërhyrje dhe në shkëmbimin e ideve për zgjidhje konkrete. Gjithashtu, ka bashkëpunuar me aktorë publikë dhe privatë përmes aplikimit dhe zbatimit të projekteve të përbashkëta, si p.sh. projekte në fushën e shëndetësisë, inovacionit dhe zhvillimit ekonomik. Institucioni ka organizuar dhe ka marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta shkencore dhe akademike me partnerë rajonalë dhe kombëtarë, si dhe ka kontribuar në organizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe informuese në kuadër të ditëve ndërkombëtare që lidhen me çështje të shëndetit publik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Në funksion të përmbushjes së misionit social dhe rritjes së ndikimit në komunitet, Universiteti i Vlorës ka organizuar gjithashtu një sërë aktivitetesh të suportit social dhe bamirësisë, me përfshirjen aktive të stafit akademik dhe studentëve, në institucione të tilla si qendrat e kujdesit për të moshuarit, spitali psikiatrik, shtëpia e fëmijëve dhe struktura të tjera sociale.

Disa prej aktivitete socio-kulturore me impakt komunitar, të organizuar nga UV në bashkëpunim me grupet e interesit.

- Promovimi i përdorimit sistematik të qasjes administrative për të luftuar krimin e organizuar në Shqipëri – bashkëpunim me Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG): https://univlora.edu.al/njoftime/promoting-the-systematic-use-of-the-administrative-approach-to-combat-organized-crime-in-albania
- Dita Botërore e Ligatinave – në bashkëpunim me Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura, Vlorë (AdZM) https://univlora.edu.al/njoftime/dita-boterore-e-ligatinave
- 103-vjetori i Ditës Kombëtare të Shërbimit Pyjor – në bashkëpunim me Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura, Vlorë (AdZM) https://univlora.edu.al/njoftime/aktivitet-i-departamentit-te-kimise-per-103-vjetorin-e-dites-kombetare-te-sherbimit-pyjor
- Praktika në Biologji Mjedisore - në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, Vlorë; Administratën Rajonale të Zonave të Mbrotjura, Vlorë (AdZM); Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Vlorë; Qendrën e Tranferimit të Teknologjive Bujqësore, Lushnjë; Qendrën e tranferimit të teknologjive bujqësore, Vlorë; Teknoplastika, Vlorë; Petroliferën Italo-Shqiptare; Lungomare Vlorë; Peizazhi i Mbrojtur (kategoria V), Pishë Poro-Nartë. https://univlora.edu.al/njoftime/studentet-e-masterit-shkencor-ne-biologji-mjedisore-realizuan-me-sukses-praktikat-dy-javore
- Informimi, Parandalimi, Mbrojtja: Qasja Europiane ndaj Kancerit të Qafës së Mitrës dhe Roli i edukimit shëndetësor - në bashkëpunim me repartin e Onkologjisë, Spitali Rajonal Vlorë https://univlora.edu.al/njoftime/parandalimi-qe-ka-fuqine-te-shpetoje-jete
- Dita Ndërkombëtare e bankave – takim me stakeholders bankarë: https://univlora.edu.al/njoftime/aktivitet-dita-nderkombetare-e-bankave
- Studentët e UniVlorës në Kuvendin e Shqipërisë

https://univlora.edu.al/njoftime/studentet-e-univlores-ne-kuvendin-e-shqiperise

- Shërbime shëndetësore komunitare https://univlora.edu.al/njoftime/vullnetarizem-ne-sherbim-te-komunitetit-nga-keshilli-studentor
- Projektet Smart City - në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë https://univlora.edu.al/njoftime/smart-city-hub
- Bisedë e hapur me të rinj universitarë dhe të shkollave të mesme – për Lefter Çipa https://univlora.edu.al/njoftime/biri-rrefen-atin---aktitiviteti-ne-nder-te-artistit-lefter-cipa
- Bisedë e hapur me të rinj universitarë dhe të shkollave të mesme - Naxhi Kasoruho https://univlora.edu.al/njoftime/takim-me-muzikologun-naxhi-kasoruho
- Aktiviteti "Dhuro Gjak" nga Fakulteti i Shëndetit - në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Vlorë https://univlora.edu.al/njoftime/aktiviteti-periodik-dhuro-gjak-i-ndermarre-nga-fakultetit-te-infermierise
- Dita Botërore e Shëndetit https://univlora.edu.al/njoftime/dita-boterore-e-shendetit-2025
- Aktivitet ndërgjegjësues nga Fakulteti i Shëndetit: "Përkujto - Mbështet - Vepro" https://univlora.edu.al/njoftime/ne-date-18-11-2022-departamenti-i-kujdesit-shendetesor-fakulteti-i-shendetit-organizoi-nje-aktivitet-me-karakter-edukues
- Dita Ndërkombëtare e Shkopit të Bardhë https://univlora.edu.al/njoftime/dita-nderkombetare-e-shkopit-te-bardhe

Në përfundim, politika e zhvillimit social e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë kontribuon në krijimin e një mjedisi akademik të shëndetshëm, gjithëpërfshirës dhe dinamik, duke mbështetur zhvillimin integral të individit dhe përmbushjen e misionit institucional në funksion të shoqërisë.

VI. Rritja e përpjekjeve për ndërkombëtarizim përmes projekteve kërkimore ndërkombëtare dhe ofrimit të programeve të studimit në bashkëpunim me IAL-të europiane

Projekte kërkimore ndërkombëtare 2020-2025

UV ka treguar bashkëpunim të qëndrueshëm kërkimor me institucione të arsimit të lartë nga vendet e BE-së, OECD-së dhe G20-s, të dokumentuar përmes:

- Marrëveshjeve të Mirëkuptimit (MoU) - https://univlora.edu.al/marreveshje-mirekuptimi
- Inter-Institutional Agreements (IIA) - https://univlora.edu.al/marreveshje-nderinstitucionale

Aktualisht, universiteti ka **120 MoU aktive** dhe **164 IIA**, si dhe ka implementuar mbi **25 projekte ndërkombëtare** vetëm në 5 vitet e fundit. Bashkëpunimet shtrihen në Itali, Greqi, Norvegji, Belgjikë, Spanjë, Finlandë, Francë, SHBA, si dhe në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Mesdheut.
https://univlora.edu.al/projekte-nderkombetare

Aplikime në thirrje ndërkombëtare në fushën e kërkimit

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë dëshmon një angazhim të qëndrueshëm, aktiv dhe konkurrues në thirrje ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor, përmes aplikimeve të rregullta në programe prestigjioze si Horizon Europe, Erasmus+, COST Actions, Interreg dhe IPA CBC, si dhe programe të tjera ndërkombëtare të financimit, në bashkëpunim me institucione partnere akademike dhe kërkimore nga vendet e Bashkimit Evropian dhe më gjerë.

Tabela më poshtë paraqet në mënyrë të strukturuar angazhimin konkret të stafit akademik dhe administrativ të UV-së në përgatitjen dhe dorëzimin e aplikimeve për projekte kërkimore dhe zhvillimore gjatë periudhës 2024–2025 dhe 2025–2026. Si shihet, vetëm në dy vitet e fundit Universiteti 'Ismail Qemali' ka dorëzuar 51 aplikime në programe të ndryshme në BE, ndërkohë që aplikime të tjera janë në fazë përfundimtare dhe pritet të finalizohen me dorëzimin e tyre brenda afateve zyrtare të thirrjeve përkatëse.

Kjo databazë përditësohet rregullisht nga SKSH&P duke shërbyer si një instrument monitorimi dhe analize për vlerësimin e performancës së stafit të universitetit në këtë aks strategjik, si dhe si tregues i kapaciteteve institucionale të UV-së për pjesëmarrje aktive në skemat konkurruese ndërkombëtare të financimit të kërkimit

No	Date	Program	Acronym	Coordinator
1	21.11.2024	CEEPUS		University of Novi Sad, Serbia
2	18.11.2024	HORIZON EUROPE	Children_First	Cyprus University of Technology
3	18.12.2024	SMP-COSME-2024-SEE-01	SLATE	Associacao Promotora Da Rede Dinamica Xxi Potugal
4	02.12.2024	EIT HEI	M4EUS	Mersin University, Turkey
5	17.01.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	NEED2CRED	University of Leon, Spain
6	31.01.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	CIRCLE	Chieti Pesacara. Italy
8	31.01.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	SFF Startup WBunis	International Burch University, Bosnie Hercegovina
9	31.01.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	GREEN-PACT	UV
10	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	U-TURN	University of Banja Luka, Bosnie
11	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	MindFulU	University of Montenegro
12	04.02.2025	EIT Raw materials	MMI	Polytechnic Univesrity of Tirana
13	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	NURTURE	Royal college of surgeons in Ireland
14	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	Eco-STEM	Organizata Drite, Kosove
15	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	GREENSTEP	UV
16	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	ROMOLOGY	University of Montenegro
17	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	GREEN	Univesrity of Saraievo, Bosna
18	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	DataVoyage	University of Montenegro
19	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	DETECH	University of Montenegro
20	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	TALENT	University of Novi Sad, Serbia
21	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	U-WELL	Napolis university of Pafos
22	06.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	BRIDGE2E	Thomas More Univesrity of Applied Sciences
23	06.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	WIKADIH	CEPS - University college for business studies
24	06.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	CIRECON	University of East Srajevo
25	06.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	PaLVR	Aristoteli Universty
26	10.02.2025	ERASMUS-EDU-2025 JMO-MODULE	WB-EU-path	UV
27	07.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	Cyberimpact	Polytechnic Univesrity of Tirana
28	07.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	WB-STEAME	University of Krakow, Poland
29	10.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	ACESS-ABLE	Kolegji AAB Kosovo
31	12.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	CIRC-ECOFURN	University of Thessalias, Greece
32	20.02.2025	ERASMUS+ KA220-HED	MINDSET	Mindrove, Gyor, Hungary
33	06.03.2025	ERASMUS-2025- CB-VET	NEXTLEVEL	CINOP BV, HOLAND
34	06.03.2025	ERASMUS-2025- CB-VET	STM-Tourism	Sinop university, Turkey
35	10.03.2025	ERASMUS-YOUTH 2025-CB	LearnEO	Helathy City Split HR
36	02.04.2025	Programit Interreg NEXT MED 21-27	CHILDREN FIRST	Cyprus University of Technology
37	04.04.2025	Interreg VI-A IPA CBC Programme, Greece-Albania 2021-2027	YouthUp	hellenic reulatory body of nurses, Gr
38	06.04.2025	Europeaid/183647/ID/ACT/AL(Life Skills: Advancing 21st-Century Skills and Career Guidance in Albanian Schools)	Life Skills	British Council, officially registered in Albania through its Albania Branch
39	09.06.2025	Interreg IPA ADRION (Adriatic-Ionian)	HEALTOUR	UV
40	09.06.2025	Interreg IPA ADRION (Adriatic-Ionian)	PRENCO	
41	09.06.2025	ERASMUS-EDU-2025-PEX-COVE,	REGEN-VET	
42	08.09.2025	HORIZON-CL2-2025-01	SHIFT	

43	29.09.2025	HORIZON-HLTH-2025-01	(ACTS)	University Medical center Hamburg, Germany
44	10.10.2025	HORIZON-CL4-2025-04-HUMAN-08	GenAI for Africa	HELLENIC OPEN UNIVERSITY
45	11.11.2025	HORIZON-NEB-2025-01-REGEN-01	RegenSynergy	UNIVERSITY OF CUKUROVA
46	27.11.2025	HORIZON-MSCA-2025-DN-01	CHILDRENFIRST	Cyprus University of technology
47	27.11.2025	HORIZON-WIDERA-2025-01-ACCESS-01 European Excellence Initiative (EEI)	RISE4HE	Mersin University
48	23.12.2026	ERASMUS-EDU-2026-CBHE	GREENSTEP	UV
49	23.12.2026	ERASMUS-EDU-2026-CBHE	Bridge2E	
50	21.01.2026	ERASMUS-EDU-2026-CBHE	TWICE	
51	26.01.2026	ERASMUS-EDU-2026 -JMO-MODULE	CLIM-AL-EU	UV

Programe studimi në gjuhën angleze – të ofruara nga UV ose në bashkëpunim me IAL-të europiane

Universiteti 'Ismail Qemali' ofron programe studimi të përbashkëta me universitete ndërkombëtare dhe programe në gjuhë angleze, duke ofruar mundësi edukimi për edhe studentë ndërkombëtarë:

Cikli i Studimit	*Tipi i diplomës*	*Emërtimi*	*Universiteti Partner*
Bachelor	Joint Degree	Architecture Sciences for Heritage	**Universiteti Politeknik i Barit, Itali**
	Albanian degree	Compiuter Science	
	Albanian degree	General Nursing	
	Double Degree	Mechanical Engineering	**Universiteti Politeknik i Barit, Itali**
	Double Degree	Electric Engineering	**Universiteti Politeknik i Barit, Itali**
	Double Degree	Marine Engineering	**Universiteti Politeknik i Barit, Itali**
	Joint Degree	Applied linguistic in Tourism	**Universiteti i Salentos, Itali**
	Albanian degree	English language	
Master	Joint Degree	Maritime Environment Protection and Management – MEP&M	**Universiteti i Malit të Zi,** Universiteti i Durrësit
	Albanian degree	Teaching in CLAB	
	Albanian degree	Translation and Interpreting	

Informacioni për to gjendet edhe në faqen zyrtare të UV-së:

Programet double degree
https://univlora.edu.al/programeten/DD
Programet joint degree
https://univlora.edu.al/programeten/JD
Programet English-speaking
https://univlora.edu.al/programeten/JD

Studentët ndërkombëtarë të UV-së

Universiteti 'Ismail Qemali'i kushton rëndësi të veçantë mobilitetit akademik dhe shkëmbimit të studentëve përmes programeve ndërkombëtare, veçanërisht programit ERASMUS+, duke krijuar mundësi për përfitimin e përvojave akademike dhe kulturore ndërkombëtare.

E.182: Procedurë e plotë për studentët Erasmus+ hyrës

Përveç studentëve që përfitojnë nga programet Erasmus, një kategori tjetër studentësh janë edhe studentët e huaj apo shqiptarë që kanë përfunduar ose kanë vazhduar studimet në një shtet tjetër (studentët ndërkombëtarë). Viti akademik 2025-2026 ka shënuar vitin e parë historik, gjatë të cilit Universiteti 'Ismail Qemali' rregjistroi për herë të parë studentë ndërkombëtarë në dy programe studimi: BSc in Architecture Sciences for Heritage dhe MSc in Maritime Environment Protection and Management – MEP&M.

E.183: Procedurë e plotë për përzgjedhjen e studentëve ndërkombëtarë

E.119: Lista e studentëve të rregjistruar në BSc in Architecture Sciences for Heritage; MSc in Maritime Environment Protection and Management – MEP

Në këtë mënyrë, Universiteti i Vlorës demonstron angazhimin e tij për një proces pranimi të standardizuar, gjithëpërfshirës dhe në përputhje me kërkesat e sigurimit të cilësisë dhe akreditimit institucional.

Më i plotë, ky argument gjendet në Standardin IV.5, IV.12 dhe III.17.

VII. Hartimi dhe zbatimi i një rregulloreje specifike për Alumnin, me qëllim forcimin e bashkëpunimit me ta.

Universiteti 'Ismail Qemali' ka miratuar "Rregulloren e Bashkëpunimit të studentëve Alumni me UV", të miratuar me vendim SA, nr.65, dt.26.06.2025

(https://univlora.edu.al/media/dokument/92025rregullore-alumni-2025.pdf).
Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë marrëdhënien dhe bashkëpunimin ndërmjet Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali" (në vijim: UV) dhe rrjetit të ish-studentëve (Alumni).

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë përmes Sektorit të Karrierës, Shërbimit të studentëve dhe Alumnit, synon të krijojë një mjedis gjithëpërfshirës që promovon barazinë, vlerëson diversitetin dhe ruan dinjitetin e të gjithë anëtarëve të komunitetit universitar. Kjo rregullore zbatohet në të gjitha aktivitetet e organizuara nga Sektori i Alumnit, duke përfshirë ngjarjet, komunikimet dhe përfitimet e ofruara për alumnit dhe mbështetësit.

Rrjeti Alumni është një organizim joformal, por i strukturuar, që përfaqëson interesat e ish-studentëve të UV-së. Koordinimi i marrëdhënieve dhe database i kontakteve dhe aktiviteteve të tyre bëhet nga Sektorit të Karrierës, Shërbimit të Studentëve dhe Alumnit (SKSSA) në Universitetin "Ismail Qemali". Ky Sektor është përgjegjës për:

- Mbledhjen dhe përditësimin e të dhënave të alumnit,
- Organizimin e aktiviteteve dhe eventeve,
- Menaxhimin e platformës dixhitale të alumnit,

Faqja zyrtare e UV-së ka një sektor të posatshëm, të dedikuar për alumni (https://univlora.edu.al/alumni), në të cilin gjendet:

- Rregullorja specifike e UV-së për mbajtjen e marrdhënieve me alumnin, https://univlora.edu.al/media/dokument/92025rregullore-alumni-2025.pdf
- Databazë e përditësuar e ish-studentëve sipas programeve dhe viteve akademike
- Rrjeti Alumni UV - formulari i aplikimit të alumnit për tu rregjistruar në database-n e Alumni UV,

shtojca 1 - Formular Regjistrimi për Alumni
https://univlora.edu.al/media/dokument/formular-alumni.pdf

- Alumni UV të suksesshëm, etj.
  https://univlora.edu.al/alumni

Alumnit e diplomuar gjatë periudhës 31 vjeçarë të funksionimit të Universitetit "Ismail Qemali" janë pjesë integrale e institucionit tonë akademik si:

- Pedagogë me kohë të plotë në UV (shumë prej tyre edhe në pozicione drejtuesish)
- Pedagogë me kohë të pjesshme në UV: lektorë, seminaristë dhe monitorues e tutorë të studentëve aktualë në institucionet e praktikës
- Personel ndihmës-akademik me kohë të plotë në UV
- Stakeholders në tryezat e përbashkëta të organizuara nga UV
- Aktorë kryesorë në projektet e realizuara nga UV.

Institucioni nxit pjesëmarrjen e ish-studentëve në aktivitete akademike, profesionale dhe promovuese, si leksione të hapura, konferenca, panele diskutimi, duke kontribuar në ndarjen e përvojave profesionale dhe forcimin e lidhjes universitet–treg pune.

Konferenca, panele diskutimi, leksione të hapura me ish-studentë të ftuar

Dita Ndërkombëtare e Kontabilitetit
https://univlora.edu.al/njoftime/dita-nderkombetare-e-kontabilitetit-2025
Dita Ndërkombëtare e Bankave
https://univlora.edu.al/njoftime/aktivitet-dita-nderkombetare-e-bankave
Leksioni i hapur nga **PhD. Juljana Xhindoli** dhe **Dr. Juliana Cuni:** "Informimi, Parandalimi, Mbrojtja: Qasja Europiane ndaj Kancerit të Qafës së Mitrës dhe Roli i edukimit shëndetësor"
https://univlora.edu.al/njoftime/parandalimi-qe-ka-fuqine-te-shpetoje-jete
Career Day - Fakulteti i Ekonomisë
https://univlora.edu.al/njoftime/-career-day-fakulteti-i-ekonomise
Work-shop: "Eksplorimi i strategjive për reduktimin e Burnout-it tek studentët e Fakultetit të Shëndetit"
https://univlora.edu.al/njoftime/workshop-mbi-reduktimin-e-burnout-it-tek-studentet-e-fsh

E.203: Kontributi i ish-studentëve në mentorimin e studentëve aktualë (udhëheqës praktikash)

Lidhja me ish-studentët realizohet përmes strukturave dhe kanaleve të dedikuara të komunikimit, përfshirë databaza të të diplomuarve dhe platforma digjitale të cilat shërbejnë për informimin mbi aktivitetet institucionale, mundësitë e bashkëpunimit dhe zhvillimet akademike.

Procedura për mbledhjen dhe përditësimin e kontakteve të të diplomuarve

E.204: Kërkesë ISKSH për Statistika mbi punësimin e ish-studentëve

Në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm, institucioni mbledh dhe analizon feedback-un e ish-studentëve mbi përgatitjen akademike dhe përvojën e tyre universitare, si dhe monitoron ecurinë e punësimit të të diplomuarve. Këto të dhëna përdoren për rishikimin e programeve të studimit, forcimin e shërbimeve të karrierës dhe rritjen e relevancës së ofertës akademike të UV-së.

Raport Alumni 2025
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/05/raport-Alumni-2025.pdf
Rekomandimet e raportit Alumni 2025
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/05/REKOMANDIMET-PYETESOR-ALUMNI.pdf

Më i plotë, ky argument gjendet në Standardin V.9.

I – INSTITUCIONI I ARSIMIT TË LARTË, MENAXHIMI, AUTONOMIA DHE SIGURIMI I CILËSISË

Standardi I.1 Institucioni dhe strukturat e tij funksionojnë në përputhje me statutin e institucionit.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ushtron veprimtarinë e tij akademike, administrative dhe financiare në përputhje me Statutin e institucionit, i cili përbën aktin themelor rregullator të funksionimit institucional. Statuti përcakton qartë misionin, organizimin, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet strukturave drejtuese, akademike dhe administrative, duke garantuar një qeverisje universitare të qëndrueshme dhe transparente *(https://univlora.edu.al/legjislacioni)*.

E.1: Statuti i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë 2025
E.2: Statuti UV 2019
E.3: Vendimi për miratimin e strukturës organizative të UV-së (organigramë institucionale). Vendimi i Senatit Akademik për miratimin/ndryshimin e Statutit. Vendimi i Bordit të Administrimit për miratimin/ndryshimin e Statutit.Miratimi i Statutit UV nga MA

Strukturat drejtuese të universitetit, përfshirë Senatin Akademik, Rektorin, Rektoratin dhe Bordin e Administrimit, janë të ndërtuara dhe funksionojnë në përputhje me parashikimet statutore dhe legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë. Këto organe ushtrojnë kompetencat e tyre përkatëse në mënyrë të koordinuar, duke siguruar ndarjen e përgjegjësive dhe respektimin e hierarkisë institucionale në proceset vendimmarrëse.

E.4: Rregullorja e përgjithshme e UV-së
E.5: Rregullorja e funksionimit të SA

Vendime dhe procesverbale të Senatit Akademik, që dëshmojnë ushtrimin e kompetencave statutore: miratimi i kuotave, raportit vjetor, strategjisë, buxhetit

Vendim Senati Nr.12, datë 10.03.2023
"Për miratimin e kuotave të Pranimit të studimeve në të gjitha ciklet e studimit 2023-2024"
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Vendim-Senati-Nr.-12-date-10.03.2023-Per-miratimin-e-kuotave-te-Pranimit-te-studimeve-ne-te-gjitha-ciklet-e-studimit-2023-2024.pdf
Vendim Senati Nr. 60, datë 19.12.2022
"Për miratimin e raportit vjetor të veprimtarisë së UV"
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Vendim-Senati-Nr.-60-date-19.12.2022-Per-miratimin-e-raportit-vjetor-te-veprimtarise-se-UV.pdf
Vendim Senati Nr. 5, datë 21.02.2024
"Për miratimin e kritereve të pranimit të studentëve në të gjitha ciklet e studimit për vitin akademik 2025-2026
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/04/Vendim-Nr.-5-Senati-Akademik-2024.pdf
Vendim Senati Nr. 120, datë 05.12.2025
Për miratimin paraprak të planit të veprimit dhe planit financiar të UV-së për periudhën 2025-2030
https://univlora.edu.al/media/dokument/vsa120-2025.pdf
Vendim Senati Nr. 5, datë 21.02.2024
Për miratimin paraprak të projekt-buxhetit për vitin 2024 të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/04/Vendim-Nr.-5-Senati-Akademik-2024.pdf

Vendime dhe procesverbale të Bordit të Administrimit, që dëshmojnë ushtrimin e kompetencave statutore: raportit vjetor, strategjisë, buxhetit

Vendim Bordi Nr. 22, datë 12.03.2025
"Për miratimin e buxhetit të Universitetit "Ismail Qemali",
file:///C:/Users/User/Downloads/a12%20(1).pdf

Vendim Bordi Nr. 96, datë 18.12.2025
"Për miratimin e raportit vjetor të veprimtarisë së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë për vitin akademik 2024-2025"
https://univlora.edu.al/media/dokument/vba96-2025.pdf
Vendim Bordi Nr. 95, datë 18.12.2025
"Për miratimin e strategjisë të zhvillimit institucional 2025-2030 të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë"
https://univlora.edu.al/media/dokument/vba95-2025.pdf



Organigrama e UV-së, e miratuar në SA, BA dhe MA
https://univlora.edu.al/organigrama

UV-ja përbëhet nga këto njësi kryesore (**E.1** neni 9, pika 4):

a) Fakulteti i Ekonomisë;
b) Fakulteti i Shkencave Humane;
c) Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore;
d) Fakulteti i Shëndetit.

UV-ja përbëhet nga këto njësi bazë (**E.1**, neni 10, pika 4):

Fakulteti Shkencave Humane:
1) Departamenti i Drejtësisë;
2) Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë;
3) Departamenti i Edukimit;
4) Departamenti i Gjuhëve të Huaja;

Fakulteti i Ekonomisë:
1) Departamenti i Biznesit;
2) Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit;
3) Departamenti i Ekonomiksit;

Fakulteti i Shëndetit:
1) Departamenti i Infermierisë;
2) Departamenti i Kujdesit Shëndetësor;

3) Qendra kërkimore- shkencore e Shëndetit Publik;

Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore:

1) Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare;
2) Departamenti i Shkencave Detare;
3) Departamenti i Biologjisë;
4) Departamenti i Matematikës dhe Fizikës;
5) Departamenti i Shkencave Kompjuterike;
6) Departamenti i Kimisë.

Në UV funksionojnë këto qendra kërkimore-shkencore (**E.1** neni 11, pika 2):

1) Qendra kërkimore - shkencore në Shkencat e Aplikuara;
2) Qendra kërkimore - shkencore për Inovacion dhe Teknologji;
3) Qendra kërkimore - shkencore e Shëndetit Publik;
4) Qendra kërkimore - shkencore e Albanologjisë dhe Ballkanistikës.

Departamentet e UV-së kanë në përbërje së paku 7 anëtarë, personel akademik me kohë të plotë, ku së paku 3 prej tyre kanë grada shkencore/tituj akademikë (**E.1**, neni 10, pika 3).
Fakultetet e UV-së kanë së paku 3 departamente dhe secila nga një qendër kërkimore-shkencore. Fakulteti i Shëndetit ka dy departamente dhe qendra kërkimore-shkencore e tij plotëson kriteret e njësisë bazë, me 9 staf akademik të brendshëm dhe 6 prej tyre me tituj dhe grada shkencore.

Njësitë akademike bazë dhe kryesore funksionojnë mbi bazën e strukturave të miratuara dhe rregulloreve përkatëse, të cilat operacionalizojnë dispozitat e Statutit në nivel fakulteti dhe departamenti. Proceset akademike, përfshirë organizimin e mësimdhënies, kërkimin shkencor dhe vlerësimin e veprimtarisë akademike, realizohen sipas rregullave të brendshme dhe kompetencave të përcaktuara në Statut (**E.1**.)

Vendim Senati Nr.14, datë 09.01.2020
"Për miratimin e rregullores së fakultetit të Shkencave Humane"
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2020/01/Vendim-Nr.-14-Dt.-09.01.2020.pdf
Vendim Senati Nr.12, datë 09.01.2020
"Për miratimin e rregullores së Departamentit të Ekonomiks "
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2020/01/Vendim-Nr.-12-Dt.-09.01.2020.pdf

E.6*:* Vendime për emërimin e drejtuesve akademikë (dekanë, zëvendësdekanë, përgjegjës departamenti), sipas procedurave statutore.

Institucioni ka miratuar një sërë aktesh nënligjore dhe rregulloresh të brendshme specifike, të cilat sigurojnë zbatimin praktik të Statutit dhe harmonizimin e veprimtarisë institucionale me kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar.

E.7: Rregullore financiare e UV-së
E.8: Rregullore e funksionimit të Bordit të Administrimit të UV-së
E.9: Rregullore për krijimin dhe rregjistrimin e dokumentave
E.10: Rregullore UNVIMAS
E.11: Rregullore për shërbimet ndaj të tretëve
E.12: Rregullore Erasmus+
E.13: Rregullore për studentët ndërkombëtarë
E.14: Rregullore për mediat sociale të UV-së
E.15: Rregullore për Laboratorin Multimedial UniVlora
E.16: Rregullore e botimit të Revistave Shkencore të UV-së
E.17: Rregulloren e Etikës së Kërkimit Shkencor dhe Publikimit në UV
E.18: Rregullore për projektet PKZHUV
E.19: Rregullore për organizimin e zgjedhjeve në UV-së
E.20: Rregullore për akordimin e titullit Profesor Emeritus
E.21: Rregullore për përdorimin e programeve kompiuterike për detektimin e plagjiaturës
E.22: Udhëzues etik për AI në UV-së

Kodi Etikës në UV
https://univlora.edu.al/keshilli-i-etikes

Standardi I.2 Institucioni organizohet në mënyrë të tillë që të sigurojë eficiencë në menaxhim.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë vlerëson se organizimi i tij institucional është ndërtuar për të garantuar një menaxhim eficient të burimeve njerëzore, financiare dhe infrastrukturore, në përputhje me misionin dhe objektivat strategjikë të institucionit. Struktura e brendshme e UV-së është e ndërtuar në zbatim të Udhëzimit Nr.27, dt.29.12.2017 për 'Strukturat e brendshme akademike dhe administrative në IAL', e miratuar me vendime VSA Nr. 97, datë 17.12.2024, VSA nr.14, dt.24.02.2025 dhe me vendime BA nr.23, dt.11.03.2025 dhe nr.35, dt.30.05.2025 Struktura dhe Organigrama e UV-së është verifikuar për përputhshmërinë me legjislacionin nga MA dhe është miratuar përfundimisht me Vendim nr.287, dt.30.06.2025 të MA.**(E.3)**

VSA për miratimi i Statutit dhe Organigramës UV
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/05/VSA14-1.pdf
https://drive.google.com/file/d/1fNIBl_ldw4wRgQwmKBqxQhAGc1X7sG8_/view
VBA për miratimi i Statutit dhe Organigramës UV
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/05/VBA1.pdf
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/05/VBA5.pdf
E.23: Detyrat funksionale të strukturës së brendshme të UV-së

Struktura organizative e universitetit reflekton ndarjen funksionale të përgjegjësive dhe kompetencave, duke synuar shmangien e mbivendosjeve dhe rritjen e efektivitetit në vendimmarrje dhe zbatim (**E.1**, neni 13.I). Struktura institucionale është e organizuar në tre drejtori: 2 drejtori me funksione ndihmësakademike nën varësinë e Rektorit të UV-së dhe 1 drejtori me funksione administrative nën varësinë e Administratorit. Sektori i Auditit të Brendshëm është sektor unik, në varësi të Bordit të Administrimit. Të gjitha njësitë kryesore të UV-së kanë struktura mbështetëse ndihmësakademike dhe administrative, ndërkohë që të gjitha njësitë bazë që e kanë nevojë funksionale kanë personel ndihmësakademik.

Struktura Akademike në nivel institucioni

- Senati Akademik
- Rektorati
- Rektori
- Zv.Rektori Akademik
- Zv.Rektori për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor

Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel institucioni

- Asistenti i Rektorit
- Drejtoria e Shërbimeve ndihmës-akademike
  1) Sektori i kurrikulave dhe statistikave
  2) Sektori i sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe akreditimit
  3) Sektori i burimeve njerëzore dhe arkiv-protokollit
  4) Sektori juridik
  5) Sektori i IT
  6) Sektori i bibliotekës dhe botimeve
- Drejtoria e Kërkim-Zhvillimit dhe Marrdhënieve me të tretët
  1) Sektori i kërkimit shkencor dhe projekteve
  2) Sektori i marrdhënieve me jashtë
  3) Sektori i promovimit dhe marrëdhënieve me publikun
  4) Sektori i karrierës, shërbimit të studentëve dhe alumni
  5) Qendra e Zhvillimit Rajonal

Struktura Administrative në nivel institucioni

- Bordi i Administrimit
- Administratori
- Sektori i auditimit të brendshëm
- Drejtoria e Shërbimeve administrative
  1) Sektori ekonomik
  2) Sektori i prokurimeve dhe investimeve
  3) Sektori i shërbimeve

Struktura Akademike në nivel njësie kryesore

1. Asambleja e Personelit Akademik
2. Dekanati
3. Dekan
4. Zv. dekan akademik
5. Zv. dekan për kërkimin shkencor

Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore

1. Sekretaria mësimore
2. Asistenti i Dekanit / Specialist i Arkiv-Protokollit
3. Sektori i Shërbimeve Ndihmës/akademike
   a. Specialisti i bibliotekës
   b. Specialisti IT
   c. Specialist i zyrës së studentëve

Struktura administrative në nivel njësie kryesore

1. Sektori i Shërbimeve Administrative
   a. Specialist finance
   b. Shërbime: mirëmbajtës, punonjës pastrimi.

Struktura ndihmës akademike me karakter akademik në nivel njësie bazë

1. Laborant

Struktura ndihmës akademike me karakter akademik në nivel Qendre kërkimore/shkencore

1. Specialist
2. Laborant

Kjo hierarki organizative paraqitet skematikisht në Organigramën e Universitetit 'Ismail Qemali' (https://univlora.edu.al/organigrama).
Organet kolegjiale, autoritetet drejtuese dhe komisionet e përhershme të UV-së janë ngritur në përputhje të plotë me aktet ligjore e nënligjore, si dhe aktet rregullatore të UV-së.
Vendime KIZ / KZF për organet kolegjiale dhe autoritetet drejtuese: SA, Rektor, Dekan, Drejtuesa departamentesh. https:
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/06/Vendimi-per-fituesit.pdf
https://univlora.edu.al/media/dokument/vendim-kiz-fitues-rektor.pdf
https://univlora.edu.al/media/dokument/vendim-kiz-fitues-senati-akademik.pdf
https://univlora.edu.al/media/dokument/vendimet-e-kiz-p-r-shpalljen-p-r-shpalljen-e-rezultateve-p-r-rekor-dhe-an-tar-senati-akademik-n-uv.pdf

E.24: Ngritja dhe funksionimi i Këshillit të Etikës: VSA për Këshillin e Etikës, Procedurë vendimmarrjeje e KE.
Kodi i Etikës në UV https://univlora.edu.al/legjislacioni

E.25: Ngritja dhe funksionimi i BA: Shkresa e MA për ngritjen e BA, Vendim SA për ngritjen e BA., Administrator.

E.26: Procedurë aprovimi Buxheti vjetor: Kërkesat buxhetore departament, fakultet, rektorat; Shkresa e Administratorit për SA dhe BA, VSA për buxhetin, VBA për buxhetin.

Organet drejtuese dhe strukturat administrative funksionojnë sipas një modeli të qartë organizativ, ku linjat e raportimit dhe përgjegjësisë janë të përcaktuara dhe të dokumentuara. Rektorati, njësitë administrative qendrore dhe strukturat mbështetëse bashkëpunojnë në mënyrë të koordinuar për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e veprimtarisë institucionale, duke kontribuar në rritjen e koherencës së menaxhimit. Varësia e strukturës së brendshme të Universitetit 'Ismail Qemali' është si më poshtë vijon (**E.1**, neni 13.II):

a. Strukturat akademike, ndihmësakademike me karakter mësimor dhe ndihmësakademike me karakter administrativ janë në varësi të Rektorit.
b. Strukturat akademike dhe ndihmësakademike me karakter mësimor e administrativ në nivel njësie kryesore kanë varësi funksionale nga Dekani i njësisë kryesore përkatëse.
c. Strukturat akademike, ndihmësakademike me karakter mësimor, në nivel njësie bazë kanë varësi funksionale nga Drejtuesi i njësisë bazë përkatëse.
d. Strukturat administrative në nivel institucioni janë në varësi të Administratorit të UV.
e. Strukturat administrative në nivel njësie kryesore, në mungesë të Administratorëve të Fakulteteve, mbeten në varësi të Administratorit të Institucionit.
f. Struktura e Auditit të Brendshëm është në varësi të Bordit të Administrimit.
g. Strukturat juridike, burimeve njerëzore, arkiv-protokollit dhe teknologjisë së informacionit në nivel institucioni apo njësie kryesore, ushtojnë veprimtarinë e tyre në funksion të të gjitha strukturave në institucion.

Institucioni ka ndërmarrë masa për optimizimin e proceseve administrative përmes miratimit të Rregullores së përgjithshme **(E.4)** dhe rregulloreve specifike **(E.7-E.21**)(Standardi I.1), urdhrave e njoftimeve, planeve strategjike të sektorëve, si dhe përdorimit të sistemeve elektronike të menaxhimit dhe informimit (@univlora.edu.al dhe UNVIMAS), të cilat lehtësojnë flukset e punës, reduktojnë kohën e përpunimit dhe rrisin transparencën në shërbimet ndaj stafit dhe studentëve.

E.27: Urdhra dhe udhëzime të Rektorit, që synojnë përmirësimin e eficiencës në administrim.
E.28: Planet strategjike të sektorëve institucionalë të UV-së, me objektiva të qarta menaxheriale SSBC&A
E.29: Planet strategjike të sektorëve institucionalë të UV-së, me objektiva të qarta menaxheriale SKS&A
E.30: Dokumentacion mbi përdorimin e platformave elektronike për shërbimet ndaj studentëve dhe stafit.

Në Universitetin e Vlorës është i konstituuar procesi i Vlerësimit të Performancës, që është i detyrueshëm për të gjithë personelin e UV-së dhe finalizohet me plotësimin e formularit në fund të çdo viti akademik (***E.4*** neni 50). Procesi i vlerësimit të performancës drejtohet nga autoritetet drejtuese dhe drejtuesit e njësive ndihmëse, të përcaktuar si menaxherë të procesit të vlerësimit. Formulari i performancës miratohet nga Senati Akademik.

E.31: Formulari i Vlerësimit të Performancës, i miratuar nga SA.Vlerësim performance

Masa dhe rekomandime për përmirësim, të nxjerra nga vetëvlerësime ose auditime të brendshme/jashtme.

Raport vjetor Sektori Auditit te brendshem viti 2023
https://drive.google.com/file/d/1ON6-JOBRxaKOqpcdm4iFBNO1_dPQY0PB/view
Raport vjetor Sektori Auditit te brendshem viti 2025
https://drive.google.com/file/d/1-VgvrIZ-4IFIIr7vqxbyQT4JeQ9oosJc/view

Këto mekanizma kanë ndikuar pozitivisht në eficiencën e menaxhimit të përditshëm dhe në cilësinë e shërbimeve universitare.

Standardi I.3 Institucioni harton një strategji zhvillimi.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë vlerëson se hartimi dhe zbatimi i Strategjisë së Zhvillimit përbën një element kyç të qeverisjes institucionale dhe një instrument themelor për orientimin afatmesëm dhe afatgjatë të veprimtarisë akademike, kërkimore dhe administrative. UV ka miratuar në vazhdimësi:

E.35: Strategjia e Zhvillimit të UV-së 2025-2030
E.32: Strategjia mbi barazinë gjinore në Universitetin 'Ismail Qemali'
E.33: Strategjia mbi ndërkombëtarizimin në Universitetin 'Ismail Qemali',
E.34: Strategjia mbi kërkimin shkencor në Universitetin 'Ismail Qemali',

Procesi i hartimit të Strategjisë së Zhvillimit UV 2025-2030

Procesi i hartimit të strategjisë është realizuar në mënyrë të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse, duke përfshirë strukturat drejtuese, njësitë akademike dhe administrative, si dhe duke marrë në konsideratë opinionet dhe nevojat e gjithë strukturave të UV-së. Drafti i parë, i hartuar nga grupi i punës, u përcoll elektronikisht tek gjithë drejtuesit e njësive bazë për diskutime dhe sugjerime në departamente. Pas diskutimeve nëpër njësitë bazë dhe Rektorat, miratimi në Senatin Akademik kaloi në dy faza:

- Fillimisht u miratua dokumenti strategjik i gjendjes aktuale, misionit, vizionit, skenarëve strategjikë dhe linjave strategjike, që do të ndjekë Universiteti 'Ismail Qemali' gjatë 6 viteve në vazhdim.
- Pas miratimit në parim të skenarëve dhe linjave strategjike të UV-së, në fazën e dytë u pregatit, diskutua dhe miratua Plani i veprimit të Strategjisë së Zhvillimit, i detajuar në Skenarë, Linja dhe Objektiva strategjikë, Masat (veprimet) kryesore, Instrumentet që mund të përdoren, Treguesit e performancës, Afatet, Strukturat përgjegjëse dhe Parashikimi financiar i përafërt.

Drafti përfundimtar i Strategjisë së Zhvillimit 2030, u prezantua nga Rektoria e UV-së në një mbledhje të zgjeruar të Senatit Akademik, Drejtuesve të njësive bazë dhe Këshillit Studentor, me prezencë mediatike. Varianti final i Strategjisë së Zhvillimit UV 2030 kaloi për miratim në Bordin e Administrimit të UV-së. Kjo qasje ka kontribuar në përcaktimin e objektivave strategjikë realistë, të matshëm dhe të lidhur drejtpërdrejt me kapacitetet aktuale dhe perspektivat e zhvillimit të universitetit.

Strategjia e Zhvillimit UV 2030 është publikuar në:

- faqen zyrtare të UV-së në format pdf dhe prezantim ppt
  https://univlora.edu.al/;
  https://univlora.edu.al/legjislacioni;
  https://univlora.edu.al/media/dokument/uv-plani-strategjik-2025-2030.pdf,
- mediat sociale të UV-së si rregjistrim i plotë i prezantimit në kanalin e UV-së në YouTube,
  https://www.youtube.com/watch?v=D1MAj6blhSQ
- mediat lokale.
  https://www.youtube.com/watch?v=w1xq7sZ9t8M
- broshura informuese

Konteksti strategjik i zhvillimit të Universitetit 'Ismail Qemali', Vlorë

Strategjia e zhvillimit është ndërtuar në përputhje me misionin dhe vizionin e institucionit, si dhe me prioritetet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e arsimit të lartë.

Qëllimi 1:

Arsimi i lartë si faktor kyç për zhvillimin e kapitalit njerëzor, social dhe ekonomik, duke siguruar një ofertë të re akademike të përshtatur me tregun e punës dhe aftësitë e së ardhmes.
(*Dokumenti i Politikave të Arsimit të Lartë 2030 - MA)*

Qëllimi 2:

Integrimi i UV në Zonën Europiane të Arsimit dhe Kërkimit Shkencor përmes financimit, sigurimit të cilësisë, ndërkombëtarizimit dhe specializimit.
(*Dokumenti i Politikave të Arsimit të Lartë 2030 - MA*)

Misioni UV

Universiteti “Ismail Qemali” i Vlorës ka për mision
- të ofrojë arsim të lartë cilësor,
- të zhvillojë kërkim shkencor me ndikim
- të kontribuojë në zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe kulturor të vendit.

UV angazhohet
- të garantojë edukim cilësor e transformues,
- të nxisë inovacionin dhe kërkimin shkencor me theks aplikativ,
- të forcojë partneritetet me industrinë dhe komunitetin
- të sigurojë një mjedis të drejtë, të digjitalizuar dhe të aksesueshëm për të gjithë.
- angazhim të përhershëm për të adresuar nevojat shoqërore

Vizioni UV 2030:

Universiteti ‘Ismail Qemali’ – Universitet Ndërkombëtar
- programe ndërkombëtare
- studentë ndërkombëtarë

Universiteti ‘Ismail Qemali’ – Universitet 4.0
- universitet i digjitalizuar,
- universitet i ndërkombëtarizuar,
- universitet i lidhur me industrinë dhe biznesin,
- universitet i mbështetur në inovacion
- universitet i orientuar drejt kompetencave të së ardhmes

Strategjia e zhvillimit e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë adreson në mënyrë të integruar dimensionet kryesore të veprimtarisë institucionale, përfshirë zhvillimin e programeve të studimit, përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, ndërkombëtarizimin, forcimin e lidhjeve me tregun e punës, si dhe menaxhimin eficient të burimeve njerëzore, financiare dhe infrastrukturore.

Skenarët strategjikë të UV-së:

I. Ndërkombëtarizimi,
II. Universitet SMART,
III. Leader Profesional,
IV. Qendër Zhvillimi Rajonal.

Linjat dhe Objektivat strategjikë të UV-së:

Linjat strategjike		*Objektivat strategjikë*
I.1 Partneritet dhe kooperim ndërkombëtar	I.1.1	Zgjerimi dhe forcimi i rrjetit të partneriteteve akademike
	I.1.2	Rritja e kapaciteteve institucionale të UV-së: administrative dhe akademike për transformimin në universitet ndërkombëtar
	I.1.3	Nxitja e pjesëmarrjes në projekte kërkimore dhe inovacioni ndërkombëtar
	I.1.4	Promovimi ndërkombëtar i universitetit dhe diplomave
	I.1.5	Nxitja e ndërkombëtarizimit në shtëpi (“Internationalization at Home”)
I.2 Programe studimi ndërkombëtare dhe mobilitete afatgjata	I.2.1	Rritja e nivelit të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit
	I.2.2	Tërheqja e studentëve ndërkombëtarë
	I.2.3	Rritja e mobiliteteve afatgjata të studentëve dhe stafit
	I.2.4	Modernizimi i shërbimeve universitare për ndërkombëtarizim
I.3 Kërkim shkencor i përbashkët sipas standarteve ndërkombëtare	I.3.1	Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor sipas standardeve Scopus/WoS
	I.3.2	Nxitja e projekteve të përbashkëta me institucione europiane
	I.3.3	Licencimi dhe akreditimi i laboratorëve kërkimorë
	I.3.4	Rritja e mobiliteteve kërkimore ndërkombëtare (COST, Marie Curie, etj.)
	I.3.5	Forcimi i revistës UniVlora Scientific Journal.

	I.3.6	Krijimi i infrastrukturës digjitale shkencore
II.1 Edukim SMART	II.1.1	Përmirësimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies digjitale
II.2 Sistem Shërbimesh SMART	II.2.1	Digjitalizimi i shërbimeve universitare dhe mbështetja e studentëve
II.3 Infrastrukturë SMART	II.3.1	Modernizimi i ambienteve dhe ndërtimi i ekosistemeve digjitale
III.1 ESCO Standart	III.1.1	Modernizimi i programeve dhe kurrikulave (Universitet 4.0): ➢ mësimdhënie interaktive dhe student-centered, ➢ digjitalizim i plotë i materialeve mësimore në dispozicion të studentit, ➢ qasje fleksibile dhe mikrokredenciale, ➢ përdorimi i teknologjive të avancuara.
	III.1.2	Përputhja e kurrikulave me nevojat e tregut të punës dhe klasifikimet europiane të profesioneve
III.2 Spin off / Start Up	III.2.1	Nxitja e sipërmarrjes dhe inovacionit
III.3 Diploma, punësimi	III.3.1	Rritja e punësueshmërisë së diplomantëve
III.4 Life Long Learning	III.4.1	Ofrimi i trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm
III.5 Dimensioni social.	III.5.1	Zhvillimi i një mjedisi gjithëpërfshirës dhe jo-diskriminues
IV.1 Partneritet Strategjik me Shoqërinë (grupet e interesit)	IV.1.1	Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin, biznesin dhe sektorin publik
IV.2 Edukim dhe angazhim shoqëror i studentëve	IV.2.1	Fuqizimi i rolit të studentëve në komunitet dhe në vendimmarrje
	IV.2.2	Promovimi i qytetarisë aktive dhe vullnetarizmit
	IV.2.3	Zhvillimi i kompetencave qytetare, sociale dhe ndërkulturore
	IV.2.4	Zhvillimi i medias dhe zërit studentor
	IV.2.5	Ndërtimi i një jete kampusi social, kulturor dhe sportiv
IV.3 Rritja e vizibilitetit dhe identitetit universitar	IV.3.1	Zhvillimi i një identiteti të fortë institucional (Brand UniVlora)
	IV.3.2	Media universitare e fuqizuar
	IV.3.3	Organizimi i eventeve të profilit të lartë akademik, shkencor dhe kulturor
IV.4 Katalizator ekonomik dhe kulturor	IV.4.1	Zgjerimi i shërbimeve ndaj të tretëve
	IV.4.2	Kontributi i universitetit në zhvillimin ekonomik dhe kulturor të rajonit

Si përfundim Strategjia e Zhvillimit të Universitetit 'Ismail Qemali' shërben si dokument orientues për planifikimin vjetor dhe vendimmarrjen institucionale, duke siguruar koherencë ndërmjet prioriteteve strategjike dhe veprimeve operative.

E.35: Strategjia e Zhvillimit të UV-së 2025-2030
E.36: Strategjia e Zhvillimit të UV-së 2018-2024
E.37: Procedura e miratimit të Strategjisë UV 2025-2030

Publikimi i Strategjisë së Zhvillimit (broshura)
https://univlora.edu.al/media/dokument/strategjia-uv-2030-3.pdf

Standardi I.4 Institucioni respekton kufijtë e autonomisë së tij.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë vlerëson se ushtron autonominë institucionale në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për arsimin e lartë, duke respektuar kufijtë e autonomisë akademike, organizative, administrative dhe financiare të përcaktuara nga legjislacioni kombëtar dhe aktet nënligjore përkatëse. Autonomia konsiderohet nga institucioni si një parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm dhe për garantimin e cilësisë në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe shërbime universitare.

Në praktikë, autonomia akademike ushtrohet përmes kompetencave të strukturave akademike në hartimin dhe zbatimin të programeve të studimit, organizimin e proceseve mësimore dhe kërkimore, si dhe në vlerësimin e veprimtarisë akademike, gjithmonë në respektim të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare

të cilësisë. Çdo proces vendimmarrës fillon nga njësitë bazë, me mbledhje të protokolluara të tyre, draft-propozime të grupeve të punës të ngritur prej drejtuesit të njësisë bazë, dhe vijon më pas me vlerësimin nga strukturat përgjegjëse e me miratim përfundimtar në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit (nëse përfshihet aspekti financiar).

E.38: Procedurë e plotë miratimi programi BSc në "Computer engineering"
E.39: Procedurë miratim kuotash Fakulteti Ekonomik
E.40: Procedure e plotë kritere pranimi 2026-2027 në UV
E.41: Procedurë prioritetesh strategjike të kërkimit shkencor me mbledhje departamenti i Shkencave Kompjuterike deri në SA

Autonomia organizative dhe administrative ushtrohet përmes strukturimit të brendshëm të universitetit, menaxhimit të burimeve njerëzore dhe organizimit të shërbimeve administrative, në përputhje me kompetencat e deleguara dhe procedurat ligjore.

E.42: Procedurë e ndryshimit të pozicionit të specialistes në laborante tek QKSH, FSHTN

Në aspektin e autonomisë financiare, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë administron burimet financiare në përputhje me legjislacionin përkatës, rregullat e financimit publik dhe aktet e brendshme të miratuara. Proceset e planifikimit, shpërndarjes dhe kontrollit financiar realizohen në mënyrë të dokumentuar dhe transparente, duke respektuar kufijtë e autonomisë dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm.

E.43: Aprovimi MA për procedurat e ndjekura nga UV *:* Miratim programesh nga MA, miratimi i statutit dhe organigramës.

Universiteti respekton qartë kufijtë e autonomisë së tij në marrëdhënie me institucionet publike dhe autoritetet mbikëqyrëse, duke siguruar zbatim korrekt të detyrimeve ligjore dhe raportim të rregullt institucional. UV ushtron gjithë funksionet e lejuara nga autonomia e tij akademike, financiare dhe administrative, por në çdo rast këto funksione janë të monitoruara dhe aprovuara nga Ministria e Arsimit. Universiteti raporton tek kjo Ministri në mënyrë periodike, vjetore ose 6 mujore për të gjitha këto aspekte, dhe zbaton programet, kuotat e pranimit, statutin, planin buxhetor vjetor etj, vetëm pas miratimit nga MA.

VSA për miratimin e Statutit dhe Organigramës UV
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/05/VSA14-1.pdf
https://drive.google.com/file/d/1fNIBl_ldw4wRgQwmKBqxQhAGc1X7sG8_/view
Vendim Bordi Nr. 1, datë 09.01.2025
"Për miratimin e numrit të personelit akademik në të gjitha nivelet në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/05/VBA1.pdf
Vendim Bordi Nr. 5, datë 09.01.2025
"Për miratimin e disa ndryshimeve në statutin e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/05/VBA5.pdf

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë respekton dhe zbaton Kodin e Etikës si një instrument themelor për garantimin e lirisë akademike dhe përcaktimin e kufijve të autonomisë institucionale. Përmes këtij kodi, UV siguron që veprimtaria mësimore, kërkimore dhe artistike të zhvillohet në një mjedis të bazuar në integritet akademik, respekt të mendimit të lirë dhe përgjegjshmëri institucionale. Kodi i Etikës udhëheq marrëdhëniet ndërmjet stafit akademik, administrativ dhe studentëve, duke garantuar ushtrimin e lirë të veprimtarisë akademike brenda kornizës ligjore dhe rregullatore në fuqi, si dhe mbrojtjen e autonomisë institucionale në proceset vendimmarrëse dhe akademike.

VSA për ngritjen e Këshillit të Etikës UV
https://univlora.edu.al/media/dokument/vsa5-2026.pdf
Kodi Etikës në UV
https://univlora.edu.al/keshilli-i-etikes

Programi i Transparencës në faqen zyrtare të UV-së (https://univlora.edu.al/programi-i-transparences)

pasqyron të përditësuara të gjitha raportimet dhe vendimmarrjet e strukturave të UV-së.

C-monitorimi Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026
https://univlora.edu.al/media/dokument/c-raport-monitorimi-6-mujor-per-ska-2021-2026-dhe-planin-e-veprimit-korrik-dhjetor-2024.pdf
https://univlora.edu.al/media/dokument/c-raport-monitorimi-6-mujor-per-ska-2021-2026-jan-qer-2025-6.pdf
Raport vjetor i veprimtarisë së UV-së viti akademik 2024-2025
https://univlora.edu.al/media/dokument/raport-vjetor-institucional-2024-2025.pdf
Miratimi i planit buxhetor vjetor 2023
https://univlora.edu.al/media/dokument/mbi-realizimin-faktik-te-planit-buxhetor-te-vitit-2023.pdf
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Vendim-Senati-Nr.-8-date-20.02.2023-Per-miratimin-paraprak-te-Projekt-Buxhetit-per-vitin-2023.pdf

Standardi I.5 Institucioni favorizon debatin konstruktiv.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë vlerëson se promovimi i debatit konstruktiv ndërmjet stafit akademik, studentëve dhe strukturave drejtuese përbën një element kyç të qeverisjes demokratike dhe të përmirësimit të cilësisë institucionale. Institucioni ka krijuar mekanizma të formuar dhe të formalizuar për të lehtësuar shkëmbimin e ideve, diskutimin kritik dhe marrjen e vendimeve kolektive në bazë të argumenteve profesionale dhe akademike.

Në praktikë, Universiteti mbështet debatet konstruktive përmes: mbledhjeve të rregullta të Senatit Akademik, Bordit të Administrimit, dekanateve, departamenteve dhe strukturave studentore. Axhenda e mbledhjes dhe materialet për diskutim në të dërgohen minimalisht dy ditë përpara në adresat elektronike të organeve kolegjiale. Diskutimet në këto organe zhvillohen në mënyrë të dokumentuar dhe transparente, duke lehtësuar shqyrtimin e propozimeve dhe vendimeve dhe duke kontribuar në rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së proceseve akademike dhe administrative.

Institucioni ka krijuar një ambient të hapur për reflektim dhe kritika konstruktive në lidhje me politikat institucionale, strategjitë akademike dhe menaxhimin e burimeve, duke inkurajuar pjesëmarrjen aktive të të gjithë aktorëve të brendshëm. Kjo qasje ka ndikuar në zhvillimin e një kulture institucionale bazuar në dialog, bashkëpunim dhe përgjegjësi kolektive.

E.44: Emaile me njoftimin e axhendës dhe materialeve për diskutim në mbledhjet SA, BA.
E.45: Procesverbale të mbledhjeve të Senatit Akademik, ku dokumentohen diskutime dhe vendime.
Procesverbale të mbledhjeve të Bordit të Administrimit, ku dokumentohen diskutime dhe vendime.
Procesverbale të dekanateve dhe departamenteve, që përfshijnë diskutime mbi çështje akademike dhe organizative. Vendime dhe raportime të Këshilli të Etikës, procesverbale të mbledhjeve të Këshillit të Studentëve, ku dokumentohen diskutime dhe vendime.
E.46: Vlerësim i shërbimeve ndihmës-akademike dhe administrative prej studentëve: Vendim SA për miratimin e formatit të Pyetësorit të Vlerësimit të Cilësisë së Shërbimeve të ofruara prej stafit ndihmës-akademik të UV-së

Standardi I.6 Institucioni publikon veprimtarinë kryesore të organeve kolegjiale, raportin vjetor dhe aspekte të tjera të lidhura me transparencën.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë e konsideron transparencën një parakusht themelor për qeverisjen demokratike dhe llogaridhënien institucionale. Universiteti siguron qasje të hapur për studentët, stafin dhe publikut të gjerë për dokumentet dhe vendimet që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin institucional. UV ka ndërmarrë masa për publikimin e veprimtarisë kryesore të organeve kolegjiale, përfshirë Senatin Akademik, Bordin e Administrimit dhe strukturat institucionale dhe fakultetore në disa nivele:

- Faqja zyrtare e UV-së: publikon vendimet e SA, BA e Rektoratit, njoftimet e punësimit, thirrjeve Erasmus+, thirrjeve të projekteve PKZHUV etj.
  https://univlora.edu.al/vendime-senati
  https://univlora.edu.al/vendime-bordi
  https://univlora.edu.al/vendime-te-rektoratit
  https://univlora.edu.al/njoftimek/6
  https://univlora.edu.al/njoftimek/5
- Programi i Transparencës në faqen zyrtare të UV-së
  https://univlora.edu.al/programi-i-transparences
  pasqyron të përditësuara të gjitha raportimet dhe vendimmarrjet e strukturave të UV-së: strukturën e pagave të UV-së, raportet e veprimtarisë financiare, rregjistrat e parashikimit të prokurimit publik, relacion mbi kontratat e kancelarive, vendime për dhënie bursash e honoraresh.
- Faqet sociale të UV-së
  YouTube me 121+video, 36+ podcaste UniVlora;
  https://www.youtube.com/@universitetiismailqemalivlore
  Instagram me 1398+ postime dhe 2500+ ndjekës:
  https://www.instagram.com/uni.ismail_qemali.vlore/profilecard/?igsh=dWpjcm5zc3ZrdXAz
  Facebook me 17K ndjekës
  https://www.facebook.com/people/Universiteti-Ismail-Qemali-Vlor%C3%AB-Faqe-Zyrtare/100080334315032/
- Pasqyrime mediatike

Kultura institucionale promovon llogaridhënie dhe përgjegjësi, duke lehtësuar verifikimin dhe monitorimin e veprimtarive kolegjiale nga aktorët e brendshëm dhe të jashtëm. Për më tepër, Universiteti siguron që informacioni i publikuar të jetë i saktë, i qartë dhe i përditësuar, duke rritur besueshmërinë dhe transparencën institucionale.

Njoftime për aktivitetet akademike dhe kërkimore, të publikuara online për UV-në dhe publikun e gjerë:

Sesion informimi mbi programet "MIP" dhe "LEAD"
https://univlora.edu.al/njoftime/sesion-informimi-mbi-programet-mip-dhe-lead
Konferenca e 1-rë Ndërkombëtare(INTERCON-SE-NCDs-I-MAP)
https://univlora.edu.al/njoftime/konferenca-e-1-re-nderkombetare-intercon-se-ncds-i-map
Aktiviteti me Akademinë e Forcave të Armatosura
https://univlora.edu.al/njoftime/forum-midis-akademise-se-forcave-te-armatosura-dhe-universitetit-ismail-qemali
Takimi i 5-të transnacional i projektit CRED4TEACH
https://univlora.edu.al/njoftime/takimi-i-5-te-transnacional-i-projektit-cred4teach-mikrokredenciale-te-bazuara-ne-mooc
Open Day 2025
https://univlora.edu.al/njoftime/-univlora-open-day
Leksion i hapur për 100-vjetorin e Kontrollit të Lartë të Shtetit
https://univlora.edu.al/njoftime/leksion-i-hapur-ne-kuader-te-100-vjetorit-te-kontrollit-te-larte-te-shtetit
Konferenca e 14 Ndërkombëtare -Asecu
https://univlora.edu.al/njoftime/konferenca-nderkombetare-asecu-dhe-shkolla-verore-2025
Sesion informues Teknologjitë inovative 3D
https://univlora.edu.al/njoftime/teknologjite-inovative-3d
Takimi akademik dhe kulturor me temë “Intelligenza delle Mani
http://univlora.edu.al/njoftime/takimi-akademik-dhe-kulturor-me-teme-intelligenza-delle-mani

Çdo person apo institucion jashtë universitetit mund të kërkojë ti vihen në dispozicion dokumentacion të prodhuara nga UV. Këto dokumenta UV mund t’ua vëndosë në dispozicion vetëm pas një procedure

rigoroze dhe verifikim prej Koordinatorit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në UV, të sanksionuar në Rregulloren e tij të përgjithshme neni 10 (**E.4,** neni 10) - procedurë që siguron mosdaljen jashtë UV-së të materialeve me informacione sensitive.

E.47 : Procedurë për dhënie dokumentash jashtë UV-së

Standardi I.7 Institucioni harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë në programe e studimit që ofron.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë e konsideron sigurimin e cilësisë si një element kyç për zhvillimin institucional, efektivitetin akademik dhe përmbushjen e misionit të tij. Në këtë kontekst, institucioni ka hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura të qarta dhe transparente për sigurimin e cilësisë, të cilat janë të harmonizuara me kërkesat kombëtare dhe standardet ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë përfshijnë të gjithë ciklet e studimit dhe trajtojnë aspekte të ndryshme të veprimtarisë akademike, përfshirë:

- riorganizimin e programeve të studimit,
- përditësimin dhe vlerësimin e syllabuseve dhe kurrikulave,
- fokus-grupet me studentët e cikleve të ndryshme
- përfshirjen e studentëve në proceset e vlerësimit nëpërmjet pyetësorëve online, të emetuar në sistemin UNVIMAS,
- bashkëpunimin me aktorë të jashtëm (tregu i punës, partnerë ndërkombëtarë, alumni) nëpërmjet takimeve të përbashkëta dhe Pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet ALUMNI-t**.**

1. Riorganizimi i programeve të studimit,
   Departamentet në mënyrë të vazhdueshme riorganizojnë programet e tyre të studimit, për të reflektuar ndryshimet në udhëzimet dhe aktet nënligjore, zhvillimet profesionale korrente, ndryshimet në kërkesat e tregut dhe përmirësimin në qasjet e mësimdhënies (***E.4***, neni 55, pika 4).
   E.48 : Procedurë e riorganizimit të programit të studimit: Bcs në "Infermieri të Përgjithshme"
2. Përditësimi dhe vlerësimi i syllabuseve dhe kurrikulave,
   Përpara fillimit të vitit akademik departamentet rishikojnë dhe aprovojnë titullarët e literaturën bazë, si dhe dorëzojnë syllabuset e vitit akademik në vijim (**E.4***,* neni 63, pika 4). Nëpërmjet këtij mekanizmi sigurohet vlerësimi i përvitshëm i cilësisë dhe përditësimi i përmbajtjes së kurrikulës akademike.
   E.49: Vendim për miratimin e Titullarëve në programet e Ciklit të dytë në DI dhe Literaturës në programin Bsc në Infermieri të Përgjithshme.
3. Fokus-grupet me studentët e cikleve të ndryshme
   Fokus-grup me studentë të programeve Master FSHTN
   https://univlora.edu.al/njoftime/aktiviteteve-te-organizuara-te-fokus-grupeve-me-studente-ne-prag-diplomimi-te-disa-prej-programeve-master-ne-fakultetin-e-shkencave-teknike-dhe-natyrore-si-dhe-fakultetin-e-shkencave-humane-dhe-drejte
   Fokus-grup me studentë të programeve Bachelor FSHH dhe FSH
   https://univlora.edu.al/njoftime/fokus-grupe-me-studente-ne-prag-diplomimi-prill-2025
   https://univlora.edu.al/njoftime/fokus-grupe-me-studente-ne-fakultetin-e-shendetit-gjate-muajit-mars-2025
4. Përfshirjen e studentëve në proceset e vlerësimit nëpërmjet pyetësorëve online, të emetuar në sistemin UNVIMAS, raportet e të cilëve publikohen në faqen zyrtare të UV-së:
   https://univlora.edu.al/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise:
   https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve-2020-2021
   https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve-2024-2025
5. Bashkëpunimin me aktorë të jashtëm (tregu i punës, partnerë ndërkombëtarë, alumni) nëpërmjet

takimeve të përbashkëta dhe Pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet ALUMNI-t**.**
Njoftim në faqen web UV pyetësori i studentëve për vlerësimin dhe përmiresimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara në UV
https://univlora.edu.al/njoftime/pyetesori-i-studenteve-per-vleresimin-dhe-permiresimin-e-cilesise-se-sherbimeve-te-ofruara-prej-stafit-administrativ-dhe-ndihmesakademik
Njoftim në faqen web UV raporti i analizës së rezultateve të pyetesorit për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara në UV
https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-rezultateve-te-pyetesoreve-te-studenteve-2024-2025
Raport Alumni 2025
https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-rezultateve-te-pyetesorit-te-alumni-t
Rekomandimet e raportit Alumni 2025
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/05/REKOMANDIMET-PYETESOR-ALUMNI.pdf

Procedurat institucionale janë formalizuar përmes rregulloreve dhe udhëzimeve të miratuara nga organet kompetente, të cilat përcaktojnë qartë hapat e vlerësimit dhe përmirësimit të programeve, përgjegjësitë e strukturave akademike dhe menaxheriale, si dhe mekanizmat e raportimit dhe monitorimit. Ky sistem i strukturuar siguron që çdo proces i lidhur me cilësinë të jetë transparent, i dokumentuar dhe i aksesueshëm për të gjithë aktorët e brendshëm.

Standardi I.8 Institucioni monitoron dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme programet e studimit për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka vendosur një sistem të strukturuar për monitorimin dhe vlerësimin e programeve të studimit, me qëllim sigurimin e arritjes së objektivave formuese dhe rezultateve të të nxënit. Sistemi bazohet në një qasje të integruar, që përfshin të gjitha ciklet e studimit dhe lidhjen e programeve me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Procesi i monitorimit përfshin mbledhjen dhe analizimin e të dhënave mbi përparimin akademik të studentëve, pjesëmarrjen në mësimdhënie, aktivitetet laboratorike dhe kërkimore, si dhe vlerësimin e kënaqësisë së studentëve. Rezultatet e këtyre monitorimeve përdoren për marrjen e vendimeve mbi përmirësimin e programeve dhe adaptimin e tyre ndaj nevojave të tregut të punës dhe zhvillimeve shkencore.

Vlerësimi i programeve realizohet përmes mekanizmave të formalizuar si:

- raporte periodike të departamenteve mbi progresin e programeve dhe realizimin e objektivave të të nxënit, me analizën e rezultateve të provimeve për çdo cikël studimi
- anketa dhe feedback nga studentët mbi cilësinë e mësimdhënies dhe programeve,
- vlerësime nga ekspertë të jashtëm për sigurinë e cilësisë.

Ky proces siguron që objektivat e programeve të jenë të qarta, të matshme dhe të përputhshme me rezultatet e synuara të të nxënit.

E.50: Raporte vjetore të departamenteve dhe fakulteteve me Analizën e rezultateve të provimeve dhe notave të studentëve.

E.51 : Raporte akreditimi të programeve: Bsc në Teknologji Informacioni
Raporti i Pyetësorit të studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi UV
https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve-2024-2025
https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve-2023-2024

Institucioni evidenton se ky sistem monitorimi dhe vlerësimi ndihmon në identifikimin e dobësive dhe forcave të programeve, duke mundësuar një përmirësim të vazhdueshëm dhe garantimin e cilësisë akademike. Përveç kësaj, Universiteti siguron dokumentimin dhe raportimin e rregullt të të dhënave dhe

rekomandimeve, duke e bërë procesin transparent dhe të aksesueshëm për organet vendimmarrëse dhe aktorët e brendshëm.

Standardi I.9 Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka zhvilluar dhe zbatuar një sistem të integruar të procedurave dhe metodologjive për vlerësimin e programeve të studimit në të gjitha fazat e tyre: nga hapja dhe zhvillimi, te monitorimi i ecurisë së studentëve, deri te diplomimi dhe integrimi i tyre në tregun e punës. Ky sistem siguron që çdo program i ofruar të jetë në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, objektivat e formimit dhe nevojat e tregut të punës.

Duke synuar që procesi i mësimdhënies të përmirësohet vazhdimisht, Universiteti i Vlorës e konsideron të rëndësishme vlerësimin e studentit për lëndën në përgjithësi, si dhe për cilësinë e mësimdhënies dhe të stafit akademik në veçanti. Ky proces realizohet përmes instrumenteve të ndryshëm si: pyetësorëve të cilësisë së mësimdhënies, staf ndihmësakademik e administrative, pyetësor Alumni, takim me fokus-grupet. UV ka ndërmarrë nisma për rritjen e efikasitetit në fushën e vlerësimit të cilësisë duke përdorur instrumenta si:

- *Pyetësori i cilësisë së mësimdhënies*
  Ky pyetesor është miratuar me vendim Senati Akademik nr 97, datë 21.210.2020. Pyetësori për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në Universitetin e Vlorës realizohet në fund të çdo semestri dhe ka për qëllim mbledhjen e reagimeve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe programeve akademike. Ky instrument i mundëson universitetit të përmirësojë kurrikulat, të zhvillojë profesionalisht stafin dhe të marrë vendime të bazuara në të dhëna konkrete, duke siguruar përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së arsimit. Përdorimi i këtij pyetësori mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë, i cili kërkon që institucionet e arsimit të lartë të krijojnë mekanizma të brendshëm për sigurimin e cilësisë dhe përfshirjen e studentëve në vendimmarrje. Realizimi i pyetësorit në fund të semestrit siguron që studentët të kenë një përvojë të plotë të kursit, duke dhënë vlerësime të mirëinformuara që kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.

- *Pyetësori i vlerësimit të shërbimeve ndihmës akademike dhe administrative*
  Ky pyetësor vjen në kuadër të politikave të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë për sigurimin e brendshëm të cilësisë, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standarteve të cilësisë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe europian për Arsimin e Lartë.
  Mbështetur në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 26, datë 12.05.2021 "Për disa Ndryshime në Vendimin e Senatit Akademik Nr.74 datë 16.06.2020 "Për procedurën e Analizës së Pyetësorëve të Studentëve për Vlerësimin dhe Përmirësimin e Cilësisë së Shërbimeve Prej Stafit Administrativ dhe Ndihmësakademik në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë",

- *Pyetësori i vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet Alumni-it*
  Në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë Nr. 80/2015, Datë 22.07.2015, Kreu X, Nenit 103, Pika 4: "Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të studimit", në Kodin e Cilësisë, miratuar me VKM Nr. 824, datë 24.12.2021, si dhe në Statutin e UV-së,(**E.1**, Neni 80, pika 1), si dhe në Vendim Senati Nr. 13, datë 06.05.2021, Rekomandimi Nr.7. Vlerësimi dhe përmirësimi i programeve të studimit, do të bëhet nëpërmjet diversifikimit të instrumentit të ALUMNI-t, me Vendim Senati Akademik Nr 20, dt 24.04.2023, organizimi i pyetësorit për ALUMNI-n do të bëhet çdo 3 (tre) vjet.
  Ky pyetësor i hedhur për herë të parë dhe realizuar nga SSBCA me shkresën Nr. 784 Prot, datë 27.02.2025 ku ka përcjellë raportin e analizës së pyetësorit të vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet alumnit. Me urdhër rektori nr. 55, datë 05.03.2025, protokolluar me Nr. 834 Prot., u

ngrit grupi i punës për hartimin e rekomandimeve.

- *Fokus grupe me studentë*

  Universiteti i Vlorës (UV) implementon fokus grupet si një instrument vlerësimi për të mbledhur informacione të thelluara dhe për të kuptuar më mirë përvojat dhe nevojat e studentëve dhe stafit. Ky instrument i lejon UV-së të marrë reagime të drejtpërdrejta mbi cilësinë e programeve të studimit dhe mësimdhënies, duke zbuluar perceptime dhe shqetësime që mund të mos shfaqen përmes pyetësorëve të strukturuar. Si procedurë çdo fillim viti Sektori i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë harton një kalendar vjetor për fokus-grupet per të vlerësuar cilat programe do të përfshihen në takimet e fokus-grupeve dhe ia paraqet Rektorit për miratim. Pas miratimit nga Rektori, Sektori SBCA nis punën duke njoftuar drejtuesit e njësive kryesore dhe atyre bazë mbi axhendat përkatëse .
  https://univlora.edu.al/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise

Pyetësori i studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UV

Raport i analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për vitin akademik 2024-2025
https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve-2024-2025
Raport i analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për vitin akademik 2023-2024
https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve-2023-2024
Raport i analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për vitin akademik 2022-2023
https://univlora.edu.al/njoftime/raport-i-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve-per-cilesine-e-mesimdhenies-2022--2023
Raport i analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për vitin akademik 2021-2022
https://univlora.edu.al/njoftime/raport-i-analizes-se-pyetesorve-te-studenteve-per-cilesine-e-mesimdhenies-viti-akademik-2021---2022
Raport i analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për vitin akademik 2020-2021
https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve-2020-2021
Raport i analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për vitin akademik 2019-2020
https://univlora.edu.al/njoftime/raporte-te-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve-per-cilesine-e-mesimdhenies-per-vitin-akademik-2019-2020

Pyetësori i Vlerësimit të Cilësisë së Shërbimeve të ofruara prej stafit ndihmës-akademike dhe administrativ të UV-së

Raporti i analizës së rezultateve të pyetësorëve të studentëve për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara prej stafit ndihmësakademik dhe administrativ, viti akademik 2023-2024
https://univlora.edu.al/njoftime/raport-dhe-rekomandime-per-permiresimin-e-cilesise-se-sherbimeve-administrative
Raport i analizës së rezultateve të pyetësorëve të studentëve për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara, viti akademik 2022-2023
https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-rezultateve-te-pyetesoreve-te-studenteve
Raport i analizës së rezultateve të pyetësorëve të studentëve për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara, viti akademik 2021-2022
https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-rezultateve-te-pyetesoreve-te-studenteve-per-vleresimin-dhe-permiresimin-e-cilesise-se-sherbimeve-te-ofruara
Pyetësori i studentëve për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara prej stafit administrativ dhe ndihmësakademik, viti akademik 2020-2021

https://univlora.edu.al/njoftime/pyetesori-i-studenteve-per-vleresimin-dhe-permiresimin-e-cilesise-se-sherbimeve-te-ofruara-prej-stafit-administrativ-dhe-ndihmesakademik

Fokus-grupe me studentë

Fokus grupe me studentë në prag diplomimi në Fakultetin e Ekonomisë, dhe Fakultetin e Shkencave Humane gjatë muajit shkurt 2025
https://univlora.edu.al/njoftime/fokus-grupe-me-studente-ne-prag-diplomimi-shkurt-2025
Fokus-grupet mars - prill 2024
https://univlora.edu.al/njoftime/fokus-grupe-me-studente-gjate-muajit-mars-prill-2024
Fokus-grupet Master maj 2023
https://univlora.edu.al/njoftime/aktiviteteve-te-organizuara-te-fokus-grupeve-me-studente-ne-prag-diplomimi-te-disa-prej-programeve-master-ne-fakultetin-e-shkencave-teknike-dhe-natyrore-fakultetin-e-shkencave-humane-dhe-drejtesise
Fokus Grupe Bachelor 2022
https://univlora.edu.al/njoftime/aktivitete-te-organizuar-ne-kuader-te-fokus-grupeve-te-realizuara-me-studente-ne-prag-diplomimi-te-tre-prej-programeve-bachelor-ne-fakultetin-e-ekonomise

Pyetësori për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet ALUMNI-t

https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-rezultateve-te-pyetesorit-te-alumni-t

Sondazhi kombëtar i studentëve

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 109, datë 15.02.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) e të Bordit të Akreditimit (BA) dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë", një nga mekanizmat kryesorë të sigurimit të jashtëm të cilësisë është vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS). SKS është një instrument i jashtëm me anë të të cilit vlerësohet se në çfarë mase institucionet përmbushin kënaqshmëritë e studentëve sipas këndvështrimit të tyre. Procesi është anonim dhe bazohet tërësisht në opinionin individual të studentëve për institucionet ku ata studiojnë. UV pas takimeve informuese me përfaqësuesit e Ascal,ka nisur me fushatat në të 4 Fakultetet , ku ka prezantuar këtë instrument dhe ka asistuar studentën në plotësimin e tij masivisht nga studentët.

Njoftime në faqe web UV për Sondazhin Kombëtar të Studentëve 2025
https://univlora.edu.al/njoftime/takim-informues-ne-kuader-te-sondazhit-kombetar-te-s
https://univlora.edu.al/njoftime/sondazhi-kombetar-i-studenteve-2025https://univlora.edu.al/njoftime/thirrje-per-sondazhin-kombetar-te-studentevetudenteve-s

Universiteti gjithashtu dokumenton proceset e diplomimit dhe ecurinë e studentëve në tregun e punës përmes regjistrimeve të diplomave, statistikave të punësimit, bashkëpunimit me ish-studentët (alumni) dhe partnerët e industrisë. Këto të dhëna përdoren për analizë të brendshme dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve dhe metodave të mësimdhënies.

Vendim Senati Akademik nr 97, datë 21.210.2020: "Për miratimin e pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UV "
https://univlora.edu.al/media/dokument/vsa97-2020.pdf
Vendimin e Senatit Akademik Nr. 26, datë 12.05.2021: "Për disa ndryshime ne VSA Nr. 74, datë 16.06.2020"
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2021/05/Vendim-Senati-Nr.-25-date-12.05.2021-Per-nje-ndryshim-ne-VSA-nr.51date-20.09.2019-.....pdf
Vendimin e Senatit Akademik Nr.74 datë 16.06.2020 : "Për Procedurën e analizës së pyetësorëve të studentëve për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara prej stafit administrativ dhe ndihmësakademik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2020/07/vendim-nr-74.pdf
Vendim Senati Nr. 13, datë 06.05.2021: "Për Miratimin e Planit të Veprimit në Kuadër të Rekomandimeve të lëna nga Bordi Akreditimit."

https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2021/05/Vendim-Senati-Nr.-13-date-06.05.2021-Per-Miratimin-e-Planit-te-Veprimit-ne-Kuader-te-Rekomandimeve-te-Lena-nga-Bordi-Akreditimit.pdf
Vendim Senati Akademik Nr 20, dt 24.04.2023: "Për miratimin e procedurës të analizës dhe vlerësimit të pyetësorit të vlerësimit të cilësisë të programeve të studimit nëpërmjet alumnit"
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2023/09/Vendim-Senati-Nr.-20-date-24.04.2023-Per-miratimin-e-procedures-te-analizes-dhe-vleresimit-te-pyetesorit-te-vleresimit-te-cilesise-te-prog.-te-studimit-nepermjet-alumnit.pdf

Standardi I.10 Institucioni përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e mara në vijim të tyre.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka vendosur një qasje të strukturuar për Sigurimin e Cilësisë së Brendshme (SBC) në programet e studimit, duke përfshirë në mënyrë aktive njësitë akademike, stafin akademik dhe studentët në të gjitha fazat e procesit: planifikimin, zhvillimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve. Kjo përfshirje e aktorëve të brendshëm siguron që proceset vendimmarrëse të bazohen në analizë të dhënash dhe përvojë praktike.

Procesi i SBC përfshin:
- Mbledhje dhe diskutime në departamente dhe fakultete, ku identifikohen dobësitë dhe forcat e programeve.
- Pjesëmarrje e studentëve në anketa dhe feedback, për të vlerësuar përmbajtjen dhe mjetet mësimore.
- Raporte periodike të monitorimit dhe vetëvlerësimit, të cilat përmbajnë rekomandime konkrete për përmirësim.

Rezultatet e këtyre proceseve dhe masat e ndërmarra publikohen dhe komunikohet përmes:
- Faqes zyrtare të universitetit, ku shpallen raportet e SBC dhe vendimet e nxjerra.
- Njoftime dhe raporte për organet kolegjiale, të tilla si Senati Akademik dhe Dekanati.
- Raporte të përmbledhura për studentët dhe stafin, për të garantuar transparencë dhe pjesëmarrje aktive.

Rezultatet e proceseve të sigurimit të brendshëm të cilësisë analizohen dhe diskutohen në organet përkatëse akademike, ndërsa palët e interesuara informohen në mënyrë periodike mbi gjetjet kryesore dhe masat e marra për përmirësimin e programeve të studimit. Informimi realizohet përmes raporteve zyrtare, publikimeve institucionale dhe komunikimit formal, duke garantuar përfshirje, llogaridhënie dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë akademike. Grupet e vlerësimit të brendshëm ngrihen me urdhër dekani dhe kanë në përbërjen e tyre staf akademik dhe studentë të programit përkatës. Në raportin vjetor 2023-2024 (faqe 65) jepet një informacion i plotë mbi të gjitha GVB e ngritura, si dhe grupet e punës për nxjerjen e rekomandimeve mbi raportet e gjeneruara për vlerësim nga instrumentat që UV implementon.

Përmes këtij procesi, Universiteti siguron që përmirësimi i programeve të jetë i vazhdueshëm, bazuar në të dhëna të matshme dhe rekomandime të përbashkëta. Ky sistem promovon gjithashtu një kulturë bashkëpunimi dhe dialogu midis studentëve, stafit akademik dhe administrativ.

Raporti vjetor 2024-2025 (faqe 65)
https://univlora.edu.al/media/dokument/raport-vjetor-institucional-2024-2025.pdf
Raporti vjetor 2023-2024 (faqe 89)
https://univlora.edu.al/media/dokument/raporti-veprimtarise-uv-2023-2024-opt.pdf
Raporti vjetor 2022-2023 (faqe 326)
https://drive.google.com/file/d/1psq8R_5JfxDdycvYmWwqQOEI5pIpqq_L/view

Trajnim: "Përfshirja e personelit akademik në procesin e sigurimit të cilësisë".
https://univlora.edu.al/njoftime/trajnim-perfshirja-e-personelit-akademik-ne-procesin-e-sigurimit-te-cilesise
Takim informues mbi SSBCA me studentët e vitit të parë
https://univlora.edu.al/njoftime/aktivitete-informuese-dhe-sensibilizuese-me-studentet-e-viteve-te-para-

mbi-instrumentat-qe-uv-perdor-per-sigurimin-e-brendshem-te-cilesise-si-dhe-mbi-mundesite-e-shkembimit-studentor-ne-kuader-te-prog

Work shop 'Optimizimi i programeve të studimit të mësuesisë & Sfidat për një edukim cilësor afatgjatë' https://univlora.edu.al/njoftime/workshop-me-teme-optimizimi-i-programeve-te-studimit-te-mesuesise-sfidat-per-nje-edukim-cilesor-afatgjate

Takim këshillues në kuadër të projektit "Bologna Hub Peer Support" për Zhvillimi i Kurrikukalave; Qasjet Invovative në Mësimdhënie e Mësimnxënie. https://univlora.edu.al/njoftime/takimi-i-pare-keshillues-ne-kuader-te-projektit-bologna-hub-peer-support

E.52: Raporte të departamenteve mbi implementimin e rekomandimeve të dala nga vlerësimi i programeve.

E.53: Plan masa Alumni

E.54: Raport aktivitetesh SSBCA: (Takim informues mbi SSBCA me studentët e vitit të parë, Work shop Optimizimi i programeve të studimit të mësuesisë & Sfidat për një edukim cilësor afatgjatë)

Standardi I.11 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka vendosur politika dhe procedura të qarta dhe të strukturuara për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBCA). Këto politika synojnë efektivitetin, transparencën dhe publikimin e informacionit, si dhe ndërtimin e një kulture të brendshme të cilësisë që përfshin stafin akademik, studentët dhe njësitë administrativë. Në strukturat institucionale të UV-së funksionon Sektori i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Akreditimit. Ai ka një rol të rëndësishëm në garantimin e cilësisë dhe në menaxhimin e proceseve të akreditimit brenda UV-së.

Detyrat e këtij sektori janë të lidhura ngushtë me sigurinë e standardeve të cilësisë, vlerësimin e performancës dhe sigurinë që UV përmbush kërkesat dhe rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare:

Përgatitja dhe Zbatimi i Politikave të Cilësisë

- Hartimi, implementimi dhe përditësimi i politikave dhe procedurave të brendshme për sigurimin e cilësisë.
- Sigurimi që këto politika të jenë në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë.

Menaxhimi i Procesit të Akreditimit

- Koordinimi i proceseve të akreditimit për programe, departamente ose tërë institucionin.
- Sigurimi që institucioni të përmbushë kriteret dhe kërkesat për akreditim të brendshëm dhe ndërkombëtar.

Vlerësimi dhe Monitorimi i Cilësisë

- Monitorimi i vazhdueshëm i performancës dhe cilësisë së proceseve, aktiviteteve dhe shërbimeve brenda institucionit.
- Pjesëmarrja në zhvillimin e mekanizmave të vlerësimit të cilësisë për të identifikuar fushat që kërkojnë përmirësim.
- Analizimi i feedback-ut nga studentët, stafi dhe palët e tjera të interesuara për të siguruar që standardet e cilësisë të përmbushen.

Trajnimi dhe Ngritja e Aftësive të Stafit

- Organizimi i trajnimeve dhe workshop-eve për stafin e institucioneve lidhur me proceset e sigurimit të cilësisë dhe akreditimit.
- Ofrimi i mbështetjes për departamentet dhe fakultetet në zbatimin e standardeve të cilësisë.

Përgatitja dhe Mbikëqyrja e Raporteve të Cilësisë

- Hartimi dhe përgatitja e raporteve të brendshme dhe të jashtme mbi cilësinë dhe akreditimin për autoritetet dhe palët e interesuara.

- Sigurimi që këto raporte të jenë të saktë, të plota dhe të përputhshme me kërkesat e akredituesve dhe autoriteteve përkatëse.

Përmirësimi i Vazhdueshëm i Cilësisë

- Identifikimi dhe implementimi i strategjive për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe aktiviteteve brenda institucionit.
- Sigurimi i një procesi të vazhdueshëm të vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e palëve të interesuara.

Koordinimi me Entet e Akreditimit dhe Autoritetet Rregullatore

- Bashkëpunimi me agjencitë kombëtare dhe ndërkombëtare të akreditimit për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e akreditimit.
- Ndihma në përgatitjen e raporteve për proceset e akreditimit dhe auditeve nga autoritetet rregullatore dhe agjencitë akredituese.

Angazhimi me Studentët dhe Palët e Interesuara

- Ofrimi i mundësive për studentët, pedagogët dhe palët e tjera të interesuara për të dhënë feedback lidhur me cilësinë e shërbimeve dhe aktiviteteve të institucionit.
- Koordinimi i sondazheve dhe aktiviteteve të tjera për të mbledhur informacion nga studentët dhe stafi për të vlerësuar cilësinë dhe nevojat për përmirësim.

Sigurimi i Transparencës dhe Llogaridhënies

- Sigurimi që proceset e sigurimit të cilësisë dhe akreditimit të jenë transparente dhe të mbështetura me dokumentacion të plotë dhe të qartë.
- Ofrimi i informacionit të nevojshëm për autoritetet dhe palët e interesuara mbi masat e cilësisë dhe rezultatet e akreditimit.

Faqja zyrtare e Universitetit 'Ismail Qemali' ka një sektor të dedikuar për Sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të Cilësisë (https://univlora.edu.al/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise; https://univlora.edu.al/sigurimi-i-jashtem-i-cilesise), si dhe një sektor për Programin e Transparencës (https://univlora.edu.al/programi-i-transparences). Të dy këta sektorë pasqyrojnë arkivat dhe databasa-t e raportimeve periodike të SBCA dhe aktiviteteve në kuadër të përmirësimit të cilësisë.

Kultura e brendshme e cilësisë është forcuar përmes trajnimeve, takimeve koordinuese, dhe nxitjes së bashkëpunimit midis departamenteve dhe fakulteteve, duke siguruar që të gjithë aktorët të jenë pjesë e një procesi të vazhdueshëm për përmirësim të cilësisë.(**E.28, E.23** fq.14-28**, E.54)**

<u>Përfundimi dhe Vlerësimi</u>

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka vendosur një strukturë funksionale dhe transparente të qeverisjes, që operon në përputhje me statutin dhe ligjin për arsimin e lartë. Organe kolegjiale dhe departamentale funksionojnë sipas rregullave institucionale, duke favorizuar debat konstruktiv dhe pjesëmarrje të aktorëve të brendshëm dhe duke publikuar veprimtaritë kryesore dhe raportet vjetore për të siguruar transparencë.

Universiteti harton dhe zbaton politika dhe procedura të qarta për sigurimin e cilësisë në programet e studimit, duke garantuar që proceset e hapjes, zhvillimit, monitorimit dhe vlerësimit të programeve të jenë të dokumentuara, të publikuara dhe të aksesueshme për studentët, stafin dhe njësitë akademike. Instrumentet e matjes dhe indikatorët e përcaktuar lejojnë monitorim të vazhdueshëm të programeve, vlerësim të ecurisë së studentëve, dhe lidhje të drejtpërdrejtë me tregun e punës.

Arritjet më kuptimplotë të Universitetit 'Ismail Qemali' në fushën e menaxhimit, autonomisë dhe sigurimit të cilësisë gjatë 5 vjeçarit të fundit janë:

- Ngritja e një strategjie zhvillimore të UV-së, që synon ta çojë performancën e saj drejt standarteve të një universiteti 4.0.
- Përshtatja e Statutit dhe strukturës institucionale të UV-së me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe aktet nënligjore në fuqi.
- Zgjerimi i kuadrit rregullator të UV-së, në Rregulloren e përgjithshme dhe me një numër rregulloresh

specifike, me përcaktime të qarta dhe të detajuara për të gjitha proceset e realizuara në UV. Në këtë mënyrë, të gjitha detyrat funksionale dhe procedurat e UV-së zhvillohen sipas rregullave të mirëpërcaktuara, të diskutuara gjerësisht dhe të miratuara në organet kolegjiale të saj.

- Krijimi i sistemit të raportimit shkresor për çdo aktivitet të kryer në nivel institucional dhe personal. Veçanërisht pas aktiviteteve të zhvilluara jashtë UV-së (mobilitete, pjesëmarrje në evente) personeli raporton për veprimtarinë e vet dhe rekomandimet që jep mbi implementimin e risive të konstatuara në UV.
- Fuqizimi i aktivitetit të Sektorit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Zhvillimin e proceseve të vlerësimeve institucionale dhe studentore për cilësinë e programeve të studimit dhe shërbimeve të ofruara nga UV dhe pasqyrimin transparent të tyre në faqen zyrtare të saj.

Përmes përfshirjes së studentëve, stafit akademik dhe njësive administrative në proceset e SBC, Universiteti ka ndërtuar një kulturë të brendshme të cilësisë, ku vendimmarrja bazohet në të dhëna të matshme dhe rekomandime të formalizuara. Publikimi i raporteve dhe rezultatet e masave të ndërmarra janë të qasshme për të gjitha palët e interesit, duke rritur transparencën dhe besueshmërinë e institucioneve.

Si fusha për zhvillim të mëtejshëm në Strategjinë e Zhvillimit të UV-së evidentohet akreditimi ndërkombëtar i UV-së dhe më pas përfshirja e UV-së në rankime të rëndësishme ndërkombëtare – strategji, që do të rrisë kredibilitetin e UV-së dhe do të zgjerojë hapjen e saj ndaj studentëve ndërkombëtarë.

STANDARDI I - PËRMBUSHET PLOTËSISHT

II – BURIMET DHE PARTNERITETI

Standardi II.1 Institucioni ndjek një politikë të hapur të punësimit dhe të rekruktimit të burimeve njerëzore.

Politika e hapur e punësimit dhe rekrutimit përbën një element kyç të sigurimit të cilësisë institucionale, duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve njerëzore dhe përmbushjen e misionit dhe objektivave strategjike të institucionit.
Institucioni zbaton një politikë të hapur, transparente dhe gjithëpërfshirëse të punësimit dhe rekrutimit të burimeve njerëzore, e cila synon të sigurojë përzgjedhjen e stafit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ mbi bazën e meritës, kualifikimeve profesionale dhe nevojave reale të zhvillimit institucional. Politika e punësimit mbështetet në kuadrin ligjor në fuqi për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe në Rregulloren e Përgjithshme të UV-së (**E.4**). Në këtë rregullore parashikohen procedurat dhe afatet e punësimit për të gjitha kategoritë e personelit akademik dhe joakademik, vendosja e kritereve bazë dhe favorizuese të punësimit, procedura dhe afatet e ankimimit.

Rregullore UV, neni 41 - Punësimi i stafit akademik me kohë të plotë (PAE);
Rregullore UV, neni 44 - Punësimi i stafit akademik me kohë të pjesshme (PAK)*;*
Rregullore UV, neni 43 - Punësimi i Pedagogëve të ftuar;
Rregullore UV, neni 45 - Punësimi i personelit ndihmësakademik në nivel institucioni*;*
Rregullore UV, neni 47 - Punësimi i personelit administativ*;*

Procedurat e rekrutimit janë të standardizuara dhe të dokumentuara, duke garantuar barazi mundësish, mosdiskriminim dhe transparencë në të gjitha fazat e procesit, që nga shpallja publike e vendeve vakante, kriteret e pranimit dhe dokumentacioni i kërkuar, deri tek vlerësimi i kandidatëve dhe vendimmarrja përfundimtare.

Shpalljet e vendeve të punës bëhen përmes faqes zyrtare të UV-së (https://univlora.edu.al/njoftimek/6), duke siguruar akses të gjerë për kandidatët e interesuar.

UV angazhon struktura dhe komisione të posaçme për vlerësimin e kandidatëve, të cilat funksionojnë mbi parime objektiviteti dhe profesionalizmi. Procesi i përzgjedhjes bazohet në kritere të matshme, si: formimi akademik, përvoja mësimore dhe kërkimore, produktiviteti shkencor dhe aftësitë pedagogjike, të cilat përllogariten të pikëzuara në një tabelë që kandidatëve u bëhet e ditur paraprakisht përpara mbylljes së afatit të aplikimeve.

E.55: Procedurë punësimi PAE, PAK, personel ndihmësakademik, personel administrativ.

Standardi II.2 Institucioni ndjek një politikë integruese të personelit akademik, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ndjek një politikë integruese ndaj të gjitha kategorive të personelit, duke synuar funksionimin harmonik të strukturave akademike dhe administrative në funksion të realizimit të misionit institucional. Kjo politikë bazohet në Statutin e institucionit (**E.1**), rregulloret e brendshme (**E.4**) dhe aktet përkatëse ligjore, të cilat përcaktojnë qartë rolet, përgjegjësitë dhe ndërveprimin mes personelit akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ (**E.23**).

Universiteti 'Ismail Qemali' ka përcaktuar procedura të qarta në aktet e tij rregullatore për rekrutimin e personelit të ftuar dhe akademikëve të huaj (**E.56**), (**E.4:** Rregullore UV, neni 43, 41.X.C). Për të garantuar cilësi të lartë në procesin e mësimdhënies, UV punëson me kontratë për periudha të shkurtra kohe studiues dhe personalitete të fushave të caktuata të shkencës dhe artit, vendas ose të huaj. Personeli akademik i ftuar mund të jetë:

a) personel akademik i punësuar në IAL brenda Shqipërisë, minimalisht me titull "Profesorë";
b) personalitet apo specialist i shquar, i punësuar në një institucion të rëndësishëm në një fushë të caktuar, që do të ndajë me studentët përditësimet e fundit të fushës përkatëse;
c) personel akademik i diasporës shqiptare, minimalisht me titull PhD;
d) personel akademik i IAL të BE, OECD, G-20, minimalisht me titull PhD;

Për përzgjedhjen e personelit akademik të ftuar ndërthuren kualifikimet e tyre me nevojën e njësisë bazë për veprimtari mësimdhënieje ose kërkimore-shkencore.

E.56.: Procedurë punësimi pedagog i ftuar, pedagog i huaj.

Integrimi i personelit realizohet përmes përfshirjes së tyre në strukturat vendimmarrëse dhe konsultative të institucionit, në komisione të përkohshme dhe të përhershme, si dhe në proceset e planifikimit akademik, administrativ dhe financiar. Personeli akademik dhe ndihmës mësimor-shkencor bashkëpunon ngushtë me strukturat administrative për garantimin e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve ndaj studentëve, duke kontribuar në funksionimin efikas të institucionit.

Institucioni mbështet zhvillimin profesional të të gjithë personelit përmes trajnimeve të përbashkëta, aktiviteteve informuese dhe shkëmbimit të praktikave më të mira, duke nxitur kulturën e bashkëpunimit dhe komunikimit ndërinstitucional. Gjithashtu, politikat e brendshme synojnë krijimin e një mjedisi pune gjithëpërfshirës, të bazuar në barazi, transparencë dhe respekt reciprok.

Procesi vendimmarrës në UV

- Procedurat e vendimmarrjeve që impaktojnë funksionimin e njësive bazë fillojnë nga propozimet e grupeve të punës dhe vendimmarrjet propozuese në mbledhjet e departamenteve. Në këtë mënyrë asambleja akademike shpreh opinionin e saj përpara miratimeve në Senatin Akademik apo Bordin e Administrimit.
- Dokumentat e rëndësishëm rregullatorë të UV-së: Rregullorja e përgjithshme (**E.4**), Strategjia e Zhvillimit 2025-2030 (**E.35**), kanë vajtur me rrugë elektronike (e-maile zyrtare **@univlora.edu.al**) tek të gjithë drejtuesit e njësive bazë me udhëzimin e diskutimit të tyre në mbledhjet e departamenteve dhe dërgimin e sugjerimeve për përmirësim. Vetëm pasi ka përfunduar ky proces është vazhduar më tej me miratimin e këtyre dokumenteve të kontrolluara në bazë të propozimeve të ardhura nga të gjitha njësitë bazë.

  E.57: Komunikimi elektronik me njësitë bazë për diskutimin e rregullores së përgjithshme të UV-së.

Menaxhimi financiar në UV

- Fondi buxhetor i UV-së ndahet në bazë të kërkesave buxhetore (**E.26**) të njësive bazë, të cilat kalojnë për miratim në Rektorat, Senat Akademik dhe Bordin e Administrimit;
- UV jep mbështetje financiare për rimbursimin e aktiviteteve shkencore të të gjithë pedagogëve pa filtrim duke u mbështetur në rregulloren financiare (**E.7**):
  - për shpenzimet e ndjekjes së konferencave shkencore,
  - fee të publikimit të artikujve shkencorë,
  - tarifave të marrjes së titujve akademikë.

  VSA për rimbursim tituj akademik, konferenca, rimbursim tarife:
  https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/01/Vendim-Senati-Nr.-66-Date-06.11.2024-Per-disa-Ndryshime-ne-vendimin-nr.-2.pdf
  https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/04/Vendim-Nr.-2-Senati-Akademik-2024.pdf
  https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2017/12/Vendim-Senati-Nr.75-date-13.07.2017.pdf

  E.58: Procedurë rimbursimi artikuj shkencore, konferenca, tituj akademik.

Përfshirja në veprimtaritë ekstrakademike të UV-së

Njoftimet për thirrje projektesh, mobilitete, zhvillim aktivitetesh përcillen:

- Në rrugë elektronike në adresat zyrtare të të gjithë pedagogëve;
- Në faqen zyrtare dhe mediat sociale të UV-së;

Grupet e punës për aktivitete institucionale apo hartim dokumentash strategjikë kanë gjithëpërfshirje të

personelit të të gjitha kategorive.

Thirrje për aplikim projekti:
https://univlora.edu.al/njoftime/thirrje-per-aplikime-programi-read-kohorta-e-5-te
Njoftime aktivitetesh në kuadër të projekteve:
https://univlora.edu.al/njoftime/universiteti-i-vlores-ne-konventen-kombetare-te-projektit-zero-c
https://univlora.edu.al/njoftime/sesion-trajnimi-te-titulluar-njohurite-mbi-pronen-industriale-dhe-te-drejtat-qe-ato-perfshijne

E.59: *Ngritja e grupeve të punës për procedurat institucionale*: Urdhër i Rektorit për ngritjen e grupeve të punës për akreditimin institucional; Vendime Dekani mbi ngritjen e GVB të programeve; Urdhër i Rektorit për ngritjen e grupit të punës për organizimet e 30-vjetorit të UV-së.

E.60: Komisione ad-hoc me përbërje të personelit akademik: punësimi; Erasmus+; hartime programesh të reja; pranime studentësh; ekuivalentimi modulesh.

E.61: *Vendimi i Rektoratit nr. 22, datë 24.10.2024 dhe relacion 6-mujor*, për skedën informuese. Skedë informuese për aktivitete për rritje kapacitetesh nga staf akademik; Skedë informuese për aktivitete për rritje kapacitetesh nga staf joakademik; Skedë informuese pas mobiliteteve nga staf akademik; Skedë informuese pas mobiliteteve nga staf joakademik.

Standardi II.3 Institucioni ndjek një politikë të vlerësimit të aftësive të personelit të tij dhe fokusohet në zhvillimin e mëtejshëm të tyre.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë zbaton një politikë të strukturuar për vlerësimin periodik të aftësive dhe performancës së personelit akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ, me qëllim garantimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe shërbimeve universitare.

Vlerësimi i personelit akademik dhe jo-akademik realizohet përmes:

- raporteve vjetore;
- vlerësimit individual të indikatorëve të performancës akademike dhe administrative në formularët e vlerësimit të personelit;
- pyetësorëve të vlerësimit nga studentët;

Raportet vjetore analizojnë rezultatet e vitit akademik: cilësinë akademike të kërkimit shkencor.

Raporti i vitit akademik 2024-2025
https://univlora.edu.al/media/dokument/raport-vjetor-institucional-2024-2025.pdf
Raporti i vitit akademik 2023-2024
https://univlora.edu.al/media/dokument/raporti-veprimtarise-uv-2023-2024-opt.pdf
Raporti i vitit akademik 2022-2023
https://drive.google.com/file/d/1psq8R_5JfxDdycvYmWwqQOEI5pIpqq_L/view
Raporti i vitit akademik 2021-2022
https://drive.google.com/file/d/1oMXjeUvL4wahpqVtrxmh6LTt2bU8YhwX/view
Raporti i vitit akademik 2020-2021
https://drive.google.com/file/d/1mtw02Sdw9ieCPMWR7OZrBBdIXyhvUgMq/view

Vlerësimi individual i performancës së personelit të UV-së (Standardi II.6) është i detajuar në aktet rregullatore të UV-së, përfshin vlerësimin e rezultateve individuale në punë për secilin personel akademik, ndihmësakademik dhe administrativ të UV-së dhe fokusohet në aspektin e realizimit të objektivave specifike dhe të matshme që duhet të arrihen deri në fund të periudhës së vlerësimit; si dhe vlerësimit të sjelljes profesionale ku përfshihen një sërë aftësish teknike të njohurive dhe/ose të sjelljes, të përcaktuara paraprakisht. Vlerësimi i performancës ka për qëllim të sigurojë informacion periodik nëse aftësitë dhe kompetencat e personelit janë të përshtatshme për realizimin e objektivave individuale, për të krahasuar rezultatet me pritshmëritë, për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe masat dhe veprimet përmirësuese që duhen ndërmarrë.

Formularët e performancave dorëzohen nga menaxherët e procesit të vlerësimit pranë Drejtorisë së

Shërbimeve Ndihmësakademike për Sektorin e Burimeve Njerëzore, dokumentohen në një regjistër të posaçëm dhe bëhen pjesë e dosjes individuale të personelit (**E.4**, neni 50).

VSA per vlerësim performance:
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2017/12/Vendim-Senati-Nr.52-date-20.04.2017.pdf
https://univlora.edu.al/media/dokument/vsa97-2020.pdf

Pyetësorët e vlerësimit nga studentët

Në këtë proces përfshihen edhe mekanizma të feedback-ut nga studentët, të cilët shërbejnë si instrument i rëndësishëm për identifikimin e nevojave për përmirësim dhe zhvillim profesional.

https://univlora.edu.al/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise

Pyetësori i studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UV

Raport i analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies viti akademik 2024-2025
https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve-2024-2025
Raport i analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies viti akademik 2023-2024
https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve-2023-2024
Raport i analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies viti akademik 2022-2023
https://univlora.edu.al/njoftime/raport-i-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve-per-cilesine-e-mesimdhenies-2022--2023
Raport i analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies viti akademik 2021-2022
https://univlora.edu.al/njoftime/raport-i-analizes-se-pyetesorve-te-studenteve-per-cilesine-e-mesimdhenies-viti-akademik-2021---2022
Raport i analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies viti akademik 2020-2021
https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve-2020-2021
Raport i analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies viti akademik 2019-2020
https://univlora.edu.al/njoftime/raporte-te-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve-per-cilesine-e-mesimdhenies-per-vitin-akademik-2019-2020

Pyetësori i Vlerësimit të Cilësisë së Shërbimeve të ofruara prej stafit ndihmës-akademike dhe administrativ të UV-së

Raporti i analizës së rezultateve të pyetësorëve të studentëve për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara prej stafit ndihmësakademik dhe administrativ, viti akademik 2023-2024
https://univlora.edu.al/njoftime/raport-dhe-rekomandime-per-permiresimin-e-cilesise-se-sherbimeve-administrative
Raport i analizës së rezultateve të pyetësorëve të studentëve për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara, viti akademik 2022-2023
https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-rezultateve-te-pyetesoreve-te-studenteve
Raport i analizës së rezultateve të pyetësorëve të studentëve për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara, viti akademik 2021-2022
https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-rezultateve-te-pyetesoreve-te-studenteve-per-vleresimin-dhe-permiresimin-e-cilesise-se-sherbimeve-te-ofruara
Pyetësori i studentëve për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara prej stafit administrativ dhe ndihmësakademik, viti akademik 2020-2021
https://univlora.edu.al/njoftime/pyetesori-i-studenteve-per-vleresimin-dhe-permiresimin-e-cilesise-se-sherbimeve-te-ofruara-prej-stafit-administrativ-dhe-ndihmesakademik

Zhvillimi i mëtejshëm i aftësive të personelit të UV-së

Rezultatet e vlerësimit përdoren jo vetëm për qëllime administrative, por kryesisht për orientimin e politikave të trajnimit dhe zhvillimit të kapaciteteve njerëzore. Universiteti 'Ismail Qemali' i kushton rëndësi të veçantë zhvillimit të vazhdueshëm profesional të personelit nëpërmjet dy qasjeve kryesore:

- Duke mbështetur financiarisht, me logjistikë dhe leje akademike marrjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë të stafit akademik;

- Duke ofruar dhe inkurajuar pjesëmarrjen në trajnime, seminare, programe kualifikimi, mobilitete akademike dhe aktivitete të tjera formuese brenda dhe jashtë vendit. Këto masa synojnë përmirësimin e aftësive pedagogjike, kërkimore, menaxheriale dhe digjitale të stafit, si dhe përshtatjen me zhvillimet bashkëkohore në arsimin e lartë (**E.61**).

Aktivitete për rritjen e kapaciteteve të personelit akademik dhe jo-akademik të UV-së:

Workshop: *"Optimizimi i programeve të studimit të mësuesisë. Sfidat për një edukim cilësor afatgjatë*". *https://univlora.edu.al/njoftime/workshop-me-teme-optimizimi-i-programeve-te-studimit-te-mesuesise-sfidat-per-nje-edukim-cilesor-afatgjate;*

Takim këshillues në kuadër të projektit "Bologna Hub Peer Support": *Zhvillimi i Kurrikukalave; Qasjet Invovative në Mësimdhënie e Mësimnxënie; Mobilitetet dhe Ndërkombëtarizimi.* https://univlora.edu.al/njoftime/takimi-i-pare-keshillues-ne-kuader-te-projektit-bologna-hub-peer-support

Standardi II.4 Institucion ndjek një politikë të zhvillimit social.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ndjek një politikë të qartë të zhvillimit social, e cila synon krijimin e një mjedisi universitar gjithëpërfshirës, të barabartë dhe mbështetës për të gjithë anëtarët e komunitetit akademik. Kjo politikë mbështetet në parimet e barazisë, respektimit të diversitetit, solidaritetit social dhe përgjegjësisë institucionale, duke reflektuar misionin e universitetit si institucion publik në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm shoqëror dhe rajonal.

Respektimi i diversitetit dhe gjithëpërfshirja sociale

Në këtë kuadër, institucioni zbaton masa konkrete për përmirësimin e mirëqenies sociale të personelit dhe studentëve, duke garantuar trajtim të barabartë, mosdiskriminim dhe respektim të dinjitetit njerëzor në të gjitha proceset akademike dhe administrative. Departamentet e UV-së planifikojnë sistematikisht kuota të posacme për kategori të caktuara sociale në të gjitha programet e studimit.

E.62: Regjistrimi i studentëve me kuota të veçanta.

VSA për kuotat e programeve të studimit:
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/04/Vendim-Nr.-10-Senati-Akademik-2024.pdf
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2021/02/Vendim-Nr.-2-Date-26.01.2021-Per-Miratimin-e-Kuotave-te-Pranimit-ne-Programet-e-Studimit-per-te-Gjitha-Ciklet-e-Studimit-per-Vitin-Akademik-2021-2022.pdf
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2022/02/Vendim-Senati-Nr.-5-date-02.02.2022-Per-miratimin-e-kuotave-te-pranimit-te-studenteve-ne-te-gjitha-ciklet-e-studimit-pe-2022-2023.pdf

Institucioni ndjek një politikë të qartë mbështetëse për studentët me aftësi të kufizuara, duke synuar krijimin e kushteve të përshtatshme për ndjekjen e rregullt të procesit mësimor. Në këtë kuadër, janë ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e aksesit fizik në ambientet universitare. Në godinën C dhe A janë ndërtuar rampa hyrëse, të cilat rrisin ndjeshëm aksesueshmërinë për studentët me aftësi të kufizuara në lëvizje, duke u mundësuar atyre hyrje dhe qarkullim më të lehtë në ambientet e institucionit. Përveç masave infrastrukturore, institucioni ka përcaktuar edhe masa organizative për lehtësimin e ndjekjes së mësimit. Në rastet kur në programet e studimit ka studentë me aftësi të kufizuara, mësimi organizohet në ambiente të përshtatshme, kryesisht në katin e parë, për të shmangur pengesat fizike.

E.63: Procesverbal per vendosjen e rampeve.

Për studentët me aftësi të veçanta shqisore, si studentët shurdh-memecë apo studentët e verbër, stafi akademik ofron forma të përshtatura të vlerësimit të njohurive, duke zgjedhur mënyrën më të përshtatshme për secilin student. Këto masa synojnë garantimin e barazisë në vlerësim dhe respektimin e nevojave individuale, pa cënuar standardet akademike.

Institucioni zbaton politika mbështetëse për studentët që vijnë nga pakicat rome dhe ballkano-egjiptiane, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe parimet e barazisë, përfshirjes dhe mosdiskriminimit. Këta studentë përfshihen në kategoritë përfituese të masave mbështetëse financiare, si ulja apo heqja e tarifës së studimit,

sipas akteve nënligjore përkatëse.

Universiteti promovon barazinë gjinore, përfshirjen e grupeve vulnerabël dhe aksesin e barabartë në arsim, nëpërmjet politikave institucionale dhe praktikave të mbështetjes sociale (**E.32**).

Universiteti si pasuri komunitare dhe Qendër Zhvillimi Rajonal

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë inkurajon pjesëmarrjen aktive të komunitetit universitar në jetën sociale dhe kulturore, duke organizuar dhe mbështetur aktivitete kulturore, artistike, sportive dhe vullnetare, që kontribuojnë në zhvillimin personal dhe social të studentëve dhe stafit. Këto aktivitete shërbejnë gjithashtu si mekanizma për forcimin e ndjenjës së përkatësisë institucionale dhe për ndërtimin e marrëdhënieve bashkëpunuese brenda universitetit.

Vizitë e Këshillit Studentor në Parlamentin Shqiptar
https://univlora.edu.al/njoftime/studentet-e-univlores-ne-kuvendin-e-shqiperise
Kampionati ndërfakultetor i Futbollit
https://univlora.edu.al/njoftime/kampionati-i-futbollit-univlora
Maratona Studentore
https://univlora.edu.al/njoftime/kampionati-i-futbollit-univlora
Emisione 'Zëri i Studentëve', në bashkëpunim me BLUTV
https://www.youtube.com/watch?v=pbPtyjirNdM&list=PL1xZvVJM8wVTmljdYgVIt17tA2ta0UumE
Shërbime shëndetësore komunitare
https://univlora.edu.al/njoftime/vullnetarizem-ne-sherbim-te-komunitetit-nga-keshilli-studentor
Aktivitete sensibilizuese në Ditët Ndërkombëtare të Shëndetit
https://univlora.edu.al/njoftime/dita-boterore-e-shendetit-2025
Projektet Smart City
https://univlora.edu.al/njoftime/smart-city-hub

Në aspektin e përgjegjësisë sociale, institucioni zhvillon bashkëpunime me autoritete lokale, institucione publike, organizata të shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë të komunitetit, duke kontribuar në iniciativa me ndikim social, edukativ dhe kulturor në nivel lokal dhe rajonal. Kjo qasje forcon rolin e universitetit si aktor aktiv në zhvillimin shoqëror dhe rrit ndërveprimin ndërmjet universitetit dhe komunitetit.

Promovimi i përdorimit sistematik të qasjes administrative për të luftuar krimin e organizuar në Shqipëri:
https://univlora.edu.al/njoftime/promoting-the-systematic-use-of-the-administrative-approach-to-combat-organized-crime-in-albania
Dita Ndërkombetare e bankave:
https://univlora.edu.al/njoftime/aktivitet-dita-nderkombetare-e-bankave

Politikat strategjike të Universitetit 'Ismail Qemali'

Skenari IV – UV si Qendër Zhvillimi Rajonal

Linja strategjike	Objektivat strategjikë	Veprimet kryesore
IV.3 Rritja e vizibilitetit dhe identitetit universitar	IV.3.1 Zhvillimi i një identiteti të fortë institucional (Brand UniVlora)	Hartimi i strategjisë së brandimit universitar (logo, identitet vizual)
		Përditësimi i manualit të brandimit dhe aplikimi në të gjitha njësitë
		Standardizimi i dokumenteve dhe materialeve grafike zyrtare
	IV.3.2 Media universitare e fuqizuar	Modernizimi i *faqes zyrtare* me informacion të plotë dhe të përditësuar.
		Aktivizimi i platformave mediatike:
		Podcast UniVlora

		Gazeta studentore
		Radio universitare
		Kanale sociale (YouTube, Facebook, Instagram)
		Strategji e komunikimit publik dhe brandimit institucional.
	IV.3.3 Organizimi i eventeve të profilit të lartë akademik, shkencor dhe kulturor	Hartimi i kalendarit vjetor të eventeve flagship
		Organizimi i një Konference Ndërkombëtare vjetore "UniVlora Forum"
		Krijimi i një "Jave të Shkencës & Inovacionit" dhe "Javës Kulturore të UV"
		Ftesa të personaliteteve ndërkombëtare nga akademia, industria dhe kultura
		Tituj nderi për personalitete të spikatura të jetës akademike dhe komunitare
		Evente të hapura për komunitetin: leksione publike, ekspozita, debate, premiera filmash
		Gala vjetore e Ekselencës (Studentë, Akademikë, Alumni, Partnerë)
		Promovim multimedial i eventeve (videot, kronikat, dokumentarët)

Në përfundim, politika e zhvillimit social e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë kontribuon në krijimin e një mjedisi akademik të shëndetshëm, gjithëpërfshirës dhe dinamik, duke mbështetur zhvillimin integral të individit dhe përmbushjen e misionit institucional në funksion të shoqërisë.

Disa prej aktivitete socio-kulturore me impakt komunitar, të organizuar nga UV.

1. Dita Botërore e Shëndetit
   https://univlora.edu.al/njoftime/dita-boterore-e-shendetit-2025
2. Studentët e UniVlorës në Kuvendin e Shqipërisë
   https://univlora.edu.al/njoftime/studentet-e-univlores-ne-kuvendin-e-shqiperise
3. Aktiviteti festiv "Nëntori që flet"
   https://univlora.edu.al/njoftime/aktivitet-festiv-nentori-qe-flet
4. Bisedë e hapur me të rinj universitarë dhe të shkollave të mesme - Prec Zogaj
   https://univlora.edu.al/njoftime/promovim-i-librit-me-te-ri-me-poezi-i-autorit-prec-zogaj
5. Bisedë e hapur me të rinj universitarë dhe të shkollave të mesme - Gezim Tushi
   https://univlora.edu.al/njoftime/takim-me-autorin-gezim-tushi
6. Bisedë e hapur me të rinj universitarë dhe të shkollave të mesme – për Lefter Çipa
   https://univlora.edu.al/njoftime/biri-rrefen-atin---aktitiviteti-ne-nder-te-artistit-lefter-cipa
7. Bisedë e hapur me të rinj universitarë dhe të shkollave të mesme - Naxhi Kasoruho
   https://univlora.edu.al/njoftime/takim-me-muzikologun-naxhi-kasoruho
8. Bisedë e hapur me të rinj universitarë dhe të shkollave të mesme - Rita Petro
   https://univlora.edu.al/njoftime/takim-me-rita-petron-per-letersine-poezine-dhe-te-rinjte
9. Trajnim BLSD "Basic Life Support and Defibrillation"
   https://univlora.edu.al/njoftime/trajnimi-blsd-basic-life-support-and-defibrillation
10. Qendër simulatore për trajnim shëndetësor
    https://univlora.edu.al/njoftime/qender-simulatore-per-trajnim-shendetesor
11. Trajnim për rritje kapacitetesh i stafit akademik të Fakultetit të Shëndetit Publik
    https://univlora.edu.al/njoftime/trajnim-per-rritje-kapacitetesh-i-stafit-akademik-te-fakultetit-te-shendetit-publik
12. Seminar: "Antibiotikët; antibiotiko-rezistenca sfidë për shëndetin global"

https://univlora.edu.al/njoftime/zhvillohet-seminari-i-akredituar-nga-qkev-antibiotiket-antibiotiko-rezistenca-sfide-per-shendetin-global

13. Trajnim mbi shkrimin e një projekt cilësor
    https://univlora.edu.al/njoftime/trajnimi-mbi-shkrimin-e-nje-projekt-cilesor-prane-qendres-kerkimore-shkencore-ne-fakultetin-e-shendetit-publik
14. Aktiviteti "Dhuro Gjak" nga Fakulteti i Shëndetit
    https://univlora.edu.al/njoftime/aktiviteti-periodik-dhuro-gjak-i-ndermarre-nga-fakultetit-te-infermierise
15. Trajnim: "Walk-Through for Universities on Universal Treatment Curriculum for Substance Use Disorders"
    https://univlora.edu.al/njoftime/pedagoget-e-fakultetit-te-shendetit-publik-morren-pjese-ne-trajnimin-walk-through-for-universities-on-universal-treatment-curriculum-for-substance-use-disorders
16. Dita ndërkombëtare e mamisë, 5 maj 2022
    https://univlora.edu.al/njoftime/dita-nderkombetare-e-mamise-5-maj-2022
17. Java ndërkombëtare e Tallinn Health Care College
    https://univlora.edu.al/njoftime/perfaqesues-te-fakultetit-te-shendetit-moren-pjese-ne-javen-nderkombetare-te-tallinn-health-care-college
18. Aktivitet ndërgjegjësues nga Fakulteti i Shëndetit: "Përkujto - Mbështet - Vepro"
    https://univlora.edu.al/njoftime/ne-date-18-11-2022-departamenti-i-kujdesit-shendetesor-fakulteti-i-shendetit-organizoi-nje-aktivitet-me-karakter-edukues
19. Dita Ndërkombëtare e Shkopit të Bardhë
    https://univlora.edu.al/njoftime/dita-nderkombetare-e-shkopit-te-bardhe

Standardi II.5 Institucioni siguron qëndrueshmëri afatgjatë të personelit akademik gjatë periudhës midis dy akreditimeve.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ndjek politika dhe praktika të qëndrueshme për menaxhimin e burimeve njerëzore, me synim garantimin e vazhdimësisë dhe stabilitetit të personelit akademik gjatë gjithë periudhës midis dy proceseve të akreditimit. Kjo qasje është thelbësore për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, vazhdimësinë e mësimdhënies dhe zhvillimin e qëndrueshëm të aktivitetit kërkimor-shkencor.

Institucioni planifikon nevojat për personel akademik në përputhje me ofertën akademike, ngarkesën mësimore dhe objektivat strategjike të zhvillimit, duke siguruar mbulimin e programeve të studimit me staf të kualifikuar dhe të angazhuar në mënyrë afatgjatë (Standardi II.1). Politikat e punësimit dhe kontraktimit favorizojnë marrëdhënie të qëndrueshme pune, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret institucionale.

E.64: Kërkesë për punësim me analizën e ngarkesës mësimore të programeve të FSH;

E.65: *Kontrata punësimi*: kontratë pune me kohë të caktuar; kontratë pune me kohë të pacaktuar.

Universiteti mbështet zhvillimin profesional dhe avancimin akademik të stafit, si instrument kyç për ruajtjen e qëndrueshmërisë së tij, përmes krijimit të mundësive financiare dhe logjistike për kualifikim, kërkim shkencor, mobilitete, pjesëmarrje në projekte dhe bashkëpunime kombëtare e ndërkombëtare. Këto masa kontribuojnë në rritjen e motivimit profesional dhe në forcimin e lidhjes afatgjatë të personelit akademik me institucionin (**E.58**).

Në të njëjtën kohë, institucioni monitoron strukturën dhe përbërjen e personelit akademik, duke analizuar indikatorë si raporti staf/student, ngarkesa mësimore dhe mbulimi i disiplinave bazë e profesionale, me qëllim parandalimin e ndërprerjeve apo pasigurive që mund të ndikojnë në cilësinë e programeve të studimit.

E.66: Ngarkesa mësimore e DKSH.

Tabela aneks 8

Standardi II.6 Institucioni vlerëson dhe mbështet personelin e vet në përmbushjen e detyrimeve vjetore-akademike e administrative.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë zbaton mekanizma të qartë për vlerësimin dhe mbështetjen e personelit akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ në përmbushjen e detyrimeve të tyre vjetore, në funksion të garantimit të cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve universitare. Këto mekanizma mbështeten në kuadrin ligjor për arsimin e lartë, në Statutin (E.1) e institucionit dhe në rregulloret e brendshme që përcaktojnë përgjegjësitë, kriteret e vlerësimit dhe format e mbështetjes institucionale.

Vlerësimi individual i performancës së personelit të UV-së është i detajuar në aktet rregullatore të UV-së, përfshin vlerësimin e rezultateve individuale në punë për secilin personel akademik, ndihmësakademik dhe administrativ të UV-së dhe fokusohet në aspektin e realizimit të objektivave specifike dhe të matshme që duhet të arrihen deri në fund të periudhës së vlerësimit; si dhe vlerësimit të sjelljes profesionale ku përfshihen një sërë aftësish teknike të njohurive dhe / ose të sjelljes, të përcaktuara paraprakisht. Vlerësimi i performancës ka për qëllim të sigurojë informacion periodik nëse aftësitë dhe kompetencat e personelit janë të përshtatshme për realizimin e objektivave individuale, për të krahasuar rezultatet me pritshmëritë, për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe masat dhe veprimet përmirësuese që duhen ndërmarrë.
Formulari i Vlerësimit të personelit akademik, i miratuar me Vendim të SA *nr.52/2017 dhe nr. 97/2020* (**E.31**) dhe realizohet mbi bazën e treguesve të qartë dhe të matshëm, që përfshijnë cilësinë e mësimdhënies, aktivitetin kërkimor-shkencor, përfshirjen në projekte dhe bashkëpunime, kontributin institucional si dhe respektimin e etikës akademike. Formularët e performancave dorëzohen nga menaxherët e procesit të vlerësimit pranë Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakademike për Sektorin e Burimeve Njerëzore, dokumentohen në një regjistër të posaçëm dhe bëhen pjesë e dosjes individuale të personelit.
Kompetenca e menaxherëve të vlerësimit janë:

a) Performanca e Rektorit vlerësohet nga Ministri përgjegjës për Arsimin;
b) Performanca e Administratorit dhe përgjegjësit të Sektorit të Auditit të Brendshëm vlerësohet nga Bordi i Administrimit;
c) Rektori vlerëson performancën e zëvendësrektorëve dhe drejtuesve të njësive kryesore;
d) Administratori vlerëson performancën e drejtuesit të drejtorisë në varësi;
e) Zv/rektorët vlerësojnë performancën e drejtuesve të drejtorive në varësi;
f) Drejtorët vlerësojnë performancën e përgjegjësve të sektorëve në varësi;
g) Përgjegjësit e sektorëve vlerësojnë performancën e specialistëve në varësi;
h) Dekani vlerëson performancën e zëvendësdekanit, drejtuesve të njësive bazë dhe personelit ndihmësakademik me karakter administrativ në nivel njësie kryesore;
i) Drejtuesi i njësisë bazë vlerëson performancën e përgjegjësve të grupeve mësimore/kërkimore, personelit akademik të njësisë bazë, sekretares së departamentit dhe personelit ndihmësakademik me karakter mësimor në varësi (**E.4**, neni 50).

Mendimi i studentëve mbi performancën e personelit akademik dhe administrativ është shumë i rëndësishëm dhe vlerësohet periodikisht në kushte anonimiteti nëpërmjet sistemit të brendshëm të komunikimit UNVIMAS (Standardi II.3) - (**E.31**).

Standardi II.7 Institucioni disponon dhe menaxhon pasuritë e paluajtshme dhe fokusohet në zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tyre.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë disponon pasuri të paluajtshme të destinuara për realizimin e veprimtarisë akademike, kërkimore dhe administrative, të cilat administrohen në përputhje me kuadrin

ligjor në fuqi dhe aktet nënligjore që rregullojnë administrimin e pronës publike. Menaxhimi i këtyre pasurive realizohet përmes strukturave përgjegjëse institucionale, me qëllim sigurimin e funksionalitetit, sigurisë dhe përdorimit efikas të hapësirave universitare.

UV ka planifikuar zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës fizike në përputhje me nevojat e programeve të studimit, rritjen e numrit të studentëve, zhvillimet teknologjike dhe objektivat strategjike të institucionit. Investimet në godina mësimore, laboratorë, biblioteka, ambiente administrative dhe hapësira të përbashkëta synojnë përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve universitare.

E.67: *Infrastruktura*, planimetria e godinave, objekte ndërtesa, akt miratimi higjeno-sanitar, çertifikatë shërbimi sanitar; plane mirëmbajtjeje dhe investime infrastrukturore; kartele pronesie; kontrate qiraje;
E.68: *Raport i Administratorit për rikonstruksion të ambienteve*. Plani buxhetor me fonde për lyerje dhe restaurim godinash; Procedurë prokurimi për kondicionerë; Kontrata dezinfektimi; Foto të shkallëve dhe sinjalistikës së emergjencës; ruajtjen e godinave.
E.69: *Paisje infrastrukturore:* Inventar gjenerator dhe depozita uji; Inventar për shkallë emergjence; Inventar për rampe; Inventar për depozita uji;
E.70: *Pajisje audiovizive dhe teknologjike për mësimdhënie*: Inventar videoprojektorësh, kompiuterash, printerash; Prokurim për smartboard, kompjutera.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë zbaton procedura të mirëpërcaktuara për mirëmbajtjen, rikonstruksionin dhe modernizimin e pasurive të paluajtshme, duke garantuar kushte të përshtatshme pune dhe studimi për studentët dhe stafin. Në këtë kuadër, institucioni i kushton vëmendje edhe përmbushjes së standardeve të sigurisë, aksesueshmërisë dhe mbrojtjes së mjedisit, në funksion të krijimit të një kampusi universitar funksional dhe të qëndrueshëm.

Përmes planifikimit afatmesëm dhe afatgjatë të investimeve infrastrukturore dhe monitorimit të vazhdueshëm të gjendjes së pasurive të paluajtshme, institucioni synon rritjen e eficiencës në përdorimin e burimeve fizike dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve infrastrukturore. Kjo qasje kontribuon drejtpërdrejt në realizimin e misionit institucional dhe në përmbushjen e standardeve të cilësisë në arsimin e lartë.

Tabela, aneksi 16

Standardi II.8 Institucioni siguron infrastrukturë të përshtatshme për veprimtarinë akademike-shkencore.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë siguron infrastrukturë të përshtatshme dhe funksionale për zhvillimin e veprimtarisë akademike dhe shkencore, në përputhje me kërkesat e programeve të studimit, standardet kombëtare të arsimit të lartë dhe objektivat strategjike të institucionit.

Institucioni zhvillon veprimtarinë e vet në zona të qeta dhe larg ndotjeve akustike, me ambjente gjelbëruese dhe relaksi për studentët. Çdo fakultet sipas ligjit nr. 93/2014 "*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar*", si dhe ligjit nr. 10 237/2010 "*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*", për garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë personat me aftësi ndryshe (rampa në hyrje të fakulteteve), për garantimin e jetesës në komunitete (shkallët e emergjencës në çdo godinë) në kushte të barabarta me të tjerët, si dhe garantimin, sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eleminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimit, këshillimit, pjesëmarrjes së balancuar, në përputhje me ligjin.

UV realizon në mënyrë periodike vlerësime teknike të kushteve infrastrukturore dhe të pajisjeve, përfshirë sistemet e kondicionimit (kontrolle funksionale, mbushje me gaz dhe riparime sipas nevojës) apo pajisjeve IT me qëllim garantimin e kushteve të përshtatshme të punës. UV disponon ambiente laboratorike funksionale, të pajisura me mjetet e nevojshme për realizimin e komponentit praktik të programeve të studimit. Laboratorët janë të ndriçuar dhe të ajrosur në mënyrë të përshtatshme, si dhe të pajisur me sisteme ngrohjeje dhe kondicionimi.

Mjediset e institucionit janë të përshtatshme edhe për personat me aftësi të kufizuara, pasi janë të pajisura me rampa hyrëse dhe akses funksional në ambientet kryesore mësimore dhe administrative. Institucioni ka ndërmarrë masa konkrete infrastrukturore për garantimin e aksesueshmërisë, në përputhje me planimetrinë ekzistuese të godinave dhe mundësitë fizike të tyre. Të gjitha godinat universitare plotësojnë kushtet higjieno-sanitare (**E.67**) për studentët dhe personelin akademik e administrativ, duke shmangur elementet e rrezikshmërisë dhe duke garantuar një mjedis të sigurt, funksional dhe të përshtatshëm për zhvillimin e veprimtarisë akademike dhe institucionale. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka marrë masa të posaçme për garantimin e sigurisë së studentëve dhe personelit akademik e administrativ në raste emergjente, duke hartuar dhe zbatuar plane emergjence për godinat universitare, si dhe duke siguruar infrastrukturë funksionale për evakuim të sigurt.

Godinat universitare janë të pajisura me shkallë emergjence dhe dalje sigurie të sinjalizuara, të cilat mundësojnë evakuimin e shpejtë dhe të kontrolluar në raste zjarri, tërmeti apo situatash të tjera të jashtëzakonshme. Planet e emergjencës janë të afishuara në ambiente të dukshme dhe janë të aksesueshme për komunitetin universitar, ndërkohë që sinjalistika orientuese është e qartë dhe funksionale. Masat e sigurisë janë të integruara edhe me nevojat e personave me aftësi të kufizuara, duke garantuar akses dhe orientim të përshtatshëm edhe në situata emergjente, në përputhje me strukturën fizike të godinave. Në bazë të *vendimit nr. 1, datë 20.01.2025 të rektoratit* për ndarjen e detyrave funksionale, bëhet kontrolli i shërbimeve teknike dhe mirëmbajtjes (**E.68**, **E.69, E.70**).

E.71: *Listë pajisjesh të laboratorëve didaktikë dhe kërkimorë*: Qendra Simulatore për Profesionistët e Shëndetit, Laboratorit kërkimor të FSHTN, kabinetit të mësimdhënies në distancë; Prokurim për sallën C 500; Kërkesë për laborator FSHTN; VKM godina e Apelit;

Në përfundim, infrastruktura e ofruar nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë mbështet në mënyrë efektive veprimtarinë akademike dhe shkencore, duke kontribuar drejtpërdrejt në arritjen e objektivave formuese dhe kërkimore të institucionit.

Standardi II.9 Institucioni siguron mjedise komode pune - mësimore - laboratorike të përshtatshme për personelin akademik dhe studentët dhe personat me aftësi të kufizuara.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, është krijuar në 1994 me vendndodhje në adresën: *Lagjja: Pavarësia, Rruga Kosova, Bulevardi: Vlorë-Skelë, kodi postar 9401.* Ajo ka në përbërjen e saj 4 godina të ndara sipas fakulteteve:

1. Fakulteti i Ekonomisë;
2. Fakulteti i Shëndetit;
3. Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore;
4. Fakulteti i Shkencave Humane*;*

Infrastruktura akademike e UV-së përfshin:

- 35 ambiente mësimore – leksione;
- 16 ambiente mësimore – seminare;
- 1 kabinet audio-viziv për mësimdhënie në distancë;
- 32 laboratorë didaktikë-kërkimorë;
- 47 ambiente personeli akademik;
- 17 ambiente personeli administrativ;
- 3 ambiente teknike;
- 4 biblioteka fakultetesh;
- 1 bibliotekë qëndrore;
- 1 sallë konferencash me kabinë përkthimi, me 200 poste;
- 2 salla workshop-esh me sistem audio, me 50-60 poste;
- 1 ambient për Laboratorin Multimedial UniVlora: podcast, gazetë universitare, radio studentore.

https://univlora.edu.al/media/dokument/raport-vjetor-institucional-2024-2025.pdf (fq. 129)

UV planifikon dhe administron infrastrukturën akademike në funksion të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke garantuar mbulimin e nevojave për zhvillimin normal të programeve të studimit. Ambientet mësimore janë të pajisura në mënyrë të përshtatshme për zhvillimin e leksioneve, seminareve dhe aktiviteteve praktike, ndërsa laboratorët dhe hapësirat kërkimore mbështesin realizimin e punës eksperimentale dhe kërkimore sipas fushave përkatëse.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë investon në përmirësimin dhe modernizimin e vazhdueshëm të infrastrukturës akademike dhe shkencore, duke integruar teknologji bashkëkohore të mësimdhënies dhe kërkimit. Kjo përfshin (**E.70**) pajisje audio-vizive (smartborde, videoprojektorë), pajisje didaktike (laboratorë didaktikë), sisteme informatike (*UNVIMAS*), platforma digjitale (*Google classroom UniVlora*) dhe akses në burime elektronike (laptop, salla kompjuterash), të cilat lehtësojnë procesin e të nxënit dhe rrisin efikasitetin e veprimtarisë akademike.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë siguron mjedise komode pune, mësimore dhe laboratorike të përshtatshme për personelin akademik, administrativ dhe studentët, si dhe për personat me aftësi të kufizuara. Institucioni ofron një logjistikë administrative dhe akademike të organizuar në mënyrë funksionale, (**E.71**) në shërbim të interesit të përbashkët dhe zhvillimit normal të procesit mësimor dhe kërkimor. Universiteti vë në dispozicion ambiente pune dhe mësimore të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike dhe logjistike, në përputhje me natyrën e veprimtarisë akademike dhe administrative.

Vendet e punës për personelin akademik dhe administrativ janë të pajisura me poste kompjuterike, lidhje interneti dhe akses në sistemet institucionale të menaxhimit akademik dhe administrative Ambjentet mësimore janë të ajrosura, të ndriçuara natyralisht dhe artificialisht, si dhe të pajisura me sisteme ngrohjeje dhe ftohjeje që sigurojnë kushte të përshtatshme pune gjatë gjithë vitit akademik.

Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të mobiluara me karrige dhe tavolina funksionale, të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor, dhe janë të pajisura me mjete didaktike bashkëkohore, përfshirë pajisje audiovizive dhe teknologji mbështetëse për mësimdhënien si tabela inteligjente (*smartboards*) te cilat përdoren gjatë procesit mësimor.

Standardi II.10 Për programet e studimit të fushave mjekësore, inxhinierike institucioni siguron laboratorë të standarteve të larta profesionale e shkencore.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë siguron laboratorë të dedikuar dhe funksionalë për programet e studimit të fushave mjekësore dhe inxhinierike, në përputhje me kërkesat e kurrikulave, standardet kombëtare dhe praktikat bashkëkohore të formimit profesional dhe shkencor. Këta laboratorë përbëjnë një komponent thelbësor të procesit mësimor dhe kërkimor, duke mundësuar aplikimin praktik të njohurive teorike dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve.

Programet e fushave të shëndetit: infermieri

Në dispozicion të realizimit të programeve të Fakultetit të Shëndetit UV ka vendosur *7* laboratorë:

- 2 laboratorë infermierie;
- 1 laborator mamie;
- 2 laboratorë anatomie;
- 1 qendër simulatore për profesionistët e shëndetit;
- 1 laborator për prodhimin e materialeve 3D.

Laboratorët janë të pajisur me infrastrukturë dhe pajisje laboratorike që mbështesin realizimin e punës praktike, simulimeve dhe ushtrimeve profesionale, në përputhje me specifikat e programeve përkatëse. UV siguron mirëmbajtjen, përditësimin dhe përdorimin e kontrolluar të laboratorëve, duke garantuar standarde të sigurisë, funksionalitetit dhe cilësisë shkencore. Laboratorët kanë në dispozicion 3 personel ndihmësakademik, si laborantë.

Programet e fushave inxhinierike: elektrike, mekanike, navale, armatimi

Në dispozicion të realizimit të programeve të Fakultetit të Shkencave Teknike Natyrore UV ka vendosur *7* laboratorë, ndër me inovatoret përmendim:

1 laborator simulator navigacioni;

1 laborator armatimi;

Laboratorët kanë në dispozicion 2 personel ndihmësakademik, si laborantë.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë i ka kushtuar vëmendje të veçantë integrimit të laboratorëve në procesin mësimor, përmes planifikimit të qartë të orëve praktike, angazhimit të personelit të kualifikuar dhe ndërlidhjes së veprimtarive laboratorike me objektivat e të nxënit të programeve të studimit. Për programet mjekësore, laboratorët dhe ambientet praktike mbështeten edhe nga bashkëpunimi me institucione shëndetësore, ndërsa për programet inxhinierike, nga bashkëpunime me subjekte industriale dhe teknike.

Marrëveshje me institucione brenda vendit:
https://univlora.edu.al/marreveshjet-me-institucionet-brenda-vendit

Nr.	Institucioni / Kompania	Përmbajtja e marrëveshjes / Link
1	Bashkia Vlorë	Shkëmbimi i informacionit; shkëmbim përvojash dhe projekte; koordinim për thirrje financimi nga donatorë vendas dhe të huaj; pjesëmarrje në konsorciume të projekteve dypalëshe dhe ndërkombëtare; në kuadër të projektit "Vlora Smart City"
2	Termocentrali Vlorë	https://univlora.edu.al/media/dokument/termocentrali-vlore.pdf
3	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë Tiranë	https://univlora.edu.al/media/dokument/drejtoria-e-pergjithshme-e-metrologjise-tirane.pdf
4	Nasto Inxhiniering Vlorë	https://univlora.edu.al/media/dokument/nasto-inxhinering.pdf
5	TechnoPlastic	https://univlora.edu.al/media/dokument/shoqeria-technoplastic.pdf
6	OSHEE – dega Vlorë	https://univlora.edu.al/media/dokument/oshee-dega-vlore.pdf
7	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes	https://univlora.edu.al/media/dokument/operatori-i-sistemit-te-shpendarjes.pdf
8	Spitali Rajonal Lushnje	https://univlora.edu.al/media/dokument/spitali-rajonal-lushnje.pdf
9	Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë	https://univlora.edu.al/media/dokument/spitali-psikiatrik-vlore.pdf
10	Porti Detar, Vlorë	https://univlora.edu.al/media/dokument/porti-detar-vlore.pdf

UV ka investuar në mënyrë të vazhdueshme në përmirësimin e kapaciteteve laboratorike, përmes pajisjeve bashkëkohore, modernizimit të ambienteve dhe përfshirjes në projekte zhvillimi dhe kërkimi shkencor. Monitorimi periodik i funksionimit të laboratorëve dhe vlerësimi i përputhshmërisë së tyre me standardet profesionale dhe shkencore kontribuojnë në rritjen e cilësisë së formimit akademik dhe profesional të studentëve.

Standardi II.11 Institucioni siguron mjedise të përshtatshme pushimi, sportive dhe argëtimi për personelin akademik dhe studentët e vet.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë siguron mjedise të përshtatshme pushimi, sportive, rekreative dhe kulturore për personelin akademik dhe studentët, në përpjestim me numrin e tyre, duke garantuar mirëqenie, integrim social dhe cilësi të jetës universitare, si pjesë përbërëse e funksionimit normal të institucionit.

Pranë kampusit të Fakultetit të Shkencave Humane, universiteti ofron akses të drejtpërdrejtë në mjedise shërbimi ushqimor (mensë/kafe-bar), ambjente rekreative dhe hapësira sociale, të cilat përdoren nga studentët dhe personeli akademik për pushim, socializim dhe rikuperim gjatë veprimtarisë akademike. Këto mjedise janë të integruara funksionalisht me kampusin universitar dhe janë lehtësisht të aksesueshme nga

komuniteti akademik dhe studentor.

E.72: *Foto* - Hapësira rekreative dhe sportive në ambjentet e universitetit; Hapësira parkimi; Hapësira shërbimi (mensë/bar);

Për zhvillimin e veprimtarive sportive dhe fizike, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë garanton akses për studentët dhe personelin akademik në mjedise sportive të hapura dhe të mbyllura, përmes shfrytëzimit të infrastrukturës sportive publike dhe bashkëpunimit me institucione vendore. Në këtë kuadër, universiteti përdor fushat sportive të "Flamurtarit" dhe Pallatin e Sportit për aktivitete sportive, rekreative dhe evente të organizuara në funksion të jetës universitare. Në mbështetje të veprimtarive kulturore, artistike dhe promovuese, përveç ambienteve të disponueshme brenda universitetit, UV shfrytëzon edhe mjedise publike të qytetit, si Pallati i Sportit dhe Kinoteatri, për zhvillimin e aktiviteteve kulturore-artistike, ceremonisë së diplomimit, ekspozitave dhe aktiviteteve studentore, duke krijuar mundësi për pjesëmarrje të gjerë dhe ndërveprim me komunitetin lokal. Universiteti garanton gjithashtu hapësira parkimi të dedikuara pranë çdo godine universitare, të aksesueshme për personelin akademik dhe studentët, duke lehtësuar lëvizjen, aksesin dhe funksionimin e përditshëm të veprimtarisë akademike dhe administrative.

E.73: *Kërkesë për vënie në dispozicion të ambienteve*; ceremoni diplomimi.

Ceremoni diplomimi:
https://univlora.edu.al/njoftime/diplomimi-2025---fakulteti-i-shkencave-humane
https://univlora.edu.al/njoftime/diplomimi-2025---fakulteti-i-shkencave-teknike-dhe-natyrore
https://univlora.edu.al/njoftime/diplomimi-2025---fakulteti-i-shendetit
https://univlora.edu.al/njoftime/diplomimi-2025---fakulteti-i-ekonomise
Aktivitete sportive dhe rekreative:
https://univlora.edu.al/njoftime/kampionati-i-futbollit-univlora
https://univlora.edu.al/njoftime/beach-volley-univlora-2025

Standardi II.12 Institucioni monitoron në mënyrë të vazhdueshme gjendjen e infrastrukturës fizike dhe angazhohet në përmirësimin e saj.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë zbaton mekanizma të rregullt monitorimi dhe vlerësimi për gjendjen e infrastrukturës fizike, me qëllim garantimin e funksionalitetit, sigurisë dhe përshtatshmërisë së ambjenteve universitare për zhvillimin e veprimtarisë akademike, kërkimore dhe administrative. Ky proces realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe politikat institucionale për administrimin e pasurive dhe infrastrukturës publike (**E.7**, neni11).

Institucioni kryen vlerësime periodike të gjendjes së godinave mësimore, laboratorëve, bibliotekave, ambienteve administrative dhe hapësirave të përbashkëta, duke identifikuar nevojat për mirëmbajtje, rikonstruksion apo modernizim. Rezultatet e këtij monitorimi përdoren për planifikimin e ndërhyrjeve konkrete dhe për përcaktimin e prioriteteve investuese, në përputhje me nevojat e programeve të studimit dhe objektivat strategjike të zhvillimit.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë angazhohet në përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës fizike përmes investimeve të planifikuara, projekteve të zhvillimit dhe ndërhyrjeve të mirëmbajtjes periodike. Këto masa synojnë përmirësimin e kushteve të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve universitare, si dhe rritjen e sigurisë, aksesueshmërisë dhe komoditetit për studentët dhe stafin.

Menaxhimi i infrastrukturës realizohet përmes strukturave të posaçme administrative përgjegjëse (**E.23**, fq. 151-155) për administrimin dhe mirëmbajtjen e saj, në zbatim të vendimit të rektoratit mbi ndarjen e detyrave funksionale, sektori i shërbimeve monitoron, planifikon, koordinon, mbikqyr dhe kontrollon infrastrukturën. "Ismail Qemali" Vlorë bashkëpunon edhe me palë të treta përmes kontratave dhe marrëveshjeve bashkëpunimi për ofrimin e shërbimeve mbështetëse dhe teknike.

Në këtë kuadër, institucioni i kushton rëndësi edhe përfshirjes së feedback-ut nga studentët dhe personeli, si burim informacioni për identifikimin e problematikave infrastrukturore dhe përmirësimin e mjedisit

universitar. Monitorimi i vazhdueshëm dhe angazhimi për përmirësim kontribuojnë në krijimin e një infrastrukture funksionale, të qëndrueshme dhe në përputhje me standardet e cilësisë në arsimin e lartë.

Raporti i analizës së rezultateve të pyetësorëve të studentëve për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara prej stafit ndihmësakademik dhe administrativ, viti akademik 2024-2025 (fq. 56-60).
https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-rezultateve-te-pyetesoreve-te-studenteve-2024-2025

Standardi II.13 Institucioni disponon dokumentacion të plotë të veprimtarisë akademike në letër (hardcopy) dhe në formë elektronike.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka ndërtuar dhe funksionalizuar struktura administrative dhe akademike që garantojnë administrimin, ruajtjen dhe përpunimin e dokumentacionit, të dhënave statistikore dhe informacionit studentor, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi për arsimin e lartë. Universiteti disponon struktura administrative përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit në formë fizike (letër), përfshirë arkivimin e akteve zyrtare, regjistrave dhe dosjeve institucionale.

Dokumentacioni zyrtar institucional
Dokumentacioni hyrës dhe dalës i Universitetit 'Ismil Qemali' administrohet nga Sektori i Arkiv-Protokollit në nivel institucional dhe specialistët e arkiv-protokollit në nivel njësie kryesore, dhe ruhet sipas rregullave të arkivimit institucional, duke garantuar aksesueshmërinë dhe gjurmueshmërinë e tij ('Rregullore për krijimin, rregjistrimin, ruajtjen, shërbimin, dorëzimin e dokumenteve në UV', VSA nr.76, dt.05.12.2016).

E.9: VSA nr. 76:
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2017/12/Vendim-senati-Nr.76-dt-05.12.2016.pdf

Sipas nenit 19 të "Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë" hartohet çertifikimi i regjistrit të korrespodencës në zbatim të *vendimit nr. 1, date 20.01.2025 të Rektoratit* (**E.23**, fq.101-105*),* mbi ndarjen e detyrave funksionale. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka struktura përgjegjëse (Sektori i Kurrikulës&Statistikave) për mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e statistikave institucionale, të cilat lidhen me studentët, programet e studimit, stafin akademik dhe aktivitetet institucionale. Të dhënat statistikore përpunohen periodikisht dhe përdoren për qëllime raportimi, planifikimi dhe vendimmarrjeje, si dhe për përmbushjen e detyrimeve ndaj institucioneve shtetërore.

Arkiva elektronike e Universitetit 'Ismail Qemali'
Kërkesat, njoftimi i akteve dhe komunikimi midis strukturave përbërëse të Universitetit 'Ismail Qemali' bëhet (**E.4**, neni 7):

a) në rrugë shkresore (nëpërmjet specialistëve të Arkiv-Protokollit);
b) në rrugë elektronike (emaili zyrtar i UV);
c) nëpërmjet publikimit (website zyrtar i UV).

UV me anë të kërkesës, mund të lëshojë kopje ose pjesë të njehsuara me origjinalin të akteve të nxjerra nga ai vetë ose të dokumenteve të tjera nën administrimin e tij, sipas procedurave të përcaktuara në rregullore (**E.4**, neni 10).

Në Universitetin 'Ismail Qemali' funksionon gjithashtu edhe arkiva digjitale e dokumentave institucionalë të skanuar. UV zotëron teknologjinë e përshtatshme dhe mundësinë e trajnimit të stafit për digjitalizimin e dokumentacionit, nëpërmjet specialistit të IT për digjitalizimin.

E.74: *Blerja e pajisjes për skanimin e dokumentacionit*. Certifikimi i regjistrit të korrespodencës; Dosje të punuara në arkivë digjitale;

Menaxhimi i të dhënave studentore
Universiteti disponon një bazë të dhënash të strukturuar për studentët, e cila përfshin informacion mbi regjistrimin, numrin e matrikullimit dhe të dhëna të tjera të nevojshme administrative dhe akademike. Këto

të dhëna administrohen nga sekretaritë mësimore, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi dhe procedurat e brendshme të universitetit, duke garantuar saktësinë dhe përditësimin e vazhdueshëm të informacionit sipas neneve 78,79 të Statutit të UV-së (**E.1**, neni 78-79).

Regjistri bazë i studentëve, Regjistri i arritjeve akademike dhe mbrojtja e të dhënave personale
Universiteti mban një regjistër bazë të studentëve me të dhëna personale, në formë fizike dhe elektronike. Administrimi i këtij regjistri realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, duke garantuar konfidencialitetin, sigurinë dhe aksesin e kufizuar të informacionit vetëm për personelin e autorizuar (E.4, neni 121).

a. Regjistrat bazë - plotësohen në përputhje me Udhëzimin e MA "Për pajisjen e institucioneve të arsimit të lartë publik dhe privat me regjistrat bazë të studentëve";
b. Regjistrat e arritjeve akademike (regjistrat e notave) - plotësohet pas përfundimit të vitit akademik (sezoni i riprovimeve të vjeshtës).

Në regjistër pasqyrohen vetëm rezultatet pozitive të arritura dhe përmirësimet e lejuara për studentët.
Këto regjistra administrohen nga sekretaritë mësimore (**E.4**, neni 118).

Regjistri i diplomave dhe suplementit të diplomës
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë disponon një regjistër bazë të përhershëm të studentëve, në formë të shkruar dhe elektronike, i cili përfshin të dhëna mbi diplomat e marra dhe suplementet përkatëse të diplomës. Ky regjistër garanton gjurmueshmërinë akademike të studentëve dhe ruhet në përputhje me standardet ligjore dhe institucionale.
Këto regjistër administrohet nga kryesekretarja e njësisë kryesore (**E.4**, neni 117):

E.75: *Regjistra*: Regjistër bazë; Regjistër notash. Regjistër të dhënash diplomimi;
E.76: Program mësimor në BSc në Biologji.

Të dhëna mbi programet e studimit
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë disponon dokumentacion të plotë dhe të përditësuar për programet e studimit që ofron, përfshirë formën e studimit, planet mësimore dhe kreditë përkatëse të detyrueshme (ECTS). Ky dokumentacion është i miratuar nga organet kolegjiale përkatëse dhe administrohet nga strukturat përgjegjëse akademike e administrative dhe pasqyrohet elektronikisht në faqen zyrtare të UV-së.

Programet: Diploma Profesionale
https://univlora.edu.al/programet/PP
Programet: Bachelor
https://univlora.edu.al/programet/DNP
https://univlora.edu.al/programet/PP;
Programet: Master Profesional
https://univlora.edu.al/programet/DND
Programet: Master Shkencor
https://univlora.edu.al/programet/MSC
Programet: Doktorale
https://univlora.edu.al/programet/PHD
English-speaking programes
https://univlora.edu.al/programeten/JD

Standardi II.14 Institucioni vë në përdorim sisteme të informimit dhe të menaxhimi në nivel institucional.

Universiteti 'Ismail Qemali' ka si objektiv të vetin digjitalizimin e shërbimeve universitare dhe mbështetjen e studentëve (Objektivi strategjik II.2.1). Studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme përmes faqes zyrtare të Universitetit të Vlorës (https://univlora.edu.al/studente), e cila përmban informacion të përditësuar mbi programet e studimit, oraret mësimore, njoftimet akademike dhe aktivitetet institucionale. Faqja zyrtare e Universitetit 'Ismail Qemali' ka gjithashtu disa funksione informimi dhe

menaxhimi, veçanërisht për përdorimin e shërbimeve dhe shkarkimin e faturave në funksion të procedurave studentore (https://univlora.edu.al/fatura).

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka programuar dhe përdor sistemin e informimit dhe menaxhimit UNVIMAS (UNiversity VIrtual MAnagement System) në nivel institucional, i cili mbështet në mënyrë të strukturuar veprimtarinë akademike, administrative dhe menaxheriale. Ky sistem kontribuon në realizimin e funksioneve kryesore të institucionit dhe në garantimin e një administrimi efektiv dhe transparent të proceseve. Programi kompjuterik **UNVIMAS është regjistruar si patentë e Universitetit "Ismail Qemali"** Vlorë. Ky program është ndërtuar duke respektuar standartet e industrisë së zhvillimit software. Programi kompjuterik UNVIMAS është një program tre shtresor i formatit MVC (Model View Controller), në mënyrë që të ofrojë shërbim të shpejtë të sigurt dhe cilësor. Asnjë universitet në trojet mbarëshqiptare nuk zotëron një program kompjuterik të një standardi kaq të lartë, të krahasueshëm vetëm me universitetet më të fuqishme ndërkombëtare.

E.77: Procedura e patentimit të UNVIMAS.

Përparësitë e Sistemit UNVIMAS për aktivitetin akademik dhe administrativ të Universitetit 'Ismail Qemali':

a) Ofrimi i një platforme të centralizuar për menaxhimin dhe monitorimin e progresit akademik të studentëve;
b) Mundësimi i zbatimit të parimit të konfidencialitetit të informacionit dhe komunikimit me studentët;
c) Ofrimi i shërbimeve të mësimdhënies online dhe në distancë;
d) Mundësim i marrjes së informacioneve në kohë reale prej studentëve dhe pedagogëve;
e) Përmirësimi i efikasitetit dhe transparencës në proceset akademike;
f) Mundësimi i vlerësimit online të cilësisë së mësimdhënies në universitet.

Personeli akademik, përgjegjës për leksionet e modulit/lëndës semestrale (**E.30**):

a) ngarkon në Sistemin UNVIMAS rezultatet e provimeve të pjesshme e finale, si dhe printon procesverbalet e tyre;
b) publikon Syllabuset e lëndëve;
c) dërgon në format elektronik leksionet, seminaret dhe detyrat e kursit nëpërmjet modulit E-Learning;
d) komunikon me studentët në klasat përkatëse për nevoja të mësimdhënies, nëpërmjet modulit INBOX.

Studentët: me fitimin e statusit të studentit në Universitetin 'Ismail Qemali' Vlorë, studenti është i detyruar të marr adresën elektronike (email) personale të @univlora.edu.al dhe të regjistrohet në Sistemin UNVIMAS, nën asistencën e sekretarive mësimore të fakultetit. Shërbimet që studenti i Universitetit 'Ismail Qemali' mund të marr prej sistemit të brendshëm të komunikimit UNVIMAS janë (**E.30**):

a) regjistrim online në leksione dhe seminare, sipas grupeve përkatëse;
b) informim mbi oraret e lëndëve, syllabyset dhe kreditet e lëndëve;
c) komunikim me pedagogun e lëndës, nëpërmjet modulit Inbox;
d) mundësim i mësimdhënies në distancë, nëpërmjet modulit E-learning;
e) vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, nëpërmjet pyetësorëve online të emetuar prej Sektorit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Akreditimit;
f) informim mbi rezultatet e provimit në librezën e tyre elektronike, duke ndjekur kështu progresin akademik nëpërmjet konsultimit të drejtpërdrejtë në sistem. Nëse nuk e kanë marrë këtë informacion për arsye të ndryshme, informohen drejtëpërdrejtë nga pedagogu, duke respektuar privatësinë e informacionit, referuar (**E.4**) të UV-së "Ismail Qemali" Vlorë.

Nëpërmjet Librezës Elektronike të Studentit, e cila aksesohet individualisht në sistemin UNVIMAS, çdo student mund të ndjekë realizimin e planit individual të studimit.

Në mbështetje të Strategjisë së UV-së (**E.35**, linja strategjike II.2-Sistem Shërbimesh SMART), e cila synon ndërtimin e një ekosistemi të integruar shërbimesh digjitale për Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, që automatizon proceset akademike dhe administrative, rrit transparencën dhe përmirëson përvojën e studentëve dhe stafit përmes platformave smart, ndërvepruese dhe të sigurta. Fokus vendoset te integrimi i

sistemeve (UNVIMAS, LMS, e-shërbime), vetëshërbimi online, analitika e të dhënave dhe ndërveprimi në kohë reale me përdoruesit.

- VSA nr. 71, datë 17.07.2025, (*Disa ndryshime në vendimin nr. 101, datë 06.12.2017 "Për krijimin dhe funksionimin në UV të platformës digjitale "sistemi i menaxhimit të informacionit mësimor në UV" me akronimin "uvms" (university of vlora management system*)
  https://univlora.edu.al/media/dokument/vsa71-2025.pdf
- *Manuali i përdorimit të UNVIMAS për pedagogë (2026),* ofron udhëzime të qarta hap-pas-hapi për hyrjen në sistem, menaxhimin e profilit, listave të studentëve, detyrave dhe proceseve të vlerësimit në platformën elektronike universitare. Dokumenti shërben si udhëzues praktik për stafin akademik për përdorimin korrekt dhe të sigurt të funksioneve kryesore të sistemit.
  https://univlora.edu.al/media/dokument/manual-perdorimi-unvimas-pedagog-2026.pdf
- *Manuali i përdorimit të UNVIMAS për studentë (2026)* shpjegon në mënyrë të qartë si të hyni në sistem, menaxhoni profilin, shikoni orarin, lëndët e regjistruara, vlerësimet dhe transkriptin, si dhe si të shkarkoni materialet e mësimit dhe të përdorni kodin sekret për veprime brenda platformës. Dokumenti shërben si udhëzues praktik për studentët që të përdorin korrekt dhe në mënyrë të sigurt funksionet kryesore të sistemit elektronik të universitetit.
  https://univlora.edu.al/media/dokument/manual-perdorimi-unvimas-student-2026.pdf
- *Manuali i studentit për Google Classroom,* shpjegon në mënyrë të qartë si të përdorni llogarinë universitare për t'u futur në platformë, si të bashkoheni në klasë me kodin e dhënë nga pedagogu dhe si të ndiqni detyrat, njoftimet, diskutimet dhe materialet e mësimit brenda Google Classroom.
  https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2020/11/Manual-studenti-Google-Classroom.pdf
- *Manuali i pedagogut për Google Classroom*, shpjegon në mënyrë të qartë se si të krijoni, menaxhoni dhe organizoni kurset online, si të ftoni studentët me kodin e klasës, si të postoni materiale, detyra dhe njoftime, si dhe si të vlerësoni dhe komentoni dorëzimet e tyre brenda platformës.
  https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2020/11/Manual-Pedagogu-Google-Classroom-1.pdf
- Integrimi i sistemeve të informimit me procese të sigurimit të brendshëm të cilësisë (fq. 47-50):
  https://univlora.edu.al/media/dokument/analiza-e-pyet-sorit.pdf

Rregullorja (**E.10**, neni 14 dhe 16) parashikon *mirëmbajtjen e pajisjeve* dhe të *infrastrukturës së sistemit* UNVIMAS, si dhe përgjegjësinë e strukturave IT për administrimin teknik, monitorimin dhe ndërhyrjen në rast defektesh apo problemesh funksionale të sistemit. Sistemi UNVIMAS i nënshtrohet *përditësimeve dhe ndryshimeve teknike të vazhdueshme*, me qëllim përmirësimin e performancës, sigurisë dhe funksionaliteteve, në përputhje me kërkesat teknologjike dhe ligjore (**E.10**, neni 8).

Rregullorja përcakton masa organizative dhe teknike për *garantimin e sigurisë së të dhënave* (**E.10**, neni13) në sistem, përfshirë kontrollin e aksesit, identifikimin e përdoruesve, regjistrimin e veprimeve dhe mbrojtjen nga hyrjet e paautorizuara. *Mbrojtja e informacionit dhe e të dhënave personale,* përcaktohen parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe qëllimit të përcaktuar në përpunimin e të dhënave personale, si dhe detyrimi që çdo përpunim të kryhet vetëm nga persona të autorizuar dhe për funksione të përcaktuara institucionale (**E.10**, neni 11-12).

Rregullorja parashikon përdorimin e procedurave të *backup-it, përditësimeve të sistemeve* operative dhe rikrijimit të sistemit në rast dështimi, për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit dhe integritetin e të dhënave (**E.10**, neni 13-14).

Standardi II.15 Institucioni bashkërendon veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë siguron bashkërendimin e veprimtarive në fushën e teknologjisë së informacionit në nivel institucional, nëpërmjet Sektorit IT në nivel institucional e njësisë kryesore, bazuar në procedurat e përcaktuara për administrimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve informatike. Ky bashkërendim synon garantimin e funksionimit të qëndrueshëm, të sigurt dhe efektiv të infrastrukturës digjitale në shërbim të veprimtarisë akademike, kërkimore dhe administrative.

Platformat digitale në pronësi UV:

1. Faqja zyrtare e UV-së
   https://univlora.edu.al/
2. Revista shkencore UniVlora Scientific Journal
   https://uvjournals.univlora.edu.al/
3. Faqja zyrtare e Qendrës për Zhvillim Rajonal
   https://sites.google.com/univlora.edu.al/rdcunivloraedual/home
4. Faqja zyrtare e Qendrës së kërkim-zhvillimit për Shëndetin Publik
   https://src4ph.univlora.edu.al/
5. Platforma Credis4Teachers
   https://cred4teach.univlora.edu.al/

Programet kompiuterike të informacionit të brendshëm në pronësi / përdorim të UV-së:

1. UNVIMAS
   https://uvms.univlora.edu.al/
2. Google classroom UniVlora
   https://classroom.google.com/h

I gjithë informacioni që gjendet në platformat dhe programet e sipër përmendura janë pronësi intelektuale e Universitetit 'Ismail Qemali', është programuar nga Sektori IT i universitetit dhe është i mundshëm të përditësohet në mënyrë interaktive nga personeli akademik dhe ndihmësakademik i UV-së (përditësimi i njoftimeve, syllabyseve, cv të stafit, vlerësimi i studentëve).

Për të garantuar përdorimin efektiv të teknologjisë së informacionit, institucioni mbështet zhvillimin e kompetencave digjitale të stafit akademik dhe administrativ, përmes trajnimeve dhe asistencës teknike të vazhdueshme. Ky bashkërendim kontribuon në rritjen e efikasitetit operacional dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara ndaj studentëve dhe palëve të tjera të interesuara.

Manual përdorimi Google classroom (https://univlora.edu.al/manuale-per-google-classroom)
Raporte të trajnimeve të zhvilluara për përdoruesit e sistemeve
https://classroom.google.com/c/ODE2NTcxNzQ3NjQ2
https://univlora.edu.al/njoftime/kurs-veror---komandat-e-linux-dhe-hyrje-ne-bash-scripting

Veprimtaritë e IT-së planifikohen dhe zbatohen në përputhje me objektivat strategjike të institucionit për një Universitet SMART (Skenari Strategjik II), duke synuar sa më shumë shërbime të digjitalizuara në mësimdhënie dhe administrim, si:

- menaxhimi i të dhënave të studentëve dhe personelit,
- zhvillimi i mësimdhënies së asistuar nga teknologjia,
- literaturë bazë e digjitalizuar,
- administrimi elektronik i dokumentacionit
- përmirësimi i komunikimit institucional.

Linja Strategjike	Objektiva Strategjike	Masat kryesore (Veprimet)
II.1 Edukim SMART	II.1.1 Përmirësimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies digjitale	Kalimi në mësimnxënie të bazuar tek puna e pavarur e studentit, edhe me asistencë IA
		Leksione interaktive blended- Mësimdhënie online dhe të përzier, me pedagogë ndërkombëtarë
		Integrimi i literaturës digjitale dhe print, të shpërndarë vetëm në UV.
II.2 Sistem Shërbimesh SMART	II.2.1 Digjitalizimi i shërbimeve universitare dhe mbështetja e studentëve	Shërbime administrative të digjitalizuara (aplikime, regjistrim, çertifikata)
		One-Stop-Shop për studentët

		Monitorim i progresit dhe përdorimi i softwareëve për menaxhim studentësh
II.3 Infrastrukturë SMART	II.3.1 Modernizimi i ambienteve dhe ndërtimi i ekosistemeve digjitale	Modernizimi i auditorëve dhe laboratorëve
		Ndërtimi i laboratorëve të çertifikuar dhe të pajisur sipas standardeve
		Krijimi i ekosistemeve dixhitale për bashkëpunim akademik dhe industrial
		Implementimi i infrastrukturës për mësim online dhe blended

Standardi II.16 Institucioni harton buxhetin në përputhje me procedurat e përcaktuara dhe transparente.

Buxheti i Universitetit "Ismail Qemali Vlorë" hartohet në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, ligjit, Vendimit nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj*", Vendimit nr. 542, datë 20.9.2023 të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e strategjisë kombëtare për kërkim shkencor, teknologjinë dhe inovacionin, 2023-2030*" dhe planit të veprimit për zbatimin e saj", Vendimit nr. 16, datë 11.1.2024 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e planit kombëtar për integrimin evropian 2024–2026", Vendimit nr. 12, datë 11.1.2024 të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e Programit të Reformave Ekonomike (ERP) 2024–2026*", standardet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm*", si dhe në zbatim të Statutit te UV-se (**E.1**) të miratuar me Urdhër të MAS nr. 197, datë 30.04.2019, i ndryshuar me urdhërin e MAS-it me nr. 287, datë 30.06.2025, duke u miratuar në organet drejtuese të UV-së Rektorat, Senat dhe në Bordin e Administrimit, informacioni plotësohet sipas formularëve të aneksit 7-A.(Shtojca 1/A. Pasqyrat Shtesë për Buxhetin Vjetor).

- Buxheti vjetor 2025:
  https://univlora.edu.al/media/dokument/vba22-2025.pdf
  E.78: *Procedurë për miratimin e shërbimeve ndaj të tretëve*: VSA dhe VBA për shërbimet ndaj të tretëve (shembuj)
- VSA dhe VBA për shërbimet ndaj të tretëve:
  https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/01/Vendim-Senati-Nr.-82-Date-20.11.2024-Miratim-paraprak-i-Rregullores-se-sherbimit-ndaj-te-treteve.pdf
  https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/01/Vendim-Nr.-77-Bordi-Administrimit-2024.pdf
- Lista e shërbimeve ndaj të tretëve:
  https://univlora.edu.al/media/dokument/sherbime-uv.pdf
- VBA për ngarkesa suplementare, pagesa PAK, pedagoge të ftuar:
  1. https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2022/10/Vendim-Bordi-Nr.-21-date-15.08.2022-Per-miratimin-e-mbingarkeses-mesimore-te-realizuar-per-stafin-akademik.pdf
  2. https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/02/Vendim-Bordi-Nr.-31-date-22.09.2023-Per-pagesen-e-mbingarkeses-mesimore-te-realizuar-per-stafin-akademik.pdf
  3. https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2021/09/Vendim-Bordi-Nr.-32-date-14.09.2021-date-20.09.2021-Per-pagesen-e-mbingarkeses-se-stafit-akademik-2020-2021.pdf
  4. https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2019/07/vendim-nr.-35.pdf
  5. https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/10/Vendim-Nr.-36-Bordi-Administrimit-2024-Pagasen-e-mbingarkeses-mesimore-te-realizuar-per-stafin-akademik.pdf
  6. https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2020/11/Vendim-Nr.-54-date-19.11.2020-Per-pagesen-e-mbingarkeses-se-stafit-akademik-per-2019-2020.pdf

Standardi II.17 Institucioni siguron mjetet e nevojshme për të zbatuar politikën financiare.

Universiteti 'Ismail Qemali' gjeneron dhe shpërndan të ardhurat në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", udhëzimit të përbashkët nr. 20 datë 20.09.2019 të MAS dhe MFE "*Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor*", VKM-së nr.75 datë 12.02.2018 "*Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor*".

Universiteti 'Ismail Qemali' ka siguruar rritje të qëndrueshme të ardhurash gjatë viteve 2024 e 2025. Granti i mësimdhënies nga MA është rritur progresivisht dhe të ardhurat e gjeneruara nga UV në 2025 kanë qenë 15% më shumë së në vitin 2024 (14,000,000 ALL më shumë), rritje e ardhur prej rritjes së numrit të studentëve dhe rritjes së shërbimeve të ofruara.

Programi i Transparencës në faqen zyrtare të Universitetit 'Ismail Qemali' publikon gjithë procedurat dhe raportet financiare të zbatuara nga UV.

https://univlora.edu.al/programi-i-transparences

E.79: Akt Rakordim i të Ardhurave, për vitin 2024, çelje e grantit të vitit 2024.

Standardi II.18 Institucioni ndjek një politikë të kontrollit buxhetor dhe financiar.

Universiteti "Ismail Qemali Vlorë", zbaton politikat e kontrollit në mbështëtje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", të ligjit nr.10296 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar, ligjit nr.97/2023 "*Për buxhetin e vitit 2024*", udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", i ndryshuar , si dhe udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qëndrore*" , udhëzimit nr. 24, datë 21.10.2019 "*Për një ndryshim në udhëzimin nr. 5, datë 19. 02. 2018 "Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të aresimit të lartë*" si dhe udhëzuesit të AKFAL nr. 75/5 prot., datë 31.07.2023.

Raport auditi nga KLSH
https://univlora.edu.al/media/dokument/projekt-raporti.pdf
Raporti vjetor i veprimtarisë financiare të UV-së për vitin akademik 2023-2024
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/01/Vendim-Nr.-63-Bordi-Administrimit-2024.pdf
Raportimi për periudhën 12- mujore Janar-Dhjetor 2024, si dhe raporti financiar i vitit 2024 sipas udhëzimit te AKFAL
https://drive.google.com/file/d/1tGRfSLMZKZmlo5o-b_shab-qE1ePCXjS/view
https://univlora.edu.al/media/dokument/raporti-i-monitorimit-per-periudhen-janar-dhjetor-2024.pdf

Standardi II.19 Institucioni ndjek një strategji të hapur për bashkëpunimin dhe partneritetin në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Universiteti "Ismail Qemali" ka ndërtuar dhe zbaton një strategji të hapur bashkëpunimi dhe partneriteti, e cila është e integruar në dokumentet e zhvillimit institucional dhe në politikat për ndërkombëtarizimin, kërkimin shkencor dhe lidhjen me tregun e punës. Kjo strategji synon forcimin e rolit të institucionit në nivel rajonal dhe kombëtar, si dhe rritjen e dukshmërisë dhe konkurrueshmërisë në hapësirën evropiane dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Bashkëpunimi në nivel rajonal dhe kombëtar realizohet përmes marrëveshjeve me institucione të arsimit të lartë, institucione publike dhe private, organizata profesionale dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm, në funksion të zhvillimit të programeve të studimit, realizimit të praktikave profesionale, projekteve të përbashkëta dhe aktiviteteve shkencore. Këto partneritete kontribuojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë akademike dhe rritjen e relevancës së ofertës arsimore.
https://univlora.edu.al/marreveshjet-me-institucionet-brenda-vendit

Marrëveshje bashkëpunimi me IAL kombëtare:

1. Universiteti “Luarasi” Tiranë;
2. Universiteti “Isa Boletini” Mitrovicë;
3. Akademia e Forcave të Armatosura;
4. Universiteti “Fan S. Noli” Korçë;
5. Universiteti Polis;
6. Kolegji Universitar "Reald" Vlorë;
7. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë;
8. Kolegji "Universum" Prishtinë (Kosovë);
9. Universiteti “Zoja e Këshillit të Mirë”
10. Universiteti Europian i Tiranës;
11. Universiteti i Arteve Tiranë;
12. Universiteti Politeknik i Tiranës;

Marrëveshje bashkëpunimi me organizata dhe institucione kombëtare:

1. Këshilli i Qarkut Vlorë;
2. Bashkia Vlorë
3. Agjenisa Kombëtare e Rinisë
4. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Fier;
5. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Lushnje;
6. Shkolla e Drejtorëve të Arsimit Parauniversitar;
7. Gjykata e Shkallës së Parë, Vlorë;
8. Gjykata Administrative Lushnje;
9. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë Tiranë;
10. OST – Operatori i Sistemit të Transmetimit;
11. Qendra e Kontrollit Teknik;
12. Nasto Inxhiniering Vlorë;
13. DigitalDev.Al;
14. Studio Bleta;
15. Shoqëria “TechnoPlastic” shpk;
16. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes;
17. Drejtoria e Ujësjellës & Kanalizime Vlorë;
18. OSHEE – Dega Vlorë;
19. Nisatel Vlorë;
20. Porti Detar Vlorë;
21. UBA Bank – Dega Vlorë
22. Balfin grup
23. Vlora Marina
24. Shoqëria “Green Coast Hotel” sh.p.k
25. Hotel “Regina Group” sh.p.k;
26. Hotel Kral;
27. Hotel Partner;
28. Hotel Mazarine Vlorë;
29. Balkan Sport Vlorë;
30. Shoqëria “Alb Kripa” sh.p.k
31. Shoqëria “Bena Gas” sh.p.k
32. Subjekti “NOA” sh.a;
33. Drejtoria Rajonale e Operatorit të Kujdesit Shëndetësor, DROKSH
34. Spitali Rajonal Vlorë
35. Spitali Rajonal Fier
36. Spitali Memorial Fier

37. Spitali Psikiatrik Vlorë;
38. Spitali Rajonal Lushnje;
39. "Klinika Bakaj" shpk
40. Qendra për Studimin e Demokracise dhe Qeverisjes;
41. Qendra Shqiptare për Popullsinë & Qendra Aulona;
42. Shoqata AULEDA;

Në nivel ndërkombëtar, Universiteti "Ismail Qemali" zhvillon partneritete me universitete dhe institucione homologe, duke u fokusuar në mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik, projekte kërkimore dhe shkëmbimin e përvojave të mira. Pjesëmarrja në programe dhe iniciativa ndërkombëtare mbështet procesin e ndërkombëtarizimit dhe nxit përputhjen e veprimtarisë akademike me standardet evropiane të arsimit të lartë.
https://univlora.edu.al/marreveshje-mirekuptimi

Marrëveshje bashkëpunimi me IAL ndërkombëtare:
1. Wekerle International University;
2. St. Paul the Apostle Ohrid;
3. Georgian Technical University;
4. University of Bari Aldo Moro;
5. University of Belgrade;
6. The Technical University of Varna;
7. Deggendorf Institute of Technology;
8. Mediterranean University Podgorica;
9. Tokat Gaziosmanpasa University; etj.,

… nga 90 MoU aktive.

Marrëveshje bashkëpunimi me rrjete dhe institucione ndërkombëtare:
ETEN - (Europian Teacher Education Network);
CMU- (Community of Mediterranean Universities);
UNIMED- (Mediterranean Universities Union);

Universiteti "Ismail Qemali" ka pjesë të strukturës së vet Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë (**E.23**, fq. 90-99), i cili ka për synim krijimin, zhvillimin dhe menaxhimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe lidhjeve me institucione të tjera edukative, kërkimore dhe organizata ndërkombëtare. Ky sektor ka si qëllim të nxisë bashkëpunimin akademik dhe shkencor me universitete, organizata dhe institucione të huaja, duke mundësuar shkëmbimin e njohurive dhe resurseve, si dhe duke kontribuar në zhvillimin e aktiviteteve ndërkombëtare të universitetit.

Objektivat e Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë:
Promovimi i bashkëpunimeve ndërkombëtare:
- Të krijojë dhe të menaxhojë marrëdhënie me universitete, organizata ndërkombëtare dhe institucione të tjera arsimore dhe kërkimore për të ndihmuar në zhvillimin e mundësive të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencave;
- Të zhvillojë mundësi për marrëveshje partneriteti dhe bashkëpunim me universitetet dhe organizatat ndërkombëtare për shkëmbime akademike, kërkimore dhe studentore

Zhvillimi i shkëmbimeve akademike dhe shkencore:
- Të nxisë dhe të menaxhojë programe shkëmbimi për staf akademik, studentë dhe kërkues, duke mundësuar pjesëmarrjen në programe ndërkombëtare të shkëmbimit dhe bashkëpunimit;
- Të krijojë mundësi për shkëmbime të kërkimeve, projekteve shkencore dhe përgatitjen e artikujve të përbashkët me institucione dhe universitete të tjera jashtë vendit;

Fuqizimi i pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare:
- Të mbështesë Universitetin në përfshirjen e tij në projekte ndërkombëtare, fonde dhe mundësi bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare si Erasmus+, Horizon Europe dhe iniciativa të tjera të

ngjashme;
- Të promovojë mundësitë për financime dhe bursa për studentët, stafin akademik dhe kërkuesit që të mund të përfshihen në projekte ndërkombëtare dhe aktivitete shkencore;

Zhvillimi i imazhit të universitetit në nivel ndërkombëtar:
- Të krijojë mundësi dhe aktivitete për promovimin e universitetit në nivel ndërkombëtar, duke theksuar arritjet akademike, kërkimore dhe profesionale;
- Të organizojë aktivitete që rrisin njohjen dhe përfaqësimin e universitetit në forume ndërkombëtare, duke kontribuar në krijimin e një imazhi pozitiv për institucionin;

Nëpërmjet këtyre mekanizmave, sigurohet që bashkëpunimi dhe partneriteti të jenë të qëndrueshme, të matshme dhe të orientuara drejt përmbushjes së objektivave strategjike të institucionit.

Standardi II.20 Institucioni bashkëpunon me institucionet të tjera në mbështetje të veprimtarisë së tij akademike, administrative, kërkimore-shkencore/artisike dhe praktikave profesionale.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka ndërtuar një rrjet bashkëpunimi të qëndrueshëm me institucione të ndryshme rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare, në funksion të mbështetjes së veprimtarisë akademike, kërkimore, administrative dhe të praktikave profesionale (lista e marrveshjeve Standardi II.19). Këto bashkëpunime kontribuojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, rritjen e kapaciteteve kërkimore dhe profesionale të stafit dhe studentëve, si dhe në zhvillimin e aktivitetit artistik dhe shkencor.

Në nivel akademik, universiteti bashkëpunon me institucione të tjera për:
1. zhvillimin e programeve të përbashkëta dhe të dyfishta;
2. shkëmbimin e përvojave mësimore (mobilitete Erasmus+);
3. realizimin e projekteve akademike dhe zhvillimore.

E.80: *Marrëveshje për program të përbashkët dhe të dyfishtë*: BSc në "Shkenca Arkitekturore për Trashëgiminë"; BSc në "Inxhinieri Elektrike"; MSc në "Inxhinieri Armatimi me profil "Aviacioni" dhe "Navale""; MSc në "Mbrojtje dhe menaxhim i mjedisit detar".

Tipi i diplomës	*Cikli i Studimit*	*Emërtimi*	*Universiteti Partner*
Joint Degree	Bachelor	Shkenca Arkitekturore për Trashëgiminë kulturore	Universiteti Politeknik i Barit, Itali
	Master	Mbrojtja dhe menaxhimi i Mjedisit Detar	Universiteti i Malit të Zi, Universiteti i Durrësit
		Inxhinieri Armatimi me profil minor në Aviacion dhe Naval	Akademia e Forcave të Armatosura, Tiranë
Double Degree	Bachelor	Gjuhësi të aplikuara në fushën e Turizmit	Universiteti i Salentos, Itali
		Inxhinieri Mekanike	Universiteti Politeknik i Barit, Itali
		Inxhieri Elektrike	Universiteti Politeknik i Barit, Itali
		Inxhinieri Mekanike	Universiteti Politeknik i Barit, Itali
	Master	Projektimin dhe Menaxhimin e Sistemeve Turistike dhe Kulturore	Universiteti i Barit "Aldo Moro", Itali

Projektet kërkimore dhe ndërkombëtare të universitetit përqëndrohen në modernizimin e mësimdhënies dhe kërkimit, transformimin digjital, përfshirjen dhe aksesueshmërinë, si dhe lidhjen me industrinë dhe tregun e punës. Ato mbulojnë fusha si dekarbonizimi në sektorin detar, integrimi i AI në arsimin e lartë, kapërcimi i hendekut digjital dhe bashkëpunimi universitet–ndërmarrje për punësueshmëri. Si përfitime direkte për universitetin, këto projekte sjellin rritje të kapaciteteve akademike dhe kërkimore, përditësim kurrikulash, zhvillim të kompetencave digjitale të stafit dhe studentëve, përmirësim të infrastrukturës dhe shërbimeve, forcim të bashkëpunimit me industrinë dhe rritje të profilit dhe pozicionimit ndërkombëtar institucional.

Nr	Titulli i Projektit	Periudha	Programi / Thirrja	Roli i UV	Partner Kryesor / Koordinator	Njësia e Përfshirë	Objektivi Kryesor	Përfitimet / Rezultatet Kryesore	Përfitimet për Universitetin
1	Zero-C – Transport dhe logjistikë detare me karbon zero	01.11.2023 – 31.10.2026	Ndërkombëtar / CBHE	Partner	Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	QESIT – FSHDN	Përgatitje e burimeve njerëzore për dekarbonizim dhe efiçiencë energjetike në sektorin detar	57 staf + 300 studentë të trajnuar; 60 profesionistë përmbushje kërkesash EMSA/STCW	Rritje e kapaciteteve akademike në fushën detare; përditësim i kurrikulave; lidhje me industrinë dhe autoritete rregullatore; rritje e profilit ndërkombëtar
2	EDUFAIR – Integrimi i AI në mësimin e larte	01.11.2024 – 31.10.2026	Ndërkombëtar / Digital–AI	Partner	Konsorciumi ndërkombëtar	UV (institucional)	Integrimi i AI në mësimdhënie, të nxënë dhe kërkim	Strategji digjitale; trajnime AI për stafe akademik; mësim kërkërdhënës bashkëpunues	Zhvillim i kompetencave digjitale të stafit, modernizim i mësimdhënies; adaptim i mjeteve AI; forcim i transformimit digjital institucional
3	HAWKING – Kapërcimi i hendekut digjital	01.12.2024 – 30.11.2026	Ndërkombëtar	Partner	University of Montenegro	UV (institucional)	Përmirësimi i aksesit digjital dhe përfshirjes në AL	Shërbime e-accessibility; modernizim metodash; mbështetje për studentë me nevoja të veçanta	Përmirësim i infrastrukturës digjitale; rritje e përfshirjes së studentëve me nevoja të veçanta; përputhje me politikat e aksesit dhe barazisë
4	Bashkëpunimi universitet–ndërmarrje: pas punësueshmëri	11.2020 – 11.2022	Ndërkombëtar / CBHE	Partner	International Burch University	UV + partnerë rajonalë	Forcim i lidhjes universitet–biznes	Programe praktike, internship; rritje universitet sipërmarrje; start-up dhe burse	Rritje e punësueshmërisë së të diplomuarve; rritja e qëndrueshmërisë me biznesin; zhvillim i praktikave profesionale dhe start-up

Në fushën e kërkimit shkencor dhe aktiviteteve artistike, bashkëpunimi realizohet përmes projekteve të përbashkëta, konferencave, seminarëve dhe botimeve shkencore të përbashkëta, duke forcuar kapacitetet hulumtuese dhe promovimin e inovacionit.

- *Listë projekte kërkimore të përbashkëta me financim kombëtar:*
  1. Trasformimi digital në turizëm: Ndikimi i teknologjisë në konkurrueshmërinë e SMBV- në Qarkun e Vlorës, sfidat dhe mundësitë (Dr. Rezarta Hasanaj);
  2. Onomastika e Lumit të Vlorës, trashëgimi arkeologjike-gjuhësore (Prof.As Zamira Alimemaj);
  3. Efektet anësore të vaksinës COVID-19 në popullatën e vaksinuar të qarkut Vlorë. (Dr. Majlinda Zahaj);
  4. Edukimi i Medias dhe Informacionit si kurrikul e integruar në programet master të mësuesisë (Dr. Eva Çipi);
  5. Qendër Digitale Simulatore për profesionistët e shëndetit (Prof.Dr. Aurela Saliaj);
  6. Studimi i ndikimit të Edukimit Muzikor në fushën e Pedagogjisë së Specializuar - Një qasje kërkimore dhe e aplikuar (Prof.As. Eliona Lici);
  7. Shqipëria në shkrimet e udhëtimit të periudhës paskomuniste (1990-) (Prof.Dr. Armela Panajoti).
- *Listë projekte kërkimore të përbashkëta me financim të huaj:*
  1. "Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit për arsimin profesional dhe sipërmarrjen" (DR. Rezarta Hasanaj);
  2. Arsimi i lartë për shoqëri të fuqizuara dhe të orientuara drejt qëndrueshmërisë (Prof.As Fatjona Kamberi);
  3. Fuqizimi i kapaciteteve për zbatimin e arsimit dual në arsimin e lartë shqiptar (Prof.Dr. Armela Panajoti);
  4. Fuqizimi i njohurive dhe aftësive në institucionet e arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor në përgatitje për transport dhe logjistikë detare me karbon zero (Prof. Dr Kristofor Lapa);
  5. Lumi Shushicë: Ura midis Ekologjisë dhe Biologjisë Molekulare (Dr. Aurora Bakaj);
  6. Përparimi i cilësisë së arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor përmes lehtësimit të integrimit të AI-së në mësimdhënie, të nxënë dhe kërkim shkencor (Prof. As Jonida Mehmetaj).
- *Listë botime në kuadër të grupeve kërkimore-shkencore:*

a. 'Analysis Using the Gini Coefficient'
Barleti University Prof. Assoc. Dr. Aurora Bakaj; Denada Sota; Dr. Bationa Bennewitz; Hajdar Kiçaj; Mariola Ismailaj;
b. 'Albania in the eyes of the Hebrew women who survived during the World War 2'
Mariglena Meminaj; Roland Zisi.
c. 'Shqipëria në shkrimet e udhëtarëve që e vizituan atë'
Adriana Gjika; Dorjana Klosi
d. 'Behind stereotypes and preconceptions: "The other" in "Land of Eagles"
Elonora Hodaj; Artemida Luçaj.
e. 'Post-communist Albania in Robert Carver's book'
Enkelejda Billa
f. 'Adventure tourism: tourism caves in Vlora municipality'
Prof. Asoc. Dr. Zamira Sinaj University of Vlora "Ismail Qemanli" Vlora, Albania, Prof. Dr. Fatmir Memaj Faculty of Economy, University of Tirana, Tirana, Albania

- *Konferenca, seminare dhe workshop-e në kuadër të projekteve kërkimore:*
Bridging ecology and molecular science - to train the next generation of scientists
https://univlora.edu.al/njoftime/workshop-ne-kuader-te-projektit-read
Workshop Ndëruniversitar në Biologji
https://univlora.edu.al/njoftime/workshop-nderuniversitar-ne-biologji
Konferencës së Pestë Ndërkombëtare NRA-CSIT
https://univlora.edu.al/njoftime/konferenca-e-peste-nderkombetare-nra-csit
Shkëmbim Akademik dhe Kulturor me University of Life Sciences Prague (Çeki)
https://univlora.edu.al/njoftime/workshop-ne-bashkepunim-me-university-of-life-sciences-prague
Mjeshtëria Dixhitale – Zhvillimi i Aftësive Profesionale Dixhitale, ILOFORDIGITAL INTERREG IPA South Adriatic.
https://univlora.edu.al/njoftime/diseminim-per-aktivitetet-e-projektit-ilofordigital

Bashkëpunimi me institucione të tjera mbështet gjithashtu veprimtarinë administrative dhe menaxheriale të universitetit, duke lehtësuar shkëmbimin e praktikave të mira në fushën e menaxhimit, planifikimit dhe monitorimit institucional.

Në fushën e praktikave profesionale, marrëdhëniet me kompani, institucione publike dhe organizata profesionale mundësojnë integrimin e studentëve në tregun e punës dhe zhvillimin e aftësive të tyre praktike. Marrëveshjet me institucionet ku zhvillohen praktikat mësimore kanë të përfshira klauzola specifike që sanksionojnë zhvillimin e këtyre praktikave studentore.

E.81: Dokumentacion mbi mentorimin dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.

Standardi II.21 Institucioni ndjek politika favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka zhvilluar dhe zbatuar politika të qëndrueshme dhe favorizuese për mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik në nivel ndërkombëtar, në përputhje me objektivat strategjike të ndërkombëtarizimit dhe rritjes së cilësisë akademike. Këto politika janë të integruara në dokumentet institucionale dhe në rregulloret e brendshme për studentë ndërkombëtare (**E.13**) të universitetit, duke siguruar një qasje të hapur dhe të drejtë për të gjithë pjesëmarrësit, Strategjia e Ndërkombëtarizimit (**E.33**) e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë synon që të fuqizojë pozicionin dhe përfshirjen e universitetit në arenën ndërkombëtare përmes zhvillimit të partneriteteve, mobiliteteve akademike, programeve dhe bashkëpunimeve shkencore dhe mësimore, si dhe përmirësimit të shërbimeve dhe mjedisit për studentët dhe stafin ndërkombëtar. Kjo strategji përfshin masa për rritjen e mobiliteteve studentore dhe të stafit, zgjerimin e programeve në gjuhë të huaj, konsolidimin e marrëdhënieve me institucionet e huaja dhe modernizimin e shërbimeve universitare në përputhje me standardet ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Për personelin akademik, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ofron mundësi të zhvillimit të pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare mësimdhënie, kërkimore dhe trajnime profesionale. Këto politika lehtësojnë shkëmbimin e përvojave dhe promovojnë bashkëpunimin shkencor ndërkombëtar, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor brenda universitetit.

Në nivel studentor, universiteti mbështet pjesëmarrjen në programe mobiliteti si Erasmus+, projekte bilaterale dhe marrëveshje me universitete partnere jashtë vendit. Politikat institucionale sigurojnë jo vetëm mundësi pjesëmarrjeje, por edhe mbështetje administrative dhe financiare, si dhe njohjen e krediteve akademike të fituara jashtë vendit. Kjo i mundëson studentëve të përfitojnë nga përvoja ndërkombëtare dhe të rrisin aftësitë e tyre akademike dhe profesionale (**E.12**).

Universitetet me të cilat UV ka marrëdhënie mobiliteti:
https://univlora.edu.al/marreveshje-nderinstitucionale

1. University of Castilla-La Mancha (UCLM);
2. University of Campania Luigi Vanvitelli;
3. Dunarea de Jos University of Galati;
4. Recep Tayyip Erdogan University, Turqi;
5. Aurel Vlaicu University of Arad;
6. University of Tokat Gaziosmanpasa, Turqi;
7. University of Kalisz, Poland;
8. West University of Timisoara, Rumani;
9. Polytechnic University of Cartagena, Spanjë;
10. Riga Technical University, Letoni; etj.,

...nga 120 marrëveshje ndërinstitucionale Erasmus+ aktive.

Menaxhimi i mobilitetit realizohet përmes mekanizmave institucionalë të koordinimit dhe monitorimit, duke garantuar funksionimin e qëndrueshëm të politikave dhe përdorimin efektiv të burimeve. Rezultatet e mobilitetit përdoren për të vlerësuar dhe përmirësuar politikën e universitetit në këtë fushë, duke siguruar një qasje të vazhdueshme për rritjen e pjesëmarrjes dhe ndikimit të saj në zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve dhe stafit.

Mobilitetet e personelit akademik në kuadër të projektit Erasmus+ gjatë periudhës 2020-2025:

- Fakulteti i Ekonomisë: 56 personel nga FE dhe 56 personel nga partnerët;
- Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore: 76 personel nga FSHTN dhe 37 personel nga partnerët;
- Fakulteti i Shëndetit: 65 personel nga FSH dhe 17 personel nga partnerët;
- Fakulteti i Shkencave Humane: 213 personel nga FSHH dhe 102 nga partnerët;

E.82: Procedurë mobiliteti Erasmus+ personel akademik, personel joakademik; Vërtetim mobiliteti për personel hyrës.

Mobilitetet e studentëve në kuadër të projektit Erasmus+ gjatë periudhës 2020-2025:

- Fakulteti i Ekonomisë: 27 studentë nga FE dhe 5 nga partnerët;
- Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore: 71 studentë nga FSHTN dhe 8 nga partnerët;
- Fakulteti i Shëndetit: 8 studentë nga FSH dhe 12 nga partnerët;
- Fakulteti i Shkencave Humane: 88 studentë nga FSHH dhe 28 nga partnerët;

E.83: Procedurë mobiliteti Erasmus+ student; Dokumentacion për njohjen e krediteve të fituara jashtë vendit; Vërtetim mobiliteti për student hyrës.

Niveli i mobiliteteve ndërkombëtare të UV-së është vlerësuar edhe nga tregues të jashtëm të njohur ndërkombëtarisht, si:

- pajisja me Erasmus Charter for Higher Education (ECHE) 2021–2027 (https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/02/Erasmus-Charter-for-Higher-Education-awared-to-University-of-Vlora.pdf),
- renditja nr. 1 në botë për "Student Mobility and Openness" sipas WURI Ranking 2024 (https://www.wuri.world/_files/ugd/8e5131_bb90c24bf4354b40b7821b877661a03a.pdf, fq.4)

WURI 2024: Student Mobility and Openness (A2) Top 100

Rank	Name	Rank	Name
1	University of Vlora "Ismail Qemali"	26	University of Bonn
2	University of Vienna	27	Faculty of Dentistry, Universitas Gadjah Mada
3	Daffodil International University	28	Daggendorf Institute of Technology
4	Rajshahi University of Engineering and Technology	29	Universidad Tecnológica Centroamericana UNITEC
5	University of Liberal Arts Bangladesh	30	CHRIST (Deemed to be University)
6	University of Health Sciences	31	Lovely Professional University
7	University of Mostar	32	Telkom University
8	Hayek Global College	33	LSPR Institute of Communication and Business
9	National University of Management	34	Universitas Teknokrat Indonesia
10	Shanghai Jiao Tong University	35	Politecnico di Milano
11	Badr University in Cairo	36	Nagoya University
12	Dalian Neusoft University of Information	37	Hebrew University of Jerusalem
13	Westlake University	38	Tokyo International University
14	Peking University	39	Hokkaido University
15	University of Chemistry and Technology, Prague	40	The University of Tokyo
16	The University of the South Pacific	41	METAVERSE UNIVERSAL COLLEGE (MVUC)
17	China Europe International Business School (CEIBS)	42	Universiti Kebangsaan Malaysia (UKM)
18	Xi'an Jiaotong University	43	University of Amsterdam
19	University of Cologne	44	Norwegian University of Science and Technology
20	LMU Munich	45	University of Oslo
21	Technical University of Munich	46	Fatima Jinnah Medical University
22	Chitkara University, Punjab	47	Khwaja Fareed University of Engineering and Information Technology, Rahimyar Khan, Pakistan
23	University of Split	48	Sir Syed University of Engineering and Technology
24	University of Münster	49	Superior University
25	West Bengal National University of Juridical Sciences (WBNUJS/NUJS)	50	Fatima Jinnah Women University

Standardi II.22 Institucioni kryen studimin e tregut për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, specifikisht Fakulteti i Ekonomisë, kryen sistematikisht studime të tregut dhe analiza të nevojave të sektorit arsimor, ekonomik dhe social, për të orientuar zhvillimin e programeve të studimit dhe veprimtarive të tij akademike dhe kërkimore. Këto studime synojnë të identifikojnë kërkesat e tregut për aftësi dhe kompetenca të ndryshme, duke siguruar që oferta akademike e universitetit të jetë e përshtatshme, konkurruese dhe e orientuar drejt punësimit të studentëve.

Procesi i studimit të tregut përfshin mbledhjen dhe analizimin e të dhënave nga aktorët rajonalë dhe kombëtarë, përfshirë institucionet publike, kompanitë, organizatat profesionale dhe sektorin privat. Bazuar në rezultatet e këtyre analizave, universiteti planifikon zhvillimin e programeve të reja, përmirësimin e programeve ekzistuese, dhe përshtatjen e metodave mësimore dhe kurrikulave për të përmbushur nevojat reale të tregut.

Studimi i tregut kontribuon gjithashtu në zhvillimin e praktikave profesionale, duke lehtësuar integrimin e studentëve në tregun e punës dhe duke ofruar një lidhje të drejtpërdrejtë mes arsimit të lartë dhe sektorit ekonomik. Rezultatet e analizave përdoren nga strukturat akademike dhe administrativë për të përmirësuar planifikimin strategjik, alokimin e burimeve dhe marrjen e vendimeve të bazuara në evidenca.

E.84: Studimet e tregut të punës për program mësimore DP Operator turistik.

E.85: Raporte mbi integrimin e studentëve në tregun e punës përmes praktikave, FE.

<u>Përfundimet dhe Vlerësimi</u>

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka krijuar dhe zbatuar mekanizma të qëndrueshëm dhe transparentë për menaxhimin institucional dhe financiar, për bashkëpunimin dhe partneritetet, për mobilitetin ndërkombëtar të studentëve dhe stafit akademik, si dhe për kryerjen e studimeve të tregut që orientojnë zhvillimin e programeve dhe veprimtarive të tij.

Proceset e hartimit të buxhetit janë të dokumentuara dhe të miratuara nga organet kompetente, duke garantuar transparencë, kontroll dhe llogaridhënie. Bashkëpunimet me institucione rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare mbulojnë fushat akademike, kërkimore, praktikat profesionale dhe veprimtarinë administrative, duke fuqizuar cilësinë e programeve dhe ndikimin e universitetit në shoqëri dhe tregun e punës. Politikat favorizuese për mobilitet nxisin shkëmbimin ndërkombëtar të përvojave, ndërsa studimet e tregut ofrojnë informacion të saktë për planifikimin e programeve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulave dhe praktikave profesionale.

Arritjet më kuptimplotë të Universitetit 'Ismail Qemali' në fushën e burimeve mbështetëse dhe partneriteteve institucionale gjatë 5 vjeçarit të fundit janë:

- Krijimi i një sërë mekanizmave mbështetës për zhvillimin e kapaciteteve të stafit akademik dhe administrativ: programe trajnuese me personel akademik shqiptar, ndërkombëtar dhe diasporë.
- Zhvillimi sinjifikativ i kapaciteteve infrastrukturore të njësive kryesore: akademike dhe kërkimore, kryesisht me financime të siguruara jashtë UV-së. Shtimi i disa laboratorëve kërkimorë dhe didaktikë. Nisja e procedurave të akreditimit të laboratorëve kërkimorë.
- Rritja e financave të grumbulluara prej institucionit, të ardhura prej rritjes së numrit të studentëve dhe zgjerimit të shërbimeve UV.
- Përveç rikonstruksionit tërësor të faqes zyrtare të UV-së, ngritja e disa platforma të tjera plotësuese që pasqyrojnë gjithë veprimtaritë e zhvilluara në UV. Strukturimi i gjithë platformave UniVlora është bërë i tillë që hedhja e informacionit në to bëhet në mënyrë interaktive. Krijimi i dy platformave (UNVIMAS dhe Google classroom) në të cilat mund të shpërndahen materiale didaktike online për studentët dhe të zhvillohet mësim interaktiv me dërgim detyrash dhe dërgim vlerësimesh online. UV është duke përfunduar procedurat e patentimit të sistemit të brendshëm të informacionit UNVIMAS (UNiversity VIrtual MAnagement System), jo vetëm për ta njohur si pronësi intelektuale të UV-së, por edhe për të patur të drejtën e marketimit të tij.
- Zgjerim spektakolar të marrdhënieve të partneritetit me mbi 120 IAL ndërkombëtare, mbi 15 IAL mbarëkombëtare dhe mbi 50 institucione rajonale dhe kombëtare.
- Të gjitha programet e UV-së zhvillojnë praktika profesionale në një rrjet institucionesh rajonale (Fier, Vlorë, Lushnje), nën mentorimin e ekspertëve të këtyre institucioneve.
- Fal krijimit të partneriteteve të reja me IAL shqiptare dhe OECD është mundësuar hapja e disa programeve të reja joint dhe double degree.
- Vendi i parë në klasifikimin WURI Ranking 2024 për "Student Mobility and Openness", fal zgjerimit të partneriteteve ndërkombëtare në programet Erasmus+.

Në tërësi, Universiteti tregon një qasje proaktive, të orientuar drejt rezultateve dhe të bazuar në evidenca konkrete. Ai ka struktura dhe mekanizma funksionalë për menaxhim, monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm, duke siguruar përputhje me misionin dhe objektivat strategjike.

Si fusha për zhvillim të mëtejshëm në Strategjinë e Zhvillimit të UV-së evidentohet zgjerimi i mëtejshëm i bashkëpunimeve ndërkombëtare drejt aleancave universitare dhe investime të qëndrueshme në kërkimin shkencor, inovacionin dhe partneritetet me sektorin publik dhe privat.

STANDARDI II - PËRMBUSHET PLOTËSISHT

III – PROGRAMET E STUDIMIT, MËSIMDHËNIA DHE VLERËSIMI

Standardi III.1 Institucioni ofron programe në përputhje me misionin, strategjinë e tij të zhvillimit dhe kërkesat e tregut.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ofron programe studimi që janë në përputhje të drejtpërdrejtë me misionin (**E.1:** Statuti i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, neni 3.1) dhe vizionin e tij institucional për një Universitet 4.0 (**E.35:** Strategjia e Zhvillimit të UV-së 2025-2030, fq.47), të orientuar drejt ofrimit të arsimit të lartë cilësor, zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe kontributit aktiv në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të rajonit dhe të vendit.

Në Universitetin "Ismail Qemali," Vlorë janë aktualisht të hapura këto programe studimi:

- 1 Program Profesional 1 vjeçar
- 6 Programe Profesionale 2 vjeçare
- 30 Programe Bachelor
- 37 Programe Master
- 2 Programe të Ciklit të Tretë
- 1 Program të Formimit të Zhvillimit të Vazhduar
- 5 Programe Double degree
- 3 Programe të Përbashkëta

Universiteti i Vlorës ka programe të përbashkëta me universitetet e mëposhtme:

Tipi i diplomës	*Cikli i Studimit*	*Emërtimi*	*Universiteti Partner*
Joint Degree	Bachelor	Shkenca Arkitekturore për Trashëgiminë kulturore	Universiteti Politeknik i Barit, Itali
	Master	Mbrojtja dhe menaxhimi i Mjedisit Detar	Universiteti i Malit të Zi, Universiteti i Durrësit
		Inxhinieri Armatimi me profil minor në Aviacion dhe Naval	Akademia e Forcave të Armatosura, Tiranë
Double Degree	Bachelor	Gjuhësi të aplikuara në fushën e Turizmit	Universiteti i Salentos, Itali
		Inxhinieri Mekanike	Universiteti Politeknik i Barit, Itali
		Inxhieri Elektrike	Universiteti Politeknik i Barit, Itali
	Master	Projektimin dhe Menaxhimin e Sistemeve Turistike dhe Kulturore	Universiteti i Barit "Aldo Moro", Itali

Universiteti i Vlorës ofron programe studimi në gjuhë angleze:

Cikli i Studimit	*Tipi i diplomës*	*Emërtimi*	*Universiteti Partner*
Bachelor	Joint Degree	Architecture Sciences for Heritage	Universiteti Politeknik i Barit, Itali
	Albanian degree	Compiuter Science	
	Albanian degree	General Nursing	
	Double Degree	Mechanical Engineering	Universiteti Politeknik i Barit, Itali
	Double Degree	Electric Engineering	Universiteti Politeknik i Barit, Itali

	Double Degree	Marine Engineering	Universiteti Politeknik i Barit, Itali
	Joint Degree	Applied linguistic in Tourism	Universiteti i Salentos, Itali
	Albanian degree	English language	
Master	Joint Degree	Maritime Environment Protection and Management – MEP&M	Universiteti i Malit të Zi, Universiteti i Durrësit
	Albanian degree	Teaching in CLAB	
	Albanian degree	Translation and Interpreting	

(E.80: Marrëveshjet për programet e përbashkëta dhe të dyfishta: BSc në Shkenca Arkitekturore për Trashëgiminë, BSc në Inxhinieri Mekanike, MSc "Mbrojtja dhe Menaxhimi i Mjedisit Detar", MSc "Inxhinieri Armatimi me Profil Minor në Aviacion dhe Naval")

Hartimi, rishikimi dhe zhvillimi i programeve të studimit bazohet në:

- politikat kombëtare dhe europiane të arsimit të lartë (*Dokumenti i Politikave të Zhvillimit të Arsimit të Lartë 2030, Objektivat strategjikë 1.1.1; 1.2.1. / Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, politikat C.1, C.3*).
- dokumentet strategjike institucionale (**E.35:** Strategjia e Zhvillimit të UV-së 2025-2030, Objektivat strategjikë I.2.1; III.1.1; III.1.2),
- analizën e nevojave të shoqërisë dhe tregut të punës (**E.84:** Studim i tregut të punës për programin mësimor DP Operator turistik)

Programet e studimit janë konceptuar në përputhje me prioritetet strategjike të institucionit, duke reflektuar profilin akademik të UV-së, traditën e tij në fusha të caktuara studimi dhe potencialin zhvillimor të rajonit të Vlorës. Në këtë kuadër, universiteti ofron programe në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë, të cilat mbulojnë fusha të ndryshme të dijes, duke synuar një balancë ndërmjet formimit teorik dhe zhvillimit të aftësive praktike dhe profesionale.

Institucioni ndjek procedura të qarta për hapjen e programeve të reja dhe për rishikimin periodik të atyre ekzistuese (**E.4:** Rregullorja e përgjithshme e UV-së, neni 55 pika 2,3,4). Këto procedura përfshijnë analizën e kërkesës së tregut, vlerësimin e mundësive të punësimit të të diplomuarve, konsultimin me aktorë të jashtëm (punëdhënës, institucione publike, organizata profesionale), si dhe verifikimin e kapaciteteve akademike, infrastrukturore dhe financiare të institucionit. Përmes këtij procesi, UV synon të sigurojë që ofertat akademike të jenë të qëndrueshme, relevante dhe konkurruese.

(E.38: Procedurë miratimi dhe aplikimi e programit BSc në Computer Engineering)
(E.48: Procedurë e riorganizimit të programit të studimit Bsc në Infermieri të Përgjithshme)

Përputhshmëria e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës realizohet edhe përmes integrimit të praktikave profesionale, moduleve aplikative dhe bashkëpunimeve me institucione dhe subjekte të ndryshme ekonomike dhe shoqërore (https://univlora.edu.al/marreveshjet-me-institucionet-brenda-vendit). Kjo qasje kontribuon në përgatitjen e studentëve me kompetenca të transferueshme dhe të kërkuara, duke rritur mundësitë e tyre për punësim dhe integrim profesional pas diplomimit.

Standardi III.2 Programet e studimeve ofrohen në përputhje me objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë i koncepton dhe i zbaton programet e studimit në përputhje të plotë me objektivat kombëtarë të zhvillimit të arsimit të lartë, si dhe me prioritetet dhe orientimet ndërkombëtare në këtë fushë. Institucioni mbështetet në kuadrin ligjor dhe strategjik kombëtar për arsimin e lartë, duke respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, si dhe në dokumentet udhëzuese që lidhen me integrimin e Shqipërisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë.

Në përputhje me objektivat kombëtarë: Arsim cilësor për të gjithë; Ekonomia blu dhe Zhvillimi i turizmit, sipas Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 (*https://s3albania.org/wp-content/uploads/2023/07/1a.-NSDI-_shqip_vendim-2023-02-22-88.pdf*), UV i kushton vëmendje zhvillimit të programeve që kontribuojnë në rritjen e punësimit, përgatitjen e specialistëve në fusha prioritare për ekonominë dhe administratën publike, si dhe forcimin e inovacionit dhe digjitalizimin e proceseve të punës. Më poshtë paraqitet një pjesë e programeve të Universitetit të Vlorës, të cilat synojnë formimin e specialistëve në të gjitha nivelet e arsimit të lartë, në përputhje me nevojat e tregut rajonal të punës, duke mbuluar të gjitha hallkat mbështetëse të zhvillimit të ekonomisë blu dhe potencialeve turistike në rajon.

DP në Operator Turistik
DP në Udhërrëfyes turistik për rajonin e jugut
DP në Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit
DP në Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare dhe Bregdetare
DP në Asistencë në Geriatri
BSc në Administrim Biznesi
BSc në Manaxhim Turizmi
BSc në Gjuhësi e Aplikuar në fushën e Turizmit
BSc në Shkenca Kompjuterike
BSc në Navigacion
BSc në Shkenca Arkitekturore për Trashëgiminë
BSc në Inxhinieri Navale
MP në Sipërmarrje në Turizëm
MP në Udhërrëfim dhe komunikim turistik
MP në Operacione Industriale dhe Navale
MP në Studime të Avancuara Detare
MSc në Projektim dhe Menaxhim i Sistemeve Turistike Kulturore
MSc in Maritime Environment Protection and Management
MSc në Inxhinieri Armatimi, me profil Naval dhe Aviacion
MSc në Pasuritë e Paluajtshme
MSc në Përkthim e Interpretim
MSc në Biologji Mjedisore

Në aspektin ndërkombëtar, universiteti synon përafrimin e vazhdueshëm të programeve të studimit me standardet dhe praktikat më të mira europiane dhe ndërkombëtare. Kjo realizohet përmes harmonizimit të kurrikulave me programet homologe të universiteteve partnere bazuar në Procesin e Bolonjës, përfshirjes së literaturës bashkëkohore ndërkombëtare, si dhe integrimit të dimensionit ndërkombëtar dhe ndërkulturor në përmbajtjen e programeve (**E.86:** Program studimi Bsc në Inxhinieri Elektrike ishte-bëhet)

Universiteti 'Ismail Qemali' ofron disa programe që kanë njohje automatike në tregun e BE, të cilat janë hartuar ose riorganizuar (**E.87:** Riorganizim i Programit Bsc në Infermieri të Përgjithshme sipas VKM-së nr. 823, datë 28.12.2023 për "Disa Shtesa dhe Ndryshime në Vendimin nr. 41, datë

24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë") në përputhje të plotë me strukturën e kurrikulave homologe të BE:

DP në Asistencë në Geriatri
BSc në Infermieri të Përgjithshme
BSc në Infermieri Mami
BSc në Shkenca Arkitekturore për Trashëgiminë
https://univlora.edu.al/njoftime/international-bachelors-degree-in-architecture-sciences-for-heritage

Institucioni nxit gjithashtu përdorimin e gjuhëve të huaja në procesin mësimor dhe zhvillimin e programeve të përbashkëta ose të dyfishta (**E.80**: Marrëveshjet për programet e përbashkëta dhe të dyfishta: BSc në Shkenca Arkitekturore për Trashëgiminë, BSc në Inxhinieri Mekanike, MSc "Mbrojtja dhe Menaxhimi i Mjedisit Detar", MSc "Inxhinieri Armatimi me Profil Minor në Aviacion dhe Naval"), në përputhje me objektivat e ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë.
Programe të ofruara në gjuhën angleze dhe me profesorat ndërkombëtar (**E.88:** Lista e pedagogëve të huaj në UV):

BSc në Architecture Science for Heritage
Bsc in Computer Engineering
BSc in English Language
MSc in Maritime Environment Protection and Management
MSc in Teaching in CLAB
MSc in Translation and Interpreting

UV mbështet pjesëmarrjen aktive në programe dhe nisma ndërkombëtare, të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt në modernizimin e ofertës akademike dhe në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Përvoja e fituar përmes projekteve të bashkëpunimit ndërkombëtar reflektohet në rishikimin e kurrikulave, në përditësimin e metodologjive të mësimdhënies dhe në forcimin e komponentit praktik dhe kërkimor të programeve.
Gjithashtu, studentët e UV-së kanë marr pjesë me rezultate spektakolare në konkurrime universitare kombëtare e mbarëkombëtare, si dhe në konferenca studentore, evente të realizuara nën tutorimin e stafit akademik dhe ndihmësakademik të UV-së:

Konkursi mbarëkombëtar Law Competition (Fondacioni Halimi)
https://univlora.edu.al/njoftime/departamenti-i-drejtesise---uv-fitues-ne-university-law-competition
Konkursi kombëtar UniDebate (Ministria e Rinisë)
https://univlora.edu.al/njoftime/konkursi-kombetar-i-debatit-per-universitetin
Konkursi kombëtar Debating Economics
https://univlora.edu.al/njoftime/universiteti-i-vlores-ne-krye-te-mendimit-kritik
Konferenca studentore e Fakultetit të Shëndetit
https://univlora.edu.al/njoftime/konferenca-e-dyte-studentore-e-organizuar-nga-departamenti-i-infermierise
Konferenca studentore ndërkombëtare ASEC, e zhvilluar në UV 2024
https://univlora.edu.al/njoftime/13th-asecu-youth-international-conference-and-summer-school

Standardi III.3 Programet kanë objektiva të përcaktuar qartë dhe rezultatet e tyre të të nxënit përputhen me nivelin e profilin e kualifikimit që ofrojnë.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë siguron që çdo program studimi të ketë objektiva të përcaktuara qartë, koherente dhe të matshme, të cilat janë në përputhje me misionin institucional, profilin akademik të universitetit dhe kërkesat e kuadrit kombëtar dhe europian të kualifikimeve

E.4: Rregullorja e përgjithshme e UV-së, neni 54.5; 56; 58.

Objektivat e programeve (faqja 4 e çdo programi) janë të konceptuara në mënyrë të tillë që të reflektojnë nivelin e studimit, profilin profesional ose akademik të kualifikimit dhe kompetencat që studenti pritet të fitojë në përfundim të ciklit përkatës. Rezultatet e të nxënit (learning outcomes) për çdo program studimi janë të formuluara në përputhje me Kuadrin Shqiptar të Kualifikimeve dhe me Kuadrin Europian të Kualifikimeve (niveli 5, 6, 7 dhe 8), duke respektuar ndarjen në njohuri, aftësi dhe kompetenca (faqja 4 - https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2019/12/Objektivat-e-programit-Bsc-ne-Infermieri-te-pergjithshme.pdf). Këto rezultate janë të harmonizuara me nivelin e ciklit të studimit dhe me profilin përkatës të kualifikimit, duke garantuar progresion.

E.89: Program studimi DP në Akuakulturë dhe Higjienë e Produkteve të Peshkimit, Bsc në Biologji, MP në Arsimin e Mesëm në Biologji me profil minor në Kimi, të të njëjtës fushë-Biologji

Përputhshmëria e rezultateve të të nxënit me nivelin dhe profilin e kualifikimit reflektohet edhe në përmbajtjen e programeve mësimore dhe në ndërtimin e planeve të studimit. Çdo modul ose lëndë kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në arritjen e rezultateve të përgjithshme të programit, duke shmangur mbivendosjet dhe duke garantuar një shpërndarje logjike dhe progresive të ngarkesës akademike. Metodat e mësimdhënies dhe të vlerësimit janë të përshtatura me objektivat dhe rezultatet e përcaktuara, duke synuar vlerësimin e plotë dhe të drejtë të arritjeve të studentëve.

UV i kushton rëndësi të veçantë transparencës së objektivave dhe rezultateve të të nxënit, duke i bërë ato të aksesueshme për studentët dhe palët e interesuara përmes dokumentacionit zyrtar të programeve, syllabuseve dhe materialeve informuese.

Programet: Diploma Profesionale
https://univlora.edu.al/programet/PP;
Programet: Bachelor
https://univlora.edu.al/programet/DNP;
https://univlora.edu.al/programet/PP;
Programet: Master Profesional
https://univlora.edu.al/programet/DND;
Programet: Master Shkencor
https://univlora.edu.al/programet/MSC;
Programet: Doktorale
https://univlora.edu.al/programet/PHD.
English-speaking programes
https://univlora.edu.al/programeten/JD

Kjo transparencë ndihmon studentët të kuptojnë qartë pritshmëritë akademike, rrugën e zhvillimit të tyre profesional dhe mundësitë e punësimit ose të studimeve të mëtejshme.

Standardi III.4 Institucioni përcakton qartë dhe ndjek procedurat për miratimin e programeve të reja.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka të përcaktuara qartë dhe të formalizuara procedurat për propozimin, vlerësimin dhe miratimin e programeve të reja të studimit, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator kombëtar për arsimin e lartë, si dhe me politikat dhe dokumentet e brendshme institucionale (**E.4:** Rregullorja e përgjithshme e UV-së, neni 55). Këto procedura synojnë të garantojnë që çdo program i ri të jetë i justifikuar akademikisht, i qëndrueshëm dhe në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të universitetit.

Propozimet për programe të reja hartohen dhe propozohen nga departamentet. Drejtuesi i departamentit ngre grupin e punës për përgatitjen e aplikimit të programit të ri, i cili paraqet përpara departamentit propozimin për programin e ri, sipas fushave të aplikimit të përcaktuara nga MA. Procesi nis me identifikimin e nevojës për programin përkatës, bazuar në analizën e kërkesave të

tregut të punës, zhvillimeve shkencore dhe akademike, si dhe prioriteteve strategjike të institucionit. Programi i propozuar shoqërohet me dokumentacion të detajuar, që përfshin objektivat e programit, rezultatet e të nxënit, strukturën kurrikulare, burimet njerëzore dhe infrastrukturore, si dhe vlerësimin e tarifave financiare.

Pasi kalon fazën e vlerësimit të brendshëm në departament e fakultet, programi i ri i studimit i nënshtrohet procedurave të miratimit nga organet drejtuese të universitetit, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Në mbledhjet e radhës së këtyre organeve bashkë me propozimin e departamentit paraqitet edhe relacioni vlerësues për propozimin, i përgatitur nga zëvendësrektori akademik, drejtori i shërbimeve ndihmësakademike dhe sektori i Kurrikulës & Statistikave, të cilët vlerësojnë plotësimin formal të dokumentacionit aplikues sipas akteve nënligjore në fuqi. Në rast vlerësimi pozitiv nga SA dhe BA, propozimi për programin e ri dërgohet në Ministrinë e Arsimit për miratim përfundimtar.

Vetëm pas përfundimit të këtij procesi dhe marrjes së miratimeve përkatëse, programi përfshihet në ofertën zyrtare akademike të institucionit dhe i nënshtrohet procedurave të jashtme të licencimit dhe/ose akreditimit, sipas legjislacionit në fuqi.

(**E.38:** Procedurë miratimi dhe dokumentacioni i plotë i aplikimit të programit BSc në Computer Engineering : procesverbali i mbledhjes së departamentit, vendimi i departamentit, përcjellja nga Dekani, relacioni i Sektorit të Kurrikulës & Statistikave, Vendimi i SA, Vendimi i BA, Formati i aplikimit.)

Në bazë të kërkesavve të MA, çdo vit njësitë bazë hartojnë dhe nisin për miratim në SA, BA dhe MA kriteret dhe kuotat e gjithë programeve të studimit. Procedura e hartimit dhe miratimit të tyre është e njëjtë me procedurën e lartpërmendur për programet e studimit. Hartimi i kuotave limitohet rreptësisht nga standardet e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë mbi kapacitetet pritëse të UV-së: raportet PAE/student dhe sipërfaqe/student. Pas miratimit, kuotat dhe kriteret e çdo viti akademik publikohen në faqen zyrtare të UV-së tek secili prej programeve të studimit.

(E.39: Procedurë miratimi kuotash në FE për vitin akademik 2025-2026)

(E.40: Procedurë miratimi kriteresh FSHTN për vitin akademik 2025-2026)

Programet Bachelor me kuotat dhe kriteret e vitit akademik, të publikuar në faqen zyrtare të UV-së *https://univlora.edu.al/programet/DNP*

Standardi III.5 Programet e studimeve ofrohen në përputhje me kapacitetet e institucionit.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë siguron që programet e studimit të ofrohen në përputhje të plotë me kapacitetet akademike, jo-akademike dhe infrastrukturore të institucionit, duke garantuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e procesit mësimor. Planifikimi dhe zhvillimi i ofertës akademike mbështetet në një vlerësim të kujdesshëm të burimeve ekzistuese dhe të nevojave për zhvillim të mëtejshëm, në përputhje me strategjinë institucionale dhe standardet kombëtare të arsimit të lartë.

Kapacitetet akademike të UV-së përbëhen nga staf akademik i kualifikuar, me tituj dhe grada shkencore të përshtatshme për nivelet dhe profilet e programeve të studimit që ofrohen (*Tabela përmbledhëse 1; Tabela përmbledhëse 2)*. Institucioni ndjek politika të qarta për rekrutimin dhe vlerësimin e stafit akademik (**E.4:** Rregullorja e përgjithshme e UV-së nenet 41, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 50), duke siguruar mbulimin e lëndëve dhe moduleve me pedagogë që plotësojnë kriteret ligjore dhe profesionale. Shpërndarja e ngarkesës mësimore bëhet në mënyrë të planifikuar, duke garantuar përputhjen ndërmjet kapaciteteve të stafit dhe kërkesave të programeve të studimit (**E.66:** Ngarkesa mësimore e stafit akademik të Departamentit të Kujdesit Shëndetësor).
Në aspektin e infrastrukturës dhe burimeve materiale, UV disponon ambiente mësimore, laboratorë, biblioteka dhe pajisje didaktike që mbështesin realizimin e programeve të studimit (*Tabela përmbledhëse 16)*. Strukturat administrative të UV-së vlerësojnë periodikisht gjendjen dhe përshtatshmërinë e infrastrukturës, duke ndërmarrë masa për mirëmbajtjen, modernizimin dhe

zgjerimin e saj, në funksion të nevojave specifike të programeve dhe rritjes së numrit të studentëve. Duke përdorur të ardhurat e veta, si dhe duke aplikuar vazhdimisht për fonde infrastrukturore dhe për zgjerim ambientesh Universiteti 'Ismail Qemali' ka arritur të ketë një numër të konsiderueshëm laboratorësh, të mirëpajisur me paisje të standardeve OECD dhe të mirëfurnizuara në vijimësi. Gjithashtu, UV investon periodikisht për rikonstruksionin dhe zgjerimin e sipërfaqeve në dispozicion të aktiviteteve akademike dhe kërkimore.

E.90: Pasurimi, mirëmbajtja dhe zgjerimi i infrastrukturës mësimore: Inventari i laboratorit të Biologjisë. Blerje paisjesh laboratorike. Blerje materialesh laboratori Biologji. Blerje smartbordesh, kompiuterash, kondicionerësh. VKM e Godinës së Apelit.

Përpara çdo viti akademik, Universiteti raporton plotësimin e kapaciteteve akademike (raportin pedagog/student) dhe infrastrukturore (raporti student/m^2) për çdo njësi kryesore. Ky raportim përfshin kuotat e kërkuara për gjithë programet aktuale dhe të propozuara të fakulteteve

E.91: Raporti i kapaciteteve institucionale 2025

Standardi III.6 Programet e studimit janë të organizuar në cikle studimi.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ofron programe mësimore të të gjitha cikleve të studimit, të parashikuara nga Ligji i Arsimit të Lartë, në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe me standardet europiane, duke siguruar progresion akademik, koherencë në ofertën akademike, cilësi dhe krahasueshmëri të kualifikimeve të ofruara.

Organizimi në cikle studimi përbën një element themelor të politikave institucionale për sigurimin e cilësisë dhe për integrimin e plotë të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë. UV i organizon programet e studimit në cikle studimi në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) dhe me parimet e Procesit të Bolonjës, duke garantuar strukturim të qartë, progresion akademik dhe krahasueshmëri ndërkombëtare të kualifikimeve të ofruara.

Programet e studimit ofrohen në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë, secili me objektiva të qarta dhe rezultate të të nxënit të përshtatura me nivelin përkatës të studimit.

- cikli i parë (niveli 5,6 KSHK) synon ofrimin e njohurive bazë dhe zhvillimin e aftësive themelore akademike dhe profesionale;
- cikli i dytë (niveli 7 i KSHK) fokusohet në thellimin e njohurive, zhvillimin e kompetencave të avancuara dhe specializimin profesional ose shkencor;
- cikli i tretë (niveli 8 i KSHK) është i orientuar drejt kërkimit shkencor të avancuar, inovacionit dhe formimit të studiuesve të rinj.

Për secilin cikël janë përcaktuar kërkesa të qarta për pranimin, vlerësimin dhe përfundimin e studimeve, në përputhje me nivelin e kualifikimit dhe me objektivat e programeve përkatëse:

Programe: Diploma Profesionale
https://univlora.edu.al/programet/PP;
Programe: Bachelor
https://univlora.edu.al/programet/DNP;
Programe: Master Profesional
https://univlora.edu.al/programet/DND;
Programe: Master shkencor
https://univlora.edu.al/programet/MSC;
Programe: Doktorata
https://univlora.edu.al/programet/PHD

Strukturimi i programeve në cikle studimi reflektohet qartë në planet mësimore, në ngarkesën akademike dhe në shpërndarjen e krediteve ECTS, duke siguruar një progresion logjik dhe të balancuar të të nxënit, progresion që është i sanksionuar edhe në aktet rregullatore të UV-së

E.4: Rregullorja e përgjithshme e UV-së, neni 63, pika 5);
E.92: Plani mësimor DP në Asistencë Geriartrike, Bsc në Infermieri të Përgjithshme, MP në Infermieri Kirurgjikale);
E.93: Syllabys 'Pediatri' (cikli I), Syllabys 'Pediatri e avancuar' (cikli II).

Standardi III.7 Programet e studimeve nga cikli në cikël hartohen me qëllim mirëorientimin dhe përftimin gradual të njohurive nga studentët.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë siguron që programet e studimit të jenë të hartuara në mënyrë të tillë që të ofrojnë një përvetësim gradual të njohurive, aftësive dhe kompetencave nga studentët, duke krijuar një rrugë të qartë akademike dhe zhvillim progresiv të logjikshëm të kompetencave të studentëve, nga një cikël në tjetrin. Ky parim është themelor për sigurimin e cilësisë akademike, progresionit të studentëve dhe arritjes së rezultateve të të nxënit në përputhje me profilin e kualifikimit të secilit cikël studimi.

Hartimi i programeve bazuar në progresionin gradual të njohurive nis nga përcaktimi i objektivave të qarta dhe rezultateve të të nxënit në secilin cikël, duke siguruar që çdo modul ose lëndë të kontribuojë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në arritjen e kompetencave të parashikuara. Organizimi në cikle studimi mbështetet edhe nga mekanizma institucionalë që garantojnë koherencën ndërmjet cikleve dhe lehtësojnë vijimësinë akademike të studentëve. UV synon të krijojë mundësi të qarta për progresion nga një cikël në tjetrin, duke respektuar kriteret akademike dhe duke inkurajuar zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe shkencor të studentëve. Ky proces bazohet në një analizë të kujdesshme të lidhjes ndërmjet cikleve të studimit, duke garantuar harmonizimin e njohurive themelore të ciklit të parë me specializimin dhe avancimin e kompetencave në ciklin e dytë dhe të tretë

E.94: Program studimi Bsc në "Gjuhë Shqipe dhe Letërsi", MSc në "Mësimdhënie e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë", PhD në "Studime Gjuhësore, Letrare e Kulturore"

Institucioni ndjek praktika të formalizuara për planifikimin dhe hartimin e kurrikulave, ku struktura e programeve reflekton një progresion logjik të lëndëve dhe moduleve, duke ndihmuar studentët të ndërtojnë njohuritë e tyre gradualisht, të konsolidojnë kompetencat bazë dhe të zhvillojnë aftësi të avancuara profesionale dhe shkencore. Për më tepër, integrimi gradual i praktikave profesionale, projekteve kërkimore dhe moduleve të aplikimit praktik ndihmon studentët në transferimin dhe përdorimin e njohurive në situata reale.

Më poshtë paraqitet organizimi i praktikës në programet e formimit të Infermierisë. Si shihet, praktikimi i studentëve fillon që vitin e parë të studimeve në kushte laboratorike, kalon në dy ditë në javë në institucione spitalore gjatë vitit të dytë, për të vazhduar me 3 ditë në javë gjatë vitit të tretë. Ndërsa në programet master praktika bëhet për periudha disa mujore në pavione të specializuara, në përfundim të së cilës studentët marrin individualisht dëshminë e ndjekjes së praktikës nga shefi i pavionit.

BSc në Infermieri të Përgjithshme
Viti I: Praktika laboratorike,
Viti II: Praktika klinike në module (2 ditë në javë),
Viti III: Praktika klinike në module dhe **Praktikë profesionale** (3 ditë në javë),
MP në Infermieri Kirurgjikale:
Viti IV: Praktika spitalore 2 mujore në pavionin e Kirurgjisë
E.92: Plani mësimor DP në Asistencë Geriartrike, Bsc në Infermieri të Përgjithshme, MP në Infermieri Kirurgjikale

Standardi III.8 Institucioni ofron programe të të nxënit gjatë gjithë jetës.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë angazhohet në ofrimin e një baze të qëndrueshme të programeve të të nxënit gjatë gjithë jetës (Life Long Learning – LLL), duke synuar të plotësojë nevojat e qytetarëve për zhvillim profesional, aftësi të reja dhe përditësim të njohurive, pavarësisht moshës, pozicionit profesional ose niveleve të mëparshme akademike. Këto programe përputhen me misionin dhe strategjinë institucionale të UV-së, duke u fokusuar në rritjen e kapaciteteve të individëve dhe fuqizimin e zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor të rajonit.

Programet LLL ofrohen në forma të ndryshme, duke përfshirë:

- kurse të shkurtra (*minikurse IA FSHTN*),
  https://univlora.edu.al/njoftime/nis-mini-course-on-data-sciences-and-ai-ne-universitetin-e-vlores
  https://www.facebook.com/share/r/1S7PPxLcFC/
  https://www.facebook.com/share/p/1GBgY5gFmw/
- trajnime profesionale (*trajnim Linnux*),
  https://univlora.edu.al/njoftime/komandat-e-linux-dhe-hyrje-ne-bash-scripting
- seminare/workshop (*trajnim në shkrim projektesh*),
  https://univlora.edu.al/njoftime/trajnimi-mbi-shkrimin-e-nje-projekt-cilesor-prane-qendres-kerkimore-shkencore-ne-fakultetin-e-shendetit-publik
- konferenca me kredite të çertifikuara nga institucione vlerësuese kombëtare (*konferencë infermier, mësues*)
  https://univlora.edu.al/njoftime/konferenca-i-nderkombetare-shkencore-epidemia-e-heshtur-e-semundjeve-jo-te-transmetueshme
  https://univlora.edu.al/njoftime/konferenca-nderkombetare-me-temen-ndertimi-i-kompetencave-mikrokreditet-per-rritjen-dhe-ekselencen-ecred4teach-mesuesve
- **E.95:** Modul çertifikimi për formimin e vazhduar në fushën psiko-pedagogjike + plani mësimor DE-FSHH; shkolla e Drejtorëve FSHH,
- module me mikrokredenciale (*Credits for Teachers (https://cred4teach.univlora.edu.al/)*

të përshtatura sipas kërkesave të tregut të punës dhe tendencave aktuale akademike.

Përmbajtja e këtyre programeve lidhet ngushtë me fushat e specializimit të fakulteteve, duke shfrytëzuar:

- burimet e institucionit:
  - paisjet laboratorike (*trajnim neonat FSH*),
    (https://univlora.edu.al/njoftime/qender-simulatore-per-trajnim-shendetesor)
  - sallat audio-vizive (*konferencë, workshop, trajnim – Linnux, ...*)
    https://univlora.edu.al/njoftime/komandat-e-linux-dhe-hyrje-ne-bash-scripting
    https://univlora.edu.al/njoftime/vizite-akademike---programi-ceepus
    https://univlora.edu.al/njoftime/takim-frymezues-me-wizz-air-pilot-academy
    https://univlora.edu.al/njoftime/nis-mini-course-on-data-sciences-and-ai-ne-universitetin-e-vlores
  - platformat online të UV-së (*trajnim IT)*
    (https://classroom.google.com/c/ODE2NTcxNzQ3NjQ2)
- ekspertizën e stafit akademik të UV-së
  Credits for Teachers;
  E.96: Trajnim IT për mësuesit e shkollave të mesme (Petro Sota - Fier),
- ekspertë të jashtëm
  trajnim në shkrim projektesh, trajnim në komunikim publik)
  https://univlora.edu.al/njoftime/trajnimi-mbi-shkrimin-e-nje-projekt-cilesor-prane-qendres-kerkimore-shkencore-ne-fakultetin-e-shendetit-publik
  https://univlora.edu.al/njoftime/trajnimi-public-speaking-sprint)

- staf akademik ndërkombëtar
  Minikurse Data sciences dhe IA - FSHTN,
  https://univlora.edu.al/njoftime/nis-mini-course-on-data-sciences-and-ai-ne-universitetin-e-vlores
  '5S as a method of waste elimination in Lean Management concept'
  PhD. Eng. Bartosz Spychalski
  https://univlora.edu.al/njoftime/workshop-nga-departamenti-i-biznesit
  Marrveshje me Institutin 'Jeta e re' LiderImpakt për trajnimin e stafit akademik dhe administrativ për zhvillim profesional
  https://univlora.edu.al/media/dokument/instituti-jeta-e-re.pdf)
  https://univlora.edu.al/njoftime/trajnimi-public-speaking-sprint .

Ofrimi i programeve të të nxënit gjatë gjithë jetës mbështetet në mekanizma të strukturuar për planifikim, monitorim dhe vlerësim të cilësisë. UV përdor feedback-un e pjesëmarrësve, analizën e tregut të punës dhe bashkëpnimet me aktorë të jashtëm për të përshtatur përmbajtjen dhe format e programeve në përputhje me nevojat reale dhe standardet profesionale

E.97: Modele të vlerësimit të aktiviteteve
E.98: Çertifikata të ndryshme nga aktivitetet LLL
E.99: Listë pjesëmarrësish në aktivitetin LLL, ku evidentohet vendi i punës.

Në Planin Strategjik të Zhvillimit 2030, Universiteti 'Ismail Qemali' ka vendosur si objektiv strategjik zhvillimin e moduleve dhe mikrokredencialeve fleksibël për studentë dhe profesionistë me synim zgjerimin e mëtejshëm të ofertës akademike, veçanërisht në sektorë të rinj të zhvillimit teknologjik dhe profesional (**E.35:** Strategjia e Zhvillimit të UV-së 2025-2030, Objektivi strategjik III.1.1)

Në përfundim, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë konkludon se ofron programe të të nxënit gjatë gjithë jetës, të strukturuara dhe të monitoruara në mënyrë sistematike, duke siguruar zhvillim profesional, integrim në tregun e punës dhe përputhshmëri me misionin dhe strategjinë institucionale.

Standardi III.9 Programet e studimeve mbështeten në profilin kërkimor dhe profesional të njësisë dhe realizohen në bashkëpunimin me aktorë të fushës.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (UV) siguron që programet e studimit të mbështeten në profilin kërkimor dhe profesional të njësive akademike që i ofrojnë ato, duke garantuar koherencë ndërmjet ekspertizës së stafit akademik, potencialit kërkimor të institucionit dhe kërkesave të tregut të punës (*Tabela III.9: Profili i departamenteve: programet, ekspertiza e PAE, fushat e kërkimit*).

Hartimi i programeve bazohet në analizën e kapaciteteve kërkimore të njësive akademike, duke u siguruar që studentët të përfitojnë nga eksperienca dhe ekspertiza e stafit në projekte shkencore (Standardi IV.3, https://univlora.edu.al/projekte-kombetare), laboratorë dhe aktivitete kërkimore të integruara në kurrikulë. Kjo qasje synon të rrisë cilësinë e mësimdhënies dhe relevancën profesionale të programeve, duke lidhur teorinë me praktikën dhe duke integruar zhvillimin shkencor në procesin mësimor. Një numër i konsiderueshëm laboratorësh, didaktikë dhe kërkimorë, funksionojnë në dispozicion të realizimit të programeve të studimit të UV-së, të domosdoshme për zhvillimin e aftësive dhe kompetencave të studentëve që në vitet e shkollës:

- Qendra Simulatore e Profesionistëve të Shëndetit
- Qendra Shkencore për Monitorimin dhe Ekologjinë Detare në Vlorë.
- Qendra 'SUCCESS'
- Smart City Hub center për kapacitete Ekonomike
- Laboratori kërkimor-shkencor Klinik (biokimik dhe mikrobiologjik)

- Laboratori kërkimor-shkencor i Shkencave Detare (Navigacion)
- Laboratori i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare
- Laboratori know-hub (printime 3D)
- Laboratorët didaktikë të Infermierisë së Përgjithshme
- Laboratori didaktik i Infermierisë Mami
- Laboratorët didaktikë të Anatomisë Humane
- Laboratori didaktik i Edukimit Parashkollor
- Laboratori didaktik i Përkthim-Interpretimit
- Laboratori didaktik i Fizikës
- Laboratorët didaktikë të Zoologjisë dhe Mikrobiologjisë
- Laboratori didaktik i Kimisë

Programet realizohen gjithashtu në bashkëpunim të ngushtë me aktorë të fushës, përfshirë institucione publike, organizata profesionale, kompani dhe subjekte të tjera të ekonomisë dhe shoqërisë civile, marrëveshjet me të cilat gjenden të plota në faqen zyrtare të UV-së (https://univlora.edu.al/marreveshjet-me-institucionet-brenda-vendit). Ky bashkëpunim kontribuon në përshtatjen e programeve me kërkesat reale të tregut të punës, siguron mundësi për praktikë profesionale dhe projektim të moduleve të aplikimit praktik, si dhe përforcon lidhjen ndërmjet mësimdhënies dhe nevojave profesionale dhe kërkimore të komunitetit.

Universiteti 'Ismail Qemali' ndjek procedura të formalizuara për identifikimin e mundësive të bashkëpunimit me aktorë të fushave të programeve akademike dhe për integrimin e tyre në programe, duke përfshirë:

- ***marrëveshje bashkëpunimi, për zhvillimin e praktikës profesionale*** – disa prej të cilave janë:
  - Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Fier;
  - Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Lushnje;
  - Shkolla e Drejtorëve të Arsimit Parauniversitar;
  - Gjykata e Shkallës së Parë, Vlorë;
  - Gjykata Administrative Lushnje;
  - Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë Tiranë;
  - OST – Operatori i Sistemit të Transmetimit;
  - Qendra e Kontrollit Teknik;
  - Nasto Inxhiniering Vlorë;
  - Shoqëria "TechnoPlastic" shpk;
  - Operatori i Sistemit të Shpërndarjes;
  - Drejtoria e Ujësjellës & Kanalizime Vlorë;
  - OSHEE – Dega Vlorë;
  - Porti Detar Vlorë;
  - UBA Bank – Dega Vlorë
  - Raiffeizen Bank – Dega Vlorë
  - Balfin grup
  - Vlora Marina
  - Shoqëria "Green Coast Hotel" sh.p.k
  - Hotel "Regina Group" sh.p.k;
  - Hotel Kral;
  - Hotel Partner;
  - Drejtoria Rajonale e Operatorit të Kujdesit Shëndetësor, DROKSH
  - Spitali Rajonal Vlorë
  - Spitali Rajonal Fier
  - Spitali Memorial Fier
  - Spitali Psikiatrik Vlorë;

- ***partneritete me IAL mbarëkombëtare***
  - Universiteti "Luarasi" Tiranë;
  - Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë;
  - Akademia e Forcave të Armatosura;
  - Universiteti "Fan S. Noli" Korçë;
  - Universiteti Polis;
  - Kolegji Universitar "Reald" Vlorë;
  - Universiteti i Mjekësisë, Tiranë;
  - Kolegji "Universum" Prishtinë;
  - Universiteti "Zoja e Këshillit të Mirë"
  - Universiteti Europian i Tiranës;
  - Universiteti i Arteve Tiranë;
  - Universiteti Politeknik i Tiranës;
- ***përfshirjen e ekspertëve të jashtëm si ligjërues të fushës ose mentorë praktik.***
  - Pedagogë me kohë të pjesshme PAK

Nr	**Emri dhe Mbiemri**	**Statusi**	**Fakulteti pritës**	**Viti akademik**	**Institucioni ku punon me kohë të plotë**
1.	Prof. Dr. Genc Burazeri	PAK	Fakulteti i Shëndetit	2025–2026	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
2.	Prof. Dr.Klodiana Gorica	PAK	Fakulteti i Ekonomisë	2024–2025	Universiteti i Tiranës
3.	Prof. Dr.Dorina Kripa	PAK	Fakulteti i Ekonomisë	2024–2025	Universiteti i Tiranës
4.	Prof. Dr.Ilirjan Mandro	PAK	Fakulteti i Shkencave Humane	2024–2025	Rektor, Akademia e Sigurisë
5.	Prof. Dr.Shyqyri Llaci	PAK	Fakulteti i Ekonomisë	2023–2024	Universiteti i Tiranës
6.	Ing.Altin Jonuzi	PAK	Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore	2025–2026	Operacioni i Sistemit të Shpërndarjes O.S.SH.
7.	Msc.Nikollaq Gjika	PAK	Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore	2025–2026	Drejtoria e Arsimit Parauniversitar Fier (DRAP)
8.	Magjistrat.Dorina Stroka	PAK	Fakulteti i Shkencave Humane	2025–2026	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë
9.	Dr. Eduart Kapaj	PAK	Fakulteti i Shëndetit	2025–2026	Spitali Rajonal Fier
10.	Dr. Artan Shkurti	PAK	Fakulteti i Shëndetit	2025–2026	Spitali Rajonal Vlore

  - Pedagogë të ftuar
  - Pedagogë të huaj me kohë të plotë

    E.88: Lista e pedagogëve të huaj në UV

    E.100: Dokumentacion për angazhimin vjetor të personelit akademik të huaj për mësimdhënien e gjuhës dhe kulturës italiane
  - Ekspertë shqiptarë, të huaj, diasporë, të angazhuar për leksione, work-shop dhe trajnime

    Takime me stakeholders

    Forumi "Për të ardhmen e turizmit të qëndrueshëm në Vlorë"
    https://univlora.edu.al/njoftime/forumi-per-te-ardhmen-e-turizmit-te-qendrueshem-ne-vlore
    Forumi 'Kontabiliteti: Nga auditori në realitetin ekonomik – inspirim, integritet dhe karrierë'
    https://univlora.edu.al/njoftime/dita-nderkombetare-e-kontabilitetit-2025
    Forum me praninë e Z. Scott Miller, ekspert amerikan në politikën fiskale
    https://univlora.edu.al/njoftime/takim-me-z-scott-miller-ekspert-ne-politike-fiskale-dhe-zhvillim-ekonomik
    Leksion i hapur me akademikët e Akademisë së Forcave të Armatosura
    https://univlora.edu.al/njoftime/leksion-i-hapur-me-pjesemarrjen-e-akademise-se-forcave-te-armatosura
    Leksion i hapur në kuadër të 100-vjetorit të krijimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit

https://univlora.edu.al/njoftime/leksion-i-hapur-ne-kuader-te-100-vjetorit-te-kontrollit-te-larte-te-shtetit

Trajnim 'Reanimimi i të porsalindurit', nga Qendra Shqiptare për popullsinë dhe zhvillimin, https://www.youtube.com/watch?v=6ld7oAXXef4

E.101.: Raportimi i leksioneve me personalitete ndërkombëtare

Kjo qasje forcon dimensionin profesional dhe kërkimor të programeve dhe garanton një përvojë të pasur akademike për studentët.

Standardi III.10 Programet e studimeve monitorohen në mënyrë periodike.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka vendosur mekanizma të strukturuar dhe të qëndrueshëm për monitorimin periodik të programeve të studimit, në përputhje me praktikat më të mira të sigurimit të cilësisë dhe me kërkesat e legjislacionit kombëtar. Aktet rregullatore të brendshme të UV-së janë tërësisht të kompletuara në suportin rregullator të nevojshëm për monitorimin periodik të programeve të studimit, ku në qendër të këtij sistemi monitorues është vendosur Sektori i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Akreditimit, i cili realizon rakordimin e raportimeve periodike të të gjithë njësive kryesore dhe organizimin e sondazheve për vlerësimin periodik të cilësisë së veprimtarisë akademike dhe administrative të UV-së. Ky proces, që synon të sigurojë që programet e studimit të mbeten relevante, cilësore dhe të harmonizuara me misionin, strategjinë institucionale dhe nevojat e tregut të punës, është i sanksionuar me akte rregullatore në UV.

E.4: Rregullorja e Përgjithshme UV, kreu II, neni 12;
E.23: Detyrat funksionale të strukturës së brendshme të UV-së - Sektorit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Akreditimit fq.14-28;
E.10: Rregullore UNVIMAS, neni 24;
Vendim SA për miratimin e formatit të Pyetësorit të Studentëve https://univlora.edu.al/media/dokument/vsa97-2020.pdf
Vendim SA për miratimin e formatit të Vlerësimit të performancës vjetore https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2017/12/Vendim-Senati-Nr.52-date-20.04.2017.pdf
Rregullore e bashkëpunimit të Studentëve Alumni me UV-në, neni 10, pika 8. https://univlora.edu.al/media/dokument/92025rregullore-alumni-2025.pdf

Monitorimi periodik realizohet përmes një kombinimi të instrumenteve dhe metodave:

- Analiza e performancës akademike të studentëve
  Raportet vjetore të fakulteteve dhe UV-së përfshijnë raportim për:
  - Të dhënat për numrin e përgjithshëm të studentëve, studentëve ekselentë dhe përsëritës, për çdo program studimi (tab.13 e Raportit vjetor të UV-së).
  - Të dhënat për numrin e përgjithshëm të studentëve të transferuar dhe çregjistruar. (tab.14 e Raportit vjetor të UV-së). https://univlora.edu.al/media/dokument/raport-vjetor-institucional-2024-2025.pdf

  Procesverbalet e notave të studentëve kanë të bashkangjitur edhe kalueshmërinë dhe notën mesatare të çdo grupi.
  E.102: Procesverbal notash me përqindjen e kalueshmërisë dhe notës mesatare të studentëve kalues.
- Feedback-u sistematik i studentëve për përmbajtjen e programeve, metodologjitë e mësimdhënies dhe burimet mësimore (https://univlora.edu.al/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise), nëpërmjet:
  1. Pyetësorëve vjetorë të studentëve të UV-së për Cilësinë e Mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi, nëpërmjet sistemit UNVIMAS (**E.10***:* Rregullore UNVIMAS, neni 24);
  2. Pyetësorëve të Vlerësimit të Cilësisë së Shërbimeve të ofruara prej stafit ndihmës-akademik dhe administrativ të UV-së

Raporti i analizës së rezultateve të pyetësorëve të studentëve për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara prej stafit ndihmësakademik dhe administrativ, viti akademik 2023-2024
https://univlora.edu.al/njoftime/raport-dhe-rekomandime-per-permiresimin-e-cilesise-se-sherbimeve-administrative

3. Pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet ALUMNI-t (https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-rezultateve-te-pyetesorit-te-alumni-t)
Raport Alumni 2025
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/05/raport-Alumni-2025.pdf
Rekomandimet e raportit Alumni 2025
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/05/REKOMANDIMET-PYETESOR-ALUMNI.pdf
4. Sondazhit kombëtar të studentëve
https://univlora.edu.al/njoftime/takim-informues-ne-kuader-te-sondazhit-kombetar-te-studenteve-sks
5. Fokus-grupeve me studentë të cikleve të ndryshme të studimit.
(https://univlora.edu.al/njoftime/fokus-grupe-me-studente-ne-prag-diplomimi-qershor-2025)
https://univlora.edu.al/njoftime/fokus-grupe-me-studentet-gjate-muajit-shkurt-2023

- Vlerësimi i stafit akademik dhe i njësive akademike për zbatimin e planeve mësimore dhe arritjen e rezultateve të të nxënit;

  Vlerësimi i performancës ka për qëllim të sigurojë informacion periodik nëse aftësitë dhe kompetencat e personelit janë të përshtatshme për realizimin e objektivave individuale, për të krahasuar rezultatet me pritshmëritë, për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe masat dhe veprimet përmirësuese që duhen ndërmarrë.
  Ky vlerësim kryhet prej menaxherëve të procesit të vlerësimit në linjë hierarkike, sipas (**E.4:** Rregullores së Përgjithshme të UV-së, neni 50.)
  Vendim SA për miratimin e formatit të Vlerësimit të performancës vjetore
  https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2017/12/Vendim-Senati-Nr.52-date-20.04.2017.pdf
  (**E.31:** Vlerësim performance: staf akademik, ndihmesakademik, administrativ, drejtues njësie).

Procedurat e monitorimit janë të formalizuara dhe të dokumentuara, duke përfshirë periudha të rregullta raportimi, raporte vjetore për cilësinë e programeve dhe rekomandime për përmirësim.

- Raporti vjetor institucional 2024-2025 (https://univlora.edu.al/media/dokument/raport-vjetor-institucional-2024-2025.pdf)
- Raporti vjetor institucional 2023-2024 (https://univlora.edu.al/media/dokument/raporti-veprimtarise-uv-2023-2024-opt.pdf)
- Raporti vjetor institucional 2022-2023 (https://drive.google.com/file/d/1psq8R_5JfxDdycvYmWwqQOEI5pIpqq_L/view)
- Raporti vjetor institucional 2021-2022 (https://drive.google.com/file/d/1oMXjeUvL4wahpqVtrxmh6LTt2bU8YhwX/view)
- Raporti vjetor institucional 2020-2021 (https://drive.google.com/file/d/1mtw02Sdw9ieCPMWR7OZrBBdIXyhvUgMq/view)

Kjo qasje siguron një cikël të mbyllur të vlerësimit dhe përmirësimit, ku të dhënat e mbledhura shërbejnë si bazë për vendimmarrje strategjike dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve.

Si përfundim mund të konkludojmë që në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë funksionon një sistem i qëndrueshëm dhe funksional monitorimi periodik, pasi programet e studimit monitorohen në mënyrë periodike përmes procedurave të formalizuara dhe mekanizmave të sigurimit të cilësisë,

duke garantuar ruajtjen e nivelit të cilësisë, përputhshmërinë me objektivat dhe zhvillimin profesional të studentëve.

Standardi III.11 Programet e studimeve janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm të tyre në funksion të rritjes së cilësisë.

Programet e studimit janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm, i organizuar dhe i dokumentuar, në funksion të rritjes së cilësisë akademike, zhvillimit profesional të studentëve dhe përputhshmërisë me nevojat e tregut dhe të shoqërisë. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka vendosur mekanizma të strukturuar për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit (**E.4:** Rregulloja e përgjithshme e UV-së, neni 55), në mënyrë që ato të jenë të përputhura me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe të kontribuojnë në zhvillimin e aftësive dhe kompetencave të studentëve. Përmirësimi i programeve është pjesë e politikave të sigurimit të cilësisë, duke garantuar që çdo program të reflektojë kërkesat akademike, kërkimore dhe profesionale të kohës (**E.4:** Rregullorja përgjithshme e UV-së, neni 55, pika 4).

Procesi i përmirësimit të vazhdueshëm bazohet në një cikël të mbyllur të vlerësimit, ku përdoren të dhëna të mbledhura nga monitorimi i programeve (Standardi III.10), feedback-u i studentëve, vlerësimi i stafit akademik dhe bashkëpunimi me aktorë të jashtëm, përfshirë punëdhënës dhe partnerë profesionalë. Këto informacione analizohen nga njësitë bazë dhe organet drejtuese për të identifikuar mundësitë për rishikim dhe zhvillim të programeve.

Përmirësimi ndër vite i programeve të UV-së ka përfshirë:

- Rishikimin dhe përditësimin e kurrikulave dhe rezultateve të të nxënit:
  Riorganizimin e programeve në kuadër të përputhjes së tyre me kërkesat rregullatore kombëtare (MSc në Drejtësi) dhe ndërkombëtare (BSc në Infermieri të Përgjithshme dhe Bsc në Infermieri Mami)
  E.103: Program mësimor i riorganizuar MSc në Drejtësi. Program mësimor i riorganizuar BSc në Infermieri Mami
- Integrimin e moduleve të reja ose të përmirësuara në përputhje me zhvillimet shkencore dhe profesionale;
  E.104: Program mësimor i riorganizuar MSc në "Shkenca Kompjuterike" (moduli i Inovacionit)
- Zgjerimin e bashkëpunimeve me aktorë të jashtëm dhe partnerë ndërkombëtarë;
  Riorganizimi i programeve për ti përputhur me kurrikulën e programeve të BE, me të cilat është lidhur marrëveshje Double degree.
  E.105: Programi mësimor double degree BSc në Inxhinieri Elektrike
- Përforcimin e dimensionit praktik dhe kërkimor të programeve
  Riorganizim me qëllim zgjerimin e orëve të praktikës së programeve dhe/ose projekteve klinike e detyrave të kursit.
  E.106: Program mësimor i riorganizuar BSc në Ekonomiks

UV promovon një qasje proaktive dhe të dokumentuar për përmirësimin e programeve, ku çdo ndryshim ose rishikim formalizohet dhe i nënshtrohet procedurave të brendshme të miratimit dhe komunikimit me palët e interesuara

E.48: Procedurë e riorganizimit të programit të studimit Bsc në "Infermieri të Përgjithshme". Dokumentacioni i plotë i aplikimit të programit: vendimi i departamentit, përcjellja nga Dekani, Relacioni i Drejtorisë së Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë të Studimeve, Vendimi i SA, Vendimi i BA, Formati i aplikimit.

Standardi III.12 Institucioni ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka vendosur një politikë të qartë dhe të strukturuar për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, e cila është pjesë integrale e strategjisë institucionale për rritjen e cilësisë akademike dhe të rezultateve të të nxënit të studentëve. Kjo politikë synon të sigurojë që procesi i mësimdhënies të jetë efektiv, modern, i përshtatshëm për profilin e studentëve dhe në përputhje me standardet kombëtare dhe europiane të arsimit të lartë.

Politika e UV-së për përmirësimin e mësimdhënies mbështetet në disa aspekte kryesore:

1. *Modernizimi i vazhdueshëm i infrastrukturës didaktike* – Universiteti i Vlorës investon sistematikisht në ngritjen e laboratorëve të rinj, pasurimin e laboratorëve aktualë dhe mirëfunksionimin e tyre nëpërmjet materialeve laboratorike. Në ngritjen dhe pasurimin e laboratorëve përveç fondeve të shpenzuara nga UV, janë shfrytëzuar edhe fonde të përfituara nga projektet për ngritjen e kapaciteteve në rang kombëtar (PIKSH, fondi i ndërkombëtarizimit) dhe europian (Standarti III.9).

   E.90: Pasurimi, mirëmbajtja dhe zgjerimi i infrastrukturës mësimore: Inventari i laboratorit të Biologjisë. Blerje paisjesh laboratorike. Blerje materialesh laboratori Biologji. Blerje smartbordesh, kompiuterash, kondicionerësh. VKM e Godinës së Apelit.

2. *Zhvillimi profesional i stafit akademik* – Universiteti i Vlorës zbaton politika mbështetëse për avancimin e kualifikimit të stafit akademik: krijimin e kushteve për ndjekjen e doktoratave, rimbursimin e shpenzimeve për konferencat dhe artikujt e kërkuar në kuadër të plotësimit të kritereve për titujt dhe gradat shkencore, rimbursimin e tarifave të marrjes së titujve akademikë. Universiteti gjithashtu siguron mentorimin dhe mbështetjen për pedagogët e rinj, si dhe trajnime, seminare, workshop-e dhe programe për avancim profesional të pedagogëve, duke përfshirë metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies, përdorimin e teknologjive digjitale dhe qasjet inovative në mësimdhënie.

   E.107: Urdhri i Rektores për suportin e pedagogëve doktorantë
   Vendimi për rimbursimin e tarifës së titujve akademikë
   https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/01/Vendim-Senati-Nr.-66-Date-06.11.2024-Per-disa-Ndryshime-ne-vendimin-nr.-2.pdf
   https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/04/Vendim-Nr.-2-Senati-Akademik-2024.pdf
   https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2017/12/Vendim-Senati-Nr.75-date-13.07.2017.pdf
   E.58: Procedurë rimbursimi artikulli shkencor, konference, tarifë të titullit akademik.
   Kurs trajnimi shkrim projekti FSHH
   https://univlora.edu.al/njoftime/trajnimi-mbi-shkrimin-e-nje-projekt-cilesor-prane-qendres-kerkimore-shkencore-ne-fakultetin-e-shendetit-publik
   Minikurse IA FSHTN
   https://univlora.edu.al/njoftime/nis-mini-course-on-data-sciences-and-ai-ne-universitetin-e-vlores
   Trajnim Linnux,
   https://univlora.edu.al/njoftime/komandat-e-linux-dhe-hyrje-ne-bash-scripting
   Trajnim në komunikim publik
   https://univlora.edu.al/njoftime/trajnimi-public-speaking-sprint
   Trajnim AKKSHI
   https://univlora.edu.al/njoftime/programet-nderkombetare-te-kerkimit-dhe-inovacionit
   Marrveshje me Institutin 'Jeta e re' LiderImpakt për trajnimin e stafit akademik dhe administrativ për zhvillim profesional

Trajnim për përdorimin e teknologjisë IT
https://classroom.google.com/c/ODE2NTcxNzQ3NjQ2
Manual përdorimi UNVIMAS për pedagogët
https://univlora.edu.al/media/dokument/manual-perdorimi-unvimas-pedagog-2026.pdf

3. *Përfshirja si pedagogë të ftuar të akademikëve të huaj, preferencialisht të diasporës* – Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë nxit dhe mbështet përfshirjen e akademikëve të huaj si pedagogë të ftuar, me prioritet përfaqësues të diasporës akademike shqiptare. Kjo praktikë synon pasurimin e procesit mësimor me perspektiva ndërkombëtare, transferimin e përvojave bashkëkohore didaktike dhe kërkimore, si dhe forcimin e dimensionit ndërkombëtar të programeve të studimit. Kjo qasje vlerësohet si një instrument i rëndësishëm për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe për forcimin e lidhjes së universitetit me rrjetet akademike ndërkombëtare
E.101: Raportimi i leksioneve me personalitete ndërkombëtare

4. *Përdorimi i praktikave inovative dhe digjitale* – Politika institucionale inkurajon integrimin e metodave të mësimdhënies të orientuara drejt studentit, përdorimin e platformave online dhe të resurseve të ndryshme digjitale, si dhe zhvillimin e moduleve interaktive që përmirësojnë përfshirjen dhe angazhimin e studentëve.
   - Smartborde në gjithë auditorët (leksione, seminare), të cilët mundësojnë pasurimin e informacioneve të përçuara tek studentët në formë audio-vizive, si dhe mësimdhënie interaktive me lidhje direkte me anë të internetit.
   - Paisje simulatore (laboratorët e Navigacionit, Infermierisë, Mamisë), të cilat mundësojnë praktikimin dhe formimin e aftësive të studentëve në situata thuajse reale.
     E.108: Pajisjet e laboratorëve simulatorë: Inventari i Laboratorit të Navigacionit. Inventari i Qendrës Simulatore për Profesionistët e Shëndetit
   - Platformat UNVIMAS dhe Google classroom UniVlora ofrojnë mundësinë e përcjelljes tek studentët të leksioneve të digjitalizuara, të dërgimit dhe vlerësimit të përjavshëm të detyrave të kursit – që është kyçi i motivimit të studentëve në përfshirjen e tyre në mësimnxënie.
     E.109: Module blended me qasje interaktive: Metodologjia e Kërkimit Shkencor; Menaxhim i Burimeve Njerëzore në Administrim Publik.
     Leksione online në UNVIMAS
     https://uvms.univlora.edu.al/pedagog/elearning
   - Biblioteka digjitale (https://univlora.edu.al/biblioteka) u krijon mundësi studentëve të eksplorojnë informacione shtesë përtej literaturës bazë, të ofruar prej pedagogut të lëndës.

5. *Lidhja e mësimdhënies me kërkimin dhe praktikën profesionale* – Stafi akademik përdor përvojën kërkimore dhe bashkëpunimet me aktorë të jashtëm për të ofruar shembuj praktikë, studime rasti dhe projekte aplikative, duke i dhënë mësimdhënies dimension profesional dhe shkencor.
https://univlora.edu.al/marreveshjet-me-institucionet-brenda-vendit

6. *Vlerësimi i vazhdueshëm i mësimdhënies dhe Përmirësimi i vazhdueshëm i përmbajtjes dhe metodologjisë* – Përmes mekanizmave të sigurimit të cilësisë, përfshirë feedback-un e studentëve, vlerësimet e bashkëpunëtorëve dhe raportet periodike të njësive akademike, institucioni monitoron dhe analizon performancën e mësimdhënies për të identifikuar mundësi për përmirësim. Duke u bazuar në monitorimin periodik dhe raportet e evaluimit, UV rishikon kurrikulën, metodat e vlerësimit dhe materialet mësimore për të siguruar që ato përmbushin objektivat e programeve dhe nevojat e studentëve (Standardi III 10,11).

Strategjia e Zhvillimit të UV-së 2030 (**E.35)** në Skenarin II, objektivat strategjikë II.1.1, II.3.1 parashikon respektivisht Përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies digjitale dhe Modernizimin e ambienteve dhe ndërtimin e ekosistemeve digjitale, nëpërmjet Leksioneve interaktive blended, Mësimdhënies online dhe të përzier me pedagogë ndërkombëtarë, Modernizimit

të auditorëve dhe laboratorëve dhe Krijimit të ekosistemeve dixhitale për bashkëpunim akademik dhe biznesi. Ndërkohë në Skenarin III, objektivi strategjik III.1.1 parashikohet Modernizimi i programeve dhe kurrikulave (Universitet 4.0) duke synuar kalimin nga mësimdhënia e bazuar *tek leksionet e pedagogut* tek mësimdhënia e bazuar tek *puna e pavarur e studentit.*

Standardi III.13 Programet e studimeve të shpallura zbatohen sipas strukturave të miratuara në nivel institucional dhe kombëtar.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë garanton që të gjitha programet e studimit të shpallura zbatohen në përputhje të plotë me strukturat e miratuara në nivel institucional dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga legjislacioni kombëtar për arsimin e lartë. Ky proces siguron që studentët të ndjekin programet sipas planifikimeve të miratuara, duke përfshirë lëndët, kreditet, rezultatet e të nxënit dhe ngarkesën akademike të përcaktuar.

Hyrja në zbatim e programeve ndjek procedurën e mëposhtme (**E.4:** Rregullorja e përgjithshme e UV-së, neni 55):

- planet mësimore dhe kurrikulat propozohen nga departamentet sipas formateve të aplikimit të MA,
- verifikohen nga strukturat institucionale të UV-së: Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakademike dhe Sektori i Kurrikulës dhe Statistikave, për zbatimin e formateve të përcaktuara nga MA,
- kalojnë më pas për miratim paraprak në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit
- dërgohen elektronikisht për miratim përfundimtar në MA.

Të gjitha programet mësimore në UV janë të strukturuara sipas Udhëzimit nr.41. dt.21.1.2018 të MA. Planet mësimore dorëzohen çdo fillim viti akademik në Rektorat tek ZëvendësRektorja Akademike dhe Sektori i Kurrikulës&Statistikave, të cilët verifikojnë përputhshmërinë e këtyre planeve me udhëzimin e sipërcituar dhe vendimmarrjet e SA (**E.4:** Rregullorja e përgjithshme e UV-së, neni 60, pika 4). Përpara fillimit të vitit akademik departamentet miratojnë titullarët e lëndëve, syllabyset dhe literaturën bazë që do të përdoret për vitin në vijim (**E.4:** Rregullorja e përgjithshme e UV-së, neni 63, pika 4).

E.89: Program studimi DP në Akuakulturë dhe Higjienë e Produkteve të Peshkimit, Bsc në Biologji, MP në Arsimin e Mesëm në Biologji me profil minor në Kimi, të të njëjtës fushë-Biologji

E.49: Vendim DI për titullarët dhe literaturën bazë

Politika e UV-së e zbatimit të programeve siguron transparencë për studentët dhe për publikun, duke shpallur qartë ofertën akademike dhe kurrikulat në faqen zyrtare të universitetit dhe në dokumentacionin e pranimit

Programet: Diploma Profesionale
https://univlora.edu.al/programet/PP
Programet: Bachelor
https://univlora.edu.al/programet/DNP
Programet: Master Profesional
https://univlora.edu.al/programet/DND
Programet: Master Shkencor
https://univlora.edu.al/programet/MSC
Programet: Doktorale
https://univlora.edu.al/programet/PHD
English-speaking programes
https://univlora.edu.al/programeten/JD

Ky proces forcon besueshmërinë e institucionit dhe garanton që studentët të marrin njohuritë dhe

kompetencat e premtuara në programin e studimit që kanë zgjedhur.

Si përfundim, në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, të gjitha programet e studimit të shpallura zbatohen në mënyrë të sistematizuar dhe të monitoruar, në përputhje me strukturat e miratuara institucionalisht dhe në nivel kombëtar, duke garantuar transparencë, cilësi akademike dhe përputhshmëri me ligjin dhe standardet e arsimit të lartë.

Standardi III.14 Programet e studimeve mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët në kurset teorike.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë integron elementë praktikë dhe aplikativë në të gjitha programet e studimit, në mënyrë që studentët të mund të transferojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara në kurset teorike në situata reale profesionale (në institucione të treta) dhe laboratorike (laboratore didaktike dhe simulatore). Kjo qasje siguron që procesi i të nxënit të jetë gjithëpërfshirës, duke përfshirë njohuritë teorike, aftësitë praktike dhe kompetencat profesionale të nevojshme për tregun e punës dhe për zhvillimin shkencor.

Programet e studimit përfshijnë module praktike, laboratorë dhe praktika profesionale, të cilat janë të strukturuara në mënyrë të qartë në planet mësimore dhe kurrikulat e miratuara.

- Të gjitha programet e fushës së Infermierisë, në të gjitha ciklet e studimit, kanë praktikë laboratorike dhe klinike 50-60% të orëve totale në auditor.
  E.110: Plani mësimor MP në Infermieri Kirurgjikale
- Të gjitha programet mësuesisë zhvillojnë praktika profesionale në shkollat e mesme dhe 9-vjeçare.
  E.111: Praktika e mësuesisë – vërtetim
- Programi Arkitekturë në Trashëgimi zhvillon një pjesë të konsiderueshme orësh në zona historike, arkeologjike të Vlorës dhe zonave përreth.
  https://univlora.edu.al/njoftime/nje-dite-te-zakonshme-mesimi-per-studentet-e-programit-shkrenca-arkitekturore-per-trashegimine
- Programet e Navigacionit dhe Infermierisë kanë laboratorë simulatorë në dispozicion.
  E.108: Paisjet e laboratorëve simulatorë: Inventari i Laboratorit të Navigacionit. Inventari i Qendrës Simulatore për Profesionistët e Shëndetit
- Për programet e Drejtësisë këtë vit do të krijohet një sallë gjyqi imituese.
- Programet e inxhinierive, veçanërisht MSc në Inxhinieri Armatimi do të kenë mundësi të përdorin Laboratorin e Testimit të Goditjeve në ambientet e ish-Shkollës së Aviacionit.
- Për studentët e UV-së nga institucionet bankare, vendore etj, ka pasur ofertë për ofrimin e praktikave me pagesë.
  E.85: Raporte mbi integrimin e studentëve në tregun e punës përmes praktikave, FE

Aktivitetet praktike janë të lidhura ngushtë me përmbajtjen teorike, duke mundësuar që studentët të përforcojnë njohuritë, të zhvillojnë aftësi të zgjidhjes së problemeve, të krijojnë projektim profesional dhe të fitojnë përvojë konkrete në fushën e tyre të specializimit.

E.112: Syllabysi i modulit të Praktikës Profesionale në programin Cikli i Ulët
E.113: Projekt klase në programin BSc në Shkenca Kompjuterike

UV nxit bashkëpunimin me aktorë të jashtëm, përfshirë institucione publike, kompani dhe organizata profesionale, për të siguruar mundësi praktike për studentët, si dhe mentorim dhe mbikëqyrje gjatë realizimit të projekteve praktike. Kjo qasje jo vetëm që ndihmon në konsolidimin e njohurive, por gjithashtu rrit aftësitë për të punuar në ekip, për të marrë vendime profesionale dhe për t'u përgatitur për sfidat reale të tregut të punës. Disa prej institucioneve publike dhe private, me të cilat UV bashkëpunon për zhvillimin e praktikave të programeve mësimore janë përmendur në Standardin III.9:

Institucioni monitoron efektivitetin e këtyre moduleve praktike përmes vlerësimit të performancës së studentëve dhe feedback-ut të mentorëve.

E.114: Vlerësimi i Praktikës Profesionale: Procesverbal vlerësimi i vazhduar në praktikë; Vërtetimi i shefave të pavioneve për periudhën e praktikës në programet master; Procesverbal vlerësimi në provimin e praktikës profesionale, Tezë provimi e praktikës profesionale.

Rezultatet e këtij monitorimi përdoren për të përmirësuar vazhdimisht aktivitetet praktike dhe për të rritur lidhjen midis teorisë dhe praktikës.

Programet e studimit sigurojnë përfshirjen e projektit kërkimor të studentëve, nëpërmjet zhvillimit dhe mbrojtjes së temës së diplomimit, si komponent thelbësor i formimit akademik, detyrimisht për të gjithë studentët në programet Master Shkencor dhe Doktoratë, dhe për studentët ekselentë në programet e tjera. Tema e diplomimit konceptohet si një proces i strukturuar kërkimor, i integruar në planin mësimor (6-10 kredite) dhe në rezultatet e të nxënit të programit të studimit.

Programet e studimit përcaktojnë qartë procedurat për përzgjedhjen, zhvillimin dhe vlerësimin e temës së diplomimit, duke garantuar përputhjen e saj me fushën e studimit, objektivat e programit dhe kompetencat që studenti duhet të fitojë. Në fillim të vitit akademik departamenti u vë në dispozicion studentëve bandën e temave të diplomës për atë vit akademik (shoqëruar me pedagogun propozues), prej së cilës ata përzgjedhin temën që duan të zhvillojnë. Studentët mbështeten nga staf akademik i kualifikuar në rolin e udhëheqësit shkencor, i cili siguron orientim metodologjik, etik dhe shkencor gjatë gjithë procesit kërkimor.

Zhvillimi i projektit kërkimor përmes temës së diplomimit kontribuon në përvetësimin e aftësive analitike, metodologjike dhe kërkimore, si dhe në aftësinë e studentëve për të integruar njohuritë teorike me praktikat studimore dhe kërkimore. Universiteti i Vlorës siguron respektimin e parimeve të integritetit akademik dhe etikës shkencore, përmes marrjes së lejeve etike për zhvillimin e studimeve (nëse aplikohet), mekanizmave të kontrollit antiplagjiaturë (Turnitin) dhe vlerësimit të punimeve të diplomimit (komisionet e diplomimit).

Temat e diplomave dhe punimet studimore të studentëve publikohen edhe në Buletinin Shkencor të UV-së.

https://univlora.edu.al/media/dokument/buletini-uv-nr-8-vol-2.pdf
https://univlora.edu.al/media/dokument/vi-i-studenteve-shtator-2025.pdf
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/Buletini-Shkencor-Konference-e-Hapur-Studentore-2017.pdf
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/Buletini-Shkencor-Numer-1-2019.pdf

E.115: Procedurë diplomimi me temë diplome: Banda e temave të diplomës; Lista e temave: titull, student, udhëheqës; leje etike; temë diplome: abstrakt; vendim komisioni.

E.116: Procedurë diplomimi me provim diplome

Standardi III.15 Programet zhvillohen me qëllim përfshirjen aktive të studentëve në përftimin e kompetencave.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë synon zhvillimin e programeve të studimit mbi bazën e një qasjeje të orientuar drejt studentit (student-centered learning), me synimin që studentët të jenë aktorë aktivë në procesin e të nxënit dhe jo vetëm përfitues pasivë të njohurive teorike. Fuqizimit të kësaj qasjeje i kushtohet vëmendje e posaçshme edhe në Strategjinë e Zhvillimit të UV-së 2025-2030 (**E.35**) në Skenarin III, objektivi strategjik III.1.1 ku parashikohet Modernizimi i programeve dhe kurrikulave (Universitet 4.0) duke synuar kalimin nga mësimdhënia e bazuar *tek leksionet e pedagogut* tek mësimdhënia e bazuar tek *puna e pavarur e studentit.*

Kjo qasje reflektohet në hartimin e kurrikulave, metodologjitë e mësimdhënies dhe format e

vlerësimit, të cilat janë të orientuara drejt përftimit të kompetencave profesionale, akademike dhe ndërpersonale.

a) Në hartimin e programeve dhe syllabyseve të moduleve, objektivat mësimore dhe rezultatet e të nxënit janë të formuluara në terma kompetencash dhe aftësish të matshme, duke integruar njohuritë teorike me zbatimin praktik.
E.117: Plan mësimor, ku evidentohen orët e praktikës dhe projekteve BSc në "Infermieri Mami", MP në "Infermieri Pediatrike", (syllabuse)

b) Programet parashikojnë metoda aktive të të nxënit, si: punë në grupe, studime rasti, projekte kërkimore, prezantime individuale dhe në grup, si dhe përdorimin e teknologjive digjitale në procesin mësimor.
E.117: Plan mësimor, ku evidentohen orët e praktikës dhe projekteve BSc në "Infermieri Mami", MP në "Infermieri Pediatrike", (syllabuse)
Këto forma nxisin angazhimin e drejtpërdrejtë të studentëve dhe zhvillimin e mendimit kritik, aftësive analitike dhe zgjidhjes së problemeve.

Përfshirja aktive e studentëve mbështetet gjithashtu përmes integrimit të praktikave profesionale, laboratorëve, projekteve aplikative dhe punimeve përfundimtare, të cilat realizohen në bashkëpunim me aktorë të fushësn (Standardi III.14).
Këto elemente i mundësojnë studentëve të zbatojnë në situata reale njohuritë e fituara dhe të përftojnë kompetenca të lidhura drejtpërdrejt me tregun e punës.

c) Procesi i vlerësimit të njohurive të studentëve është i ndërtuar për të reflektuar nivelin e përftimit të kompetencave dhe jo vetëm riprodhimin e njohurive teorike. Vlerësimi realizohet përmes kombinimit të formave të ndryshme, si teste, projekte, detyra kursi, prezantime, punë praktike dhe vlerësim i vazhdueshëm, duke siguruar një pasqyrë të plotë të progresit të studentëve.
E.118: Vlerësimi i njohurive të studentëve: Projekte të pavaruar të studentëve Informatike; Punë në grup të studentëve Pedagogji e specializuar; Prezantime në kuadër të modulit 'Metodologjia e kërkimit shkencor'; Tezë provimi e praktikës profesionale Pedagogji e Specializuar.
E.109: Moduli 'Metodologjia e kërkimit shkencor' me qasje interaktive

Ky model i integruar i mësimdhënies siguron që studentët të zhvillojnë aftësi të të menduarit kritik, zgjidhjes së problemeve, komunikimit efektiv dhe punës në ekip. Përveç kësaj, përfshirja aktive e studentëve lehtëson transferimin e njohurive teorike në aftësi praktike dhe profesionale, duke e bërë të mundur përfitimin maksimal nga çdo cikël studimi dhe modul i ofruar.

Për performancën dhe problematikat e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies merret periodikisht mendimi i studentëve, me qëllim integrimin e pikëvështrimeve të tyre në përmirësimin e këtyre proceseve.
https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve-2020-2021
https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve-2024-2025

Standardi III.16 Programet e studimeve synojnë përgatitjen e studentëve për punësim.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka zhvilluar programet e studimit me qëllim të qartë përgatitjen e studentëve për tregun e punës, duke siguruar që njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e fituara gjatë studimeve të jenë të përputhshme me kërkesat profesionale dhe trendet e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, duke kontribuar në rritjen e punësueshmërisë së të diplomuarve.

Përgatitja për punësim është një nga prioritetet strategjike të UV-së, që synon standardin 4.0 dhe reflektohet në strukturën e programeve, kurrikulat, aktivitetet praktike dhe projektet profesionale.

Programet e UV-së synojnë përgatitjen e studentëve për punësim nëpërmjet disa mekanizmave kyç:

- ***Integrimi i praktikave profesionale*** – Studentët që studiojnë në programet e UV-së prezantohen me institucione punësuese që vitin e parë të studimeve dhe kryejnë praktika të detyrueshme dhe projekte bashkëpunimi me kompani, institucione publike dhe organizata profesionale, duke fituar përvojë reale dhe duke zhvilluar aftësi të zbatueshme në mjediset e punës (Standardi III.14).
- ***Aftësitë e aplikuara*** – Të gjitha kurrikulat e ciklit të parë të studimeve në UV dhe një pjesë e madhe e kurrikulave të ciklit të dytë përfshijnë lëndë dhe module që synojnë zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës, si përdorimi i teknologjive të informacionit, metoda kërkimi dhe menaxhim projektesh, komunikim profesional dhe njohuri të gjuhëve të huaja.
  Moduli i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit
  Moduli i Metodologjisë së Kërkimit
  Moduli i Gjuhës Angleze, Gjermane, Italiane
  Moduli i Etikës në Komunikim
- ***Bashkëpunimi me aktorë të jashtëm*** – Universiteti ka zhvilluar partneritete me aktorë të industrisë, sektorit publik dhe organizata profesionale për të siguruar që përmbajtja e programeve të përputhet me nevojat reale të punës dhe për të rritur mundësitë e punësimit të studentëve.
  https://univlora.edu.al/marreveshjet-me-institucionet-brenda-vendit
- ***Orientim dhe karrierë*** – Institucioni ofron shërbime për orientimin profesional, punëdhënësit e ftuar, ditët e karrierës dhe këshillim të vazhdueshëm për të ndihmuar studentët të integrohen në tregun e punës pas diplomimit.
  Dita e Karrierës – Fakulteti i Ekonomisë
  https://univlora.edu.al/njoftime/-career-day-fakulteti-i-ekonomise
  Takim frymëzues me Wizair Pilot Academy
  https://univlora.edu.al/njoftime/takim-frymezues-me-wizz-air-pilot-academy
  Intelligenza delle Mani - Akademia Valore Italia
  https://univlora.edu.al/njoftime/takimi-akademik-dhe-kulturor-me-teme-intelligenza-delle-mani
  Krijimi i Sipërmarrjeve Digjitale
  https://univlora.edu.al/njoftime/-workshop-inovativ-krijimi-i-sipermarrjeve-digjitale
  Migracioni dhe tregu i punës: sfidat dhe mundësitë për zhvillim rajonal
  https://univlora.edu.al/njoftime/simpozium-migracioni-dhe-tregu-i-punes-sfidat-dhe-mundesite-per-zhvillim-rajonal
  Trajnim i Sjelljeve Profesionale të Infermierëve me Stafin Profesional shëndetësor
  https://univlora.edu.al/njoftime/trajnim-i-sjelljeve-profesionale-te-infermiereve
  Kontabiliteti: Nga auditori në realitetin ekonomik – inspirim, integritet dhe karrierë
  https://univlora.edu.al/njoftime/dita-nderkombetare-e-kontabilitetit-2025

Sektori i Karrierës, Shërbimit të Studentëve dhe Alumni ka një rol të rëndësishëm në mbështetje të zhvillimit profesional dhe personal të studentëve dhe të diplomuarve. Ky sektor është përgjegjës për ofrimin e mundësive për karrierë, mbështetje gjatë kohës që studentët janë pjesë e institucionit, si dhe ruajtjen dhe forcimin e lidhjeve me alumni (diplomuarit) pas përfundimit të studimeve.
(E.23: Detyrat funksionale të Sektorit të Karrierës, Shërbimit të Studentëve dhe Alumni, fq.44-52)

Disa nga detyrat kryesore që mund të përfshihen në këtë sektor:
Shërbimi për Karrierën e Studentëve

- Konsulencë dhe orientim për karrierën: Ofrimi i shërbimeve të konsulencës për studentët për t'i ndihmuar ata të bëjnë zgjedhje të informuara për karrierën, si dhe të kuptojnë mundësitë e mundshme në tregun e punës.
- Organizimi i aktiviteteve për zhvillimin e aftësive profesionale: Planifikimi i trajnimeve,

seminareve dhe workshop-eve që ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësi të nevojshme për tregun e punës, si menaxhimi i kohës, komunikimi, të menduarit kritik dhe aftësitë e punës në grup.
- Mbështetje në hartimin e CV-së dhe përgatitjen për intervista: Ofrimi i asistencës për përgatitjen e dokumenteve të aplikimit, si CV, letra motivimi dhe përgatitja për intervista pune.
- Organizimi i aktiviteteve të rekrutimit: Organizimi i panaireve të karrierës dhe takimeve me përfaqësues të kompanive, organizatave dhe agjencive rekrutimi për tu mundësuar studentëve mundësi për të aplikuar në pozita pune, praktika dhe mundësi tjetër karriere.

Shërbimi për Praktikat dhe Mundësitë e Punës
- Koordinimi i mundësive për praktika dhe punësim: Sektori është përgjegjës për krijimin dhe menaxhimin e mundësive për praktika profesionale dhe mundësi pune për studentët. Kjo përfshin krijimin e partneriteteve me kompani dhe organizata që ofrojnë mundësi për studentët.
- Mbështetje për aplikimet në mundësitë e punës dhe praktikave: Ndihma për studentët në procesin e aplikimit për pozita praktike dhe punësimi, duke ofruar informacion dhe asistencë gjatë fazave të aplikimit.

Menaxhimi i Informacionit dhe Burimeve për Studentët dhe Alumni
- Ofrimi i informacionit për mundësitë e karrierës: Krijimi dhe përditësimi i burimeve të informacionit që janë të aksesueshme për studentët dhe alumni, si mundësitë për punësim, praktika, bursat dhe ngjarjet e karrierës.
- Mbështetje për kërkimin e mundësive të financimit: Ofrimi i informacionit dhe asistencës për studentët dhe alumni për mundësitë e bursave, granteve dhe financimit për zhvillimin e karrierës.

Monitorimi i Përshtatshmërisë të Studentëve në Tregun e Punës
- Vlerësimi i suksesit të studentëve pas diplomimit: Monitorimi i rritjes profesionale të studentëve pas përfundimit të studimeve për të vlerësuar se sa mirë janë përgatitur ata për tregun e punës dhe për të identifikuar mundësitë për përmirësime në programet akademike dhe shërbimet që ofrohen.
- Raportimi i suksesit dhe realizimeve: Mbledhja dhe analizimi i të dhënave mbi suksesin e studentëve dhe alumni në karrierë dhe përgatitjen e raporteve që mund të përdoren për të përmirësuar shërbimet dhe strategjitë e zhvillimit të karrierës.

Standardi III.17 Programet e studimeve synojnë të nxisin mobilitetin e studentëve shqiptarë dhe të huaj.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (UV) synon që programet e studimit të krijojnë mundësi të qëndrueshme për mobilitetin akademik të studentëve, si brenda vendit ashtu edhe ndërkombëtarisht. Ky orientim është në përputhje me misionin e institucionit për të ofruar një arsimim cilësor, të hapur dhe të integruar në rrjetin akademik europian dhe ndërkombëtar, duke rritur diversitetin kulturor dhe shkëmbimin e përvojave mes studentëve dhe stafit akademik.

Numri i mobiliteteve studentë / pedagogë 2020-2025			
Studentë UV	Studentë ndërkombëtarë	Pedagogë UV	Pedagogë ndërkombëtarë
223	94	424	217

Për të nxitur mobilitetin, UV ka zhvilluar një sërë masash dhe praktikash:

- ***Programet e shkëmbimit akademik*** – Universiteti ka 120+ marrëveshje me universitete partnere në Evropë dhe jashtë saj për shkëmbime studentësh në kuadër të programeve të cikleve të studimit dhe trajnimeve të specializuara.
  https://univlora.edu.al/marreveshje-nderinstitucionale

https://univlora.edu.al/marreveshje-mirekuptimi

- ***Kreditet ECTS dhe njohja e moduleve*** – Strukturat e programeve janë të harmonizuara me sistemin ECTS, duke lehtësuar njohjen dhe transferimin e krediteve nga institucionet e tjera (Standardi III.13).

  Universiteti 'Ismail Qemali' ofron programe në gjuhën angleze, të cilat janë të publikuara, me plane mësimore: module, kredite, orë mësimore, si dhe syllabyse në faqen zyrtare të UV (https://univlora.edu.al/programeten/JD). Gjithashtu në UV ofrohen module anglisht, edhe në programet që zhvillohen në gjuhën shqipe, posaçërisht për studëntët e mobiliteteve.

  Në Rregulloren për Implementimin e Marrëveshjeve Ndër-Institucionale në kuadër të Programit Erasmus + Ka1 International Credit Mobility, nenet 12, 13 e 14 përcaktohen procedura të qarta për mënyrën e operimit me njohjen e moduleve të ndjekura gjatë mobiliteteve nga Komisioni i Ekuivalentimit të Moduleve.
  (E.12: Rregullore për Implementimin e Marrëveshjeve Ndër-Institucionale në kuadër të Programit Erasmus + Ka1 International Credit Mobility)
  (E.82: Procedurë mobiliteti Erasmus+ personel akademik, personel joakademik dhe skeda informuese. Vërtetim mobiliteti për personel hyrës)
  (E.83: Procedurë mobiliteti Erasmus+ student dhe skeda informuese, Dokumentacion për njohjen e krediteve të fituara jashtë vendit. Vërtetim mobiliteti për student hyrës)

- ***Asistencë për studentët UV që duan të ndjekin programe mobiliteti*** – Universiteti i Vlorës i inkurajon studentët e vet për të ndjekur programe mobiliteti, jo vetëm me asistencën administrative dhe akademike që u ofron për ndjekjen e këtij procesi, por edhe me mundësitë akademike të personalizuara që u krijon për kompesimin e programit akademik që mund të humbasin gjatë mobilitetit (E.4: Rregullorja e përgjithshme e UV-së, neni 87, pika 10.c).

- ***Programe në gjuhën angleze (english speaking programs)*** – UV ofron disa programe në gjuhën angleze, të aprovuara me vendim MA, që mund të ndiqen nga studentë ndërkombëtarë (https://univlora.edu.al/programeten/JD):
  BSc in Architecture Sciences for Heritage
  MSc in Maritime Environment Protection and Management – MEP&M
  BSc in Computer Engineering
  BSc in English Language
  MSc in Teaching in CLAB
  MSc in Translation and Interpreting

  Gjatë vitit akademik 2025-2026 Universiteti 'Ismail Qemali' regjistroi për herë të parë studentë ndërkombëtarë në dy programe studimi: BSc in Architecture Sciences for Heritage dhe MSc in Maritime Environment Protection and Management – MEP&M
  (**E.119**: Lista e studentëve të rregjistruar në BSc in Architecture Sciences for Heritage; MSc in Maritime Environment Protection and Management – MEP&M)

- ***Paketa e mbështetjes së studentëve ndërkombëtarë nga UV***
  (**E.13:** Rregullore për studentët ndërkombëtarë, neni 13)
  Universiteti 'Ismail Qemali' mund ti mbështesë kandidatët, e përzgjedhur si studentë ndërkombëtarë në programet e tij të studimit, në mënyrat e mëposhtme:
  - Asistencë në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe aplikimin për njehsimin e dokumenteve shkollore nga QSHA.
  - Asistencë për përmbushjen e procedurave të regjistrimit në UV.
  - Tutorial individual për njohjen dhe familjarizimin me programet, website-in, sistemin informativ të brendshëm të komunikimit, si dhe ambientet universitare të UV.
  - Tutorial individual për njohjen dhe familjarizimin me ambientet akomoduese dhe qytetin e Vlorës.

Programet e mobilitetit synojnë të nxjerrin studentë shqiptarë në programe të shkëmbimit jashtë vendit, duke i pajisur ata me njohuri, aftësi dhe përvojë ndërkombëtare që rrit kapacitetin e tyre profesional dhe perspektivat e punësimit. Ndërkohë që procesi i mobiliteteve të stafit kontribuon në forcimin e bashkëpunimit akademik dhe shkencor midis UV-së dhe institucioneve partnere, duke sjellë praktika të reja mësimore dhe inovacion në kurrikulat e institucionit.

Niveli i mobiliteteve ndërkombëtare të UV-së është vlerësuar edhe nga tregues të jashtëm të njohur ndërkombëtarisht, si:

- pajisja me Erasmus Charter for Higher Education (ECHE) 2021–2027 (https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/02/Erasmus-Charter-for-Higher-Education-awared-to-University-of-Vlora.pdf),
- renditja nr. 1 në botë për "Student Mobility and Openness" sipas WURI Ranking 2024 (https://www.wuri.world/_files/ugd/8e5131_bb90c24bf4354b40b7821b877661a03a.pdf, fq.4)

WURI 2024: Student Mobility and Openness (A2) Top 100

Rank	Name	Rank	Name
1	University of Vlora "Ismail Qemali"	26	University of Bonn
2	University of Vienna	27	Faculty of Dentistry, Universitas Gadjah Mada
3	Daffodil International University	28	Deggendorf Institute of Technology
4	Rajshahi University of Engineering and Technology	29	Universidad Tecnológica Centroamericana UNITEC
5	University of Liberal Arts Bangladesh	30	CHRIST (Deemed to be University)
6	University of Health Sciences	31	Lovely Professional University
7	University of Mostar	32	Telkom University
8	Hayek Global College	33	LSPR Institute of Communication and Business
9	National University of Management	34	Universitas Teknokrat Indonesia
10	Shanghai Jiao Tong University	35	Politecnico di Milano
11	Badr University in Cairo	36	Nagoya University
12	Dalian Neusoft University of Information	37	Hebrew University of Jerusalem
13	Westlake University	38	Tokyo International University
14	Peking University	39	Hokkaido University
15	University of Chemistry and Technology, Prague	40	The University of Tokyo
16	The University of the South Pacific	41	METAVERSE UNIVERSAL COLLEGE (MVUC)
17	China Europe International Business School (CEIBS)	42	Universiti Kebangsaan Malaysia (UKM)
18	Xi'an Jiaotong University	43	University of Amsterdam
19	University of Cologne	44	Norwegian University of Science and Technology
20	LMU Munich	45	University of Oslo
21	Technical University of Munich	46	Fatima Jinnah Medical University
22	Chitkara University, Punjab	47	Khwaja Fareed University of Engineering and Information Technology, Rahimyar Khan, Pakistan
23	University of Split	48	Sir Syed University of Engineering and Technology
24	University of Münster	49	Superior University
25	West Bengal National University of Juridical Sciences (WBNUJS/NUJS)	50	Fatima Jinnah Women University

Universiteti 'Ismail Qemali' e ka vendosur shndërrimin në Universitet Ndërkombëtar si Skenarin I të Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2030, (**E.35:** fq.74-85).

Linja strategjike

I.2: Programe studimi ndërkombëtare dhe mobilitete afatgjata

Objektiva:

I.2.1 Rritja e nivelit të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit,

I.2.2 Tërheqja e studentëve ndërkombëtarë

I.2.3 Rritja e mobiliteteve afatgjata të studentëve dhe stafit.

Standarde III.18 Institucionet pajisin studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet e një programi studimi, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë garanton që të gjithë studentët që kanë përfunduar me sukses të gjitha detyrimet e një programi studimi të pajisen me diplomën përkatëse, e cila ka statusin e dokumentit zyrtar dhe çertifikon plotësimin e standardeve akademike dhe profesionale të programit. Ky proces është i rregulluar sipas legjislacionit kombëtar për arsimin e lartë dhe procedurave institucionale të verifikimit dhe regjistrimit të rezultateve akademike.

Studimet në programet mësimore të UV-së përfundojnë me provim diplome (DP, BSc, MP) / temë diplome (MSc, Doktoratë dhe studentët ekselentë të programeve të tjera). Përpara sezonit të diplomimit studentëve iu vihen në dispozicion banda e Temave të Diplomës, nga të cilat

përzgjidhen pyetjet e provimit të diplomës. Ndërkaq për kategoritë e studentëve që mund të diplomohen me temë diplome, në fillim të vitit akademik vihet në dispozicion lista e temave të projekteve kërkimore, të përgatitura nga stafi akademik që do të udhëheqë temat kërkimore të diplomave, nga të cilat studentët zgjedhin temën që duan të zhvillojnë. Procedurat e provimit janë të përcaktuara në rregulloret e departamenteve dhe, atje ku mund të aplikohet, zbatojnë sekretimin e fletëve të provimit.

(E.120: Dosje e diplomimit të një studenti)

Diploma konsiderohet dokument zyrtar dhe përdoret për qëllime punësimi, studimesh të mëtejshme, çertifikimi profesional dhe aktivitete ndërkombëtare. Çdo diplomë e lëshuar përmban informacion të detajuar mbi:

- Programin e studimit dhe ciklin akademik të përfunduar;
- Nivelin dhe profilin e kualifikimit;
- Kreditet ECTS të fituara dhe përmbajtjen e kurrikulës;
- Data të mbrojtjes së diplomës dhe të lëshimit të saj.
- Të gjitha elementët e sigurisë së kërkuar nga aktet nënligjore të MA.
  Vendim SA për miratimin e formës së diplomave
  https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Vendim-Senati-Nr.-5-date-15.02.2023-Per-miratimin-e-rregullores-dhe-formatit-te-diplomes-per-programin-e-studimit-Diplome-e-Dyfishte-BacH-Gjuhesi-e-Aplikuar-ne-Fushen-e-Turizmit..pdf
  https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2022/11/Vendim-Senati-Nr.-51-date-14.11.2022-Per-miratimin-e-formatit-te-diplomes-se-leshuar-ne-perfundim-te-Ciklit-te-Studimeve-Profesionale.pdf
  (E.121: Formate diplomash DP, BSC, MP, MSC, double degree)

Procesi i lëshimit të diplomave përfshin kontrollin e të dhënave akademike nga njësitë përkatëse, konfirmimin e shlyerjes së të gjitha detyrimeve dhe dokumentimin për qëllime arkivore dhe ligjore. Fitimi i të drejtës për të hyrë në provimin e diplomës përcaktohet nga:

a) përmbushja e detyrimeve akademike: modulet dhe kreditet e planit mësimor të programit të studimit,
b) plotësimi i kohëzgjatjes minimale të programit, sipas përcaktimeve në urdhrin e hapjes / akreditimit të tij,
c) përmbushja e detyrimeve financiare të studentit ndaj UV
   (E.4: Rregullorja e përgjithshme e UV-së, neni 104, pika 2,3)

UV gjithashtu siguron që studentët dhe të diplomuarit të kenë informacion të qartë dhe të përditësuar mbi procedurat për marrjen e diplomës dhe çertifikatave të tjera mbështetëse, duke përfshirë transkriptet akademike dhe çertifikatat e pjesëmarrjes në module praktike apo shkëmbime ndërkombëtare. Ky proces përforcon transparencën, besueshmërinë e institucionit dhe siguron që dokumentet e lëshuara të jenë të pranueshme si në nivel kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar.

Procedurat e diplomimit janë të detajuara në Rregulloren e përgjithshme të UV-së (**E.4:** Rregullorja e përgjithshme e UV-së, neni 104, pika 7/a,b,c). Diploma nënshkruhet nga dekani i fakultetit përkatës dhe rektori i universitetit dhe ka elementë sigurie, të përcaktuar me vendim SA. Nënshkrimi i rektorit shoqërohet me vulën zyrtare të universitetit.

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë akordon për studentët në përfundim të studimeve titujt e nderit në bazë të mesatares së përgjithshme të notave si më poshtë:

- 9.00 - 9.33, *cum laude;*
- 9.34 - 9.67, *magna cum laude;*
- 9.68 - 9. 99, *summa cum laude.*
- 10.00*, maxima cum laude* "Medalje të artë".

Studentët me medalje ari qëndrojnë të publikuar përgjithmonë në faqen zyrtare të UV-së, ndërsa

studentët ekselentë (mesatare 9.0-10.0) të të gjitha viteve sipas fakulteteve përditësohen çdo vit akademik në rubrikën Krenaria Studentore (https://univlora.edu.al/krenaria-studentore).

Në rast të dëmtimit apo humbjes së Diplomës, UV jep Vërtetime Diplome me ekzakt të njëjtat elemente si diploma origjinale

E.4: Rregullorja e përgjithshme e UV-së, neni 105;

E.122: Vërtetim diplome

Standardi III.19 Institucioni siguron laboratorë të dedikuar në mbështetje të programeve të studimit dhe kërkimi shkencor/artistik.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë siguron laboratorë dhe qendra të dedikuara që mbështesin programet e studimit dhe kërkimin shkencor, duke ofruar mundësi për zhvillim praktik, pjesëmarrje në projekte kërkimore dhe përforcim të aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve në të gjitha programet e veta.

Laboratorë didaktikë, në mbështetje direkte të procesit mësimor

- Laboratorët didaktikë të Infermierisë së Përgjithshme
- Laboratori didaktik i Infermierisë Mami
- Laboratorët didaktikë të Anatomisë Humane
- Laboratori didaktik i Edukimit Parashkollor
- Laboratori didaktik i Përkthim-Interpretimit
- Laboratori didaktik i Fizikës
- Laboratorët didaktikë të Zoologjisë dhe Mikrobiologjisë
- Laboratori didaktik i Kimisë
- Laboratori i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare
- Laboratori know-hub (printime 3D)
- Kabineti i mësimdhënies në distancë
- Salla kompiuterike - 6

Laboratorë kërkimorë, në mbështetje të punës kërkimore të akademikëve dhe studentëve, si dhe shërbimeve ndaj të tretëve.

- Qendra Simulatore e Profesionistëve të Shëndetit (projekt AKKSHI + UV).
- Qendra Shkencore për Monitorimin dhe Ekologjinë Detare në Vlorë (projekt EU).
- Qendra 'SUCCESS' (projekt EU).
- Smart City Hub center për kapacitete Ekonomike (projekt EU).
- Laboratori kërkimor-shkencor Klinik (biokimik dhe mikrobiologjik) (projekt AKKSHI + UV)
- Laboratori kërkimor-shkencor i Shkencave Detare (Navigacion) (projekt EU).

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka investuar vet dhe thithur investime nga MA, AKKSHI dhe BE për krijimin dhe mirëmbajtjen e laboratorëve dhe qendrave të specializuara, të cilat mbështesin në mënyrë efektive programe të ndryshme të studimit dhe aktivitete kërkimore shkencore, teknologjike. Këto laboratorë u ofrojnë studentëve mundësinë për të aplikuar njohuritë teorike në praktikë, për të zhvilluar aftësi teknike dhe profesionale, si dhe për të marrë pjesë në projekte kërkimore nën mbikëqyrjen e stafit akademik.

UV ka nisur procedurat për akreditimin dhe liçensimin e laboratorëve të vet, me pikësynim ofrimin e zhvillimit të procedurave laboratorike dhe shërbimeve të liçencuara për të tretët.

E.123: Procedura për akreditimin e laboratorëve (Qendra Kërkimore Shkencore – FSHTN)

UV garanton qasje të barabartë të studentëve dhe stafit akademik në këto laboratorë, duke ofruar mbështetje për zhvillimin e projekteve të detyrueshme akademike, praktikave profesionale, punimeve të diplomës, hulumtimeve shkencore dhe aktiviteteve artistike. Për më tepër, laboratorët shërbejnë si mjedis i integruar për bashkëpunime me aktorë të jashtëm, institucione kërkimore dhe

kompani, duke nxitur transferimin e njohurive dhe aftësive drejt tregut dhe shoqërisë.

(E.124: Raporte mbi projektet dhe kërkimin e realizuar në laboratorë)

Standardi III.20 Institucioni siguron pajisje laboratorike, infrastrukturë dhe shërbime në mbështetje të programeve të studimit.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë siguron pajisje laboratorike, infrastrukturë të specializuar dhe shërbime mbështetëse, të cilat janë thelbësore për zbatimin efektiv të programeve të studimit dhe për garantimin e një mësimdhënieje cilësore dhe të integruar me kërkimin shkencor. Kjo qasje mbështet zhvillimin praktik të studentëve, implementimin e moduleve laboratorike dhe projektet e kërkimit, duke e lidhur teorinë me praktikën dhe standardet profesionale.

Pajisjet dhe infrastruktura për realizimin e proceseve akademike përfshin:

- ***Laboratorë modernë*** me instrumente shkencore dhe teknologjike të nevojshme për disiplinat e natyrës, inxhinierisë, shëndetësisë, teknologjive të informacionit dhe fushave të tjera të ofruara nga universiteti (Standardi III.19).
- ***Auditorë leksionesh dhe seminaresh,* të pajisur me** teknologji audio-vizuale për mësimdhënie në auditor dhe në distancë.
- ***Biblioteka digjitale (**https://univlora.edu.al/biblioteka**) dhe laboratorë kompjuterikë*** për mbështetjen e kërkimit shkencor dhe të mësimdhënies;
- ***Sistemi i brendshëm informativ UNVIMAS,*** një instrument strategjik për integrimin e sistemeve të informacionit, për mbështetjen dhe zhvillimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të UV-së. Nëpërmjet këtij sistemi dhe platformës *Google classroom UniVlora* mundësohet mësimi interaktiv dhe online. Programi kompjuterik UNVIMAS është rregjistruar si patentë e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. (**E.10:** Rregullore UNVIMAS)
- ***Shërbime mbështetëse teknike dhe administrative*** që përfshijnë mirëmbajtjen e pajisjeve, sigurimin e aksesit të studentëve dhe stafit, trajnimin për përdorimin e pajisjeve dhe asistencën për projektet e kërkimit.

UV garanton që këto pajisje dhe shërbime të jenë të disponueshme për të gjithë studentët dhe stafin akademik, duke siguruar akses të barabartë dhe mbështetje për zhvillimin e kompetencave praktike dhe shkencore. Infrastruktura dhe shërbimet mbështesin gjithashtu aktivitetet kërkimore dhe projektet e bashkëpunimit me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë, duke forcuar lidhjen midis arsimit dhe industrisë, si dhe pjesëmarrjen në projekte inovacioni dhe shkencore.

(E.90: Pasurimi, mirëmbajtja dhe zgjerimi i infrastrukturës mësimore: Inventari i laboratorit të Biologjisë. Blerje paisjesh laboratorike. Blerje materialesh laboratori Biologji. Blerje smartbordesh, kompiuterash, kondicionerësh. VKM e Godinës së Apelit.)

Standardi III.21 Biblioteka, infrastruktura dhe shërbimet e saj sigurojnë akses në literaturë bashkëkohore të lidhur me fushat e studimit dhe kërkimit në programe.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka zhvilluar një infrastrukturë të qëndrueshme të bibliotekës dhe shërbimeve mbështetëse për të garantuar akses të lehtë dhe të plotë të studentëve dhe stafit akademik në literaturë bashkëkohore dhe burime të tjera të informacionit, të lidhura ngushtë me fushat e studimit dhe kërkimit shkencor në të gjitha programet e ofruara nga institucioni.

Në Universitetin 'Ismail Qemali' funksionojnë Biblioteka Qendrore 'Nermin Vlora Fallaski' dhe bibliotekat e çdo njësie kryesore. Misioni i bibliotekës është të mbështesë personelin akademik, studentët dhe kërkuesit shkencorë me literaturë mësimore e shkencore.

UV ka 5 salla bibliotekash të shpërndara nëpër fakultete dhe në Rektorat. Biblioteka e UV-së dhe shërbimet e saj ofrojnë:

- ***Literaturë akademike dhe shkencore të printuar dhe digjitale***, përfshirë monografi, revista shkencore, baza të dhënash ndërkombëtare dhe materiale të specializuara për secilën disiplinë;
- ***Platforma dhe baza të dhënash elektronike,*** që mundësojnë qasje nga çdo vend, duke lehtësuar kërkimin dhe përdorimin e literaturës nga studentët dhe pedagogët.

Bibliotekat ofrojnë mjedise të përshtatshme për studim dhe konsultim të literaturës, duke siguruar kushte të favorshme për zhvillimin e procesit të të nxënit. Shërbimet e bibliotekës vihen në dispozicion të studentëve sipas orareve të miratuara nga institucioni, të cilat bëhen publike në ambientet universitare dhe në faqen zyrtare të institucionit (https://univlora.edu.al/biblioteka).

Përdorimi i bibliotekës realizohet përmes kartelës së regjistrimit të studentit, e cila shërben për administrimin e huazimit dhe përdorimit të literaturës, duke garantuar akses të rregullt dhe të barabartë për të gjithë studentët. Studentët orientohen për mënyrën e sigurimit të literaturës së nevojshme për ndjekjen e studimeve përmes bibliotekës, stafit akademik dhe strukturave përkatëse.

Fondi bibliotekar i universitetit mbështet të gjitha njësitë akademike dhe përditësohet periodikisht në bashkëpunim me fakultetet dhe stafin akademik, duke reflektuar nevojat specifike të programeve të studimit në të tre ciklet. Pasurimi i bibliotekës bëhet çdo vit mbi bazën e kërkesave të personelit akademik dhe propozimeve të përgjegjësit të bibliotekës, me miratimin e dekanatit. Bordi i Administrimit miraton çdo vit një fond të veçantë për blerjen e literaturës shkencore në gjuhën shqipe dhe të huaj. Gjithashtu, bibliotekat e UV-së kanë marrë në vazhdimësi donacione nga palë të treta për fonde librash të veçanta:

- Fondi Lefter Çipa
- Fondi ALSAR
- Fondi Bardhosh Gaçe

Literatura e inventarizuar e bibliotekave digjitalizohet në sistemin Cobis dhe arkiva digjitale e literaturës së UV-së ndodhet në dispozicion të personelit dhe studentëve në të gjithë kompiuterat publikë të UV-së.

(E.4: Rregullorja e përgjithshme e UV-së, neni 137)
Rregullore e Bibliotekës
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2020/02/Vendim-Nr.-42-Dt.-29.01.2020.pdf
(E.125: Relacion i Sektorit të Bibliotekës & Botimeve)
(E.126: Fondi bibliotekar i digjitalizuar në sistemin Cobis. Inventari i literaturës në bibliotekë.)

Sistemi Cobiss (https://al.cobiss.net/) është një sistem katalogimi ndërkombëtar i cili shërben për katalogimin e fondit bibliotekar, lehtësimin e qasjes dhe shfrytëzimit të fondeve të bibliotekave dhe gjithashtu promovimin kombëtar dhe ndërkombëtar të punës së autorëve. Në këtë moment UNIVLORA ka dy specialistë biblioteke në proces trajnimi për përdorimin e sistemit Cobiss dhe një fond prej 1322 titujsh të kataloguar. Në këto tituj janë edhe të gjitha botimet e autorëve të UNIVLORA, artikujt si dhe buletinet.

Përsa i përket titujve të digjitalizuar ata janë të aksesueshëm në linkun https://bibliotek.al/. Janë rreth 250 tituj të digjitalizuar, ku përfshihen koleksioni i dorëshkrimeve të Lefter Cipa, si dhe titujt më të kërkuar nga studentët.

Krahas literaturës fizike, studentët kanë akses edhe në burime elektronike dhe databaza shkencore të liçencuara, të cilat mbështesin procesin e studimit, kërkimin shkencor dhe përgatitjen e punimeve akademike.

Bibliotekat kryesore dixhitale falas:
https://www.jstor.org/
https://archive.org/

https://www.gutenberg.org/
https://openlibrary.org/
https://scholar.google.com/

Burime të hapura arsimore:

https://openstax.org/
https://merlot.org/merlot/
https://oercommons.org/
https://ocw.mit.edu/

Burime specifike sipas temave:

https://pmc.ncbi.nlm.nih.gov
https://arxiv.org/
https://eric.ed.gov/
https://doaj.org/

Buletinet shkencore të UV-së:

https://univlora.edu.al/buletini-shkencor
https://uvjournals.univlora.edu.al/

Disa prej Buletineve shkencore, të botuara nga UV kanë publikuar studime shkencore të studentëve të UV-së, të punuara në kuadrin e temave të diplomës apo prezantimeve në konferenca të ndryshme shkencore, të organizuara nga Universiteti 'Ismail Qemali'.

https://univlora.edu.al/media/dokument/buletini-uv-nr-8-vol-2.pdf
https://univlora.edu.al/media/dokument/buletini-i-studenteve-shtator-2025.pdf
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/02/Buletini-Shkencor-Numer-7-Vellimi-4-Special-Edition-2024.pdf
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/Buletini-Shkencor-Konference-e-Hapur-Studentore-2017.pdf
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/Buletini-Shkencor-Buletin-Studentor-2017.pdf
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/Buletini-Shkencor-Special-Edition-Vol.-3-2023.pdf
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/Buletini-Shkencor-Special-Edition-Vol.-2-2023.pdf

Strategjia e zhvillimit të UV për digjitalizimin e literaturës

Skenari III – Lider profesional, Linja strategjike III.1 – ESCO standart ka për Objektiv strategjik III.1.1 – Modernizimin e programeve dhe kurrikulave. Njëra nga masat që do të merren për plotësimin e këtij objektivi strategjik do të jetë *Ofrimi i literaturës bazë digjitale dhe qasje në bibliotekën digjitale të UV-së*. Në vitin 2030 e gjithë literatura bazë e moduleve të UV-së do të ofrohet për studentët jo vetëm në formë print, por edhe në formë digjitale. Kjo qasje do të zgjidhë përfundimisht:

1. problemin e ofertës sasiore të literaturës bazë në UV,
2. problemin e përditësimit të përvitshëm të literaturës bazë, që botimi print e ngadalëson.

(E.35: Strategjia UV 2025-2030, skenari III, linja strategjike III.1, objektivi strategjik III.1.1)

Përfundimet dhe Vlerësimi

Nga analiza e evidencave dhe të dhënave të grumbulluara, rezulton se Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ofron programe të studimit të përshtatura me misionin, strategjinë e zhvillimit dhe kërkesat e tregut, të strukturuara në cikle të qarta (Bachelor, Master, Doktoratë). Programet kanë objektiva të përcaktuara qartë dhe rezultatet e të nxënit janë të harmonizuara me profilet dhe nivelin e

kualifikimit, duke siguruar progresivitet të njohurive dhe përfitimin gradual të kompetencave.

Procesi i hartimit dhe miratimit të programeve të reja është transparent dhe i standardizuar, duke përfshirë analizën e nevojave të tregut, konsultime me aktorë të fushës dhe bashkëpunime ndërkombëtare. Kapacitetet e institucionit – në staf akademik, laboratorë, infrastrukturë dhe bibliotekë – mbështesin në mënyrë të qëndrueshme realizimin e programeve dhe kërkimin shkencor. Po ashtu, programet e studimit përfshijnë mekanizma të përmirësimit të vazhdueshëm dhe monitorimi periodik, duke siguruar cilësi akademike dhe profesionalizëm të studentëve.

Programet promovojnë pjesëmarrjen aktive të studentëve, përgatitjen për punësim dhe mobilitetin kombëtar dhe ndërkombëtar, duke ofruar praktika profesionale dhe mundësi aplikimi të njohurive të fituara. Institucioni ndjek politika të qarta për diplomimin dhe pajisjen e studentëve me dokumente zyrtare dhe siguron literaturë dhe burime laboratorike të nevojshme për zhvillimin e proceseve mësimore dhe kërkimore.

Arritjet më kuptimplotë të Universitetit 'Ismail Qemali' në fushën e programeve mwsimore dhe mësimdhënies gjatë 5 vjeçarit të fundit janë:

- Hapja e:
  - programeve ndërkombëtare joint dhe double degree;
  - programeve në gjuhën angleze për studentë ndërkombëtarë,
  - programeve unikale në territorin e Shqipërisë: Inxhinieri Armatimi, Arkitekturë në trashëgimi, Navigacion, Inxhinieri Navale, Mbrojtje&Menaxhim i Mjedisit Detar.
  - riorganizimi i programeve me njohje automatike në BE (fusha: infermieri, arkitekturë),
  - ka nisur puna me një grup të përbashkët pune me Universitetin e Pavias për të hapur joint degree në Medicine and Surgery.
- Mësimdhënie me profesorat të përzjerë ndërkombëtarë. Studentë ndërkombëtarë, për periudha afatshkurtra dhe afatgjata. Numër i konsiderueshëm mobilitetesh, i vlerësuar edhe në klasifikime ndërkombëtare.
- Rritja e numrit të studentëve të rregjistruar në UV.
- Rezultate të shkëlqyera e të pakonkurrueshme në ballafaqimin me studentë të IAL-ve të tjera brenda dhe jashtë vendit.
- Ofrimi i shërbimeve akademike për të tretët (programe trajnimi për mësuesit, Shkolla e Drejtorëve). Ofrimi i programeve LLL me mikrokredenciale (mësues, punonjësit e shëndetit).
- Modernizimi i teknologjive mësimdhënëse dhe rritja e orëve të praktikës profesionale në institucionet vendore.

Si fusha për zhvillim të mëtejshëm në Strategjinë e Zhvillimit të UV-së evidentohet Rritja në vazhdimësi e numrit të programeve të ofruara në gjuhën angleze dhe Modernizimi në vazhdimësi i programeve dhe kurrikulave (Universitet 4.0):

- *mësimdhënie interaktive dhe student-centered, gjerësisht në gjuhën angleze,*
- *digjitalizim i plotë i materialeve mësimore në dispozicion të studentit,*
- *qasje fleksibile (mësimdhënie në distancë dhe blended) dhe module me mikrokredenciale,*
- *përdorimi i teknologjive të avancuara në mësimdhënie.*

STANDARDI III - PËRMBUSHET PLOTËSISHT

IV- AKTIVITETI SHKENCOR / ARTISTIK DHE INOVACIONI

Standardi IV.1 Institucioni përcakton fushat parësore të aktiviteteve kërkimore, shkencore/artistike.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (UV) e trajton kërkimin shkencor si funksion themelor të veprimtarisë institucionale dhe si komponent të integruar me mësimdhënien, zhvillimin profesional dhe misionin e universitetit, në përputhje me objektivat afatgjata të tij (**E.1:** neni 3, 83). Politikat dhe orientimet për kërkimin shkencor janë të udhëhequra nga dokumentet strategjike institucionale, duke garantuar vijueshmëri dhe koherencë në përcaktimin e prioriteteve kërkimore, përkatësisht:

- Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional 2018–2024, **(**Linja strategjike nr. 3: Kërkim shkencor i përbashkët sipas standardeve ndërkombëtare) (**E.38**)
- Strategjia e Zhvillimit Institucional 2025–2030, ku kërkimi shkencor dhe ndërkombëtarizimi përbëjnë shtylla kryesore të modelit "UV 4.0 – 2030" (**E.37**, fq. 46–47).
- Strategja për Kërkimin Shkencor 2017-2022 (https://univlora.edu.al/media/dokument/strategjia-2017-2022.pdf)
- Strategja për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin 2026-2030 (**E.34**)

Përcaktimi i fushave parësore të veprimtarisë kërkimore në UV realizohet në përputhje me profilin akademik të institucionit, strukturën e njësive kryesore dhe bazë, kapacitetet njerëzore dhe infrastrukturore, si dhe me rolin e universitetit në zhvillimin rajonal dhe kombëtar (**E.1**: neni 83–85; **E.35**: pika 6.3 – skenarët strategjikë). Statuti i universitetit (**E.1**, Kreu IX) dhe Rregullorja e Përgjithshme e UV (**E.4**, Kreu X) përcaktojnë parimet dhe mekanizmat për zhvillimin e kërkimit shkencor në përputhje me legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

Në këtë kuadër, prioritetet kërkimore të UV harmonizohen me prioritetet rajonale, kombëtare dhe europiane, me synim integrimin progresiv të universitetit në Zonën Europiane të Arsimit të Lartë dhe të Kërkimit Shkencor. Ky orientim materializohet përmes promovimit të kërkimit të aplikuar, pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe ndërtimit të partneriteteve me universitete, institucione publike, industrinë dhe aktorë të zhvillimit rajonal, të reflektuara në databazën publike institucionale të marrëveshjeve dhe projekteve:

- Marrëveshje ndërinstitucionale: https://univlora.edu.al/marreveshje-nderinstitucionale
- Marrëveshje mirëkuptimi: https://univlora.edu.al/marreveshje-mirekuptimi
- Marrëveshje brenda vendit: https://univlora.edu.al/marreveshjet-me-institucionet-brenda-vendit
- Projekte kombëtare/ndërkombëtare: https://univlora.edu.al/projekte-nderkombetare
  https://univlora.edu.al/projekte-kombetare
  https://univlora.edu.al/projekte-me-financim-nga-uv

Zbatimi i prioriteteve kërkimore realizohet në nivel të njësive kryesore dhe bazë. Në përputhje me kompetencat e përcaktuara në Statutin e UV-së (**E.1**: neni 83.3) dhe në Rregulloren e Përgjithshme (**E.4**: Kreu X, neni 125.3), departamentet dhe fakultetet hartojnë dhe miratojnë orientimet dhe planet vjetore të veprimtarisë kërkimore, duke përcaktuar fushat prioritare sipas disiplinës dhe nevojave të zhvillimit, të cilat miratohen përfundimisht në Senatin Akademik të UV-së (https://univlora.edu.al/media/dokument/vsa9-2026.pdf) **(E.127); (E.41).**

Fusha prioritare të kërkimit në Universitetin 'Ismail Qemali', miratuar në Senatin Akademik

Njësia bazë / kryesore	Fusha prioritare e kërkimit shkencor	Nënfusha prioritare e kërkimit
Qendra Kërkimore Shkencore për Shëndet Publik	Shëndetësia dhe shkencat mjekësore	Shëndeti Publik, Politikat Shëndetësore Menaxhimi i Shëndetësisë
Qendra Kërkimore Shkencore Albanologjike e Ballkanistikës	Shkenca sociale albanologjike	Studime Albanologjike, Gjuhësore, Letraro-Historike dhe Kulturore

Qendra e Zhvillimit Rajonal	Biodiversiteti dhe Mjedisi Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia Shëndetësia dhe shkencat mjekësore Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit Shkencat Sociale dhe Albanologjike Uji dhe Energjia	Zhvillimi rajonal dhe politikat territorial: Zhvillimi ekonomik lokal; Inovacion territorial; Politika rajonale dhe ndërsektoriale
Qendra Kërkimore Shkencore në Shkenca të aplikuara	Uji dhe Energjia	Inxhinieri dhe Teknologji; Sisteme mekanike dhe elektrike; Automatizim industrial; Energji e qëndrueshme dhe aplikime detare; Navigacion, Siguri dhe Transport Detar; Siguria detare; Efiçienca dhe qëndrueshmëria e aktiviteteve detare;
	Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit	Matematikë e Aplikuar, Fizikë dhe Analizë Statistikore; Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Digjitale
	Biodiversiteti dhe Mjedisi	Kimi, Bioteknologji dhe Teknologji Mjedisore; Shkenca Biologjike dhe Mjedisore
Qendra Kërkimore për Inovacion dhe Teknologji	Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit	Inteligjencë Artificiale, Sisteme Inteligjente dhe Automatizim
		Internet of Things (IoT) dhe Smart Technologies
		Transformimi Digjital, Inovacioni dhe Transferimi Teknologjik
Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë	Shkenca sociale albanologjike	Gjuhësi Shqipe, Letërsi dhe Didaktikë Albanologjike
Departamenti i Gjuhëve të Huaja	Shkenca sociale albanologjike	Gjuhë të Huaja, Gjuhësi e Aplikuar dhe Studime Ndërkulturore
Departamenti i Edukimit	Shkenca sociale albanologjike	Shkencat e Edukimit
Departamenti i Drejtësisë	Shkenca sociale albanologjike	Drejtësia Digjitale dhe Teknologjia Juridike (Digital Justice & Legal Tech)
		Të Drejtat e Njeriut dhe Mosdiskriminimi
		Politikat Penale, Kriminaliteti dhe Mbrojtja e të Drejtave Procedurale
		E Drejta Civile, Tregtare dhe Mbrojtja e Konsumatorit
		E Drejta Ndërkombëtare, Integrimi Evropian dhe Migracioni
	Biodiversiteti dhe Mjedisi	E Drejta e Mjedisit, Energjisë dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm
		Metodologjia e Kërkimit Juridik dhe Qasjet Ndërdisiplinore
Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit	Shkenca sociale albanologjike	Ekonomi, Financa Publike dhe Qeverisje; Ekonomi Digjitale, Financa dhe Kontabilitet
	Biodieversiteti dhe mjedisi	Ekonomi mjedisore, Financa mjedisore dhe Kontabilitet mjedisor
	Bujqësia, ushqimi dhe bioteknologjia	Ekonomi dhe Menaxhim Agro-Ushqimor
Departamenti i Ekonomiksit	Shkenca sociale albanologjike	Zhvillimi Ekonomik dhe Ekonomia e Tranzicionit
		Ekonomia e Tregut të Punës dhe Burimeve Njerëzore
		Ekonomia e Biznesit dhe Industrisë
		Ekonomia Digjitale dhe Inovacioni

	Biodieversiteti dhe mjedisi	Ekonomia Mjedisore dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm
Departamenti i Biznesit	Shkenca sociale dhe albanologjike	Zhvillimi Rajonal, Sipërmarrja dhe Menaxhimi i Biznesit
		Ekonomia Digjitale, Inovacioni dhe Qeverisja Digjitale
	Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia	Ekonomi dhe Menaxhim Agro-Ushqimor dhe Zhvillim Rural
	Biodieversiteti dhe mjedisi	Ekonomi Mjedisore, Biznese të Gjelbra dhe Turizëm i Qëndrueshëm
	Shëndetësia dhe shkencat mjekësore	Menaxhim dhe Ekonomi e Shëndetësisë
	Uji dhe Energjia	Ekonomi, Politika dhe Menaxhim i Ujit dhe Energjisë
Fakulteti i Shëndetit	Shëndetësia dhe shkencat mjekësore	Shëndeti Publik, Politikat Shëndetësore dhe Menaxhimi i Shëndetësisë
Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare	Uji dhe Energjia	Efiçiencë Energjetike, Teknologji Industriale dhe Sisteme Propulsive
		Inxhinieri Navale, Transport Detar dhe Mjedis Detar
		Energji Elektrike, Sisteme Energjetike Inteligjente dhe Automatizim Industrial
Departamenti i Matematikës dhe Fizikës	Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit	Programim, Modelim Matematikor dhe Analizë e të Dhënave
		Analizë Matematike dhe Modelim i Fenomeneve Fizike
	Shkencat Sociale dhe Albanologjike	Analizë e Aplikuar, Metoda Kuantitative dhe Statistika Publike
Departamenti i Kimisë	Biodiversiteti dhe Mjedisi	Kimi e Aplikuar, Teknologji Kimike dhe Shkenca Materiale
		Kimi Mjedisore dhe Biokimi
Departamenti i Biologjisë	Biodiversiteti dhe Mjedisi	Biodiversitet dhe Ekologji
		Shkenca Biologjike të Aplikuara
	Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia	Bioteknologji
Departamenti i Shkencave Kompjuterike	Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit	Inteligjencë Artificiale dhe Analizë e të Dhënave
		Sisteme Digjitale, Internet of Things (IoT) dhe Monitorim Inteligjent
		Inovacion Teknologjik, Aplikime Industriale Digjitale dhe Industria 4.0
Departamenti i Shkencave Detare	Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit	Aplikime të TIK në Transport dhe Industri Detare
	Uji dhe Energjia	Energjia e Qëndrueshme dhe Menaxhimi i Burimeve Ujore në Industrinë Detare
	Biodiversiteti dhe Mjedisi	Biodiversitet dhe Mjedis Detar

Standardi IV.2 Institucioni zbaton prioritetet e aktivitetit kërkimor shkencor.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë zbaton në mënyrë të qëndrueshme dhe të strukturuar prioritetet e aktivitetit kërkimor shkencor, në përputhje me misionin, vizionin dhe objektivat strategjikë të zhvillimit institucional. Zbatimi i këtyre prioriteteve realizohet përmes një kuadri të konsoliduar procedurial, organizativ, financiar dhe infrastrukturore, i cili siguron kalimin nga planifikimi strategjik (Standardi IV.1) në implementim konkret, të dokumentuar dhe të vlerësueshëm përmes:

- përcaktimit të fushave prioritare dhe planeve vjetore të kërkimit shkencor (Standardi IV.1),
- kualifikimit të personelit akademik të departamenteve dhe qendrave kërkimore-shkencore në përputhje me fushat prioritare të kërkimit shkencor të njësive bazë (tab.III.9).
- strukturave organizative mbështetëse për zhvillimin e aktivitetit kërkimor shkencor: Sektori i Kërkimit

Shkencor dhe Projekteve, Qendrat kërkimore-shkencore të UV-së.

- mbështetjeve financiare për zhvillimin e aktivitetit kërkimor (Standardi IV.3)
- integrimit të kërkimit shkencor në programet e studimit, veçanërisht në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve (temat e diplomës/dizertacioneve).

UV operacionalizon prioritetet kërkimore përmes strukturave mbështetëse dhe rolit të tyre funksional:

- *Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Projekteve (SKSHP),* i cili mbështet planifikimin dhe menaxhimin e aktiviteteve kërkimore/projekteve, orienton zhvillimin e aplikimeve dhe ndjek përputhshmërinë e tyre me prioritetet institucionale, si dhe menaxhon partneritete me institucione akademike, organizata kërkimore dhe agjenci financuese (**E.23**, fq.75–90; **E.128**).
- *Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë (SMJ),* i cili lehtëson bashkëpunimin me institucione publike/private dhe partnerë ndërkombëtarë, duke mbështetur transferimin e njohurive dhe shpërndarjen e rezultateve kërkimore jashtë universitetit (**E.23**, fq.90–99).

Nga rreth 200 pedagogë që aktualisht ka Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, 173 prej tyre kanë përfunduar ose janë në fazë përfundimtare të studimeve doktorale. Ndër ta, 33 pedagogë (mbi 15% e PAE) i kanë realizuar këto studime në universitete prestigjioze europiane, nën mentorimin e profesorëve të njohur perëndimorë, duke sjellë në Universitetin e Vlorës përvojë të konsoliduar kërkimore, standarde bashkëkohore hulumtimi dhe një kulturë akademike të orientuar drejt ekselencës europiane.

Në funksion të rritjes së kapaciteteve njerëzore, UV organizon trajnime të vazhdueshme për personelin akademik dhe ndihmësakademik në fushën e kërkimit, projekteve dhe inovacionit, ku gjatë periudhës 2020–2025 janë realizuar një numër mjaft i konsiderueshëm trajnimesh (>500**)**, qoftë të realizuara në kuadër projektesh kombëtare/ndërkombëtare si dhe të realizuara prej UV-së, me pjesëmarrjen fizike/online të anëtarëve të stafit (**E.129:** Trajnime UV për rritjen e kapaciteteve në kërkim shkencor**)**.

UV siguron infrastrukturë kërkimore funksionale për zbatimin e prioriteteve kërkimore, përmes laboratorëve dhe qendrave kërkimore-shkencore të organizuara sipas fushave të kërkimit që ato mbështesin. Aktualisht, në UV funksionojnë Qendra e Zhvillimit Rajonal si dhe 4 qendra kërkimore-shkencore (nga një për çdo fakultet)**,** emërtimi dhe profili i të cilave janë rishikuar dhe përafruar me fushat prioritare të kërkimit shkencor, në përputhje me *nenin 11* të Statutit të UV-së (**E.1)**, konkretisht:

Qendra e Zhvillimit Rajonal:
https://univlora.edu.al/qendra-e-zhvillimit-rajonal-prane-universitetit-ismail-qemali-qzhr
https://sites.google.com/univlora.edu.al/rdcunivloraedual/home
Qendra kërkimore-shkencore në Shkencat e Aplikuara:
https://univlora.edu.al/qendra-kerkimore-shkencore-e-shkencave-te-aplikuara-e-fakultetit-te-shkencave-teknike-dhe-natyrore-qkssa
Qendra kërkimore-shkencore për Inovacion dhe Teknologji:
https://univlora.edu.al/qendra-kerkimore-shkencore-per-inovacion-dhe-teknologji-per-fakulteti-e-ekonomik-qksit
Qendra kërkimore-shkencore e Shëndetit Publik:
https://src4ph.univlora.edu.al/
Qendra kërkimore-shkencore e Albanologjisë dhe Ballkanistikës:
https://univlora.edu.al/qendra-kerkimore-shkencore-e-fakultetit-te-shkencave-humane-qsab
Laboratorët kërkimorë:
https://univlora.edu.al/strukturat-e-kerkimit-shkencor-ne-uv

Qendrat dhe laboratorët mbështesin kërkimin e aplikuar, projekte, ekspertiza dhe shërbime ndaj të tretëve, duke mundësuar zbatim praktik të prioriteteve kërkimore. Çdo qendër ka strukturë dhe burime njerëzore (përgjegjës, personel akademik dhe ndihmësakademik), duke siguruar kapacitete organizative për kërkimin.

Disa nga teknikat kërkimore, që mund të realizohen në laboratorët e Universitetit 'Ismail Qemali':

- Karakterizimi kimik i ekstrakteve të bimëve mjekësore
- Analiza mikrobiologjike për vlerësimin e ndotjes së mjediseve ujore,

- Aplikimi i teknikës MPN (Most Probable Number) për përcaktimin e ngarkesës bakteriale në mostrat ujore.
- Teste të ndjeshmërisë ndaj antibiotikëve me metodën Kirby–Bauer.
- Teknika bioteknologjike për ekstraktimin dhe analizën e proteinave.
- Identifikimi dhe karakterizimi i përbërjes llojore të makrozoobentosit në ekosistemet ujore.
- Kërkime në bioteknologji molekulare me aplikime mjedisore, ekologjike dhe biologjike.
- Studimi i bioindikatorëve molekularë për vlerësimin e cilësisë së mjedisit.
- Teste për monitorimin ekologjik dhe ruajtjen e biodiversitetit.
- Marrje mostrash për parametrat fiziko-kimikë dhe mikrobiologjikë të ujrave me dron ujor (deri 100m)
- Monitorim i ndotjes ajrore me dron ajror.

Në kuadër të bashkëpunimit të UV-së me Institute of Biology – Plant Physiology, Martin Luther University Halle-Wittenberg, Gjermani nga pala gjermane (Prof.Dr.Ralf Bernd Klösgen) është propozuar që laboratori i Biologjisë të zhvillohet dhe të shndërrohet në një qendër moderne "hot spot" për mësimdhënie, trajnim dhe kërkim shkencor në fushën e teknikave molekulare bashkëkohore. Kjo qendër synon të ofrojë një mjedis të avancuar për studentët, pedagogët dhe studiuesit, ku të mësohen dhe të aplikohen teknikat më të fundit të biologjisë molekulare, bioteknologjisë dhe analizave gjenetike (**E.130).**

Infrastruktura kërkimore përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme përmes investimeve dhe rialokimeve buxhetore. Për periudhën 2021–2025, UV ka realizuar investime në pajisje/materiale laboratorike në vlerën *15,861,870 lekë*, ndërsa investimet e siguruara në kuadër të projekteve jashtë buxhetit të UV-së janë në vlerën *79,717,624 lekë* (**E.131), (E.132).**

Institucioni integron kërkimin shkencor në programet e studimit, veçanërisht në ciklin e dytë dhe të tretë, përmes orientimit të temave të diplomës drejt linjave prioritare të njësive bazë dhe interesave kërkimore të stafit **(E.133), (E.123).** Ky proces realizohet përmes mentorimit akademik, përdorimit të metodave kërkimore dhe përfshirjes së studentëve në projekte/aktivitete, duke kontribuar në zhvillimin e aftësive kërkimore dhe në rritjen e cilësisë akademike të programeve. Një pjesë e punimeve të doktoratave të pedagogëve të UV-së, në IAL shqiptare dhe të BE-së, janë zhvilluar në laboratoret e Universitetit 'Ismail Qemali' dhe si projekte të zhvilluara në struktura të UV-së:

Pedagogu UV	*Punimi kërkimor*	*Universiteti pritës*
Emirjona Kiçaj	The impact of health education on improving self-management and the quality of care for diabetic patients	University of Brasov
Medrit Mustafaraj	A Multi-Dimensional Approach to Seawater Quality Assessment and Pollution Detection in Populated Areas	Norwegian University of Science and Technology
Mariola Ismailaj	Comparing traditional and Innovative Tools for Analyzing the Biodiversity of Aquatic Ecosystems in Albania	Universita Torr Vergata
Kerol Saçaj	Rezistenca ndaj antibiotikëve në ujërat sipërfaqësore në Shqipëri	Universiteti i Tiranës
Eni Meli	Identifikimi i disa faktorëve që shkaktojnë kufizimin e treguesve të rritjes dhe prodhimit të midhjes (M. Galloprovincialis Lamarck, 1819) në Liqenin e Butrintit	Universiteti i Tiranës
Jerina Jaho	"Sero-prevalence of Hepatitis B Virus Infection and Situation of Vaccination Coverage among Students of Faculty of Health, University of Vlore, Albania"	Universita Torr Vergata
Studime Master		
Polikseni Mone	Vlerësimi i cilësisë së ujit të lumit Shushicë	Universiteti 'Ismail Qemali'

	nëpërmjet analizës së parametrave fiziko-kimik dhe indikatorëve mikrobiologjik nga Kota deri në bashkimin me lumin Vjosë	
Gestiana Sulejmani	Vlerësimi i cilësisë së ujit të lumit Shushicë nëpërmjet analizës së parametrave fiziko-kimik dhe indikatorëve mikrobiologjik nga grykëderdhja deri në Gjorm	Universiteti 'Ismail Qemali'

Zbatimi praktik i prioriteteve dëshmohet edhe nga publikimi i arritjeve shkencore të stafit akademik dhe studentëve në Buletinet Shkencore të UV-së https://univlora.edu.al/buletini-shkencor; https://uvjournals.univlora.edu.al/), të organizuara sipas fushave prioritare:

- https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/Buletini-Shkencor-Special-Edition-Vol.-2-2023.pdf
- https://univlora.edu.al/media/dokument/bsh-nr-7-vol-5-edicion-special-2024cred-4teach.pdf
- https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/02/Buletini-Shkencor-Numer-7-Vellimi-4-Special-Edition-2024.pdf
- https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/10/Buletini-Shkencor-Numer-7-Vellimi-3-2024.pdf
- https://univlora.edu.al/media/dokument/buletini-uv-nr-8-vol-2.pdf

Universiteti 'Ismail Qemali' siguron burime financiare dhe infrastrukturore për zhvillimin e aktivitetit kërkimor, duke shfrytëzuar si fondet e brendshme, ashtu edhe programet e financimit kombëtar dhe ndërkombëtar. Bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë, qendra kërkimore dhe partnerë të tjerë strategjikë kontribuon në forcimin e kapaciteteve kërkimore dhe në zbatimin efektiv të prioriteteve të përcaktuara (Standardi IV.3).

Përmes këtyre mekanizmave, UV garanton që aktiviteti kërkimor të jetë i orientuar, i planifikuar dhe i monitorueshëm në funksion të prioriteteve strategjike, duke kontribuar në rritjen e cilësisë akademike, inovacionit dhe reputacionit institucional.

Standardi IV.3 Institucioni inkurajon zhvillimin, dinamizmin e veprimtarive kërkimore / artistike dhe shkencore.

Universiteti 'Ismail Qemali' krijon dhe zbaton politika të qarta për nxitjen e zhvillimit dhe dinamizmit të veprimtarive kërkimore, shkencore dhe artistike, në përputhje me misionin dhe objektivat strategjikë të zhvillimit akademik. Këto politika synojnë forcimin e kulturës së kërkimit dhe krijimtarisë akademike, si dhe rritjen e përfshirjes aktive të stafit akademik dhe studentëve në veprimtari kërkimore dhe artistike me impakt.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë inkurajon pjesëmarrjen e stafit akademik në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, konferenca shkencore, botime në revista të njohura dhe veprimtari artistike, duke ofruar mbështetje organizative, institucionale dhe financiare për orientimin dhe zbatimin e veprimtarive kërkimore sipas prioriteteve institucionale (Standardi IV.2). Mbështetja dhe nxitja e veprimtarisë kërkimore dhe artistike mbështetet në parimet themelore të Statutit të Universitetit, i cili sanksionon rolin e institucionit në zhvillimin e kërkimit shkencor, inovacionit dhe bashkëpunimit akademik (**E.1**: nenet 4, 5 dhe 10).

Në këtë kuadër, vendimet e Senatit Akademik kanë krijuar bazën proceduriale për aplikimin, miratimin, implementimin dhe raportimin e projekteve kërkimore të financuara nga buxheti i universitetit, duke siguruar standardizim të procesit dhe monitorim të zbatimit (VSA 16/2021).

Zbatimi praktik i këtij kuadri dëshmohet përmes praktikave të plota të projekteve, nga faza e aplikimit deri te raportimi final (**E.134)**. Ky komponent është konsoliduar më tej përmes miratimit të një rregulloreje të standardizuar për projektet kërkim-zhvillimore të financuara nga buxheti i UV-së (PKZHUV) (**E.18**), e cila unifikon veprimet e njësive bazë, qendrave kërkimore, Rektoratit dhe Bordit të Administrimit, duke garantuar qartësi proceduriale, koherencë institucionale dhe transparencë në të gjitha fazat e zbatimit të projekteve. Rregullorja përafron praktikat institucionale të UV-së me standardet kombëtare të AKKSHI dhe me parimet e

integritetit, transparencës dhe eficiencës në përdorimin e fondeve publike.

Në aspektin financiar, Universiteti ofron mbështetje të qëndrueshme për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore dhe artistike, nëpërmjet:

- sigurimit të financimeve kombëtare (AKKSHI) dhe ndërkombëtare për realizimin e projekteve shkencore të stafit të UV-së;
- mbështetjes financiare të brendshme për projekte kërkim-zhvillimi të financuara nga UV (PKZHUV). Theksojmë se financimi është rritur nga 14 milionë ALL në vitin 2025 në 19.2 milionë ALL në vitin 2026. Shpërndarja e buxhetit bëhet e specifikuar për çdo departament, qendër kërkimore-shkencore, si dhe për QZHR-në;
- mbështetjes financiare për shkrim projektesh, botim artikujsh në revista Scopus/WoS, botime në buletinet shkencore të UV-së dhe tarifa pjesëmarrjeje në konferenca të rregulluar sipas vendimeve të Senatit akademik VSA 17/2021, VBA 45/2025, VSA 75/2017 i ndryshuar me VSA 2/2024 dhe VSA 66/2024;
- mbështetjes institucionale dhe financiare për përfshirje në rrjete institucionale dhe organizime, të cilat krijojnë mundësi për pjesëmarrje në projekte (ETEN, UNIMED, CMU, EUCEN, ASECU) (**E.135)**
- mbështetjes financiare për ngritje, pasurim dhe mirëmbajtje laboratorësh kërkimorë (Standardi IV.2);
- mbështetjes financiare për iniciativat artistike të personelit akademik dhe Këshillit Studentor ("Nëntori që flet"): https://univlora.edu.al/njoftime/aktivitet-festiv-nentori-qe-flet (**E.136).**

Mbështetja financiare për veprimtarinë kërkimore shkencore (2021–2025)

Nr	*Emërtimi*	(2021-2025)
	Shpenzime për kërkimin shkencor me financim të brendshëm	ALL
1	Finacim Projekte UV	46,000,000
2	Udhëtim jashtë shtetit	12,000,000
3	Bashkëfinancim për Projektet me Finacim të huaj	34,168,294
4	Shpenzime për organizim konferenca kërkimore shkencore	54,679,834
5	Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca, rimbursim artikujsh	18,200,000
6	Bashkëfinancim për Projektet me Finacim nga AKKSHI	2,000,000
7	Shkrim Hartim Projektsh	16,521,800
	Totali	**183,569,928**
	Shpenzime për kërkimin shkencor me financim të huaj	
1	Projektet me financim të huaj	157,584,986
2	Projekte të financuara nga AKKSHI	14,107,998
	Totali	**171,692,984**
	Financimi i kërkimit shkencor në UV gjatë 2021-2025	**355,262,912**

Burimi i të dhënave: *Sektori i Financës (Tabela "Shpenzime për kërkimin shkencor 2021–2025").*

Njësitë bazë dhe strukturat përkatëse luajnë një rol aktiv në gjallërimin e veprimtarive kërkimore dhe artistike, përmes organizimit të konferencave e seminareve shkencore, workshop-eve, ekspozitave, aktiviteteve krijuese dhe shkëmbimit të praktikave më të mira. Si shembuj të aktiviteteve të organizuara nga UV përmenden:

- "Kërkimi shkencor si orientues i Politikave Shëndetësore" - Konferenca shkencore, e organizuar nga Fakulteti i Shëndetit për prezantimin e gjetjeve të projekteve të financuara nga AKKSHI.
  Libri i konferencës ISBN: 9789928379443. 119 faqe.
  https://univlora.edu.al/njoftime/simpozium-kerkimi-shkencor-si-orientues-i-politikave-shendetesore .
- Seminar "Teknologjitë Inovative 3D":
  https://univlora.edu.al/njoftime/teknologjite-inovative-3d
- Konferenca "1st INTERCON-SE-NCDs-I-MAP":
  https://univlora.edu.al/njoftime/konferenca-e-1-re-nderkombetare-intercon-se-ncds-i-map

- Workshop sensibilizues “Dita Botërore e Ligatinave”: https://univlora.edu.al/njoftime/dita-boterore-e-ligatinave

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë nxit ndërdisiplinaritetin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, duke krijuar hapësira për iniciativa të reja kërkimore dhe artistike që pasurojnë procesin akademik dhe rrisin vizibilitetin institucional. Si shembuj të aktiviteteve në bashkëpunim me institucione rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare përmenden:

- Konferenca Vlora Smart City – “Promovimi i edukimit dhe indentifikimi i mangësive/nevojave në sektorin detar shqiptar” https://univlora.edu.al/njoftime/konferenca-promovimi-i-edukimit-dhe-indentifikimi-i-mangesivenevojave-ne-sektorin-detar-shqiptar
- Simpoziumi “Gjuha e Rrënjëve”: https://univlora.edu.al/njoftime/takimi-gjuha-te-rrenjeve-ne-bashkepunim-me-aics
- Trajnim “QLOC dhe Industria e testimit të videolojërave”: https://univlora.edu.al/njoftime/qloc-dhe-industria-e-testimit-te-videolojerave
- Leksion i hapur “100-vjetori i krijimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”: https://univlora.edu.al/njoftime/leksion-i-hapur-ne-kuader-te-100-vjetorit-te-kontrollit-te-larte-te-shtetit
- Forumi “Formimi dhe Edukimi i Ekspertëve në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare”: https://univlora.edu.al/njoftime/forum-midis-akademise-se-forcave-te-armatosura-dhe-universitetit-ismail-qemali

Në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë funksionon Komiteti i Etikës së Kërkimit, i ngritur në bazë të Rregullores së UV-së, *neni 127, pika A* (**E.4**), i cili verifikon përputhjen e kërkimit shkencor në UV me standardet etike dhe ligjore. Ky komitet është ngritur me Vendim të Senatit Akademik (VSA 4/2026), pas një procesi vetëkandidimi sipas thirrjes për aplikime miratuar me VSA 124/2025). Komitetet Shkencore të Fakulteteve janë strukturat që japin lejet për zhvillimn e projekteve dhe bëjnë vlerësimin shkencor të projekteve në përfundim të tyre (**E.4** *neni 127, pika B*) (https://univlora.edu.al/strukturat-e-kerkimit-shkencor-ne-uv).

Përmes këtyre mekanizmave, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë garanton një mjedis akademik aktiv dhe motivues, ku veprimtaritë kërkimore, shkencore dhe artistike zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme dhe dinamike, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë, inovacionit dhe reputacionit institucional.

Standardi IV.4 Institucioni dhe njësitë përgjegjëse për kërkimin shkencor/ artistik dhe inovacionin vlerësojnë përformancën e tyre në nivel institucional.

Universiteti ‘Ismail Qemali’ ka ndërtuar dhe zbaton një sistem institucional të formalizuar për vlerësimin e performancës së kërkimit shkencor dhe inovacionit, i cili funksionon në mënyrë të integruar në nivel institucional, në nivel njësish kryesore dhe bazë, si dhe në nivel individual të personelit akademik dhe kërkuesve shkencorë, me synim monitorimin e vazhdueshëm të performancës dhe përmirësimin e cilësisë kërkimore.

Sistemi institucional i vlerësimit mbështetet në një kuadër rregullator të konsoliduar, të miratuar nga organet kolegjiale të universitetit, i cili përcakton misionin kërkimor të institucionit, kompetencat e strukturave drejtuese dhe akademike, si dhe mekanizmat e vlerësimit dhe raportimit të performancës si për veprimtarinë kërkimore në tërësi (**E.4:** neni 50), ashtu edhe specifikisht për cilësinë e performancës së kërkimit shkencor (**E.4:** neni 127, pika B.1.b), si dhe për mekanizmat e përgjithshëm institucionalë që lidhen me menaxhimin dhe vlerësimin (**E.18:** neni 10, pika 3 dhe 5).

Nivelet kryesore të vlerësimit të performancës përfshijnë:

i. Performanca në nivel njësie kryesore: departament / qendër kërkimore-shkencore
ii. Performanca në nivel personeli akademik/ndihmës akademikë/administrativë

iii. Performanca e cilësisë/realizimit të projekteve
iv. Vlerësimi prej studentëve

Në nivel institucional, vlerësimi i performancës kërkimore realizohet përmes indikatorëve të miratuar sipas Udhëzimit të MAS Nr 5/2018 "*Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë* (ndryshuar me udhëzimin nr. 24, datë 21.10.2019)", të reflektuar në Raportin Vjetor Institucional, ku përfshihen tregues specifikë për projektet kërkimore, publikimet shkencore, aktivitetet kërkimore dhe bashkëpunimet akademike. Këta indikatorë përdoren si bazë për analizën e performancës, krahasimin ndërmjet njësive dhe mbështetjen e vendimmarrjes institucionale në fushën e kërkimit shkencor, dhe pasqyrohen në Raportin Vjetor Institucional të Universitetit, i cili hartohet, miratohet dhe publikohet çdo vit akademik. Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë evidentohet një angazhim i lartë dhe i qëndrueshëm i personelit akademik në veprimtari kërkimore, shkencore/artistike dhe inovacion, i mbështetur nga politika të qarta institucionale dhe mekanizma funksionalë. Ky angazhim dhe rezultatet përkatëse pasqyrohen në mënyrë të dokumentuar në Raportet Vjetore Institucionale të viteve akademike 2020–2025 (sipas faqeve të referuara), ku raportohen treguesit e performancës kërkimore dhe zhvillimet kryesore. Paralelisht, institucioni ofron mbështetje të drejtpërdrejtë financiare për këtë kategori përmes instrumenteve të përshkruara në Standardin IV.3, duke stimuluar pjesëmarrjen në projekte kërkimore, publikime dhe konferenca, si dhe zhvillimin e infrastrukturës kërkimore.

Referenca:

Raporti i vitit akademik 2024-2025, fq 40-50
https://univlora.edu.al/media/dokument/raport-vjetor-institucional-2024-2025.pdf
Raporti i vitit akademik 2023-2024, fq 21-71
https://univlora.edu.al/media/dokument/raporti-veprimtarise-uv-2023-2024-opt.pdf
Raporti i vitit akademik 2022-2023, fq: 15-23; 103-154; 162-165; 302-319
https://drive.google.com/file/d/1psq8R_5JfxDdycvYmWwqQOEI5pIpqq_L/view
Raporti i vitit akademik 2021-2022, fq: 83-108; 125-199; 229-269; 350-377
https://drive.google.com/file/d/1oMXjeUvL4wahpqVtrxmh6LTt2bU8YhwX/view
Raporti i vitit akademik 2020-2021, fq:32-47;91-131;203-228;329-331
https://drive.google.com/file/d/1mtw02Sdw9ieCPMWR7OZrBBdIXyhvUgMq/view

Të dhënat e mbledhura nga raportet e njësive kryesore përbëjnë pjesë integrale të Raportit Vjetor Institucional dhe bëhen publike në përputhje me aktet institucionale, duke garantuar transparencë, krahasueshmëri dhe gjurmueshmëri të performancës kërkimore ndërmjet njësive *(Programi i Transparencës i UV;* https://univlora.edu.al/programi-i-transparences *- Informacion në lidhje me performancën e AP).*

Universiteti 'Ismail Qemali' ka ndërtuar gjithashtu mekanizma të standardizuar për vlerësimin e performancës individuale të personelit akademik dhe kërkuesve shkencorë, të cilët realizohen përmes formularëve institucionalë të vlerësimit nga drejtuesit e njësive akademike, në përputhje me detyrimet akademike dhe kërkimore të përcaktuara në aktet institucionale (***E.4:*** *neni 50 dhe 127, pika B.1.b*); (**E.31**- VSA 52/2017).

Për më tepër, Rregullorja për projektet PKZHUV (**E.18**: neni 10, pika 3 dhe 5) përcakton procedurat për aplikimin, zbatimin, monitorimin dhe raportimin e projekteve kërkimore, si dhe detyrimet për vlerësimin e rezultateve kërkimore në nivel njësie dhe instituciona. Kjo rregullore është miratuar në fund të vitit 2025 dhe implementimi i saj nis me thirrjen e re PKZHUV 2026 (**E.137**). Për periudhën pararendëse, procesi i aplikimit dhe vlerësimit të projekteve kërkim-zhvillimore është realizuar në zbatim të VSA nr. 16/2021, i dëshmuar edhe përmes rasteve praktike të vlerësimit në nivel njësie kryesore (**E.138:** Vlerësim projekti PKZHUV në nivel njësie kryesore).

Një komponent i rëndësishëm i këtij procesi është vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga studentët, përmes pyetësorëve të miratuar nga Senati Akademik, rezultatet e të cilëve analizohen, publikohen dhe përdoren për përmirësimin e cilësisë akademike dhe forcimin e lidhjes ndërmjet kërkimit shkencor dhe mësimdhënies. Raport i analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për cdo vit akademik dhe rekomandimet përkatëse publikohen në faqen zyrtare të UV-së në kuadër të Programit të Transparencës dhe

Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë:

- https://univlora.edu.al/programi-i-transparences/
- https://univlora.edu.al/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/

Bazuar në rezultatet e vlerësimit të performancës kërkimore, UV zbaton mekanizma stimulues dhe financiarë për promovimin e performancës së lartë dhe praktikave të mira, përfshirë pagesën e orëve të shkrimit të projekteve kërkimore dhe mbështetjen financiare për pjesëmarrjen e stafit akademik në aktivitete shkencore ndërkombëtare. Në këtë kuadër, institucioni mbështet gjithashtu zhvillimin e karrierës akademike, duke mbuluar tarifën (fee) për procedurën e fitimit të titullit akademik "Profesor i Asociuar", si pjesë e politikave stimuluese për rritjen e cilësisë dhe kapaciteteve kërkimore të stafit **(E.58).**

Standardi IV.5 Institucioni garanton pronësinë intelektuale të arritjeve dhe rezultateve në fushën e kërkimit shkencor dhe i përdor ato me qëllim zhvillimin ekonomik dhe financiar të tij.

UV garanton pronësinë intelektuale të arritjeve dhe rezultateve në fushën e kërkimit shkencor dhe i përdor ato në funksion të zhvillimit ekonomik dhe financiar të institucionit. UV ka ndërtuar dhe zbaton një kuadër të qartë rregullator dhe operacional për mbrojtjen e pronësisë intelektuale të produkteve shkencore, profesionale dhe teknologjike të zhvilluara brenda universitetit, duke përcaktuar qartë të drejtat dhe detyrimet e institucionit, stafit akademik dhe partnerëve në lidhje me përdorimin dhe shfrytëzimin e tyre (**E.17:** nenet 2-3; **E.4:** nenet 129-133; **E.7:** kreu IV; **E.11**; Kodi Etikës, neni 13 https://univlora.edu.al/media/dokument/kodi-etikes-universitetit-2013.pdf). Ky kuadër rregullator dhe praktik siguron mbrojtjen ligjore të pronësisë intelektuale, përdorimin e kontrolluar të rezultateve kërkimore dhe shfrytëzimin e tyre në funksion të zhvillimit ekonomik dhe financiar të universitetit.

UV integron në mënyrë sistematike rezultatet e kërkimit shkencor dhe zhvillimet bashkëkohore në tregun e punës përmes projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, duke i kthyer ato në kurrikula të përditësuara, module të reja mësimore, mikrokredenciale dhe formime profesionale. Kjo realizohet përmes bashkëpunimit të strukturuar me universitete europiane, institucione publike, autoritete vendore, operatorë ekonomikë dhe SME, në kuadër të programeve Erasmus+, Horizon Europe, Interreg IPA CBC, ADRION etj.

Një pasqyrë e detajuar e projekteve kombëtare dhe me financim të huaj, ku janë të angazhuara njësitë bazë, gjendet në databazën elektronike të projekteve të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë në:

- https://univlora.edu.al/projekte-nderkombetare/
- https://univlora.edu.al/projekte-kombetare/
- https://univlora.edu.al/projekte-me-financim-nga-uv

Në vijim paraqiten disa prej produkteve akademike dhe komunitare të projekteve ndërkombëtare kërkim-zhvillimore, të cilat dëshmojnë kthimin e rezultateve kërkimore në përfitime konkrete për universitetin dhe për komunitetin, si dhe orientimin e tyre drejt zhvillimit socio-ekonomik.

Produktet akademike dhe komunitare të disa prej projekteve ndërkombëtare të kërkim-zhvillimit të Universitetit 'Ismail Qemali'

Titulli i projektit	Përfitimet për UV	Produkti për institucionet komunitare
Master në Turizëm të Qëndrueshëm për Arsimin dhe Trajnimin Profesional (VET) dhe Sipërmarrje	Arsim profesional (VET) / model trajnimi Transformim digjital / AI në arsim Bashkëpunim universitet–industri	Përmirësim i punësueshmërisë dhe aftësive në turizëm të qëndrueshëm Fuqizim i SME/SEO për turizëm dixhital dhe të gjelbër
Arsimi i Lartë për Shoqëri të Qëndrueshme dhe të Fuqizuara	Kërkim shkencor i aplikuar (practice-oriented) Inovacion digjital / transformim digjital Zhvillim rajonal / qëndrueshmëri smart (zona jo-urbane)	Transferim praktikash dhe inovacion digjital në rajon Rritje e kapaciteteve lokale për zhvillim smart dhe reziliencë

Përmirësimi i cilësisë së arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor përmes lehtësimit të integrimit të Inteligjencës Artificiale në mësimdhënie, të nxënë dhe kërkim shkencor	Transformim digjital / AI në HE (teaching-learning-research) Bashkëpunim universitet–biznes–komunitet (Quadruple Helix) Kërkim shkencor (AI në kërkim)	Rritje e shërbimeve/produkteve digjitale nga bashkëpunimi me aktorë lokalë Ekosistem lokal inovacioni dhe zhvillimi socio-ekonomik
Zyrat e Ndërlidhjes Industriale (ILO) për fuqizimin e një rrjeti ndërkufitar të aftësive digjitale, sipërmarrëse dhe profesionale – ILOFORDIGITAL	Infrastrukturë / pajisje Zhvillim institucional / struktura (ILO Office) Inovacion & sipërmarrje digjitale Bashkëpunim universitet–biznes Hartim strategjish / politika zhvillimi	Shërbime ndërlidhëse universitet–biznes për inovacion dhe transferim aftësish Nxitje e sipërmarrjes digjitale dhe start-up-eve lokale
Mikro-kredenciale të bazuara në MOOC për zhvillimin profesional të mësuesve	Transformim digjital / MOOC / e-learning Ndërkombëtarizim / bashkëpunim (AL–MZ–UA + BE)	Trajnime fleksibël për mësuesit (online) me mikrokredenciale Modele kombëtare për adoptimin e mikrokredencialeve
Qendra Ndërkombëtare të Kompetencës Inxhinierike për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të lëvizshmërisë në Shqipëri dhe Mal të Zi	Modernizim kurrikule / real-problem-based learning Tranzicion i gjelbër & qëndrueshmëri Zhvillim institucional / struktura (Engineering Competence Centres) Kërkim i aplikuar / projekte të përbashkëta	Specialistë/inxhinierë me aftësi për mobilitet të qëndrueshëm Mbështetje për politika lokale dhe industri në sektorin e mobilitetit të gjelbër Ekosistem bashkëpunimi për inovacion në transport
Fuqizimi i njohurive dhe aftësive në institucionet e arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor në përgatitje për transport dhe logjistikë detare me karbon zero	Infrastrukturë / pajisje Modernizim kurrikule / materiale didaktike Tranzicion i gjelbër & dekarbonizim Kërkim i aplikuar / inovacion në sektor Zhvillim rajonal / ndikim në ekonomi	Profesionistë të kualifikuar për industrinë detare/portuale Aftësi dhe standarde për dekarbonizim/eficiencë energjetike Rritje e konkurrueshmërisë së sektorit detar në rajon
Qendra të Inovacionit SMART për zhvillimin e mendimit inovativ dhe sipërmarrës për të lehtësuar dhe zhvilluar zgjidhje të zgjuara të qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor	Infrastrukturë / pajisje (SMART Innovation Centres) Inovacion & sipërmarrje Smart Specialisation (S3) Modernizim kurrikule / module të reja Transformim digjital / online & hybrid Ndërkombëtarizim / mobilitet	Hub inovacioni për bizneset dhe start-up-et lokale Shërbime këshillimi/trajnimi për aktorët e inovacionit Ekosistem i qëndrueshëm rajonal për sipërmarrje dhe inovacion
Kultivimi i kompetencave të kujdesit shëndetësor të saktë te studentët e shkencave shëndetësore dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor nëpër Evropë — PRECISE (Kompetencat e Kujdesit Shëndetësor të Saktë në Evropë)	Shëndet publik / wellbeing Ndërkombëtarizim / rrjetëzim europian Modernizim mësimdhënie / inovacion edukativ Digjitalizim / online learning Kornizë kompetencash / standarde Kërkim / vlerësim & validim	Përmirësim i cilësisë së shërbimeve shëndetësore përmes kompetencave precize Rrjet bashkëpunimi ndërmjet profesionistëve dhe institucioneve shëndetësore Standardizim dhe materiale reference për praktika më të mira
Bashkëpunim i qëndrueshëm ndërmjet universitetit dhe ndërmarrjeve për përmirësimin e punësueshmërisë së të diplomuarve	Infrastrukturë / pajisje (Qendra "SUCCESS") Bashkëpunim universitet–biznes Platformë digjitale / networking Modernizim kurrikule / mësimdhënie praktike Punësueshmëri / treg pune Inovacion & sipërmarrje / start-up support	Fuqizim i lidhjeve universitet–biznes dhe rritje e punësimit Ofrim i praktikave dhe profileve të përshtatura për ndërmarrjet Start-up-e dhe shërbime inovative për komunitetin

Zhvillimi i një programi të përbashkët rajonal master në Mbrojtjen dhe Menaxhimin e Mjedisit Detar	Infrastrukturë / pajisje (IT; pajisje nënujore; dron; e-books) Modernizim kurrikule / program i ri master Ndërkombëtarizim / program në anglisht Tranzicion i gjelbër & qëndrueshmëri Zhvillim rajonal / Blue Economy Politika publike / integrim europian Transformim digjital / mësim në distancë	Profesionistë të rinj për sektorët publik/privat në ekonominë blu Mbështetje për institucionet në përmbushjen e standardeve mjedisore të BE Monitorim më i mirë i mjedisit detar dhe vijës bregdetare
Energjia e zgjuar për qytete të zgjuara	Infrastrukturë / pajisje Tranzicion i gjelbër & qëndrueshmëri Edukim profesional / VET Bashkëpunim universitet–biznes Politika / strategji EU Inovacion / angazhim rinor	Rritje e ndërgjegjësimit për energjinë dhe eficiencën Nisma qytetare për energji të zgjuar në komunitet Zgjidhje inovative nga të rinjtë për sfida energjetike lokale
Zhvillimi i qëndrueshëm i ekonomive blu përmes arsimit të lartë dhe inovacionit në vendet e Ballkanit Perëndimor	Infrastrukturë / pajisje Inovacion & sipërmarrje Zhvillim rajonal / Blue Economy Bashkëpunim universitet–biznes Modernizim kurrikule / program studimi	Rritje e inovacionit dhe sipërmarrjes në sektorët detarë Qendra lokale inovacioni për ekonomi blu Punësim dhe zhvillim ekonomik në zonat bregdetare
Economic growth and governance in the WB: A pathway to EU integration (WB-EU-path)"	Modernizim kurrikule (sillabuse master me fokus BE) Kërkim shkencor / studime EU Ndërkombëtarizim / rrjet akademik EU Rritje reputacioni institucional të UV	Evidencë për reforma dhe qeverisje në procesin integrues Ndërgjegjësim publik për integrimin europian Mbështetje për politika publike dhe aktorë lokalë/rajonalë
Infrastrukturë laboratorike virtuale për shëndet dhe mirëqenie	Kërkim shkencor në shëndet & mirëqenie (Living Lab) Akses transnacional + virtual në 17 infrastruktura kërkimore Trajnime dhe zhvillim kapacitetesh për staf/kërkues Transformim digjital në kërkim (të dhëna + EOSC)	Evidencë dhe metoda inovative (rehabilitim, kujdes kalimtar, aktivitete të jetës së përditshme) Transferim metodologjish Living Lab te aktorë lokalë Standardizim dhe harmonizim procesesh në shërbime komunitare

Në nivel të përmbajtjeve mësimore dhe zhvillimit të kompetencave profesionale, projekte si:

- Zero-C - https://zeroc-project.com/
- SMART- https://smartinnovationcentres.com/
- DUALBA- https://dualba.ef.uns.ac.rs/en/
- MAred - http://www.mared.ac.me/
- INTEC - https://intec.fh-joanneum.at/

kanë kontribuar në modernizimin e programeve të studimit, integrimin e moduleve të reja të orientuara drejt industrisë dhe forcimin e lidhjes midis arsimit të lartë dhe nevojave reale të tregut të punës, veçanërisht në sektorë si transporti detar, logjistika, teknologjitë e gjelbra, inovacioni dhe arsimi dual.

Paralelisht, përmes projekteve të fokusuara në zhvillimin profesional dhe format fleksibël të të nxënit, si:

- CRED4TEACH- https://cred4teach.eu/ (VSA 52/2025)

universiteti ka zhvilluar dhe ofron mikrokredenciale, trajnime dhe module të certifikuara, të bazuara në analiza nevojash dhe të dizajnuara në bashkëpunim me aktorë të arsimit, industrisë dhe politikëbërjes.

Lidhja e kërkimit me biznesin dhe zhvillimin rajonal është forcuar më tej përmes projekteve si:

- ILOFORDIGITAL https://www.sviluppoitaliamolise.com/progetto-ilofordigital/
- KNOWHUB https://www.fh-joanneum.at/en/project/knowhub/

të cilat kanë institucionalizuar mekanizma të ndërveprimit universitet–industri, qendra inovacioni dhe struktura të transferimit të njohurive.

UV garanton pronësinë intelektuale të rezultateve të kërkimit dhe inovacionit përmes një kuadri të qartë rregullator institucional. Pronësia intelektuale e publikimeve, produkteve shkencore dhe rezultateve kërkimore është e sanksionuar në Nenin 133 "Publikimet dhe Pronësia Intelektuale" në Rregulloren e UV-së (**E.4**), i cili përcakton të drejtat e autorësisë, mënyrën e përdorimit dhe mbrojtjen e rezultateve të kërkimit të realizuara nga personeli akademik dhe studentët.

Në funksion të rritjes së vizibilitetit dhe mbrojtjes së autorësisë së botimeve shkencore, UV është anëtarësuar në infrastrukturën ndërkombëtare **Crossref**, duke mundësuar pajisjen e botimeve institucionale me numër DOI dhe regjistrimin e tyre në rrjete globale të objekteve kërkimore (VSA 17/2025).

Në zbatim të këtij kuadri, UV ka formalizuar ofrimin dhe shfrytëzimin e rezultateve kërkimore dhe ekspertizës akademike ndaj palëve të treta përmes *Rregullores për shërbimet e ofruara ndaj të tretëve* (**E.11**), e cila disiplinon procedurat e ofrimit të shërbimeve, marrëdhëniet kontraktuale, tarifimin, administrimin financiar dhe shpërndarjen e të ardhurave të gjeneruara. Ky mekanizëm krijon një bazë të qëndrueshme për përdorimin ekonomik të rezultateve kërkimore dhe pronësisë intelektuale në funksion të zhvillimit ekonomik dhe financiar të universitetit sanksionuar dhe në Rregulloren financiare të UV-së (**E.7**: neni 19) si dhe vendimet e Bordit të Administrtimit për miratimin e tarifave për shërbimet ndaj të tretëve (VBA 22/2022; VBA 57/2025).

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve institucionale për menaxhimin e pronësisë intelektuale dhe patentimit, UV ka përfshirë në strukturën organizative një specialist të dedikuar për çështjet e pronësisë intelektuale dhe patentave (**E.23**: fq. 86–90). Aktualisht, shfrytëzimi ekonomik dhe financiar i rezultateve kërkimore nuk realizohet ende përmes patentave të regjistruara, pasi institucionit ndodhet në fazën e licencimit/patentimit dhe ndjekjes së procedurave për mbrojtjen ligjore të produkteve inovative. Megjithatë, Universiteti gjeneron përfitim ekonomik konkret përmes ofrimit të shërbimeve ndaj palëve të treta, të bazuara në ekspertizën akademike dhe kapacitetet kërkimore, si:

- aktivitete trajnuese LLL me mikrokredenciale me pagesë (**E.96);**
- shërbime profesionale për verifikimin e plagjiaturës për subjekte të treta (**E.78)**

Zbatimi praktik i këtij kuadri dëshmohet gjithashtu dhe përmes iniciativave konkrete si:

- Nisja e procedurave për mbrojtjen ligjore dhe patentimin e sistemit informatik UNVIMAS (**UN**iversity **VI**rtual **MA**nagement **S**ystem) gjatë vitit 2025, si praktikë e parë e dokumentuar e mbrojtjes së pronësisë intelektuale të një produkti inovativ të zhvilluar brenda institucionit (**E.77);**
- Nisja e procedurave për licencimin e shërbimeve laboratorike dhe kërkimore nga qendrat kërkimore-shkencore dhe laboratorët e universiteteve, përfshirë procedurat e akreditimit të shërbimeve në Qendrën Kërkimore Shkencore të FSHTN, në funksion të garantimit të cilësisë dhe njohjes formale të shërbimeve të ofruara ndaj të tretëve (**E.123).**
- Në kuadër të forcimit të dimensionit të tretë të universitetit – inovacionit dhe transferimit të njohurive – Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës ka konsoliduar infrastrukturën e nevojshme teknike dhe organizative për nisjen e prodhimit dhe komercializimit të produkteve me markën institucionale UniVlora, në formën e iniciativave *spin-off*. Fokusi fillestar është vendosur në zhvillimin e vajrave esenciale dhe produkteve kozmetike me bazë kërkimore, duke shfrytëzuar ekspertizën akademike dhe kapacitetet laboratorike të universitetit, si një model konkret i lidhjes së kërkimit shkencor me tregun dhe zhvillimin lokal (**E.175)**.
- Paralelisht, UniVlora Scientific Journal (https://uvjournals.univlora.edu.al/), në vijim të procesit të rritjes së cilësisë dhe ndërkombëtarizimit, synon pas indeksimit në platforma prestigjioze ndërkombëtare të aplikojë një tarifë publikimi (Article Processing Charge – APC) për artikujt e pranuar. Ky hap përbën një praktikë të zakonshme në revistat e indeksuara dhe do të kontribuojë në garantimin e qëndrueshmërisë financiare, rritjen e standardeve editoriale dhe forcimin e pozicionimit të revistës në hapësirën akademike ndërkombëtare.

Si rezultat i menaxhimit më të mirë të mbledhjes së të ardhurave dhe diversifikimit të burimeve të të ardhurave institucionale, në fund të vitit buxhetor 2025 Universiteti 'Ismail Qemali' arkëtoi mbi 10% të ardhura më tepër se viti paraardhës.

Standardi IV.6 Në zbatim të prioriteteve të kërkimit shkencor/artistik, institucioni kanalizon veprimtaritë e kërkimit në nivel departamenti.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë kanalizon veprimtarinë mësimore dhe kërkimore-shkencore në nivel departamenti, duke e përcaktuar departamentin si njësinë bazë të zhvillimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Ky rol është i sanksionuar në *nenin 10* të Statutit të Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali" (**E.1**), ku departamenti përcaktohet si njësi bazë akademike, si dhe detajohet më tej në *nenet 24–25* të Rregullores së Universitetit (**E.4**), e cila përcakton kompetencat, përgjegjësitë dhe mënyrën e funksionimit të njësive bazë akademike. Struktura akademike e UV përfshin 16 departamente, të organizuara në 4 fakultete, të cilat përbëjnë njësitë bazë ku zhvillohet veprimtaria mësimore dhe kërkimore-shkencore sipas fushave homogjene të studimit dhe kërkimit (**E.1**, nenet 9–11).

Në përputhje me kuadrin normativ institucional, departamentet organizohen në grupe mësimore, si dhe në grupe kërkimore-shkencore të përhershme ose të përkohshme, të cilat funksionojnë si nënstruktura operative për zhvillimin e mësimdhënies dhe kërkimit. Krijimi, përbërja dhe funksionet e këtyre grupeve përcaktohen në aktet e brendshme institucionale dhe miratohen sipas procedurave përkatëse (**E.4:** nenet 24–25), përfshirë vendimet e Senatit Akademik (VSA 12/2025) dhe aktet e emërimit të drejtuesve të grupeve mësimore dhe kërkimore (**E.139).**

Departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtarinë kërkimore përmes kompetencave të drejtuesit të njësisë bazë dhe përgjegjësve të grupeve mësimore dhe kërkimore, të cilët monitorojnë aktivitetin shkencor, organizojnë analiza periodike dhe raportojnë rezultatet e arritura (**E.4:** nenet 24–25; *Kreu I neni 4, Kreu II* i Rregullores e Departamentit të Infermierisë. Ushtrimi i këtyre kompetencave realizohet duke respektuar plotësisht lirinë akademike të personelit akademik, të sanksionuar në Statutin e Universitetit (**E.1:** nenet 43–46) dhe në Kodin e Etikës (https://univlora.edu.al/keshilli-i-etikes – nenet 2 dhe 6), duke garantuar të drejtën e stafit për të zhvilluar kërkimin shkencor sipas interesave profesionale dhe për të shfrytëzuar burimet materiale, infrastrukturore dhe financiare të institucionit në funksion të veprimtarisë akademike dhe kërkimore.

Në këtë kuadër, departamentet dhe grupet kërkimore veprojnë si promotorë të drejtpërdrejtë të veprimtarive të kërkimit shkencor, duke iniciuar dhe propozuar studime, aktivitete shkencore, botime dhe projekte kërkimore. Nismat për organizimin e aktiviteteve kërkimore (workshop-e, konferenca, seminare) dhe për aplikime në projekte kombëtare ose ndërkombëtare nisin në nivel departamenti ose grupi kërkimor dhe formalizohen përmes procedurave institucionale përkatëse

E.140: Kërkesa dhe propozime të departamenteve për organizimin e aktiviteteve shkencore konferencave, seminareve dhe workshopeve shkencore;

E.141: Projekt aplikim PKZHUV i iniciuar nga departamenti**.**

Veprimtaria kërkimore e iniciuar nga departamentet dokumentohet në analizat vjetore të departamenteve dhe në raportet institucionale, të cilat shërbejnë si instrument formal për vlerësimin e ecurisë së kërkimit dhe planifikimin e aktiviteteve kërkimore për periudhën pasuese

E.142: Analiza vjetore e Qendres Kerkimore Shkencore e Shendet Publik mbi veprimtarinë mësimore dhe kërkimore;

E.143: Procesverbale të mbledhjeve të departamentit shkenca kopmjuterike dhe gjuhe shqipe dhe letersise, për miratimin e objektivave kërkimore; Vendime fakulteti për objektivat vjetore të kërkimit

Departamentet në UV mbështeten financiarisht në mënyrë transparente dhe të hapur për zhvillimin e veprimtarive kërkimore, përmes fondeve të parashikuara në buxhetin vjetor dhe afatmesëm të institucionit, të alokuara mbi bazën e kërkesave buxhetore të paraqitura nga njësitë bazë (**E.26,** fq.3-33).

Në funksion të garantimit të transparencës institucionale, informacioni mbi buxhetin dhe të dhënat financiare publikohet rregullisht në faqen zyrtare të UV-së, në kuadër të Programit të Transparencës:

https://univlora.edu.al/programi-i-transparences/ (Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të AP). Gjatë dy viteve të fundit, fondi për Projekte Kërkim-Zhvillimi të financuara nga UV është shpërndarë drejtpërdrejt në nivel departamenti dhe qendrave kërkimore-shkencore. Më parë, pas shpërndarjes në nivel fakulteti, fondi shpërndahej në nivel njësie bazë me vendim të dekanatit (**E.144).** Në të njëjtën mënyrë mbështetet edhe fondi për aktivitete kërkim-zhvillimi dhe socio-kulturore, ndërsa fondi për rimbursim botimesh/artikujsh, konferencash dhe shkrim projektesh ofrohet mbi bazën e performancës dhe arritjeve individuale të personelit akademik. Me ngritjen e Këshillit Studentor, aktiviteteve të planifikuara prej tij i është dedikuar një fond i veçantë në buxhetin vjetor të UV-së (VBA 22/2025 fq: 34).

Ndërveprimi me aktorë dhe partnerë jashtë institucionit në fushën e kërkimit shkencor realizohet mbi një qasje "*bottom-up*", ku nisma për bashkëpunim, projekte dhe studime të përbashkëta lind në nivel departamenti dhe grupeve kërkimore. Në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Vlorës, departamentet propozojnë marrëdhënie bashkëpunimi, aplikime në projekte dhe organizim aktivitetesh shkencore me partnerë të jashtëm, të cilat – pas miratimeve përkatëse institucionale – formalizohen dhe zbatohen në nivel fakulteti dhe universiteti, duke dëshmuar rolin aktiv të njësive bazë në zhvillimin dhe ndërkombëtarizimin e veprimtarisë kërkimore.

E.145: Kërkesa zyrtare të iniciuara nga departamentet për bashkëpunim me partnerë të jashtëm - Marrëveshje bashkëpunimi (MoU) të propozuara nga departamentet dhe të miratuara institucionalisht

E.146: Projekt aplikime të iniciuara nga departamenti (HORIZON- fq 1-13, PKZHUV- fq 14-28, PIKSH-AKKSHI- fq 29-54)

Standardi IV.7 Institucioni miraton objektiva të qarta për njësitë, grupet kërkimore / artistike dhe personelin akademik.

Njësitë bazë, grupet kërkimore/artistike dhe personeli akademik i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë objektiva të qarta në fushën e kërkimit shkencor (Standadi IV.1), të cilat integrohen në planifikimin vjetor të veprimtarisë akademike dhe në organizimin e kohës vjetore të punës së personelit. Në nivel departamenti dhe grupi kërkimor, objektivat kërkimore përcaktohen dhe miratohen çdo vit akademik përmes diskutimeve të hapura me personelin akademik, në kuadër të mbledhjeve të departamenteve, analizave vjetore dhe planeve të punës. Këto procese dokumentohen përmes procesverbaleve dhe vendimeve përkatëse të njësive bazë (**E.143**).

Në përmbushje të objektivave të miratuara, departamentet përcaktojnë detyrimet vjetore të personelit akademik në fushën e kërkimit shkencor, duke i reflektuar ato në organizimin e kohës vjetore të punës. Ky proces bazohet në kuadrin rregullator institucional, veçanërisht *në Nenin 39* të Rregullores së Universitetit (**E.4**), i cili përcakton shpërndarjen e kohës vjetore të punës ndërmjet veprimtarive mësimore, kërkimore, administrative dhe aktiviteteve të tjera akademike. Programimi i kësaj kohe miratohet nga drejtuesi i departamentit në konsultim me anëtarin e personelit akademik, duke garantuar balancimin e detyrimeve dhe mbështetjen institucionale për realizimin e tyre (**E.147)**.

Në funksion të realizimit të objektivave kërkimore, Universiteti aplikon masa konkrete mbështetëse për personelin akademik të angazhuar në veprimtari kërkimore, projekte shkencore dhe mobilitete akademike, përfshirë riorganizimin e ngarkesës mësimore dhe administrative, dhënien e lejeve akademike (**E.148)** dhe aplikimin e instrumentit të vitit sabatik, sipas *Nenit 49* të Rregullores së Universitetit (**E.4**) i reflektuar në tabelën më poshtë, duke dëshmuar mbështetjen reale institucionale për avancimin shkencor të stafit akademik.

Masa mbështetëse të UV-së për realizimin e objektivave kërkimore: viti sabatik

Viti akademik	Nr. personel në vit sabatik	Njësa Bazë
2021–2022	2	DITD_ FSHTN DFK_FE

2022–2023	1	DD_FSHH
2023–2024	5	DGJSHL_FSHH DE_FSHH DSHK_FSHTN DE_FE DF_FSHTN
2024–2025	4	DGJH_FSHH DD_FSHH
2025–2026	2	DD_FSHH DSHK_FSHTN
Totali 2021-2026	**14**	

Burimi i të dhënave: Databaza e Sektorit të Burimeve Njerëzore

Për realizimin e objektivave në fushën e kërkimit, departamentet ngrejnë grupe pune dhe komisione ad-hoc për hartimin e projekteve, studimeve dhe nismave kërkimore, duke promovuar punën në grup dhe koordinimin ndërmjet stafit akademik (**E.146:** Fq.4, fq.15, fq.34*)*.

Paralelisht, Universiteti i Vlorës nxit dhe zhvillon bashkëpunime me institucione të arsimit të lartë, qendra kërkimore dhe ekspertë brenda dhe jashtë vendit, përmes:

- marrëveshjeve të bashkëpunimit
  https://univlora.edu.al/marreveshje-nderinstitucionale
  https://univlora.edu.al/marreveshje-mirekuptimi
  https://univlora.edu.al/marreveshjet-me-institucionet-brenda-vendit
- projekteve të përbashkëta dhe aktiviteteve akademike
  https://univlora.edu.al/projekte-nderkombetare/
  https://univlora.edu.al/projekte-kombetare/
  https://univlora.edu.al/projekte-me-financim-nga-uv

Në funksion të realizimit të objektivave kërkimore dhe forcimit të kapaciteteve akademike, njësitë bazë në UV organizojnë në mënyrë të vazhdueshme aktivitete shkencore si leksione të hapura, seminare dhe workshop-e, duke përfshirë edhe ekspertë të jashtëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Këto aktivitete kontribuojnë në shkëmbimin e praktikave të mira, transferimin e njohurive, rritjen e ndërveprimit akademik dhe stimulimin e stafit dhe studentëve për angazhim aktiv në kërkim shkencor dhe zhvillim profesional.

Konferenca, seminare, workshop-e dhe leksione të hapura me ekspertë të jashtëm:

- ETEN Symposium 2026 (European Teacher Education Network)
  https://univlora.edu.al/njoftime/eten-symposium-2026---vlore-albania
- Bisedë e hapur me pedagoët e huaj të programit Ceepus: Advancing Sustainable Environmental, Health and Safety Practices for Green Job Readiness (Sustainforce Alliance)
  https://univlora.edu.al/njoftime/vizite-akademike---programi-ceepus
- "Intelligenza delle Mani" – bashkëpunim me Valore Italia dhe 355HUB
  https://univlora.edu.al/njoftime/takimi-akademik-dhe-kulturor-me-teme-intelligenza-delle-mani
- Workshop ndërkombëtar *"Tourism Business Ideas for Vlora District"* në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Shkencave të Aplikuara, Kempten.
  https://univlora.edu.al/njoftime/workshop-i-studenteve-te-fe
- V.I.T.A. – Valona Innovation Talent Activators
  https://univlora.edu.al/njoftime/universiteti-ismail-qemali-vlore-organizon-eventin-vita
- Vlora Smart City – "Promovimi i edukimit dhe indentifikimi i mangësive/nevojave në sektorin detar shqiptar"
  https://univlora.edu.al/njoftime/konferenca-promovimi-i-edukimit-dhe-indentifikimi-i-mangesivenevojave-ne-sektorin-detar-shqiptar
- Workshop "Krijimi i sipërmarrjeve digjitale"

https://univlora.edu.al/njoftime/-workshop-inovativ-krijimi-i-sipermarrjeve-digjitale

- Sesione trajnimi mbi pronësinë industriale
  https://univlora.edu.al/njoftime/sesion-trajnimi-te-titulluar-njohurite-mbi-pronen-industriale-dhe-te-drejtat-qe-ato-perfshijne
- Bashkëpunime me Raiffeisen Bank Albania
  https://univlora.edu.al/evente/sesion-interaktiv-edukim-financiar-me-raiffeisen-youth

Standardi IV.8 Institucioni synon rritjen e vazhdueshme të veprimtarive kërkimore/artistike e shkencore dhe garanton gjithëpërfshirjen e personelit akademik dhe studentëve të ciklit të dytë dhe të tretë.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë synon rritjen e vazhdueshme të veprimtarive kërkimore/artistike dhe shkencore, si dhe përmirësimin e reputacionit të tij akademik, duke e përcaktuar kërkimin shkencor si prioritet strategjik të zhvillimit institucional. Ky orientim është i sanksionuar në Statutin e Universitetit (**E.1**, neni 4) dhe në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2025–2030 (**E.35,** Skenari I, Linja strategjike I.3), ku kërkimi shkencor dhe ndërkombëtarizimi përbëjnë shtylla kryesore të vizionit të universitetit. Në zbatim të këtij kuadri strategjik, universiteti aplikon masa organizative, institucionale dhe stimuluese për rritjen e volumit dhe cilësisë së veprimtarive kërkimore, duke nxitur angazhimin e stafit në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, botime shkencore dhe pjesëmarrje në aktivitete shkencore ndërkombëtare. Mbështetja financiare dhe mekanizmat për stimulimin e kërkimit shkencor trajtohen në mënyrë të detajuar në Standardin IV.3.

Raportet vjetore institucionale dëshmojnë gjithashtu një trend rritës të projekteve, botimeve dhe aktiviteteve kërkimore gjatë periudhës 2021–2025 (Raportet Vjetore Institucionale 2020–2025 https://univlora.edu.al/programi-i-transparences – Informacion në lidhje me performancën e AP; Tabela përmbledhëse 19, 20).

Universiteti organizon dhe merr pjesë në mënyrë të vazhdueshme në veprimtari shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si organizator, bashkëorganizator dhe partner aktiv në konferenca dhe simpoziume (Standardi IV.7).

Veprimtari kërkimore/artistike e shkencore të organizuara nga UV, që kanë ndikuar në rritjen e vizibilitetit dhe reputacionit të UV-së

- Doctor Honoris Causa: Andrea de Genaro, Enver Roshi, Andreas Schieder
- Promovime Librash: Mero Baze, Preç Zogaj
- Biseda të hapura: Gëzim Tushe, Aleksandër Çipa, Plator Nesturi
- UniVlora OpenDay
  https://www.youtube.com/watch?v=HuMaWnXi6VQ
- Ekspo UniVlora në organizime shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare (International week, Stamboll; Panairi i Punës, Sarandë, Berat)
- Podcaste
  https://univlora.edu.al/laboratori-mediatik
- Reportazhe për veprimtarinë e UV-së në televizione lokale dhe nacionale
  https://www.youtube.com/watch?v=pbPtyjirNdM&list=PL1xZvVJM8wVTmljdYgVIt17tA2ta0UumE
  https://www.youtube.com/watch?v=d6Ar2rOpcWg
  https://www.youtube.com/watch?v=9fwnivPdEWU

Veprimtari kërkimore/artistike e shkencore të organizuara nga UV në nivel ndërkombëtar

- Aktivitete shkencore të organizuara nga UV, me pjesëmarrje ndërkombëtare
  "Intelligenza delle Mani" – bashkëpunim me Valore Italia dhe 355HUB
  https://univlora.edu.al/njoftime/takimi-akademik-dhe-kulturor-me-teme-intelligenza-delle-mani
  "Komunikimin e Rrezikut, Angazhimin e Komunitetit dhe Menaxhimin Infodemik për Infeksionet dhe Sëmundjet kronike në Situatat Shëndetësore Emergjente" – konfererencë ndërkombëtare e Fakultetit të

Shëndetit
https://www.facebook.com/share/p/16jLyxWUAv/
Mini-kurs ndërkombëtar për Data Sciences and AI – me pjesëmarrje dhe profesorat ndërkombëtar
(E.149: Programi dhe diploma i mini-kursit ndërkombëtar për Data Sciences and AI, maj 2025)
https://univlora.edu.al/njoftime/nis-mini-course-on-data-sciences-and-ai-ne-universitetin-e-vlores

- Aktivitete ndërkombëtare, të zhvilluara në UV

  13th ASECU Intrenational Conference & Summer School - (si anëtar i rrjetit ASECU, UV organizoi Konferencën Rinore Ndërkombëtare dhe Shkollën Verore (1–7 shtator 2024), me pjesëmarrje të universiteteve nga Shqipëria, Greqia, Hollanda, Turqia, Kosova, Bullgaria, Maqedonia e Veriut, Rumania dhe Armenia; punimet shkencore të prezantuara janë publikuar në Buletinin Shkencor të UV-së.
  https://asecu.gr/files/asecu-youth/15th-call-for-papers-2024.pdf
  https://www.facebook.com/profile.php?id=61564993866167&sk=photos
  Punimet shkencore të publikuara në Buletinin Shkencor të UV-së
  https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/02/Buletini-Shkencor-Numer-7-Vellimi-4-Special-Edition-2024.pdf
  ETEN Symposium 2026 (si anëtar i rrjetit ETEN, do të zhvillohet në UV (22–24 prill 2026), symposiumi duke krijuar një platformë ndërkombëtare shkëmbimi për akademikë dhe studiues nga vende të ndryshme të Europës, Azi-së, Kanada-së dhe SHBA-së, për të diskutuar sfidat dhe risitë në edukimin e mësuesve, me fokus qendror: "*Education for active citizenship in a global society*" (edukimi për qytetari aktive në një shoqëri globale) dhe për të shkëmbyer praktikat e mira (good practices), forcuar rrjetet profesionale dhe promovuar inovacionin pedagogjik.
  https://etenjournal.com/2026/01/27/the-board-meets-the-hosts/
  The Symposium 2026 will take place at the University of Vlora – Ismail Qemaliin, Albania, 22-24 April – all you need to know! – ETEN Journal
  V.I.T.A. – Valona Innovation Talent Activators
  Iniciativë ndërkombëtare që synon të nxisë bashkëpunimin ndërmjet universitetit, institucioneve dhe sektorit privat, me fokus të veçantë te inovacioni dhe zhvillimi i talenteve të reja.
  https://univlora.edu.al/njoftime/universiteti-ismail-qemali-vlore-organizon-eventin-vita

- Aktivitete artistike e sociale, të organizuara nga Këshilli Studentor

  Marshim sensibilizues 'Dita Botërore e Shëndetit'
  https://univlora.edu.al/njoftime/dita-boterore-e-shendetit-2025
  Program artistik 'Nëntori që flet'
  https://univlora.edu.al/njoftime/aktivitet-festiv-nentori-qe-flet
  Vullnetarizëm në shërbim të komunitetit
  https://univlora.edu.al/njoftime/vullnetarizem-ne-sherbim-te-komunitetit-nga-keshilli-studentor
  Aktivitete sportive ndëruniversitare
  https://univlora.edu.al/njoftime/aktivitete-nderuniversitare

- Aktivitete artistike e sociale, të organizuara nga njësitë bazë

  Gëzuar 28-29 nëntorin 2024!
  https://univlora.edu.al/njoftime/gezuar-28-dhe-29-nentor-2024
  Dita Botërore e Ligatinave
  https://univlora.edu.al/njoftime/dita-boterore-e-ligatinave
  103-vjetori i Ditës Kombëtare të Shërbimit Pyjor
  https://univlora.edu.al/njoftime/aktivitet-i-departamentit-te-kimise-per-103-vjetorin-e-dites-kombetare-te-sherbimit-pyjor
  Informimi, Parandalimi, Mbrojtja: Qasja Europiane ndaj Kancerit të Qafës së Mitrës dhe Roli i edukimit shëndetësor
  https://univlora.edu.al/njoftime/parandalimi-qe-ka-fuqine-te-shpetoje-jete
  dhe shumë, shumë të tjera.

- Projekte me pjesëmarrje studentësh në grupet e punës.

Studimi i ndikimit të Edukimit Muzikor në fushën e Pedagogjisë së Specializuar - Një qasje kërkimore dhe e aplikuar- PKKZH
Onomastika e Lumit të Vlorës, trashëgimi arkeologjike-gjuhësore - PKKZH
Efektet anësore të vaksinës COVID-19 në popullatën e vaksinuar të qarkut Vlorë - PKKZH
Vleresimi mikrobiologjik dhe fiziko kimik i lumit Shushice, Vlorë - PKZHUV
Ngritja e database rajonal të vlerësimit të zhvillimit psikomotor dhe socio emocional të fëmijëve 0-6 vjeç.- PKKZH
Universiteti si Nxitës i trasformimit digital në shkolla përmes projekteve praktike:Arduino, IoT dhe AI-PKZHUV ..etj
https://univlora.edu.al/projekte-kombetare
https://univlora.edu.al/projekte-me-financim-nga-uv

- Tema diplomash: master shkencor,
  Buletin Shkencor ekskluziv me punimet e diplomave të studentëve master
  https://univlora.edu.al/media/dokument/buletini-i-studenteve-shtator-2025.pdf
- Projekte PKZHUV/AKKSHI mbi temat e doktoratës (jashtë UV-së) së personelit akademik dhe doktorantëve të UV-së.
  Phd© M.Mustafaraj – Projekti PKKZH - Vlerësimi i Indikatorëve të Cilësisë së Ujit dhe Ndikimi i Tyre në Ndotjen Bregdetare dhe Kënaqësinë e Turistëve: Një Rast Studimi në Bregdetin e Vlorës, Shqipëri
  Phd© E.Kiçaj – Projekti PKZHUV - Impakti i edukimit shëndetësor në përmirësimin e praktikave vet-menaxhuese dhe cilësinë e kujdesit për pacientët diabetike.
  Phd© Zh.Graçi – Projekti PKKZH - Barrierat dhe zgjidhjet për Përmirësimin e Praktikave të Menaxhimit të Dhimbjes më Spitalet Rajonale të Jugut të Shqipërisë, etj.

Rritja e performancës kërkimore dhe përmirësimi i reputacionit institucional dëshmohen edhe përmes renditjes së UV-së në *Albanian National H-index Ranking 2025***,** ku universiteti renditet në vendin e 8-të nga 45 IAL kombëtare, bazuar në tregues shkencometrikë nga Scopus dhe Web of Science**.** Për një universitet me më pak se 200 personel akademik, ky është një tregues mëse i kënaqshëm. Nëse renditja do të bëhej në raport me numrin e PAE të institucionit, pozicionimi i UV-së do të ishte shumë më i lartë. Informacion më i detajuar gjendet në linkun: https://al.h-index.com/en



Një tjetër evidencë e përmirësimin të reputacionit të UV-së, është dhe pjesëmarrja e stafit akademik në forume

ndërkombëtare në fusha prioritare që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm, ekonominë, shëndetin dhe zhvillimin urban, si:

World Food Forum- https://univlora.edu.al/njoftime/forumi-boteror-te-ushqimit-world-food-forum-2025
Marmara Urban Forum - https://univlora.edu.al/njoftime/marmara-urban-forum-maruf25

Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të brendshëm institucionalë, mundëson pjesëmarrjen sa më të gjerë të personelit akademik dhe studentëve të ciklit të dytë dhe të tretë në veprimtari kërkimore, projekte, konferenca, shkolla verore dhe aktivitete të tjera shkencore si pjesë integrale e zhvillimit të kapaciteteve kërkimore (Tabela përmbledhëse 19, 20, 22). Përfshirja realizohet përmes angazhimit të tyre në:

- ekipe projektesh PKZHUV, AKKSHI
- bashkëautorësi në botime shkencore https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/10/Buletini-Shkencor-Numer-7-Vellimi-3-2024.pdf *fq 44, fq 69*,
- pjesëmarrje në aktivitete kërkimore të financuara ose të mbështetura nga universiteti, p.sh.:
  - përfshirja e studentëve të Infermierisë në aktivitet kërkimor/akademik jashtë vendit në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional **(E.150);**
  - pjesëmarrja e katër studentëve të Shkencave Kompjuterike në "3rd Winter School of ASECU Youth", organizuar nga Department of Business Administration, University of the Aegean (Greqi), me temë: "Future Technologies and Artificial Intelligence for a Digital Economy and Society" **(E.151);**
- Workshop ndërkombëtar, ku përmendim atë të organizuar 14 janar 2026, në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Shkencave të Aplikuara, Kempten, Gjermani me temë: "*Tourism Business Ideas for Vlora District*". Në këtë workshop morën pjesë 16 studentë nga Fakulteti i Ekonomisë i UV-së https://univlora.edu.al/njoftime/workshop-i-studenteve-te-fe

Programet e doktoratës janë të integruara në planin institucional të veprimtarisë kërkimore dhe përbëjnë një komponent të rëndësishëm të prodhimit shkencor të universitetit, përmes tematikave të disertacioneve, publikimeve të përbashkëta dhe pjesëmarrjes së doktorantëve në projekte kërkimore dhe aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare (**E.152:** Programi individual i doktoranteve te Ciklit të III-të**)**. Një pasqyrë e detajuar mbi ciklin e tretë (doktoraturat), studentët doktorantë dhe organizimin e tyre gjendet në databazën/faqen elektronike të UV-së: https://univlora.edu.al/studente-doktorature.

Universiteti garanton integritetin dhe cilësinë e veprimtarisë kërkimore përmes përdorimit të sistemit antiplagjiaturë iThenticate dhe AIDetection ofruar nga platforma Turnitin, i cili shërben për verifikimin sistematik të punimeve të studentëve (Bachelor/Master/Doktoraturë) dhe produkteve kërkimore që publikohen në revistat shkencore të UV-së, duke garantuar respektimin e standardeve të etikës akademike dhe pronësisë intelektuale (**E.4**: neni 130; **E.17**). Kontrolli antiplagjiaturë i produkteve të kërkimit shkencor kryhet nga Komiteti i Etikës së Kërkimit, në një proces vlerësimi anonim (blind), pa identifikim të autorëve. Për çdo rast hartohet një raport vlerësimi etik, i cili dokumenton rezultatet e kontrollit antiplagjiaturë dhe konkluzionet për përputhshmërinë me standardet e integritetit akademik **(E.153).**

Çdo vit realizohet rimbursimi financiar i pjesëmarrjes në aktivitete shkencore në OECD dhe botimeve shkencore, në revista të indeksuara në Scopus dhe Web of Science. Procedura e rimbursimit finalizohet vetëm pas kontrollit rigoroz të dokumentacionit justifikues nga SKSH&P **(E.58).**

Përmes këtyre mekanizmave, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë garanton rritjen e vazhdueshme të veprimtarive kërkimore/artistike dhe shkencore, si dhe gjithëpërfshirjen e personelit akademik dhe studentëve të ciklit të dytë dhe të tretë, duke kontribuar në rritjen e cilësisë akademike dhe reputacionit institucional.

Standardi IV.9 Institucioni bën të njohura rezultatet në fushën e kërkimit shkencor/artistik.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka ngritur dhe ka funksionale një infrastrukturë të plotë fizike dhe digjitale, e cila mundëson botimin, publikimin, shpërndarjen dhe arkivimin e rezultateve të kërkimit shkencor dhe artistik në gjuhën shqipe dhe angleze. Kjo infrastrukturë mbështetet dhe administrohet nga strukturat ndihmëse akademike dhe administrative në nivel Rektorati, konkretisht Sektori i Bibliotekës&Botimeve, Sektori i

Kërkimit Shkencor&Projekteve dhe Sektori IT (**E.23**: fq.59-73 ; fq.75-90; fq.47-59). Publikimi i rezultateve kërkimore dhe mbrojtja e pronësisë intelektuale janë të sanksionuara në aktet rregullatore institucionale të Universitetit, përkatësisht:

- Rregullorja e Përgjithshme e Universitetit, Kreu X dhe XI (**E.4**);
- Rregullorja e Botimit të Revistave Shkencore (**E.16**);
- Rregullorja e Etikës së Kërkimit Shkencor dhe Publikimit në UV (**E.17**).

Kanale dhe platforma të publikimit të rezultateve kërkimore

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë i publikon rezultatet e kërkimit shkencor përmes:

A. Revistave shkencore të menaxhuara nga UV

1. *Buletini Shkencor i Universitetit të Vlorës,* ISSN: 2310-6719 (gjuhë shqip dhe anglisht) https://univlora.edu.al/buletini-shkencor
2. *UniVlora Scientific Journal,* ISSN: 3104-5626, DOI: https://doi.org/10.63871/unvl.jsuv (gjuhë anglisht) https://uvjournals.univlora.edu.al/

B. Platformave digjitale institucionale të UV-së

- Faqja zyrtare e Universitetit: https://univlora.edu.al/
- Qendra për Zhvillim Rajonal: https://sites.google.com/univlora.edu.al/rdcunivloraedual/home
- Qendra e Kërkim-Zhvillimit për Shëndetin Publik: https://src4ph.univlora.edu.al/
- Platforma Cred4Teachers: https://cred4teach.univlora.edu.al/

Publikimet dhe aktivitetet shkencore pasqyrohen rregullisht në seksionet përkatëse të faqes zyrtare të universitetit, përfshirë:

- *Kërkimi shkencor https://univlora.edu.al/filozofia-e-kerkimit-shkencor*
- *Botime (Scopus, WoS, UV) https://univlora.edu.al/botime-scopus; https://univlora.edu.al/botime-wos*
- *Buletini Shkencor https://univlora.edu.al/buletini-shkencor*
- *Data Repository UniVlora https://univlora.edu.al/data-repository-e-uv*
- *Doktorata https://univlora.edu.al/studente-doktorature*
- *Projekte https://univlora.edu.al/projekte-kombetare*
- *UniVlora Scientific Journal https://uvjournals.univlora.edu.al/*

Këto informacione pasqyrojnë gjithë produktin kërkimor të prodhuar nga personeli akademik i Universitetit 'Ismail Qemali' dhe përditësohen në vazhdimësi.

Publikimi si detyrim institucional

Publikimi i rezultateve kërkimore përbën komponent të detyrueshëm në projektet kërkimore (me financim të brendshëm, kombëtar apo të huaj) që Universiteti implementon:

- projektet e financuara nga buxheti i UV-së (**E.18**: Rregullore PKZHUV, neni 10, pika 1, germa "c"; neni 11);
- projektet kombëtare (**E.154**: Kontrata me AKKSHI e projekteve 2025, neni 16(c) neni 10**);**
- projektet ndërkombëtare, ku publikimet dokumentohen përmes botimeve speciale dhe raporteve shkencore, ku përmendim:
  - *Botimi special i Buletinit Shkencor* – KNOW HUB 2023- Përmbledhje e punimeve shkencore të projektit ndërkombëtar KNOW HUB 2023, e publikuar si edicion special i *Scientific Buletin* të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/Scientific-Buletin-Special-Edition-Know-Hub-2023.pdf
  - *Botimi special i Buletinit Shkencor* – CRED4TEACH 2024 - Edicioni special i *Buletinit Shkencor* që përmbledh rezultatet kërkimore dhe kontributet e projektit CRED4TEACH 2024, duke përfshirë artikuj, studime dhe analiza të publikuara nga personeli akademik dhe partnerët. https://univlora.edu.al/media/dokument/bsh-nr-7-vol-5-edicion-special-2024cred-4teach.pdf
  - *Konferenca Përmbyllëse Ndërkombëtare* - projekti MORIN, https://drive.google.com/file/d/1uLWIjvqf2SioPOjcLCQZhjW4Rx62uEOO/view

Revistat shkencore institucionale të UV-së

Universiteti 'Ismail Qemali' garanton funksionimin e dy revistave shkencore me ISSN:
Buletinin Shkencor
ISSN print: 2310-6719, ISSN online: 3005-8473 (https://portal.issn.org/resource/ISSN/3005-8473)
Univlora Scientific Journal
ISSN online: 3104-5626 (https://portal.issn.org/resource/ISSN/3005-8473)
të cilat shërbejnë si platforma të qëndrueshme për publikimin dhe shpërndarjen e rezultateve kërkimore në fusha të ndryshme të dijes.

UniVlora Scientific Journal, e hapur me Vendim të Senatit Akademik nr.46, datë 08/04/2025, është një revistë akademike multidisiplinare, e orientuar drejt promovimit të kërkimit shkencor cilësor, inovacionit dhe shkëmbimit akademik.
Revista UVSJ:

- publikohet në gjuhë angleze
- artikujt kanë numra identifikues DOI
- ka përbërje editoriale ndërkombëtare,
- i nënshtrohet double blind-review
- realizon detektimin e plagjiaturës me sistemin antiplagjiaturë iThenticate dhe AIDetection, ofruar nga platforma Turnitin.

UVSJ siguron infrastrukturë të hapur për komunitetin kërkimor akademik (scholarly research community), duke qenë pjesë e rrjetit CrossRef dhe të gjithë artikujt e publikuar në të pajisen me numrin indentifikues DOI (Digital Object Identification) prej këtij organizmi.

Revista synon rritjen e vizibilitetit shkencor, nxitjen e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe aplikimin e rezultateve kërkimore në zgjidhjen e problematikave reale. Revista mirëpret kontribute nga autorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, me synim nxitjen e bashkëpunimit, rritjen e dukshmërisë shkencore dhe kontributin në zhvillimin e qëndrueshëm në nivel lokal, rajonal dhe global. Përmes standardeve rigoroze editoriale dhe të procesit të vlerësimit shkencor, revista synon avancimin e dijes teorike, mbështetjen e inovacionit dhe promovimin e aplikimit të rezultateve shkencore në zgjidhjen e sfidave reale.

Qëllimet

- Të shërbejë si një forum multidisiplinar për kërkimin shkencor.
- Të promovojë përhapjen e punimeve shkencore origjinale, rigoroze dhe me ndikim.
- Të nxisë bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar ndërmjet studiuesve, institucioneve dhe praktikuesve.
- Të mbështesë studiuesit e rinj në zhvillimin e profilit dhe dukshmërisë së tyre akademike.
- Të kontribuojë në zhvillimin e dijes shkencore, inovacionit dhe politikëbërjes e praktikës të bazuar në evidencë.

Struktura e Revistës UVSJ
Revista është e strukturuar në gjashtë seksione kryesore:

- *Seksioni i Shkencave Teknike* – përfshin inxhinierinë, teknologjinë, matematikën, fizikën dhe fusha të ngjashme.
- *Seksioni i Shkencave Natyrore* – përfshin kiminë, biologjinë, shkencat mjedisore dhe fusha të afërta.
- *Seksioni Ekonomik* – trajton ekonominë, financën, menaxhimin, biznesin, politikat publike dhe sfidat globale ekonomike.
- *Seksioni i Edukimit* – fokusohet në pedagogji, zhvillimin e kurrikulës, psikologjinë e edukimit, arsimin e lartë dhe të nxënit gjatë gjithë jetës.
- *Seksioni i Drejtësisë* – fokusohet në studimet juridike, jurisprudencën, qeverisjen dhe rolin e së drejtës në shoqëri dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.
- *Seksioni i Shëndetit* – i dedikuar mjekësisë, infermierisë, farmacisë, shëndetit publik dhe shkencave shëndetësore ndihmëse.

Revista inkurajon qasje ndërdisiplinore dhe kërkime integruese që lidhin kufijtë ndërmjet këtyre fushave, duke theksuar rolin e shkencës dhe dijes akademike në formësimin e njohurive, politikave dhe praktikave. Brenda 2 viteve të ardhshme, Universiteti i Vlorës do të aplikojë në Elsevier, Clarivat dhe NCBI për ta bërë UVSJ respektivisht pjesë të databasave SCOPUS, WoS dhe PubMed.

Databaza dhe arkivimi institucional

Universiteti ka ndërtuar dhe përditëson databazën elektronike institucionale të botimeve shkencore, e cila përfshin publikimet e personelit akademik, përfshirë botime të indeksuara në Scopus dhe Web of Science. Databaza është e aksesueshme online në faqen zyrtare të universitetit dhe ofron *open access* për stafin akademik, studentët dhe publikun. Databaza përditësohet periodikisht nga strukturat përgjegjëse (SKSH&P dhe SIT).

Në funksion të ruajtjes dhe shpërndarjes së qëndrueshme të prodhimit shkencor, biblioteka universitare garanton arkivimin e qëndrueshëm të botimeve shkencore, punimeve të diplomës dhe disertacioneve të doktoraturës, të cilat depozitohen në mënyrë të detyrueshme dhe arkivohen sipas viteve akademike dhe njësive përkatëse (**E.124).** Disertacionet e doktoraturës janë gjithashtu të aksesueshme përmes platformës elektronike institucionale, në përputhje me rregulloret dhe praktikat e arkivimit digjital https://univlora.edu.al/publikime-doktorature. Procesi i arkivimit dhe përditësimit dokumentohet përmes pasqyrave dhe raporteve përkatëse të bibliotekës universitare (**E.155).**

Standardi IV.10 Institucioni është përgjegjës për garantimin e cilësisë së punimeve shkencore/artistike dhe integritetin e tyre në nivel institucional.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë jo vetëm që nxit zhvillimin e kërkimit shkencor, por ka ndërtuar dhe zbaton një sistem të konsoliduar rregullator dhe funksional institucional për garantimin e cilësisë dhe integritetit të çdo produkti shkencor. Ky sistem është i sanksionuar në kuadrin normativ të brendshëm të universitetit, në veçanti në *nenet 3 dhe 4* të Statutit të UV-së (**E.1**), ku kërkimi shkencor përcaktohet si funksion themelor institucional dhe zhvillohet mbi parime të cilësisë dhe integritetit akademik, si dhe në Rregulloren e Universitetit (**E.4**), konkretisht në Kreun X – Kërkimi Shkencor, ku përcaktohen parimet bazë, organizimi, strukturat përgjegjëse dhe përgjegjësitë institucionale për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë kërkimore-shkencore.

Në funksion të garantimit të cilësisë akademike dhe integritetit shkencor, UV ka miratuar një sërë aktesh të posaçme institucionale, përfshirë:

- Rregulloren e botimit të revistave shkencore (**E.16**)
- Rregulloren për Parandalimin dhe Trajtimin e Plagjiaturës (**E.21**)
- Rregulloren e Etikës së Kërkimit Shkencor dhe Publikimit në UV (**E.17**)

të cilat përcaktojnë standardet etike, kriteret e cilësisë, procedurat e shqyrtimit dhe përgjegjësitë institucionale për botimet shkencore, punimet kërkimore dhe disertacionet, duke siguruar një qasje të unifikuar, transparente dhe të gjurmueshme në nivel universiteti.

Universiteti ka ngritur dhe ka në funksion struktura të posaçme akademike për garantimin e cilësisë së punimeve shkencore të botuara dhe publikuara në nivel institucional, përfshirë:

- Komiteti i Etikës në Kërkim, në nivel institucional (VSA 4/2026);
- Komitetet shkencore të njësive kryesore (**E.156)**
- Bordet editoriale / reviewer të Revistave Shkencore https://uvjournals.univlora.edu.al/editorial-board
- Komisioni i kontrollit të Plagjiaturës (iThenticate dhe AIDetection ofruar nga platforma Turnitin) (**E.157)**
- Vlerësues (reviewers) / grupe vlerësimi të ngritura për veprimtari kërkimore specifike (VSA 50/2023**; E.134:** Dosje e plotë e një projekti PKZHUV – thirrja, aplikimi, vlerësimi, raportimi dhe pagesat**; E.16:** Aneksi II: Formulari i vlerësimit të manuscripteve; **E.158:** Procedurë e plotë e botimit të artikujve

shkencorë në UVSJ**)**.

Këto struktura veprojnë në përputhje me kuadrin rregullator të miratuar nga Senati Akademik dhe shqyrtojnë cilësinë shkencore të punimeve, përputhshmërinë me standardet akademike dhe respektimin e parimeve etike përpara publikimit apo botimit. Procesi i vlerësimit dokumentohet përmes formularëve të posaçëm, procesverbaleve dhe vendimeve përkatëse, duke garantuar transparencë dhe gjurmueshmëri institucionale.

Në kuadër të ndërkombëtarizimit dhe rritjes së cilësisë së vlerësimit shkencor (Standadi IV.12), UV përfshin ekspertizë të jashtme dhe personalitete të huaja në përbërjen e bordeve editoriale, komiteteve shkencore dhe veprimtarive akademike, siç dëshmohet nga pjesëmarrja e ekspertëve ndërkombëtarë si:
Anëtarë të Komitetit Shkencor në Konferenca shkencore :

- https://sites.google.com/univlora.edu.al/morin-project/committees?authuser=1
- https://src4ph.univlora.edu.al/abstract-book/
- https://sites.google.com/univlora.edu.al/folateinternationalconference/home
- https://sites.google.com/univlora.edu.al/folateinternationalconference/publication?authuser=0

Anëtarë të Komitetit Shkencor-Revista apo botime periodike:

- fq.3, https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/02/Buletini-Shkencor-Numer-7-Vellimi-4-Special-Edition-2024.pdf
- fq.2 https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/10/Buletini-Shkencor-Numer-7-Vellimi-3-2024.pdf

Kjo pjesëmarrje kontribuon në rritjen e cilësisë së vlerësimit shkencor dhe në harmonizimin e praktikave institucionale me standardet ndërkombëtare të publikimit dhe peer-review.

UV garanton eliminimin e plagjiaturës dhe respektimin e pronësisë intelektuale përmes përdorimit të detyrueshëm të programit elektronik të çertifikuar iThenticate dhe AIDetection ofruar nga platforma Turnitin, të rregulluar me akt të posaçëm institucional (**E.21)**. Sipas *neni 2* të saj, të gjitha disertacionet e doktoratës, temat e diplomës, artikujt shkencorë botimet institucionale dhe punimet për promovim akademik i nënshtrohen kontrollit antiplagjiaturë, si pjesë integrale e procedurave të vlerësimit dhe vendimmarrjes akademike (**E.153**). Procesi realizohet nga persona të autorizuar me vendim të Rektorit, me afate të përcaktuara qartë dhe raportim formal. Universiteti siguron gjithashtu përdorimin e këtij sistemi për palë të treta (**E.21.** neni 9), kundrejt tarifave të miratuara (VBA 57/2025), duke prodhuar raporte teknike të detajuara për përqindjen e përputhjes, analizën e citimeve dhe identifikimin e përmbajtjes së gjeneruar nga inteligjenca artificiale. Kontrata për përdorimin e sistemit antiplagjiaturë rinovohet periodikisht dhe shoqërohet me dokumentacion të plotë financiar dhe administrativ, duke garantuar funksionim të vazhdueshëm dhe kontroll efektiv institucional (**E.159).**

Standardi IV.11 Institucioni i llojit universitet/akademi përcakton qartë detyrimet për personelin akademik në kuadër të pjesmarrjes në veprimtari kërkimore, studime, publikime e botime dhe i mbështet për përmbushjen e tyre.

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë ka përcaktuar qartë detyrimet e personelit akademik në fushën e kërkimit shkencor, publikimeve dhe botimeve, duke i konsideruar ato si funksione thelbësore të veprimtarisë universitare, të integruara me mësimdhënien dhe zhvillimin institucional. Ky përcaktim bazohet në Statutin e Universitetit (**E.1:** nenet 3 dhe 46) dhe në aktet rregullatore të brendshme (**E.4:** neni 38 dhe Kreu X), ku kërkimi shkencor përbën pjesë përbërëse të misionit institucional dhe të detyrimeve profesionale të stafit akademik.

Gjatë pesë viteve të fundit akademike, UV dëshmon në mënyrë të qartë, të qëndrueshme dhe të dokumentuar se personeli akademik është i angazhuar sistematikisht në veprimtari kërkimore-shkencore, studime, publikime dhe botime, duke e bërë kërkimin shkencor një komponent real dhe funksional të rolit akademik (Aneks 1, tabelat 19 dhe 20; Tabela: Standardi IV.3). Angazhimi kërkimor i stafit akademik pasqyrohet në mënyrë të strukturuar në raportimet vjetore institucionale dhe në databazën institucionale të kërkimit shkencor, të

administruar nga strukturat përgjegjëse (SKSHP), duke mundësuar monitorimin e vazhdueshëm të veprimtarisë kërkimore dhe rezultateve shkencore.

Në vitin akademik 2024–2025, personeli akademik i UV-së ka marrë pjesë dhe ka paraqitur punime në konferenca, seminare dhe veprimtari të tjera shkencore kombëtare, të pasqyruara në Tabelën nr. 5 të Raportit Vjetor Institucional të UV-së për vitin akademik 2024–2025- https://univlora.edu.al/media/dokument/raport-vjetor-institucional-2024-2025.pdf

Paralelisht, stafi akademik ka qenë i angazhuar në veprimtari kërkimore ndërkombëtare, duke prezantuar punime shkencore në konferenca dhe kongrese të zhvilluara në vende të Bashkimit Evropian dhe OECD-së, të botuara në Proceedings me ISBN/ISSN, siç ilustrohet në Tabelën nr. 3 dhe Tabelën nr. 29 të Raportit Vjetor Institucional 2024–2025. Gjithashtu, personeli akademik është përfshirë në rrjete dhe programe kërkimore ndërkombëtare, përfshirë COST Actions (**E.160**), në përputhje me objektivat institucionale për ndërkombëtarizimin e kërkimit shkencor (**E.35:** Skenari I – Ndërkombëtarizimi).

Në aspektin e publikimeve shkencore, personeli akademik i UV-së ka realizuar në mënyrë të vazhdueshme botime në revista shkencore të indeksuara në Scopus dhe Web of Science, si autor i parë ose bashkautor, duke përmbushur kriteret e përcaktuara për prodhimin shkencor cilësor. Këto publikime pasqyrohen në databazën institucionale të botimeve shkencore *https://univlora.edu.al/botime-scopus* , *https://univlora.edu.al/botime-wos* dhe në Raportin Vjetor Institucional 2024–2025 (seksioni "Artikuj shkencorë me Scopus" fq 46).

Personeli akademik ka kontribuar gjithashtu në hartimin dhe përshtatjen e teksteve mësimore dhe cikleve të leksioneve, të miratuara nga njësitë bazë përkatëse, duke garantuar lidhjen funksionale ndërmjet kërkimit shkencor dhe mësimdhënies, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme të UV-së (**E.4:** nenet 64 dhe 140);

E.161: Procedurë miratimi teksti mësimor**;**

E.162: Lista e teksteve mësimore nga akademikë të IAL-ve të tjera. Lista e teksteve mësimore nga akademikë të UV-së**).**

Standardi IV.12 Institucioni që ka përcaktuar në strategjinë e vet si prioritet kryesor kërkimin shkencor, fokusohet në ndërkombëtarizimin e kërkimit dhe veprimtarive që lidhen me të.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, duke e konsideruar kërkimin shkencor si prioritet strategjik të zhvillimit akademik dhe institucional, orienton politikat dhe veprimtaritë e tij drejt ndërkombëtarizimit të kërkimit dhe forcimit të bashkëpunimit shkencor me partnerë ndërkombëtarë. Ky orientim pasqyrohet qartë në dokumentet strategjike institucionale, ku ndërkombëtarizimi i kërkimit përkufizohet si instrument kyç për rritjen e cilësisë, dukshmërisë dhe impaktit të veprimtarisë shkencore (**E.35:** fq.77; **E.34.:***;* **E.33:**, fq.15).

Linja strategjike	***Objektivat strategjikë***	***Veprimet që do të ndërmerren***
I.3 Kërkim shkencor i përbashkët sipas standarteve ndërkombëtare	I.3.1 Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor sipas standardeve Scopus/WoS	▪ Trajnime për metodologjinë e kërkimit shkencor ▪ Zbatimi i sistemit të incentivave për publikime me faktor ndikimi ▪ Kontrolli i antiplagjiaturës për çdo publikim
	I.3.2 Nxitja e projekteve të përbashkëta me institucione europiane	▪ Ndërtimi i konsorciumeve kërkimore rajonale dhe europiane ▪ Aplikime në Horizon Europe, Erasmus+ KA2, COST ▪ Organizimi i tryezave shkencore me partnerë të jashtëm
	I.3.3 Licencimi dhe akreditimi i laboratorëve kërkimorë	▪ Përgatitja e dokumentacionit të akreditimit ▪ Investime në laboratorë modern ▪ Certifikimi sipas standardeve ISO ku aplikohet

	I.3.4 Ritja e mobiliteteve kërkimore ndërkombëtare (COST, Marie Curie, etj.)	▪ Mbështetje për aplikime individuale të stafit ▪ Bashkëpunime me rrjete kërkimore europiane ▪ Përfshirja e doktorandëve në mobilitete kërkimore
	I.3.5 Forcimi i revistës UniVlora Scientific Journal.	▪ Profesionalizimi i Bordit Editorial dhe zgjerimi me ekspertë ndërkombëtarë ▪ Vendosja e një sistemi të standardizuar të "peer-review" të dyfishtë (double-blind peer review) ▪ Ritja e cilësisë së publikimeve përmes thirrjeve ndërkombëtare për dorëzimet ▪ Puna për indeksimin e revistës në Scopus dhe WoS ▪ Botimi i rregullt i volumit dhe numrit (minimumi dy herë në vit) ▪ Digitalizimi i plotë i procesit të publikimit dhe arkivimit ▪ Ritja e vizibilitetit dhe marketingut shkencor
	I.3.6 Krijimi i infrastrukturës digjitale shkencore	▪ Ndërtimi i bazës së të dhënave "UniVlora Repository" për projektet K&Zh ▪ Arkivë digjitale e kërkimeve dhe raporteve ▪ Sisteme analitike për matjen e performancës shkencore

Në zbatim të kësaj linje strategjike, Universiteti "Ismail Qemali" ka zhvilluar:

- Marrveshje bashkëpunimi në fushën e kërkimit
- Aplikime në thirrje ndërkombëtare në fushën e kërkimit
- Konferenca ndërkombëtare për publikimin e rezultateve të kërkimit
- Prezantime të hulumtimeve të stafit akademik të UV-së në konferenca ndërkombëtare
- Në kuadër të Programit të Doktoratës në "Studime gjuhësore, letrare e kulturore", organizohen aktivitete të përbashkëta UV-IAL europiane.
- Kërkues të huaj, të ftuar për të përhapur gjetjet e kërkimeve të tyre në UV

Marrveshje bashkëpunimi në fushën e kërkimit

UV dëshmon bashkëpunim të qëndrueshëm kërkimor me institucione të arsimit të lartë nga vendet e BE-së, OECD-së dhe G20-s, të dokumentuar përmes:

- Marrëveshjeve të Mirëkuptimit (MoU)- https://univlora.edu.al/marreveshje-mirekuptimi
- Inter-Institutional Agreements (IIA)- https://univlora.edu.al/marreveshje-nderinstitucionale

Aktualisht, universiteti ka **120 MoU aktive** dhe **164 IIA**, si dhe ka implementuar mbi **25 projekte ndërkombëtare** vetëm në 5 vitet e fundit. Bashkëpunimet shtrihen në Itali, Greqi, Norvegji, Belgjikë, Spanjë, Finlandë, Francë, SHBA, si dhe në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Mesdheut.

Ndërkombëtarizimi i kërkimit mbështetet gjithashtu përmes anëtarësimit aktiv në rrjete universitare ndërkombëtare si CMU, EUCEN, ASECU, ETEN, etj. (https://univlora.edu.al/anetaresime-nderkombetare), ku UV ka organizuar edhe aktivitete drejtuese dhe shkencore ndërkombëtare, si:

- mbledhja e Bordit Drejtues të CMU e zhvilluar në dhjetor 2022 (https://www.youtube.com/watch?v=NxDDjaziQX8),
- Simpoziumi ndërkombëtar i rrjetit ETEN, i planifikuar të zhvillohet në prill 2026 (https://etenjournal.com/2025/12/30/the-symposium-2026-will-take-place-at-the-university-of-vlora-in-albania-22-24-april-all-you-need-to-know/).

Paralelisht, universiteti ka ndërmarrë hapa konkretë për zgjerimin e mëtejshëm të rrjetit të tij ndërkombëtar përmes aplikimit dhe procesit të anëtarësimit në rrjete me prestigj akademik si UNIMED dhe EURAS **(E.163).**

Aplikime në thirrje ndërkombëtare në fushën e kërkimit

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë dëshmon një angazhim të qëndrueshëm, aktiv dhe konkurrues në thirrje ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor, përmes aplikimeve të rregullta në programe prestigjioze si

Horizon Europe, Erasmus+, COST Actions, Interreg dhe IPA CBC, si dhe programe të tjera ndërkombëtare të financimit, në bashkëpunim me institucione partnere akademike dhe kërkimore nga vendet e Bashkimit Evropian dhe më gjerë.

Tabela më poshtë paraqet në mënyrë të strukturuar angazhimin konkret të stafit akademik dhe administrativ të UV-së në përgatitjen dhe dorëzimin e aplikimeve për projekte kërkimore dhe zhvillimore gjatë periudhës 2024–2025 dhe 2025–2026. Si shihet, vetëm në dy vitet e fundit Universiteti 'Ismail Qemali' ka dorëzuar 51 aplikime në programe të ndryshme në BE, ndërkohë që aplikime të tjera janë në fazë përfundimtare dhe pritet të finalizohen me dorëzimin e tyre brenda afateve zyrtare të thirrjeve përkatëse.

Kjo databazë përditësohet rregullisht nga SKSH&P duke shërbyer si një instrument monitorimi dhe analize për vlerësimin e performancës së stafit të universitetit në këtë aks strategjik, si dhe si tregues i kapaciteteve institucionale të UV-së për pjesëmarrje aktive në skemat konkurruese ndërkombëtare të financimit të kërkimit.

Lista e aplikimeve në projekte me financim të huaj

No	Date	Program	Acronym	Coordinator
1	21.11.2024	CEEPUS		University of Novi Sad, Serbia
2	18.11.2024	HORIZON EUROPE	Children_First	Cyprus University of Technology
3	18.12.2024	SMP-COSME-2024-SEE-01	SLATE	Associacao Promotora Da Rede Dinamica Xxi Potugal
4	02.12.2024	EIT HEI	M4EUS	Mersin University, Turkey
5	17.01.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	NEED2CRED	University of Leon, Spain
6	31.01.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	CIRCLE	Chieti Pesacara. Italy
8	31.01.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	SFF Startup WBunis	International Burch University, Bosnie Hercegovina
9	31.01.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	GREEN-PACT	UV
10	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	U-TURN	University of Banja Luka, Bosnie
11	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	MindFulU	University of Montenegro
12	04.02.2025	EIT Raw materials	MMI	Polytechnic Univesrity of Tirana
13	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	NURTURE	Royal college of surgeons in Ireland
14	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	Eco-STEM	Organizata Drite, Kosove
15	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	GREENSTEP	UV
16	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	ROMOLOGY	University of Montenegro
17	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	GREEN	Univesrity of Saraievo, Bosna
18	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	DataVoyage	University of Montenegro
19	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	DETECH	University of Montenegro
20	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	TALENT	University of Novi Sad, Serbia
21	04.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	U-WELL	Napolis university of Pafos
22	06.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	BRIDGE2E	Thomas More Univesrity of Applied Sciences
23	06.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	WIKADIH	CEPS - University college for business studies
24	06.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	CIRECON	University of East Srajevo
25	06.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	PaLVR	Aristoteli Universty
26	10.02.2025	ERASMUS-EDU-2025 JMO-MODULE	WB-EU-path	UV
27	07.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	Cyberimpact	Polytechnic Univesrity of Tirana
28	07.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	WB-STEAME	University of Krakow, Poland
29	10.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	ACESS-ABLE	Kolegji AAB Kosovo
31	12.02.2025	ERASMUS-EDU-2025-CBHE	CIRC-ECOFURN	University of Thessalias, Greece
32	20.02.2025	ERASMUS+ KA220-HED	MINDSET	Mindrove, Gyor, Hungary
33	06.03.2025	ERASMUS-2025- CB-VET	NEXTLEVEL	CINOP BV, HOLAND
34	06.03.2025	ERASMUS-2025- CB-VET	STM-Tourism	Sinop university, Turkey
35	10.03.2025	ERASMUS-YOUTH 2025-CB	LearnEO	Helathy City Split HR
36	02.04.2025	Programit Interreg NEXT MED 21-27	CHILDREN FIRST	Cyprus University of Technology
37	04.04.2025	Interreg VI-A IPA CBC Programme, Greece-Albania 2021-2027	YouthUp	hellenic reulatory body of nurses, Gr
38	06.04.2025	Europeaid/183647/ID/ACT/AL(Life Skills: Advancing 21st-Century Skills and Career Guidance in Albanian Schools)	Life Skills	British Council, officially registered in Albania through its Albania Branch
39	09.06.2025	Interreg IPA ADRION (Adriatic-Ionian)	HEALTOUR	UV
40	09.06.2025	Interreg IPA ADRION (Adriatic-Ionian)	PRENCO	Instituto Nazionale di Oceanografia e di

				Geofisica Sperimentale, Italia
41	09.06.2025	ERASMUS-EDU-2025-PEX-COVE,	REGEN-VET	Comune di Ceglie Messapica
42	08.09.2025	HORIZON-CL2-2025-01	SHIFT	POLITECNICO DI MILANO
43	29.09.2025	HORIZON-HLTH-2025-01	(ACTS)	University Medical center Hamburg, Germany
44	10.10.2025	HORIZON-CL4-2025-04-HUMAN-08	GenAI for Africa	HELLENIC OPEN UNIVERSITY
45	11.11.2025	HORIZON-NEB-2025-01-REGEN-01	RegenSynergy	UNIVERSITY OF CUKUROVA
46	27.11.2025	HORIZON-MSCA-2025-DN-01	CHILDRENFIRST	Cyprus University of technology
47	27.11.2025	HORIZON-WIDERA-2025-01-ACCESS-01 European Excellence Initiative (EEI)	RISE4HE	Mersin University
48	23.12.2026	ERASMUS-EDU-2026-CBHE	GREENSTEP	UV
49	23.12.2026	ERASMUS-EDU-2026-CBHE	Bridge2E	THOMAS MORE MECHELEN-ANTWERPEN
50	21.01.2026	ERASMUS-EDU-2026-CBHE	TWICE	VAASAN YLIOPISTO, FINLAND
51	26.01.2026	ERASMUS-EDU-2026 -JMO-MODULE	CLIM-AL-EU	UV

Burimi: Databaza e SKSHP

Konferenca ndërkombëtare për publikimin e rezultateve të kërkimit

Institucioni organizon dhe bashkëorganizon konferenca, workshop-e dhe aktivitete shkencore ndërkombëtare, të reflektuara edhe në Raportet Vjetore Institucionale (Tabela nr. 5, viti 2024–2025) *https://univlora.edu.al/media/dokument/raport-vjetor-institucional-2024-2025.pdf*.

Një tregues i qartë i këtij angazhimi është organizimi dhe bashkëorganizimi i konferencave dhe workshop-eve ndërkombëtare në kuadër të projekteve të ndryshme, si më poshtë:

- MORIN – Konferencë ndërkombëtare në kuadër të projektit MORIN https://sites.google.com/univlora.edu.al/morin-project/programme?authuser=0
- KNOWHUB – Aktivitete dhe konferencë ndërkombëtare në kuadër të projektit KNOWHUB https://www.facebook.com/projectKnowHub/ https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/Scientific-Buletin-Special-Edition-Know-Hub-2023.pdf
- TEAVET – Konferenca finale ndërkombëtare e projektit TEAVET https://sites.google.com/view/teavet-final-conference/home
- SMART – Takim konsorciumi dhe event ndërkombëtar për shpërndarjen e rezultateve të projektit SMART https://smartinnovationcentres.com/the-smart-consortium-meeting-and-regional-dissemination-event-in-vlore-albania/
- FoLate – Konferencë ndërkombëtare në kuadër të projektit FoLate https://sites.google.com/univlora.edu.al/folateinternationalconference/home
- 1st International Staff Week – Javë ndërkombëtare stafi, me pjesëmarrjen e mbi 40 anëtarëve të stafit akademik dhe përfaqësuesve të zyrave Erasmus të universiteteve partnere evropiane https://univlora.edu.al/njoftime/1st-international-staff-week-uv

Prezantime të hulumtimeve të stafit akademik të UV-së në konferenca ndërkombëtare

Stafi akademik i UV-së merr pjesë aktive në jetën shkencore ndërkombëtare përmes prezantimit të punimeve kërkimore në konferenca ndërkombëtare si dhe përfshirjes në borde shkencore dhe editoriale të konferencave dhe aktiviteteve akademike ndërkombëtare. Këto veprimtari janë të dokumentuara dhe në Raportin Vjetor Institucional 2024–2025 (Tabela nr. 3 dhe 29*):*

https://src4ph.univlora.edu.al/forumi-boteror-te-ushqimit-world-food-forum-2025/
https://univlora.edu.al/njoftime/marmara-urban-forum-maruf25
https://src4ph.univlora.edu.al/vizita-e-pare-kerkimore-ne-strukturat-e-laboratorave-te-gjalla-tevitalise-living-lab-e-4-kerkuesve-shkencore-nga-qendra-kerkimore-shkencore-e-fakultetit-te-shendetit/
https://src4ph.univlora.edu.al/perfaqesues-te-fakultetit-te-shendetit-moren-pjese-ne-javen-nderkombetare-te-tallinn-health-care-college/).

Në kuadër të Programit të Doktoratës në "Studime gjuhësore, letrare e kulturore", organizohen aktivitete të

përbashkëta UV-IAL europiane, si:

- **“**Practical Tips for Writing Academic Papers”**,** Prof. Tatjana Glušac**,** link**:**https://docs.google.com/forms/d/1gElsEwEZlVil4pmfpWUTixWZZeScFTT9_jcD1lp8smU/edit
- “Critical Thinking Skills in an AI-Driven World”, Prof. Alexandra Mihaela Covaci, link**:**https://docs.google.com/forms/d/1SurC7e0MQtIJ-bUL306G7PWcK6rwNGDqpyyaa76_-10/edit
- “Besueshmëria e Punimit të Kërkimit Shkencor: Si të përballemi me sfidat”, Prof.Dr. Shpresa Delija, link: https://docs.google.com/forms/d/1J02uc2Xxd4081tqT3xGFE0TEz9KAPh2iyVWr0luXtcU/edit

Forcimi i ndërkombëtarizimit të veprimtarisë kërkimore të UV-së mbështetet edhe nga tregues të jashtëm të njohur ndërkombëtarisht, si:

- renditja e universitetit ndër institucionet më të mira shqiptare sipas Webometrics Ranking of World Universities (https://www.webometricsranking.com/country/albania).
- pajisja me Erasmus Charter for Higher Education (ECHE) 2021–2027 (https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/02/Erasmus-Charter-for-Higher-Education-awared-to-University-of-Vlora.pdf),

Kërkues të huaj, të ftuar për të përhapur gjetjet e kërkimeve të tyre në UV

Universiteti “Ismail Qemali” garanton gjithashtu mbështetje financiare dhe logjistike për angazhimin e personelit të huaj në veprimtaritë kërkimore, përmes skemave të Visiting Professor të miratuara me vendim Senati (VSA 95/2017), mobiliteteve Erasmus+ ICM**,** si dhe angazhimit të keynote speakers në konferenca ndërkombëtare **(E.164)**, duke mbuluar shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe ushqimit, në përputhje me rregulloret dhe procedurat e brendshme financiare neni 27, pika 1(b) - Rregullore financiare UV **(E.7).**

- “Practical Tips for Writing Academic Papers”- Prof. Tatjana Glušac,
- “Critical Thinking Skills in an AI-Driven World”- Prof. Alexandra Mihaela Covaci,
- “Data Science Principles with AI Focus- Prof dr. A.Elezi
- Forum i hapur me ekspert amerikan me një karrierë të gjatë në politikë fiskale, zhvillim ekonomik dhe investime publike. - Z. Scott Miller https://univlora.edu.al/njoftime/takim-me-z-scott-miller-ekspert-ne-politike-fiskale-dhe-zhvillim-ekonomik
- “Shkëmbim Akademik dhe Kulturor” – Workshop ndërkombëtar i organizuar më 11.09.2025, pranë sallës ‘Ali Asllani’, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, në bashkëpunim me Departamentin e Biologjisë, studentë dhe staf akademik nga University of Life Sciences Prague (Çeki) https://univlora.edu.al/njoftime/workshop-ne-bashkepunim-me-university-of-life-sciences-prague

Standardi IV.13 Institucioni ka prioritet përfshirjen në veprimtaritë mësimore e shkencore/artistike të personelit të huaj akademik dhe diasporës.

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë ka vendosur përfshirjen e personelit akademik të huaj dhe të diasporës shqiptare si një prioritet të qartë institucional, në funksion të rritjes së cilësisë akademike, ndërkombëtarizimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si dhe forcimit të profilit ndërkombëtar të universitetit. Ky orientim reflektohet në dokumentet strategjike të zhvillimit dhe ndërkombëtarizimit, ku bashkëpunimi akademik ndërkombëtar, mobiliteti i stafit dhe kërkimi shkencor i përbashkët përbëjnë shtylla kryesore të zhvillimit institucional (**E.33; E.34; E.35**).

Përfshirja e personelit akademik të huaj (OECD, BE, G20), në veprimtaritë mësimore dhe kërkimore, për periudha të shkurtra dhe afatgjata

Në këtë kuadër, UV fton dhe angazhon rregullisht personel akademik të huaj për periudha afatshkurtra dhe afatgjata në veprimtari mësimore dhe kërkimore, përmes marrëveshjeve institucionale dhe programeve të mobilitetit akademik. Në mënyrë të qëndrueshme, UV zbaton çdo vit akademik Marrëveshjen për mësimdhënien e gjuhës dhe kulturës italiane midis Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Italisë (MAECI) dhe Ambasadës së Italisë në Shqipëri, duke angazhuar personel akademik të

huaj për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve përkatëse (**E.100).**

Gjatë periudhës 2020–2025, mbi 350 pedagogë të huaj janë angazhuar në leksione, mini-kurse, workshop-e dhe aktivitete kërkimore në njësitë kryesore të universitetit. Shembuj përfaqësues përfshijnë:

- Profesorë të ftuar nga Universiteti i Cádiz (Spanjë) në fushën e Biologjisë;
- Profesorë nga Universiteti i Catanias, Itali (Prof. R. Strongoli, PhD V. Tutino, Prof. P. Leotta – Nëntor 2023);
- Profesorë nga universitete amerikane, përfshirë Prof. A. Elezi, Prof. M. Robinson dhe Prof. R. Ressler (Maj 2025);
- Pritjen e stafit akademik të huaj në kuadër të programit Erasmus+ International Credit Mobility (ICM) (**E.165).**

Bashkëpunime kërkimore dhe publikime të përbashkëta ndërkombëtare

Në fushën e kërkimit shkencor, personeli akademik i UV-së publikon rregullisht rezultate kërkimore në bashkëpunim me personel akademik të huaj nga vende të OECD, BE dhe G20, si dhe me studiues të diasporës shqiptare. Këto bashkëpunime reflektohen në publikime të indeksuara në Scopus dhe Web of Science dhe janë të pasqyruara në databazën institucionale të botimeve shkencore:

https://univlora.edu.al/botime-scopus
https://univlora.edu.al/botime-wos

Përfshirja e personelit të huaj në projekte, borde dhe komitete shkencore

Personeli akademik i huaj është gjithashtu i përfshirë në:

- grupe pune për aplikime në projekte ndërkombëtare (p.sh. Jean Monnet Actions – PhD Entela Çukani, University of Salento; Prof. Pëllumb Kelmendi, Auburn University) **(E.166**);
- grupe pune për aplikime në projekte PKZHUV (psh. Phd. Abeer Watted, AI-Qasemi Academic College, Israle; **(E. 141)**

Bordi editorial i UniVlora Scientific Journal (UVSJ) përfshin edhe personel akademik të huaj, si:

Dr. Dimitra Sifaki-Pistolla
Dr. Vasiliki Eirini Chatzea
https://uvjournals.univlora.edu.al/editorial-board

Anëtarë të Komiteteve Shkencore – Konferenca shkencore të organizuara nga UV, të dokumentuara në:

https://sites.google.com/univlora.edu.al/morin-project/committees?authuser=1
https://src4ph.univlora.edu.al/abstract-book/
https://sites.google.com/univlora.edu.al/folateinternationalconference/home
https://sites.google.com/univlora.edu.al/folateinternationalconference/publication?authuser=0

Anëtarë të Komiteteve Shkencore – Revista dhe botime periodike, të pasqyruara në botimet institucionale:

Buletini Shkencor i UV-së, Numri 7, Vëllimi 4, Edicion Special 2024, fq. 3
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/02/Buletini-Shkencor-Numer-7-Vellimi-4-Special-Edition-2024.pdf
Buletini Shkencor i UV-së, Numri 7, Vëllimi 3, 2024, fq. 2
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/10/Buletini-Shkencor-Numer-7-Vellimi-3-2024.pdf

Kjo pjesëmarrje e drejtpërdrejtë e personelit akademik të huaj në struktura editoriale dhe shkencore dëshmon angazhimin institucional të UV-së për ndërkombëtarizimin e proceseve të vlerësimit shkencor dhe rritjen e besueshmërisë akademike të produkteve kërkimore të publikuara nën kujdesin e universitetit.

Përfshirja e diasporës shqiptare në veprimtaritë akademike dhe kërkimore

Universiteti angazhohet në mënyrë aktive në përfshirjen e studiuesve të diasporës shqiptare në veprimtaritë kërkimore dhe akademike, veçanërisht përmes projekteve ndërkombëtare. Në kuadër të programit READ – Cohorta IV, UV po implementon 3 projekte kërkimore (*https://univlora.edu.al/projekte-nderkombetare)* në

bashkëpunim me studiues të diasporës që veprojnë në universitete prestigjioze ndërkombëtare, përfshirë:

- Prof. Dr. Fioralba Çakoni (Rutgers University, SHBA),
- Dr. Bationa Bennewitz (Martin Luther University, Gjermani),
- Prof. Andi Hoxhaj (King's College London).

Gjithashtu, bashkëpunime të rëndësishme janë realizuar në kuadër të projektit EU4Innovation me studiues të diasporës shqiptare, përfshirë Dr. Adelajda Matuka (University of Bologna), për zhvillimin dhe bashkë-mësimdhënien e moduleve akademike me komponentë kërkimorë (**E.167:** Marrëveshja GIZ EU4Innovation Dokumentacion bashkëpunimi me Dr. Adelajda Matuka (University of Bologna**).**

Mini-kursi ndërkombëtar në fushën e Inteligjencës Artificiale, i organizuar në maj 2025, përbën një tjetër evidencë konkrete të angazhimit të studiuesve të diasporës shqiptare në veprimtaritë akademike dhe kërkimore të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Në kuadër të këtij aktiviteti, është angazhuar Prof. Artur Elezi, studiues i diasporës, i cili ka kontribuar si lektor dhe ekspert në zhvillimin e përmbajtjes mësimore dhe kërkimore të mini-kursit (**E.149).**
Për vijueshmërinë e këtij bashkëpunimi, është arritur marrëveshje që këto mini-kurse ndërkombëtare të zhvillohen periodikisht çdo vit, duke forcuar bashkëpunimin afatgjatë me diasporën akademike dhe ndërkombëtarizimin e ofertës akademike të UV-së.

Përmes këtyre praktikave të konsoliduara, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë garanton përfshirjen sistematike dhe cilësore të personelit akademik të huaj dhe të diasporës në veprimtaritë mësimore dhe kërkimore, duke kontribuar drejtpërdrejt në ndërkombëtarizimin, cilësinë akademike dhe zhvillimin e qëndrueshëm institucional.

Standardi IV.14 Institucioni ka prioritet mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve dhe siguron mekanizmat për përfshirjen sa më shumë të tyre.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë e ka vendosur mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve si prioritet institucional, duke e trajtuar atë si një instrument kyç për ndërkombëtarizimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, rritjen e cilësisë akademike dhe integrimin e Universitetit në Hapësirën Evropiane dhe ndërkombëtare të Arsimit të Lartë. Ky orientim është i sanksionuar në Strategjinë mbi kërkimin shkencor UV, Strategjinë e Ndërkombëtarizimit të UV-së dhe në Planin Strategjik Institucional 2025–2030 (**E.34.:** Skenari 4: Rrjete dhe mobilitet kërkimor, Objektivi 4.1; **E.33.:** pika 1, fq. 13; **E.35.:** Objektivi Strategjik I.2.3 "Rritja e mobiliteteve afatgjata të studentëve dhe stafit", fq. 81).

Në nivel organizativ, proceset e mobilitetit hyrës dhe dalës mbështeten dhe koordinohen nga Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë (SMJ) në Rektorat, i cili vepron si strukturë qendrore përgjegjëse për menaxhimin administrativ dhe teknik të mobiliteteve Erasmus+ dhe programeve të tjera ndërkombëtare. Kjo strukturë siguron asistencë të vazhdueshme për stafin akademik dhe studentët gjatë gjithë ciklit të mobilitetit (para nisjes, gjatë realizimit dhe pas kthimit), garanton zbatimin e rregulloreve përkatëse dhe kontribuon në monitorimin dhe raportimin institucional të treguesve të mobilitetit (**E.23.:** fq. 90–99; **E.168**).

Universiteti "Ismail Qemali" inkurajon dhe mbështet përfshirjen e personelit akademik në veprimtari mësimdhënieje dhe kërkimi shkencor për periudha afatshkurtra (1–3 muaj) në institucione partnere të vendeve të BE-së, OECD-së dhe G20-s, kryesisht përmes programeve Erasmus+ International Credit Mobility (ICM) dhe marrëveshjeve ndërinstitucionale. Për këtë qëllim, universiteti zbaton një Rregullore të posaçme për Erasmus+ ICM, e cila përbën praktikë të mirë për menaxhimin dhe mbështetjen e mobiliteteve akademike (**E.12**).

Të dhënat e raportuara në raportet vjetore institucionale dëshmojnë se niveli i përfshirjes së personelit akademik në mobilitete afatshkurtra është në përputhje dhe mbi pragun orientues prej 10% të përcaktuar nga standardi. Mobilitetet e realizuara gjatë tre viteve të fundit paraqiten në Tabelën më poshtë.

Mobilitete të realizuara në 3 vitet e fundit

	Studentë		Staf akademik		Staf Administrativ	
Viti akademik	*Dalës*	*Hyrës*	*Dalës*	*Hyrës*	*Dalës*	*Hyrës*
2024-2025	22	6	101	53	22	29
2023-2024	13	9	65	42	45	26
2022-2023	44	7	110	56	35	37
Total	**79**	**22**	**276**	**151**	**102**	**92**

Burimi: Database e SMJ

Institucioni mbështet aktivisht edhe mobilitetin e studentëve përmes një rrjeti të gjerë marrëveshjesh ndërinstitucionale (IIA) aktive dhe mekanizmave transparentë të informimit, aplikimit dhe përzgjedhjes, të administruara nga SMJ në bashkëpunim me njësitë akademike (**E.82; E.83).**

Si rezultat, raporti mesatar i mobilitetit studentor rezulton rreth 1 në 13 studentë, duke dëshmuar se më shumë se 5% e studentëve kanë mundësi reale për të realizuar një mobilitet Erasmus+ gjatë një cikli studimi, me njohje të plotë akademike të rezultateve.

Në funksion të rritjes së mobilitetit hyrës, UV ka ndërtuar dhe zbaton një kuadër të qartë rregullator për pranimin dhe integrimin e studentëve të huaj dhe të diasporës shqiptare, përfshirë institucionalizimin e regjistrimit të studentëve incoming Erasmus+ (Vendim Rektorati nr. 16/2024), miratimin e Rregullores për studentët ndërkombëtarë (**E.13**) dhe rezervimin e kuotave të posaçme për studentët nga trojet shqiptare.

Paralelisht, universiteti ka zgjeruar ofertën akademike në gjuhë të huaj, siç pasqyrohet në listën publike *uni-vlora-courses-in-english-language-2023-2024.pdf*, si dhe përmes hapjes së programeve të studimit plotësisht në gjuhën angleze, të publikuara gjithashtu në faqen zyrtare të universitetit: https://univlora.edu.al/programet-nderkombetare. Këto programe përfshijnë:

- BSc in Architecture Sciences for Heritage
- BSc in Computer Engineering
- BSc in English Language
- MSc in Translation and Interpreting
- MSc in Teaching in CLAB
- MSc in Maritime Environment Protection and Management – MEP&M

Zgjerimi i ofertës akademike në gjuhë të huaj ka krijuar kushte reale për tërheqjen e studentëve ndërkombëtarë dhe rritjen e mobilitetit hyrës.

Në mbështetje të këtij kuadri, universiteti ka hartuar dhe publikuar Incoming Students Guide, dokument i cili përditësohet në mënyrë të vazhdueshme dhe ofron informacion të strukturuar për të gjithë ciklin e mobilitetit, nga aplikimi dhe regjistrimi deri te integrimi akademik dhe përfundimi i qëndrimit në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë. Ky udhëzues kontribuon në rritjen e transparencës procedurale dhe në përmirësimin e cilësisë së përvojës studentore dhe gjendet i publikuar gjithashtu në faqen zyrtare të universitetit:
https://ld.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2023/01/nderkombtarizimi_2023.pdf

Niveli i mobiliteteve ndërkombëtare të UV-së është vlerësuar edhe nga tregues të jashtëm të njohur ndërkombëtarisht, si:

- pajisja me Erasmus Charter for Higher Education (ECHE) 2021–2027 (https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/02/Erasmus-Charter-for-Higher-Education-awared-to-University-of-Vlora.pdf),
- renditja nr. 1 në botë për "Student Mobility and Openness" sipas WURI Ranking 2024 (https://www.wuri.world/_files/ugd/8e5131_bb90c24bf4354b40b7821b877661a03a.pdf, fq.4)

WURI 2024: Student Mobility and Openness (A2) Top 100

Rank	Name	Rank	Name
1	University of Vlora "Ismail Qemali"	26	University of Bonn
2	University of Vienna	27	Faculty of Dentistry, Universitas Gadjah Mada
3	Daffodil International University	28	Deggendorf Institute of Technology
4	Rajshahi University of Engineering and Technology	29	Universidad Tecnológica Centroamericana UNITEC
5	University of Liberal Arts Bangladesh	30	CHRIST (Deemed to be University)
6	University of Health Sciences	31	Lovely Professional University
7	University of Mostar	32	Telkom University
8	Hayek Global College	33	LSPR Institute of Communication and Business
9	National University of Management	34	Universitas Teknokrat Indonesia
10	Shanghai Jiao Tong University	35	Politecnico di Milano
11	Badr University in Cairo	36	Nagoya University
12	Dalian Neusoft University of Information	37	Hebrew University of Jerusalem
13	Westlake University	38	Tokyo International University
14	Peking University	39	Hokkaido University
15	University of Chemistry and Technology, Prague	40	The University of Tokyo
16	The University of the South Pacific	41	METAVERSE UNIVERSAL COLLEGE (MVUC)
17	China Europe International Business School (CEIBS)	42	Universiti Kebangsaan Malaysia (UKM)
18	Xi'an Jiaotong University	43	University of Amsterdam
19	University of Cologne	44	Norwegian University of Science and Technology
20	LMU Munich	45	University of Oslo
21	Technical University of Munich	46	Fatima Jinnah Medical University
22	Chitkara University, Punjab	47	Khwaja Fareed University of Engineering and Information Technology, Rahimyar Khan, Pakistan
23	University of Split	48	Sir Syed University of Engineering and Technology
24	University of Münster	49	Superior University
25	West Bengal National University of Juridical Sciences (WBNUJS/NUJS)	50	Fatima Jinnah Women University

Institucioni mbështet gjithashtu pjesëmarrjen aktive të studentëve të ciklit të dytë dhe të tretë në evente ndërkombëtare shkencore, përmes mbulimit të shpenzimeve, përfshirjes në projekte kërkimore dhe nxitjes së pjesëmarrjes në konferenca, shkolla verore dhe workshop-e ndërkombëtare.
Në këtë kuadër, janë të dokumentuara raste konkrete të përfshirjes së studentëve në aktivitete ndërkombëtare të financuara nga projekte me fonde të huaja, si projekti KnowHub, ku 15 studentë të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë morën pjesë në aktivitete trajnuese dhe workshop-e pranë University of Girona (Spanjë), si dhe projekti INTEC, në kuadër të të cilit 3 studentë të UV-së morën pjesë në workshop-e të organizuara në universitete partnere në Mal të Zi.

Workshopi ndërkombëtar *"Tourism Business Ideas for Vlora District"*, 14 janar 2026, në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Shkencave të Aplikuara, Kempten
https://univlora.edu.al/njoftime/workshop-i-studenteve-te-fe
'13th ASECU Youth International Conference and Summer School' 02.09.2024, në Universitetin 'Ismail Qemali' Vlorë.
https://univlora.edu.al/njoftime/13th-asecu-youth-international-conference-and-summer-school

Gjithashtu, janë evidentuar raste të përfshirjes së studentëve të ciklit të dytë (Master Shkencor) në fushën e Infermierisë në aktivitete ndërkombëtare të strukturuara, përfshirë pjesëmarrjen e studentëve në formate Blended Intensive Programme (BIP) / COIL në fushën e Palliative Care, të zhvillua në bashkëpunim me Thomas More University (Belgjikë), si dhe raste të përfshirjes së studentëve dhe stafit akademik në aktivitete ndërkombëtare të strukturuara në format e-learning, përfshirë zhvillimin dhe ndjekjen e kursit ndërkombëtar **"**Adult Health Behaviour" në fushën e Infermierisë, i realizuar në bashkëpunim me Tallinn Health Care College (Estoni) dhe institucione të tjera partnere evropiane. Kursi është zhvilluar përmes platformës Moodle dhe webinareve Zoom, me pjesëmarrje aktive të pedagogëve dhe studentëve, vlerësim akademik dhe njohje me kredite ECTS, duke dëshmuar ndërkombëtarizimin e mësimdhënies dhe angazhimin real të komunitetit akademik të Universitetit "Ismail Qemali" në formate bashkëkohore dhe digjitale të arsimit të lartë (**E.169)**.

Këto përvoja kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e kompetencave kërkimore, profesionale dhe ndërkulturore të studentëve, si dhe në ndërkombëtarizimin e formimit akademik në ciklet e avancuara të studimit

Standardi IV.15 Institucioni siguron vazhdimësi dhe rritje të impaktit të tij në fushën e kërkimit shkencor/artistik.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë siguron vazhdimësi dhe rritje të qëndrueshme të impaktit të veprimtarisë së

tij kërkimore-shkencore përmes miratimit dhe zbatimit të dokumenteve strategjike afatmesme dhe afatgjata, të cilat orientojnë politikat institucionale në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit.

Në këtë kuadër, për periudhën 2017–2022, Universiteti ka zbatuar Strategjinë Institucionale 2017–2022, e cila ka shërbyer si dokument bazë orientues për zhvillimin e kërkimit shkencor, forcimin e kapaciteteve akademike, rritjen e publikimeve shkencore dhe pjesëmarrjen në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare (https://univlora.edu.al/media/dokument/strategjia-2017-2022.pdf).

Në vijimësi të kësaj qasjeje dhe në përputhje me zhvillimet e reja kombëtare dhe evropiane në fushën e kërkimit dhe inovacionit, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka miratuar Strategjinë për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin 2026–2030 (**E.34**), e cila përfaqëson një fazë të avancuar të konsolidimit institucional dhe rritjes së impaktit shkencor(https://univlora.edu.al/strategjia-e-kerkimit-shkencor-2025-2030).

Strategjia 2026–2030 bazohet në katër boshte strategjike zhvillimi:
- kërkim shkencor ndërkombëtar dhe ekselencë shkencore;
- infrastrukturë dhe kapacitete kërkimore;
- kërkim shkencor i aplikuar dhe inovacion;
- rrjete kërkimore dhe mobilitet shkencor;

duke synuar rritjen e cilësisë, dukshmërisë dhe ndikimit shoqëror të kërkimit shkencor të universitetit.

Ndryshe nga dokumentet e mëparshme strategjike, Strategjia e Zhvillimit 2026–2030 (**E.35**) vendos theks të veçantë në:
- përdorimin e treguesve të matshëm të performancës (KPI);
- monitorimin dhe raportimin vjetor institucional;
- rishikimin periodik çdo dy vjet;
- lidhjen e drejtpërdrejtë të kërkimit shkencor me zhvillimin rajonal, politikat publike dhe inovacionin.

Ky kuadër strategjik garanton jo vetëm vazhdimësinë institucionale të politikave kërkimore, por edhe rritjen progresive të impaktit shkencor, ekonomik dhe shoqëror të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, duke e pozicionuar atë si një aktor aktiv në Hapësirën Evropiane të Kërkimit (ERA) dhe në zhvillimin e qëndrueshëm rajonal dhe kombëtar.

Kërkimi shkencor në fokus të objektivave strategjike të Universitetit 'Ismail Qemali'

Në funksion të sigurimit të koherencës ndërmjet strategjisë institucionale dhe veprimtarisë kërkimore konkrete, Universiteti ka institucionalizuar një mekanizëm vjetor formal për përcaktimin dhe miratimin e fushave prioritare të kërkimit shkencor. Ky proces garanton përfshirjen e njësive bazë, transparencën e vendimmarrjes dhe orientimin e kërkimit drejt nevojave reale akademike dhe shoqërore.

Procesi zhvillohet çdo vit në bazë të një urdhri rektori, përmes të cilit fakultetet, departamentet dhe qendrat kërkimore-shkencore ngarkohen të identifikojnë dhe propozojnë fushat dhe nënfushat prioritare të kërkimit, në përputhje me profilin e tyre akademik, kapacitetet ekzistuese dhe prioritetet institucionale.

Propozimet e njësive bazë harmonizohen me prioritetet strategjike të UV-së dhe me orientimet e Fushave dhe Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit të publikuara nga AKKSHI, duke dëshmuar koherencë të qartë ndërmjet misionit akademik, kërkimit shkencor të aplikuar dhe impaktit shoqëror. Miratimi përfundimtar i fushave prioritare realizohet çdo vit nga Senati Akademik (**E.41)**, në përputhje me *nenin 4, pika 2(a)* të Rregullores PKZHUV**(E.18).**
Fushat prioritare të miratuara shërbejnë si bazë për orientimin e projekteve kërkimore, planifikimin e financimit institucional, zhvillimin e temave të doktoraturave, si dhe forcimin e lidhjes ndërmjet kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe zhvillimit institucional.

Kërkimi shkencor në funksion të zhvillimit institucional të Universitetit 'Ismail Qemali'

Vazhdimësia e kërkimit shkencor dëshmohet qartë nga numri, shtrirja kohore dhe diversiteti tematik i projekteve kërkimore të zbatuara dhe në zbatim gjatë periudhës 2021–2025, të financuara në kuadër të:

- Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH),
- Projekteve të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH),
- Thirrjeve për Teknologji dhe Inovacion (PTI),
- financimeve të UV-së në projekte të Kërkimit-Zhvillimit https://univlora.edu.al/projekte-kombetare; https://univlora.edu.al/projekte-me-financim-nga-uv.

Këto projekte mbulojnë fusha prioritare si shkencat sociale dhe albanologjike, shëndetësia dhe shkencat mjekësore, biodiversiteti dhe mjedisi, uji dhe energjia, teknologjia, edukimi dhe inovacioni, duke dëshmuar një angazhim të qëndrueshëm institucional për zhvillimin e kërkimit të aplikuar dhe ndërdisiplinor.

Rritja e impaktit të kërkimit shkencor reflektohet edhe përmes investimeve të vazhdueshme në infrastrukturë kërkimore (Standadi IV.4*),* të cilat kanë krijuar kapacitete afatgjata për zhvillimin e studimeve shkencore, ofrimin e shërbimeve kërkimore dhe forcimin e bashkëpunimit me aktorë të tretë. Ngritja dhe modernizimi i qendrave kërkimore dhe laboratorëve të specializuar*,* veçanërisht në fushat e shëndetësisë, mjedisit dhe monitorimit detar, kanë forcuar rolin e UV-së si institucion referencë në nivel rajonal, duke garantuar përdorimin e këtyre kapaciteteve jo vetëm për kërkim shkencor, por edhe për mësimdhënie dhe shërbime ndaj komunitetit.

Në vijim të zbatimit të projekteve kërkimore dhe zhvillimore, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka prodhuar një sërë rezultatesh konkrete me impakt të drejtpërdrejtë në funksionimin institucional, kapacitetet kërkimore dhe cilësinë e mësimdhënies, ndër të cilat përfshihen:

- kabinete për mësimdhënie në distancë (projekti MEP&M);
- pajisje audio-vizive (ledwall, smartboard);
- aparaturë monitoruese për ndotjen e ajrit (projekti Zero-C);
- aparaturë për filmime nënujore (projekti MEP&M);
- ngritja e Qendrës Shkencore për Monitorimin dhe Ekologjinë Detare në Vlorë (PIKSH 2025);
- qendra simulatore për navigacion (projektet MARED, MEP&M, ZERO-C
- qendra simulatore për profesionistë shëndeti (PIKSH 2022);
- laborator virtual me pajisje printimi 3D për struktura anatomike (projekti KnowHub);
- Smart Hub (projekti SMART);
- laboratorë funksionalë (projekti SUCCESS), etj.

Përfshirja e doktorantëve në veprimtari akademike

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë siguron vazhdimësinë e kërkimit shkencor dhe zhvillimin e kapaciteteve akademike përmes integrimit aktiv të doktorantëve në veprimtaritë akademike dhe kërkimore. Doktorantët përfshihen në mënyrë të strukturuar në mësimdhënie, projekte kërkimore, publikime shkencore dhe aktivitete praktike, me synim ndërtimin e brezit të ardhshëm të personelit akademik dhe rinovimin e burimeve njerëzore të institucionit.

Ky proces rregullohet dhe monitorohet përmes neni 8 i Rregullores së Studimeve të Doktoraturës (**E.170)**, dhe dokumentohet përmes raporteve të ecurisë vjetore, orareve mësimore dhe evidencave të pjesëmarrjes në projekte dhe publikime (**E.171:** Raporte të ecurisë vjetore të studentëve doktorantë). Shembuj konkretë përfshijnë:

- doktorant A. Lula – projekt PKKZH "Onomastika e Lumit të Vlorës";
- doktorant S. Alizoti – projekt PKZHUV "Ngritja e klubit të velës 'Ismail Qemali'";
- doktorantët I. Cani, F. Dhimitri, J. Lapaj, S. Alizoti – të angazhuar në mësimdhënie sipas ngarkesës së miratuar, etj.

Këto praktika dëshmojnë angazhimin institucional të UV-së për përfshirjen aktive të doktorantëve në jetën akademike dhe kërkimore, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor dhe në garantimin e vazhdimësisë së burimeve njerëzore akademike.

Bashkëpunimi ndërinstitucional me fokus rritjen e reputacionit të UV-së dhe rritjen e kapaciteteve të personelit.

Politikat e bashkëpunimit me institucione brenda dhe jashtë vendit përbëjnë një element thelbësor në rritjen e impaktit shkencor dhe reputacionit institucional të UV-së. Një tregues i qartë i këtij bashkëpunimi është edhe angazhimi i personelit akademik të UV-së në struktura këshillimore, panele ekspertësh dhe projekte kërkimore të organizatave ndërkombëtare, si Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO), International Agency for Research on Cancer (IARC), Komisioni Europian dhe organizata të tjera të rëndësishme ndërkombëtare. Këto angazhime, të realizuara mbi bazë kriteresh rigoroze profesionale dhe shkencore, kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve të personelit akademik, transferimin e njohurive dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, si dhe në forcimin e reputacionit institucional të UV-së në nivel rajonal, europian dhe global (**E.172:** Çertifikime ekspert në Organizata Ndërkombëtare Prof. asoc. F.Kamberi**).**

Paralelisht, UV investon në mënyrë të vazhdueshme në rritjen e kapaciteteve të stafit akademik për aplikim dhe menaxhim projektesh kërkimore, përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe aktivitete informuese të organizuara nga AKKSHI si dhe në kuadër të programeve evropiane, përfshirë Horizon Europe, EIT:

- https://univlora.edu.al/njoftime/programet-nderkombetare-te-kerkimit-dhe-inovacionit
- https://univlora.edu.al/njoftime/trajnimi-rajonal-per-menaxhimin-e-qendrueshem-te-projekteve-ne-kuader-te-erasmus-suprom-wp3)
- https://www.instagram.com/p/DHgEn5LtyW3/

Këto aktivitete trajnuese kontribuojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së aplikimeve, rritjen e shkallës së ndërkombëtarizimit të kërkimit dhe konsolidimin e kapaciteteve njerëzore të universitetit në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit.

UV demonstron angazhim të qëndrueshëm në mbështetjen dhe nxitjen e kërkimit shkencor përmes sigurimit të fondeve institucionale të dedikuara për njësitë bazë akademike dhe Qendrat e Kërkimit Shkencor (QKSH). Në kuadër të projekteve PKZHUV, UV ka rritur mbështetjen financiarve për njësitë bazë dhe QKSH, duke reflektuar prioritetin institucional për zhvillimin e kapaciteteve kërkimore dhe realizimin e aktiviteteve kërkimore-shkencore. Konkretisht, fondi i planifikuar për çdo njësië bazë në buxhetin vjetor është rritur nga 800,000 ALL në vitin e kaluar, në 1,000,000 ALL për njësitë bazë në buxhetin e vitit aktual, duke krijuar kushte më të favorshme për zhvillimin e iniciativave kërkimore (VBA 22/2025; VBA 10/2026).

Vazhdimësia dhe rritja e impaktit të kërkimit shkencor mbështeten edhe financiarisht përmes buxheteve vjetore të dedikuara për rimbursimin e pjesëmarrjes në konferenca shkencore, mbështetjen e publikimeve shkencore, organizimin e aktiviteteve kërkimore dhe pagesën e orëve për shkrimin e projekteve, pavarësisht rezultatit përfundimtar të aplikimeve. Kjo qasje institucionale garanton angazhim të vazhdueshëm të stafit akademik në kërkim shkencor dhe kontribuon në ndërtimin e një kulture kërkimi të qëndrueshme dhe motivuese (Standardi IV.3*).*

Si rezultat i zbatimit të qëndrueshëm të këtyre politikave dhe instrumenteve, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë ka siguruar rritje të dukshme të kapaciteteve njerëzore, infrastrukturore dhe institucionale në fushën e kërkimit shkencor, duke forcuar grupet kërkimore, duke rritur prodhimin shkencor cilësor dhe duke konsoliduar rolin e tij si aktor aktiv në zhvillimin shkencor dhe inovativ në nivel rajonal dhe kombëtar.

Standardi IV.16 Institucioni siguron transferimin e rezultateve të veprimtarive kërkimore e shkencore në funksion të zhvillimit të vendit, ekonomisë dhe shoqërisë.

Universiteti ‘Ismail Qemali’ siguron transferimin e rezultateve të veprimtarisë kërkimore dhe shkencore në funksion të zhvillimit ekonomik, social dhe institucional, duke e orientuar kërkimin akademik drejt aplikimit praktik, impaktit në komunitet dhe kontributit në zhvillimin lokal, rajonal dhe kombëtar. Ky orientim është i integruar në kuadrin strategjik (**E.35:** Skenari IV- UV si Qendër Zhvillimi Rajonal) dhe rregullator institucional (**E.4:** neni 122, 124; **E.1:** neni 3, pika 2(d)), ku kërkimi shkencor trajtohet si instrument zhvillimi

dhe shërbimi ndaj shoqërisë, përtej prodhimit teorik të njohurive.

Mekanizmat e UV-së për vlerësimin në mënyrë të vazhdueshme të ecurisë së rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.

UV vlerëson në mënyrë të vazhdueshme ecurinë dhe rezultatet e veprimtarisë kërkimore përmes një sistemi të strukturuar institucional, i cili përfshin monitorimin, analizën dhe raportimin periodik të projekteve kërkimore dhe rezultateve të tyre. Në nivel universiteti, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përfshin tregues të kërkimit shkencor në Raportet Vjetore Institucionale (https://univlora.edu.al/media/dokument/raport-vjetor-institucional-2024-2025.pdf fq 24-51), ndërsa Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Projekteve (SKSHP) monitoron dhe analizon projektet kërkimore në përputhje me procedurat dhe rregulloret në fuqi (**E.18:** neni 4, pika 4). Në nivel fakulteti, komitetet kërkimore dhe zëvendësdekanët për kërkimin shkencor ndjekin performancën kërkimore dhe adresojnë nevojat për përmirësim, duke garantuar një qasje të integruar dhe të vazhdueshme të vlerësimit të rezultateve, sanksionuar dhe në Rregulloren e Përgjithshme UV-së neni 23.B (**E.4:**).

Politikat promovuese të rezultateve në fushën e kërkimit shkencor; debatet, diskutimet dhe angazhimi në zbatimin e tyre në funksion të zhvillimit social-ekonomik-shkencor të vendit

Universiteti zbaton politika aktive për promovimin dhe transferimin e rezultateve të kërkimit shkencor, duke i bërë ato pjesë të debateve akademike, shkencore dhe profesionale, si dhe duke nxitur përdorimin praktik të tyre në funksion të zhvillimit social-ekonomik. Në këtë kuadër, UV organizon dhe bashkorganizon konferenca, simpoziume, forume dhe workshop-e me karakter shkencor, inovativ dhe aplikativ, ku marrin pjesë përfaqësues të institucioneve publike, biznesit, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë. Këto aktivitete shërbejnë si platforma konkrete për shkëmbim njohurish, debat shkencor dhe transferim ekspertize ku listoj disa pej tyre:

- Integration between academia and bussines https://univlora.edu.al/njoftime/universiteti-ismail-qemali-vlore-organizon-eventin-vita;
- Promovimi i përdorimit sistematik të qasjes administrative për të luftuar krimin e organizuar në Shqipëri https://univlora.edu.al/njoftime/promoting-the-systematic-use-of-the-administrative-approach-to-combat-organized-crime-in-albania
- Simpoziumi "Migracioni dhe tregu i punës" https://univlora.edu.al/njoftime/simpozium-migracioni-dhe-tregu-i-punes-sfidat-dhe-mundesite-per-zhvillim-rajonal;
- Forumi për të ardhmen e turizmit të qëndrueshëm në Vlorë https://univlora.edu.al/njoftime/forumi-per-te-ardhmen-e-turizmit-te-qendrueshem-ne-vlore

UV këshillon, orienton dhe realizon studime të aplikuara në bashkëpunim me institucione publike, biznes dhe organizata të tjera, duke kontribuar drejtpërdrejt në adresimin e nevojave reale të zhvillimit ekonomik dhe social. Gjatë viteve të fundit akademike, një numër i konsiderueshëm aktivitetesh kërkimore dhe aplikative janë zhvilluar në bashkëpunim me aktorë vendorë dhe rajonalë, duke dëshmuar orientimin e kërkimit drejt zbatimit praktik dhe përdorimit të rezultateve në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes. Në këtë kontekst, rezultate konkrete të transferimit të kërkimit shkencor përfshijnë raste si:

- Projekte të teknologjisë dhe inovacionit – 'Hartëzimi i Kompetencave SMART në Turizëm' https://univlora.edu.al/njoftime/takim-pune-i-projektit-masto-akkshi ;
- Vlora Smart City – "Promovimi i edukimit dhe indentifikimi i mangësive/nevojave në sektorin detar shqiptar" (bashkëpunim me Norwegian University of Science and Technology)
- https://univlora.edu.al/njoftime/workshop-mbi-vlora-smart-city
- Qendra inovative "Smart City Hub" https://www.facebook.com/reel/1357408735606935;
- "Intelligenza delle Mani" – bashkëpunim me Valore Italia dhe 355HUB https://univlora.edu.al/njoftime/takimi-akademik-dhe-kulturor-me-teme-intelligenza-delle-mani

ku gjetjet kërkimore janë përdorur për analiza, planifikim strategjik e mbështetje të proceseve vendimmarrëse.

Mbështetja për kërkuesit e rinj: ndërmarrje e iniciativa vetjake të zbatimit të arritjeve të kërkimit shkencor, patentave, krijimin e start-up dhe spin-off.

Mbështetja për kërkuesit e rinj në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë përbën një prioritet strategjik në kuadër të zhvillimit të kërkimit shkencor, inovacionit dhe transferimit të dijes. Në këtë kuadër, UV krijon kushte lehtësuese dhe mekanizma mbështetës për krijimin e start-up-eve dhe spin-off-eve akademike.

UV i mbështet ***start-up*** e studentëve në disa linja ndërveprimi:

- Universiteti 'Ismail Qemali' bën Lehtësuesin Start-up në dhënien e granteve nga fondi i alokuar prej Qeverisë Shqiptare për ngritjen e start-up në Rajonin e Jugut të Shqipërisë **(E.173)**. Një nga detyrat e Specialistëve të Projekteve në SKSH&P është Ndjekja e procedurave të bashkëpunimit të UV si Lehtësues në partneritetet me bizneset dhe start-up jashtë UV (**E.23:** fq.83);
- Në bashkëpunim me partnerë europianë pedagogët e UV-së mentorojnë studentët për hartimin e planeve të zhvillimit të start-up dhe sigurimin e fondeve për mbështetjen e tyre **(E.174)**
  Podcast UniVlora: Sfidat drejt inovacionit në turizëm
  https://univlora.edu.al/njoftime/pod-cast-univlora-nr-35---studentet-e-ekonomise-ndajne-pervojen-erasmus-dhe-sfidat-drejt-inovacionit-ne-turizem
  Workshopi ndërkombëtar *"Tourism Business Ideas for Vlora District"* në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Shkencave të Aplikuara, Kempten.
  https://univlora.edu.al/njoftime/workshop-i-studenteve-te-fe
- Mbështetjen publicitare në mediat sociale të UV-së për promocionin dhe rritjen e vizibilitetit të start-upeve të studentëve.
  Podcast UniVlora: Nga studentë në sipërmarrës – rrugëtimi për të ndërtuar një biznes të suksesshëm
  https://www.youtube.com/watch?v=UqKCc2n2Qb0&t=9s

Universiteti 'Ismail Qemali' ka nisur të punojë për krijimin dhe zhvillimin e ***spin-off***-eve akademike, me synim shndërrimin e rezultateve të kërkimit shkencor në produkte dhe shërbime inovative nën markën ***UniVlora***, duke nxitur transferimin e dijes, sipërmarrjen akademike dhe rritjen e ndikimit të universitetit në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.

- Qendra Kërkimore Shkencore e Shkencave të Aplikuara ka nisur bashkëpunimin me biznese italiane për testimin dhe prodhimin në laboratorët e UV të Kremrave Kozmetikë UniVlora, bazuar në bimë mjekësore të kultivuara në Rajonin e Jugut të Shqipërisë.
- Departamenti i Kimisë, UV ka nisur procedurat për prodhimin e Vajrave Esencialë UniVlora, si produkte farmakologjike dhe estetike, si zbatim praktik i Dizertacionit të pedagoges së Departamentit të Kimisë, Dr.Jonida Salihila: "Karakterizimi kimik i ekstrakteve të disa bimëve mjekësore të vendit tonë me teknika kromatografike" (https://plus-legacy.cobiss.net/cobiss/al/en/bib/2048437545) **(E.175).**

Universiteti promovon transferimin e njohurive dhe rezultateve kërkimore përmes aktiviteteve trajnuese dhe workshop-eve tematike, të cilat synojnë fuqizimin e kompetencave profesionale dhe inovative të stafit akademik, studentëve dhe aktorëve të jashtëm. Këto aktivitete përfshijnë trajnime për krijimin e sipërmarrjeve digjitale, pronësinë industriale dhe të drejtat përkatëse, edukimin financiar në bashkëpunim me sektorin bankar, aktivitete STEM, si dhe trajnime për menaxhimin e projekteve dhe përdorimin e teknologjive innovative:

- Workshop ndërkombëtar *"Tourism Business Ideas for Vlora District"* në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Shkencave të Aplikuara, Kempten.
  https://univlora.edu.al/njoftime/workshop-i-studenteve-te-fe
- V.I.T.A. – Valona Innovation Talent Activators
  https://univlora.edu.al/njoftime/universiteti-ismail-qemali-vlore-organizon-eventin-vita
- Workshop "Krijimi i sipërmarrjeve digjitale"
  https://univlora.edu.al/njoftime/-workshop-inovativ-krijimi-i-sipermarrjeve-digjitale
- Sesione trajnimi mbi pronësinë industrial
  https://univlora.edu.al/njoftime/sesion-trajnimi-te-titulluar-njohurite-mbi-pronen-industriale-dhe-te-

drejtat-qe-ato-perfshijne

- Bashkëpunime me Raiffeisen Bank Albania
  https://univlora.edu.al/evente/sesion-interaktiv-edukim-financiar-me-raiffeisen-youth

Përmes këtyre mekanizmave dhe praktikave të konsoliduara, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë dëshmon se rezultatet e kërkimit shkencor nuk mbeten në nivel teorik, por transferohen në mënyrë aktive në shoqëri, ekonomi dhe politika publike, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe në rritjen e impaktit institucional të universitetit në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar.

Standardi IV.17 Institucioni garanton pronësinë intelektuale të arritjeve dhe rezultateve në fushën e kërkimit shkencor dhe i përdor ato me qëllim zhvillimin ekonomik dhe financiar të tij.

UV garanton pronësinë intelektuale të arritjeve dhe rezultateve në fushën e kërkimit shkencor dhe i përdor ato në funksion të zhvillimit ekonomik dhe financiar të institucionit. UV ka ndërtuar dhe zbaton një kuadër të qartë rregullator dhe operacional për mbrojtjen e pronësisë intelektuale të produkteve shkencore, profesionale dhe teknologjike të zhvilluara brenda universitetit, duke përcaktuar qartë të drejtat dhe detyrimet e institucionit, stafit akademik dhe partnerëve në lidhje me përdorimin dhe shfrytëzimin e tyre (**E.17:** nenet 2-3; **E.4:** nenet 129-133; **E.7:** kreu IV; **E.11**; Kodi Etikës, neni 13 https://univlora.edu.al/media/dokument/kodi-etikes-universitetit-2013.pdf). Ky kuadër rregullator dhe praktik siguron mbrojtjen ligjore të pronësisë intelektuale, përdorimin e kontrolluar të rezultateve kërkimore dhe shfrytëzimin e tyre në funksion të zhvillimit ekonomik dhe financiar të universitetit.

UV integron në mënyrë sistematike rezultatet e kërkimit shkencor dhe zhvillimet bashkëkohore në tregun e punës përmes projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, duke i kthyer ato në kurrikula të përditësuara, module të reja mësimore, mikrokredenciale dhe formime profesionale. Kjo realizohet përmes bashkëpunimit të strukturuar me universitete europiane, institucione publike, autoritete vendore, operatorë ekonomikë dhe SME, në kuadër të programeve Erasmus+, Horizon Europe, Interreg IPA CBC, ADRION etj.

Një pasqyrë e detajuar e projekteve kombëtare dhe me financim të huaj, ku janë të angazhuara njësitë bazë, gjendet në databazën elektronike të projekteve të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë në:

- https://univlora.edu.al/projekte-nderkombetare/
- https://univlora.edu.al/projekte-kombetare/
- https://univlora.edu.al/projekte-me-financim-nga-uv

Në vijim paraqiten disa prej produkteve akademike dhe komunitare të projekteve ndërkombëtare kërkim-zhvillimore, të cilat dëshmojnë kthimin e rezultateve kërkimore në përfitime konkrete për universitetin dhe për komunitetin, si dhe orientimin e tyre drejt zhvillimit socio-ekonomik.

Produktet akademike dhe komunitare të disa prej projekteve ndërkombëtare të kërkim-zhvillimit të Universitetit 'Ismail Qemali'

Titulli i projektit	Përfitimet për UV	Produkti për institucionet komunitare
Master në Turizëm të Qëndrueshëm për Arsimin dhe Trajnimin Profesional (VET) dhe Sipërmarrje	Arsim profesional (VET) / model trajnimi Transformim digjital / AI në arsim Bashkëpunim universitet–industri	Përmirësim i punësueshmërisë dhe aftësive në turizëm të qëndrueshëm Fuqizim i SME/SEO për turizëm dixhital dhe të gjelbër
Arsimi i Lartë për Shoqëri të Qëndrueshme dhe të Fuqizuara	Kërkim shkencor i aplikuar (practice-oriented) Inovacion digjital / transformim digjital Zhvillim rajonal / qëndrueshmëri smart (zona jo-urbane)	Transferim praktikash dhe inovacion digjital në rajon Rritje e kapaciteteve lokale për zhvillim smart dhe reziliencë

Përmirësimi i cilësisë së arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor përmes lehtësimit të integrimit të Inteligjencës Artificiale në mësimdhënie, të nxënë dhe kërkim shkencor	Transformim digjital / AI në HE (teaching-learning-research) Bashkëpunim universitet–biznes–komunitet (Quadruple Helix) Kërkim shkencor (AI në kërkim)	Rritje e shërbimeve/produkteve digjitale nga bashkëpunimi me aktorë lokalë Ekosistem lokal inovacioni dhe zhvillimi socio-ekonomik
Zyrat e Ndërlidhjes Industriale (ILO) për fuqizimin e një rrjeti ndërkufitar të aftësive digjitale, sipërmarrëse dhe profesionale – ILOFORDIGITAL	Infrastrukturë / pajisje Zhvillim institucional / struktura (ILO Office) Inovacion & sipërmarrje digjitale Bashkëpunim universitet–biznes Hartim strategjish / politika zhvillimi	Shërbime ndërlidhëse universitet–biznes për inovacion dhe transferim aftësish Nxitje e sipërmarrjes digjitale dhe start-up-eve lokale
Mikro-kredenciale të bazuara në MOOC për zhvillimin profesional të mësuesve	Transformim digjital / MOOC / e-learning Ndërkombëtarizim / bashkëpunim (AL–MZ–UA + BE)	Trajnime fleksibël për mësuesit (online) me mikrokredenciale Modele kombëtare për adoptimin e mikrokredencialeve
Qendra Ndërkombëtare të Kompetencës Inxhinierike për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të lëvizshmërisë në Shqipëri dhe Mal të Zi	Modernizim kurrikule / real-problem-based learning Tranzicion i gjelbër & qëndrueshmëri Zhvillim institucional / struktura (Engineering Competence Centres) Kërkim i aplikuar / projekte të përbashkëta	Specialistë/inxhinierë me aftësi për mobilitet të qëndrueshëm Mbështetje për politika lokale dhe industri në sektorin e mobilitetit të gjelbër Ekosistem bashkëpunimi për inovacion në transport
Fuqizimi i njohurive dhe aftësive në institucionet e arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor në përgatitje për transport dhe logjistikë detare me karbon zero	Infrastrukturë / pajisje Modernizim kurrikule / materiale didaktike Tranzicion i gjelbër & dekarbonizim Kërkim i aplikuar / inovacion në sektor Zhvillim rajonal / ndikim në ekonomi	Profesionistë të kualifikuar për industrinë detare/portuale Aftësi dhe standarde për dekarbonizim/eficiencë energjetike Rritje e konkurrueshmërisë së sektorit detar në rajon
Qendra të Inovacionit SMART për zhvillimin e mendimit inovativ dhe sipërmarrës për të lehtësuar dhe zhvilluar zgjidhje të zgjuara të qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor	Infrastrukturë / pajisje (SMART Innovation Centres) Inovacion & sipërmarrje Smart Specialisation (S3) Modernizim kurrikule / module të reja Transformim digjital / online & hybrid Ndërkombëtarizim / mobilitet	Hub inovacioni për bizneset dhe start-up-et lokale Shërbime këshillimi/trajnimi për aktorët e inovacionit Ekosistem i qëndrueshëm rajonal për sipërmarrje dhe inovacion
Kultivimi i kompetencave të kujdesit shëndetësor të saktë te studentët e shkencave shëndetësore dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor nëpër Evropë — PRECISE (Kompetencat e Kujdesit Shëndetësor të Saktë në Evropë)	Shëndet publik / wellbeing Ndërkombëtarizim / rrjetëzim europian Modernizim mësimdhënie / inovacion edukativ Digjitalizim / online learning Kornizë kompetencash / standarde Kërkim / vlerësim & validim	Përmirësim i cilësisë së shërbimeve shëndetësore përmes kompetencave precize Rrjet bashkëpunimi ndërmjet profesionistëve dhe institucioneve shëndetësore Standardizim dhe materiale reference për praktika më të mira
Bashkëpunim i qëndrueshëm ndërmjet universitetit dhe ndërmarrjeve për përmirësimin e punësueshmërisë së të diplomuarve	Infrastrukturë / pajisje (Qendra "SUCCESS") Bashkëpunim universitet–biznes Platformë digjitale / networking Modernizim kurrikule / mësimdhënie praktike Punësueshmëri / treg pune Inovacion & sipërmarrje / start-up support	Fuqizim i lidhjeve universitet–biznes dhe rritje e punësimit Ofrim i praktikave dhe profileve të përshtatura për ndërmarrjet Start-up-e dhe shërbime inovative për komunitetin

Zhvillimi i një programi të përbashkët rajonal master në Mbrojtjen dhe Menaxhimin e Mjedisit Detar	Infrastrukturë / pajisje (IT; pajisje nënujore; dron; e-books) Modernizim kurrikule / program i ri master Ndërkombëtarizim / program në anglisht Tranzicion i gjelbër & qëndrueshmëri Zhvillim rajonal / Blue Economy Politika publike / integrim europian Transformim digjital / mësim në distancë	Profesionistë të rinj për sektorët publik/privat në ekonominë blu Mbështetje për institucionet në përmbushjen e standardeve mjedisore të BE Monitorim më i mirë i mjedisit detar dhe vijës bregdetare
Energjia e zgjuar për qytete të zgjuara	Infrastrukturë / pajisje Tranzicion i gjelbër & qëndrueshmëri Edukim profesional / VET Bashkëpunim universitet–biznes Politika / strategji EU Inovacion / angazhim rinor	Rritje e ndërgjegjësimit për energjinë dhe eficiencën Nisma qytetare për energji të zgjuar në komunitet Zgjidhje inovative nga të rinjtë për sfida energjetike lokale
Zhvillimi i qëndrueshëm i ekonomive blu përmes arsimit të lartë dhe inovacionit në vendet e Ballkanit Perëndimor	Infrastrukturë / pajisje Inovacion & sipërmarrje Zhvillim rajonal / Blue Economy Bashkëpunim universitet–biznes Modernizim kurrikule / program studimi	Rritje e inovacionit dhe sipërmarrjes në sektorët detarë Qendra lokale inovacioni për ekonomi blu Punësim dhe zhvillim ekonomik në zonat bregdetare
Economic growth and governance in the WB: A pathway to EU integration (WB-EU-path)"	Modernizim kurrikule (sillabuse master me fokus BE) Kërkim shkencor / studime EU Ndërkombëtarizim / rrjet akademik EU Rritje reputacioni institucional të UV	Evidencë për reforma dhe qeverisje në procesin integrues Ndërgjegjësim publik për integrimin europian Mbështetje për politika publike dhe aktorë lokalë/rajonalë
Infrastrukturë laboratorike virtuale për shëndet dhe mirëqenie	Kërkim shkencor në shëndet & mirëqenie (Living Lab) Akses transnacional + virtual në 17 infrastruktura kërkimore Trajnime dhe zhvillim kapacitetesh për staf/kërkues Transformim digjital në kërkim (të dhëna + EOSC)	Evidencë dhe metoda inovative (rehabilitim, kujdes kalimtar, aktivitete të jetës së përditshme) Transferim metodologjish Living Lab te aktorë lokalë Standardizim dhe harmonizim procesesh në shërbime komunitare

Në nivel të përmbajtjeve mësimore dhe zhvillimit të kompetencave profesionale, projekte si:

- Zero-C - https://zeroc-project.com/
- SMART- https://smartinnovationcentres.com/
- DUALBA- https://dualba.ef.uns.ac.rs/en/
- MAred - http://www.mared.ac.me/
- INTEC - https://intec.fh-joanneum.at/

kanë kontribuar në modernizimin e programeve të studimit, integrimin e moduleve të reja të orientuara drejt industrisë dhe forcimin e lidhjes midis arsimit të lartë dhe nevojave reale të tregut të punës, veçanërisht në sektorë si transporti detar, logjistika, teknologjitë e gjelbra, inovacioni dhe arsimi dual.

Paralelisht, përmes projekteve të fokusuara në zhvillimin profesional dhe format fleksibël të të nxënit, si:

- CRED4TEACH- https://cred4teach.eu/ (VSA 52/2025)

universiteti ka zhvilluar dhe ofron mikrokredenciale, trajnime dhe module të certifikuara, të bazuara në analiza nevojash dhe të dizajnuara në bashkëpunim me aktorë të arsimit, industrisë dhe politikëbërjes.

Lidhja e kërkimit me biznesin dhe zhvillimin rajonal është forcuar më tej përmes projekteve si:

- ILOFORDIGITAL https://www.sviluppoitaliamolise.com/progetto-ilofordigital/
- KNOWHUB https://www.fh-joanneum.at/en/project/knowhub/

të cilat kanë institucionalizuar mekanizma të ndërveprimit universitet–industri, qendra inovacioni dhe struktura të transferimit të njohurive.

UV garanton pronësinë intelektuale të rezultateve të kërkimit dhe inovacionit përmes një kuadri të qartë rregullator institucional. Pronësia intelektuale e publikimeve, produkteve shkencore dhe rezultateve kërkimore është e sanksionuar në Nenin 133 "Publikimet dhe Pronësia Intelektuale" në Rregulloren e UV-së (**E.4**), i cili përcakton të drejtat e autorësisë, mënyrën e përdorimit dhe mbrojtjen e rezultateve të kërkimit të realizuara nga personeli akademik dhe studentët.

Në funksion të rritjes së vizibilitetit dhe mbrojtjes së autorësisë së botimeve shkencore, UV është anëtarësuar në infrastrukturën ndërkombëtare **Crossref**, duke mundësuar pajisjen e botimeve institucionale me numër DOI dhe regjistrimin e tyre në rrjete globale të objekteve kërkimore (VSA 17/2025).

Në zbatim të këtij kuadri, UV ka formalizuar ofrimin dhe shfrytëzimin e rezultateve kërkimore dhe ekspertizës akademike ndaj palëve të treta përmes *Rregullores për shërbimet e ofruara ndaj të tretëve* (**E.11**), e cila disiplinon procedurat e ofrimit të shërbimeve, marrëdhëniet kontraktuale, tarifimin, administrimin financiar dhe shpërndarjen e të ardhurave të gjeneruara. Ky mekanizëm krijon një bazë të qëndrueshme për përdorimin ekonomik të rezultateve kërkimore dhe pronësisë intelektuale në funksion të zhvillimit ekonomik dhe financiar të universitetit sanksionuar dhe në Rregulloren financiare të UV-së (**E.7**: neni 19) si dhe vendimet e Bordit të Administrtimit për miratimin e tarifave për shërbimet ndaj të tretëve (VBA 22/2022; VBA 57/2025).

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve institucionale për menaxhimin e pronësisë intelektuale dhe patentimit, UV ka përfshirë në strukturën organizative një specialist të dedikuar për çështjet e pronësisë intelektuale dhe patentave (**E.23**: fq. 86–90). Aktualisht, shfrytëzimi ekonomik dhe financiar i rezultateve kërkimore nuk realizohet ende përmes patentave të regjistruara, pasi institucionit ndodhet në fazën e licencimit/patentimit dhe ndjekjes së procedurave për mbrojtjen ligjore të produkteve inovative. Megjithatë, Universiteti gjeneron përfitim ekonomik konkret përmes ofrimit të shërbimeve ndaj palëve të treta, të bazuara në ekspertizën akademike dhe kapacitetet kërkimore, si:

- aktivitete trajnuese LLL me mikrokredenciale me pagesë (**E.96);**
- shërbime profesionale për verifikimin e plagjiaturës për subjekte të treta (**E.78)**

Zbatimi praktik i këtij kuadri dëshmohet gjithashtu dhe përmes iniciativave konkrete si:

- Nisja e procedurave për mbrojtjen ligjore dhe patentimin e sistemit informatik UNVIMAS (**UN**iversity **VI**rtual **MA**nagement **S**ystem) gjatë vitit 2025, si praktikë e parë e dokumentuar e mbrojtjes së pronësisë intelektuale të një produkti inovativ të zhvilluar brenda institucionit (**E.77);**
- Nisja e procedurave për licencimin e shërbimeve laboratorike dhe kërkimore nga qendrat kërkimore-shkencore dhe laboratorët e universiteteve, përfshirë procedurat e akreditimit të shërbimeve në Qendrën Kërkimore Shkencore të FSHTN, në funksion të garantimit të cilësisë dhe njohjes formale të shërbimeve të ofruara ndaj të tretëve (**E.123).**
- Në kuadër të forcimit të dimensionit të tretë të universitetit – inovacionit dhe transferimit të njohurive – Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës ka konsoliduar infrastrukturën e nevojshme teknike dhe organizative për nisjen e prodhimit dhe komercializimit të produkteve me markën institucionale UniVlora, në formën e iniciativave *spin-off*. Fokusi fillestar është vendosur në zhvillimin e vajrave esenciale dhe produkteve kozmetike me bazë kërkimore, duke shfrytëzuar ekspertizën akademike dhe kapacitetet laboratorike të universitetit, si një model konkret i lidhjes së kërkimit shkencor me tregun dhe zhvillimin lokal (**E.175)**.
- Paralelisht, UniVlora Scientific Journal (https://uvjournals.univlora.edu.al/), në vijim të procesit të rritjes së cilësisë dhe ndërkombëtarizimit, synon pas indeksimit në platforma prestigjioze ndërkombëtare të aplikojë një tarifë publikimi (Article Processing Charge – APC) për artikujt e pranuar. Ky hap përbën një praktikë të zakonshme në revistat e indeksuara dhe do të kontribuojë në garantimin e qëndrueshmërisë financiare, rritjen e standardeve editoriale dhe forcimin e pozicionimit të revistës në hapësirën akademike ndërkombëtare.

Si rezultat i menaxhimit më të mirë të mbledhjes së të ardhurave dhe diversifikimit të burimeve të të ardhurave institucionale, në fund të vitit buxhetor 2025 Universiteti 'Ismail Qemali' arkëtoi mbi 10% të ardhura më tepër se viti paraardhës.

Përfundimet dhe Vlerësimi

Në përputhje me kërkesat e Standardit IV, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka ndërtuar dhe po konsolidon një kuadër funksional për kërkimin shkencor, krijimtarinë akademike dhe inovacionin, të integruar me misionin dhe strategjinë institucionale. Institucioni disponon struktura përgjegjëse, rregullore dhe mekanizma mbështetës që sigurojnë planifikimin, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e veprimtarisë kërkimore në nivel institucional dhe njësish përbërëse. Veprimtaria kërkimore zhvillohet në përputhje me parimet e etikës, lirisë akademike dhe transparencës, duke nxitur përfshirjen aktive të stafit akademik dhe kërkuesve të rinj.

Universiteti ka shënuar progres të qëndrueshëm në rritjen e prodhimit shkencor, forcimin e infrastrukturës kërkimore, zgjerimin e bashkëpunimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në orientimin e kërkimit drejt nevojave të zhvillimit ekonomik e shoqëror. Arritjet më kuptimplotë të Universitetit 'Ismail Qemali' në fushën e kërkimit dhe inovacionit, gjatë 5 vjeçarit të fundit janë:

- Partneritete me homologë të IAL ndërkombëtare: gjermane, norvegjeze, italiane etj., që orientojnë në vazhdimësi natyrën dhe standardet e kërkimit shkencor në laboratorët kërkimorë të UV-së.
- Numër i lartë pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare, kombëtare dhe financim në rritje nga UV për to. Produktet e këtyre projekteve janë prezantuar në vazhdimësi në komunitet, shoqatat e biznesit dhe qeverisjen vendore.
- Përmirësim në vazhdimësi i infrastrukturës laboratorike, me financim në rritje, të huaj dhe UV. Akreditim e licencim të laboratorëve kërkimorë.
- Ngritja e strukturave mbështetëse për Start-up studentor dhe Spin-off për produkte UniVlora. Patentim të sistemit kompiuterik të informimit UNVIMAS.
- Publikime të konsiderueshme me faktor impakti, SCOPUS dhe WoS, të cilat nëse vlerësohen për numër pedagogësh PAE, mund të përbëjnë koeficentin më të lartë të botimeve në gjithë universitetet shqiptare.
- Publikimin e UniVlora Scientific Journal, të strukturuar sipas standarteve më cilësore bashkëkohore: gjuhë angleze, indeksim DOI:, përbërje editoriale ndërkombëtare, double blind-review, detektim plagjiature me sistemin iThenticate.

Në tërësi, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë vlerësohet se i përmbush kriteret e Standardit IV në një nivel të kënaqshëm, mbi nivelin aktual të arsimit e shoqërisë shqiptare dhe në zhvillim të vazhdueshëm, duke dëshmuar angazhim të qartë institucional për rritjen e cilësisë, ndikimit dhe qëndrueshmërisë së kërkimit shkencor dhe inovacionit.

Si fusha prioritare për zhvillim të mëtejshëm në Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë identifikohen rritja e qëndrueshme e burimeve financiare për kërkimin shkencor, akreditimi dhe licencimi i gjithë laboratorëve kërkimorë, forcimi i mekanizmave të transferimit të teknologjisë, si dhe institucionalizimi i start-up-eve dhe spin-off-eve akademike. Një rëndësi e veçantë i kushtohet gjithashtu zgjerimit të partneriteteve në projekte të përbashkëta me institucione të arsimit të lartë të vendeve të OECD-së dhe përfshirjes aktive në hulumtime të bazuara në standardet europiane të kërkimit dhe inovacionit.

STANDARDI IV - PËRMBUSHET PLOTËSISHT

V – STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve.

Universiteti i Vlorës zbaton një politikë të qartë, transparente dhe të drejtë për pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve, në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi për arsimin e lartë, aktet nënligjore përkatëse, si dhe me Statutin dhe rregulloret e brendshme të institucionit. Këto politika synojnë garantimin e barazisë së mundësive, mosdiskriminimin dhe respektimin e meritës akademike për të gjithë kandidatët.

Kuadri rregullator i Universitetit të Vlorës i parashikon të detajuara procedurat për të gjitha kategoritë e studentëve që pranohen në UV: studentë të të gjitha cikleve të studimit, studentët e programeve të dyta, studentë ndërkombëtarë, studentë që kërkojnë të transferojnë studimet në UV, studentë që vijnë apo largohen për periudha të shkurtra studimi (mobilitete Erasmus hyrëse):

E.4: Rregullore e UV
neni 61 (kuotat e pranimit),
neni 68 (pranimi në ciklin I),
neni 70 (pranimi në ciklin II),
neni 76 (pranimi në ciklin III),
neni 84, pika 2,3 (pranimi në program të dytë studimi),
neni 85 (transferrimi i studimeve).

E.12 Rregullore për studentët Erasmus, kap.III

E.13 Rregullore për studentët ndërkombëtarë të UV'së, kap.II

Përveç kërkesave të përgjithshme të përcaktuara nga legjislacioni kombëtar, Universiteti i Vlorës aplikon kritere shtesë pranimi, të propozuara nga njësitë bazë dhe të miratuara nga organet kolegjiale të institucionit, në përputhje me specifikat e programeve të studimit.

E.40: Procedurë e plotë për kriteret e pranimit në programet e FSHTN: shkresa MA, vendim departamenti, relacion Sektori i Kurrikulave dhe Statistikave, vendim SA

E.39: Procedurë e plotë për kuotat e pranimit në FE: shkresa MA, vendim departamenti, relacion Sektori i Kurrikulave dhe Statistikave, vendim SA

E.176: Procedurë e plotë për përzgjedhjen e studentëve BSc në programet e FSH: shkresa MA, vendim për ngritjen, relacion IT, vendim komisioni, shkresa përcjellëse për Rektorat, QSHA.

E.177: Procedurë e plotë për përzgjedhjen e studentëve MSc në Financë: shkresa MA, aplikimet, vendim për ngritjen e komisionit, vendim komisioni, shkresa përcjellëse për Rektorat, QSHA.

E.178: Procedurë e plotë për përzgjedhjen e studentëve Doktorantë në "Doktoratë në Studime Gjuhësore, Letrare e Kulturore": shkresa MA, aplikimet, vendim për ngritjen e komisionit, vendim komisioni, shkresa përcjellëse për Rektorat, QSHA.

E.179: Procedurë e plotë për përzgjedhjen e studentëve të transferuar ne programin e studimit BSc në "Shkenca Kompjuterike": shkresa MA, aplikimet, vendim për ngritjen e komisionit, vendim komisioni, shkresa përcjellëse për Rektorat, QSHA.

E.180: Procedurë e plotë për përzgjedhjen e studentëve për program të dytë studimi në BSc në "Infermieri të Përgjithshme": shkresa MA, aplikimet, vendim për ngritjen e komisionit, vendim komisioni, shkresa përcjellëse për Rektorat, QSHA.

E.181: Procedurë e plotë për ripranimet e studentëve në programet e studimit të Ciklit të Parë në Departamentin e Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare: aplikimet, vendim për ngritjen e komisionit, vendim komisioni, shkresa përcjellëse për Rektorat,

QSHA

Studentët ndërkombëtarë të UV-së

Universiteti 'Ismail Qemali'i kushton rëndësi të veçantë mobilitetit akademik dhe shkëmbimit të studentëve përmes programeve ndërkombëtare, veçanërisht programit ERASMUS+, duke krijuar mundësi për përfitimin e përvojave akademike dhe kulturore ndërkombëtare.

E.182: Procedurë e plotë për studentët Erasmus+ hyrës

Përveç studentëve që përfitojnë nga programet Erasmus, një kategori tjetër studentësh janë edhe studentët e huaj apo shqiptarë që kanë përfunduar ose kanë vazhduar studimet në një shtet tjetër (studentët ndërkombëtarë). Viti akademik 2025-2026 ka shënuar vitin e parë historik, gjatë të cilit UV ka rregjistruar studentë ndërkombëtarë në dy programet e veta, që ofrohen në gjuhën angleze.

E.183: Procedurë e plotë për përzgjedhjen e studentëve ndërkombëtarë

E.119: Lista e studentëve të rregjistruar në BSc in Architecture Sciences for Heritage; MSc in Maritime Environment Protection and Management – MEP

Në këtë mënyrë, Universiteti i Vlorës demonstron angazhimin e tij për një proces pranimi të standardizuar, gjithëpërfshirës dhe në përputhje me kërkesat e sigurimit të cilësisë dhe akreditimit institucional.

Standardi V.2 Institucioni u ofron studentëve mbështetje nëpërmjet shërbimeve universitare për të lehtësuar ecurinë e tyre.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka ndërtuar dhe funksionalizuar një sistem të integruar shërbimesh universitare në mbështetje të studentëve, me qëllim lehtësimin e ecurisë së tyre akademike, administrative dhe sociale gjatë gjithë ciklit të studimeve (https://univlora.edu.al/studente).

A. Në aspektin akademik, studentët përfitojnë nga shërbime këshillimi dhe orientimi (Standardi V.5), të ofruara nga strukturat akademike dhe administrata përkatëse, që lidhen me regjistrimet në sekretari dhe në sistemin UNVIMAS, zgjedhjen e lëndëve, progresin akademik, si dhe informimin mbi rregulloret dhe procedurat e studimit.

   Universiteti 'Ismail Qemali' ka miratuar një numër rregullash dhe procedurash për të asistuar rrugëtimin akademik të studentëve në këtë universitet.
   Studentët kanë të sanksionuar një sërë të drejtash dhe detyrimesh gjatë jetës së tyre universitare (**E.4:** Rregullore e UV, neni 106):

   - Ndjekja e të gjitha veprimtaritë mësimore, që zhvillohen në kuadrin e programit të studimit ku studentët janë regjistruar;
   - Kërkimi i orëve suplementare konsultimesh me pedagogët e lëndëve për çfarëdolloj problemi që ka paqartësi apo kërkon mbështetje akademike;
   - Mobilitetet akademike dhe kërkimore, të ofruara nga UV;
   - Përdorimi i infrastrukturës së vënë në dispozicion nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë për realizimin e procesit mësimor, veprimtarive ekstrakurikulare dhe kërkimit shkencor;
   - Marrja pjesë në proceset e vendimmarrjes së Universitetit "Ismail Qemali"
   - E drejta për të zgjedhur dhe të zgjidhen në organet e institucionet parashikuar për studentë, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe statusin e UV-së;
   - Organizimi në këshillat e studentëve nëpërmjet të cilave bëhet përfaqësimi i tyre në organet drejtuese të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë;

- Shprehja e vlerësimeve për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit të universitetit;
- Paraqitja e kërkesave dhe ankimeve (me gojë e me shkrim) tek Drejtuesi i departamentit për vlerësimet në provime, mësimdhënien, lektorët apo efikasitetin e programeve akademike, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë rregullore;
- Kërkimi i përmirësimit të notave të marra, sipas përcaktimeve Rregulloren e UV-së;
- Përfitimi i bursëve të studimit, kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, si dhe i shpërblimeve të veçanta që administrohen nga universiteti;

Studentëve iu ofrohen mundësi të personalizuara për zgjidhjen e situatave jashtë procesit normal të studimeve:

- Sezoni i Verës, ku mund të marrin intensivisht (5-7 javë) module të prapambetura apo të humbura nga mobilitetet (**E.4:** Rregullore e UV, neni 94, pika 1)
- 2 Sezone Riprovimesh (**E.4:** neni 94, pika 1)
- Sezon plotësues përpara provimeve të diplomës, për studentët që u duhet vetëm 1-2 provime për të hyrë në diplomim (**E.4:** neni 94, pika 1)
- Mundësi për përmirësimin e notës (**E.4:** neni 101)
- Mundësi për shtyrjen e datës së provimit, në rast arsyesh madhore (**E.4:** neni 94 /11)
- Sistem shumë të qartë ankimi për vlerësimin në provime (**E.4:** neni 97)
- Mundësi për të rifilluar studimet pas periudhave të shkëputjes (**E.4:** neni 108, 109)

B. Në aspektin administrativ, universiteti ofron shërbime të strukturuara dhe të standardizuara përmes zyrave përkatëse, duke siguruar informim të vazhdueshëm, transparencë procedurale dhe asistencë për studentët në trajtimin e çështjeve administrative. Digjitalizimi i një pjese të konsiderueshme të shërbimeve ka kontribuar në përmirësimin e aksesit, reduktimin e kohës së pritjes dhe rritjen e efikasitetit në ndërveprimin student–institucion.

Udhëzime për studentët
https://univlora.edu.al/studente
Manuali i përdorimit UNVIMAS për studentë 2026
https://univlora.edu.al/media/dokument/manual-perdorimi-unvimas-student-2026.pdf
Manual përdorimi për Google classroom
https://univlora.edu.al/manuale-per-google-classroom
informacion për shërbimet për studentët
https://univlora.edu.al/fatura
shkarkimi i faturave
https://univlora.edu.al/fatura

Studentët e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë pajisen me kartën e studentit, e cila është dokument unik. Me anë të saj studentët përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara, sipas përcaktimeve nga Bashkia Vlorë.

E.4: Rregullore UV, neni 112
E.184: Shkresa e Bashkisë për kartat e studentit

Shërbimet universitare monitorohen dhe vlerësohen periodikisht nëpërmjet mekanizmave të sigurimit të brendshëm të cilësisë, përfshirë feedback-un e studentëve dhe analizën e performancës së strukturave përkatëse. Sektori i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë & Akreditimit zhvillon sondazhe periodike për Vlerësimin e Cilësisë së Shërbimeve të ofruara prej stafit ndihmës-akademike dhe administrativ të UV-së, nëpërmjet platformës UNVIMAS. Rezultatet e këtij vlerësimi publikohen në faqen zyrtare të UV-së (https://univlora.edu.al/njoftime/raport-dhe-rekomandime-per-permiresimin-e-cilesise-se-sherbimeve-administrative) dhe shërbejnë për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve

dhe përshtatjen e tyre me nevojat reale të studentëve.

Vendim SA për miratimin e formatit të Pyetësorit të Studentëve
https://univlora.edu.al/media/dokument/vsa97-2020.pdf
Pyetësorë të Vlerësimit të Cilësisë së Shërbimeve të ofruara prej stafit ndihmës-akademike dhe administrativ të UV-së
https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-rezultateve-te-pyetesoreve-te-studenteve-2024-2025

Në përfundim, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ofron shërbime universitare të strukturuara, funksionale dhe të orientuara drejt studentit, të cilat kontribuojnë në lehtësimin e ecurisë akademike, administrative dhe sociale të studentëve dhe në përmirësimin e përvojës së tyre universitare.

Standardi V.3 Institucioni përdor sistem efikas informimi për studentët.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka ndërtuar dhe funksionalizuar një sistem të integruar dhe efikas informimi për studentët, i cili synon garantimin e aksesit të barabartë, transparencës dhe komunikimit të vazhdueshëm gjatë gjithë ciklit të studimeve. Ky sistem informimi përfshin një kombinim të kanaleve tradicionale dhe digjitale, të koordinuara në nivel institucional, dhe është i orientuar drejt nevojave reale të studentëve, duke kontribuar drejtpërdrejt në lehtësimin e ecurisë akademike dhe administrative të tyre.

Kanalet tradicionale të komunikimit në UV përfshijnë:

- Komunikimin me sekretarinë mësimore (**E.4:** Rregullore UV, neni 118, 120)
- Komunikimin me këshilltarin akademik të fakultetit (**E.4:** Rregullore UV, neni 111)
- Komunikimin me pedagogët e lëndës (**E.4:** Rregullore UV, neni 38, 1,3,6,7, 10, 9)
- Komunikimin me Specialistët e Shërbimeve ndaj Studentit (**E.23:** Specialisti i Shërbimeve të Studentit fq.159-161)

Informimi i studentëve realizohet që në ditën e parë të regjistrimit, përmes aktiviteteve prezantuese dhe orientuese, të cilat kanë për qëllim njohjen e tyre me organizimin e universitetit, programet e studimit, shërbimet dhe rregullat institucionale. Gjatë javës së parë të vitit akademik organizohen takime informuese me strukturat përkatëse, përfshirë edhe shërbimin e teknologjisë së informacionit (IT), ku studentët njihen me sistemet elektronike të universitetit, mënyrën e përdorimit të platformave digjitale dhe kanalet zyrtare të komunikimit.

E.4: Rregullore UV, neni 111
E.185: Organizimi dhe informimi i studentëve ditën e parë të shkollës.
Udhëzime pë studentët
https://univlora.edu.al/studente
Njoftim për takim informues për studentët e vitit të parë
https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0FL36nHNk1XriZaYVmCgYU78tvn9L1nNnbH75oG4CJgCCfjhTQFv9BpXv18zSKRvhl&id=100080334315032
https://univlora.edu.al/njoftime/njoftim-per-studentet-e-vitit-te-pare--finance-dhe-kontabilitet

Pedagogët, në fillim të çdo semestri, informojnë studentët në mënyrë të strukturuar mbi programin e lëndës, objektivat e të nxënit, metodologjinë e mësimdhënies, format e vlerësimit dhe literaturën bazë dhe ndihmëse. Ky informacion shërben si bazë për organizimin e punës së studentit dhe për një ndjekje më efektive të lëndës.
Pedagogët orientojnë studentët për bandën e pyetjeve të tezës përpara provimeve, ofrojnë konsultime përpara riprovimeve, sipas kërkesës së studentëve, ofrojnë transparencë maksimale në vlerësimin e studentëve. Pas çdo provimi të pjeshëm apo final:

- Studentëve iu vihet në dispozicion testi i tyre, bashkë me vlerësimin e bërë prej pedagogut
- Studentët sqarohen sipas kërkesës, për arsyet e vlerësimit dhe krahasohen përgjigjet e tyre me kërkesat e literaturës.
- Në rast mosdakortësie, studentit i sqarohet procedura e ankimimit të rezultatit.

E.4: Rregullore UV, neni 38, 1,3,6,7, 10, 9
E.4: Rregullore UV, neni 97

Në funksion të këtij sistemi, në Universitetin e Vlorës funksionojnë struktura të këshillimit akademik, ndërsa në secilin fakultet ekzistojnë zyrat e studentit, të cilat shërbejnë si pika kryesore informimi dhe orientimi për studentët. Këto struktura ofrojnë asistencë për çështje që lidhen me programet e studimit, procedurat akademike dhe administrative, si dhe me shërbimet universitare, duke kontribuar në një komunikim të drejtpërdrejtë dhe të organizuar.

E.23: Specialisti i Shërbimeve të Studentit fq.159-161

Specialistët e Shërbimeve ndaj Studentit në çdo fakultet:

1. Asistojnë dhe këshillojnë studentin për përfitimin e bursave dhe kredive studentore, organizimeve studentore etj.
2. Udhëzojnë studentët aktualë dhe të ardhshëm për mundësitë e mbështetjeve financiare të studimeve në UV, mbështesin studentët gjatë procesit të aplikimit, njoftojnë dhe udhëzojnë studentët për mundësitë e përkrahje financiare.
3. Shërbejnë si pikë referimi për informim të studentëve bachelor dhe master mbi kërkesat dhe pyetjet e tyre, si dhe këshillojnë studentët e ardhshëm dhe të tanishëm mbi politikat e universitetit për kushtet e pranimit e regjistrimit. Rregjistrojnë kerkesat e studentëve përsa i përket programeve studimore, progresit akademik dhe planifikimit të karrierës dhe i adresojnë për zgjidhje tek këshilltarët akademik të departamenteve përkatës.
4. Organizojnë orientimin e studentëve të rinj, në njoftimin me politikat dhe procedurat e studimit në UV, në bashkëpunim me këshilltarët akademikë dhe tutoriatin e studentëve. Këshillojnë studentët në procesin e aplikimit, konkurimit, regjistrimit dhe fillimit të shkollimit. Asistojnë tek ata gjatë gjithë periudhës së studimit për tu njohur me legjislacionin universitar (Ligji, Statuti, Rregulloret e programeve të studimit, Udhëzimet e MA si dhe Urdhërat e Rektorit)

Kanalet digjitale të komunikimit në UV përfshijnë:

- Faqja zyrtare e UV-së: univlora.edu.al
- Platforma kompiuterike e sistemit të brendshëm të komunikimit UNVIMAS
- Platforma kompiuterike Google classroom për UniVlorën
- Faqet e mediave sociale të UV-së dhe njësive kryesore
- Emailet institucionale @univlora.edu.al

Universiteti 'Ismail Qemali' ka si objektiv të vetin digjitalizimin e shërbimeve universitare dhe mbështetjen e studentëve (**E.35:** Linja strategjike II.2 Sistem Shërbimesh SMART, Objektivi strategjik II.2.1). Studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme përmes faqes zyrtare të Universitetit të Vlorës (https://univlora.edu.al/studente), e cila përmban informacion të përditësuar mbi programet e studimit, oraret mësimore, njoftimet akademike dhe aktivitetet institucionale, si dhe përmes Sistemit të Brendshëm të Komunikimit UNVIMAS, nëpërmjet së cilës rregjistrohen në kurset e zgjedhura prej tyre, marrin në mënyrë konfidenciale rezultatet e provimeve, komunikojnë me pedagogët dhe marrin materiale didaktike online (Standardi II.14).

E.10: Rregullore UNVIMAS, neni 24
Manual përdorimi UNVIMAS për studentët 2026
https://univlora.edu.al/media/dokument/manual-perdorimi-unvimas-student-2026.pdf
Manual përdorimi Google classroom

https://univlora.edu.al/manuale-per-google-classroom

Paralelisht, UV përdor rrjetet sociale zyrtare (Standardi V.6) si mjete shtesë komunikimi për shpërndarjen e informacionit dhe njoftimeve me interes për studentët.

Mediat sociale si kanal informimi për studentët

Njoftime për evente

Njoftim për eventin VITA
https://univlora.edu.al/njoftime/universiteti-ismail-qemali-vlore-organizon-eventin-vita
Njoftim për Ditën e Karrierrës
https://univlora.edu.al/njoftime/njoftim-per-studentet-e-fakultetit-te-ekonomise
Njoftim për Këshillin Studentor
https://univlora.edu.al/njoftime/njoftim-per-keshillin-kombetar-rinor

Pasqyrimet e aktiviteteve

Vullnetarizëm në shërbim të komunitetit
https://univlora.edu.al/njoftime/vullnetarizem-ne-sherbim-te-komunitetit-nga-keshilli-studentor
Food-party e studentëve
https://univlora.edu.al/njoftime/food-party-organizuar-me-studente-te-dgjh
Studentët e Këshillit Studentor në Kuvendin e Shqipërisë
https://univlora.edu.al/njoftime/studentet-e-univlores-ne-kuvendin-e-shqiperise
Aktiviteti i dhënies së bursave ALSAR
https://univlora.edu.al/njoftime/ceremonia-e-akordimit-te-bursave-nga-alsar
Strategjia e zhvillimit UV
https://univlora.edu.al/njoftime/strategjia-2025---2030

Njoftime për Erasmus+

https://univlora.edu.al/njoftimek/5

Njoftime për aktivitete universitare

Njoftim për paisjen me emailet universitare
https://univlora.edu.al/njoftime/njoftim-per-studentet
Njoftim për procesin mësimor
https://univlora.edu.al/njoftime/njoftim-per-anullimin-e-zhvillimit-te-procesit-mesimor-ne-datat-18-19

Në funksion të komunikimit zyrtar institucional, çdo studenti i krijohet një adresë elektronike zyrtare me formatin emër.mbiemër@univlora.edu.al, e cila shërben si kanal kryesor për dërgimin e informacionit akademik dhe administrativ.

E.4: Rregullore UNVIMAS, neni 24.1
E.23: Specialisti IT në fakultete, fq.165-167
E.186: Librezë elektronike studenti

Përdorimi i kësaj adrese garanton komunikim të strukturuar, konfidencial, të sigurt dhe të verifikueshëm ndërmjet universitetit dhe studentëve. Në këtë proces studentët asistohen nga specialistët e IT nëpër fakultete, të cilët ofrojnë mbështetje për përdoruesit e UNVIMAS si dhe për problemet teknike që ata mund të hasin gjatë përdorimit.

Përmes këtyre instrumenteve, studentët informohen në mënyrë të rregullt dhe në kohë reale mbi rregulloret akademike, procedurat administrative, oraret, njoftimet zyrtare, shërbimet universitare, aktivitetet akademike dhe mundësitë për zhvillim profesional dhe mobilitet.

Si përfundim, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë disponon dhe përdor një sistem informimi të strukturuar, funksional dhe efikas, i cili mbështet studentët në mënyrë të vazhdueshme gjatë ecurisë së tyre akademike dhe administrative.

Standardi V.4 Institucioni inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në jetën institucionale.

Universiteti 'Ismail Qemali' i Vlorës promovon dhe mbështet në mënyrë aktive përfshirjen e studentëve në jetën institucionale, duke i konsideruar ata partnerë të rëndësishëm në zhvillimin akademik, organizativ dhe shoqëror të universitetit. Universiteti njeh dhe garanton të drejtën e studentëve për t'u përfaqësuar në organet kolegjiale dhe vendimmarrëse të institucionit.

Strukturat përfaqësuese të studentëve në organet kolegjiale dhe vendimmarrëse të Universitetit 'Ismail Qemali' janë:

- Këshilli Studentor i UV-së
- Senati Akademik (2 studentë)
- Këshilli i Etikës së UV-së (1 student)
- Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (1 student)
- Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët (1 student)
- Këshilli i Etikës së Kërkimit në UV (1 student)

E.1: Statuti i UV-së, neni 74, 17, 28, 22, pika 3.a, 3.b, 5.a, 5.c
E.4: Rregullore e UV-së, neni 127, pika A.2.d
E.187: Vendimi i zgjedhjes së Këshillit studentor
E.188: Vendimi i KIZ për Senatin Akademik
Vendimi i SA për Këshillin e Etikës
https://univlora.edu.al/media/dokument/vsa5-2026.pdf
Vendimi i SA për Këshillin e Etikës në Kërkim
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/vendim-Senati-102.pdf

Në UV është ngritur dhe funksionon Këshilli Studentor (https://univlora.edu.al/keshilli-studentor), i cili ka hartuar vet Rregulloren e funksionimit të tij dhe ka patur jetë aktive me organizime të propozuara nga ata vet apo të programuara nga strukturat e Rektoratit. Këshilli Studentor ka një ambient të dedikuar për takimet dhe mbledhjet e tij, mentorohet nga Përgjegjësja e Sektorit të Karrierës, Shërbimit për Studentët & Alumnit, ka fond buxhetor të dedikuar dhe UV në vazhdimësi ka plotësuar çdo kërkesë për financimin e aktiviteteve të kërkuara prej tij.

Buxheti UV 2025 me fondin për Këshillin Studentor, fq.14, reshti i parë, shpenzime për aktivitete sociale
https://univlora.edu.al/media/dokument/vba22-2025.pdf
Rregullore e Këshillit Studentor
https://univlora.edu.al/media/dokument/rregullore-keshillit-studentor-2025.pdf
E.189: Procesverbal mbledhjeje për rizgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Studentor.
Procesverbal mbledhjeje e Këshillit Studentor
E.190: Aktivitete extrakurrikulare të propozuara dhe organizuara nga Këshilli Studentor: Kërkesa e KS dhe Raportimi i aktivitetit: "Nëntori që Flet" (Procedurë e plotë shkresore)

Studentët po ashtu marrin pjesë në komisionet ad hoc të ngritura për procedura të ndryshme institucionale, si:

- Hartimi i raportit të akreditimit institucional dhe programeve
- Hartimi (student doktorate UV) dhe diskutimi i Stategjisë së Zhvillimit të UV-së (me praninë e Këshillit Studentor)
- Komisionet ad hoc të vlerësimit të aplikimeve dhe të apelimit për përzgjedhjen e studentëve në mobilitete Erasmus+ (studenti propozohet nga kryetari i Këshillit Studentor)

E.191: *Grupe pune me pjesëmarrje studentësh:* Urdhri për grupin e punës për harimin e raportit të vetvlerësimit të brendshëm institucional të UV-së. Urdhri për grupin e punës për harimin e raportit të vetvlerësimit të programit. Urdhri për grupin e punës për harimin e Strategjisë së Zhvillimit UV 2030 (Suarti student doktorate në UV)

E.192: *Procedurë përzgjedhjeje e studenti Erasmus+ me përfshirje studentësh në vendimmarrje:* Propozimi për studentin e komisioneve Erasmus+; Shkresa e Rektorit për ngritjen e komisioneve; Vendim i firmosur i komisionit ad hoc Erasmus+

Universiteti krijon hapësira formale dhe informale për shprehjen e mendimit studentor, mbledhjen e feedback-ut dhe kontributin në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe programeve të studimit nëpërmjet:

- Pyetësorëve vjetorë të studentëve të UV-së për Cilësinë e Mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi, nëpërmjet sistemit UNVIMAS
  Raport i analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për vitin akademik 2024-2025
  https://univlora.edu.al/njoftime/raporti-i-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve-2024-2025
- Pyetësorëve të Vlerësimit të Cilësisë së Shërbimeve të ofruara prej stafit ndihmës-akademike dhe administrativ të UV-së
  Raporti i analizës së rezultateve të pyetësorëve të studentëve për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara prej stafit ndihmësakademik dhe administrativ, viti akademik 2023-2024
  https://univlora.edu.al/njoftime/raport-dhe-rekomandime-per-permiresimin-e-cilesise-se-sherbimeve-administrative

Nëpërmjet këtyre mekanizmave përfaqësues dhe pjesëmarrës, Universiteti i Vlorës krijon kushte për një rol aktiv të studentëve në jetën institucionale, duke forcuar kulturën e bashkëpunimit, transparencës dhe përfshirjes në vendimmarrje, në përputhje me standardet e sigurimit të cilësisë dhe kërkesat e akreditimit institucional.

Standardi V.5 Institucioni ndjek një politikë të orientimit dhe këshillimit të studentëve.

Institucioni zbaton një politikë të qartë dhe të strukturuar për orientimin dhe këshillimin e studentëve, me qëllim mbështetjen e tyre gjatë gjithë ciklit të studimeve, nga faza e pranimit deri në përfundimin e programit dhe integrimin në tregun e punës. Kjo politikë realizohet përmes mekanizmave institucionalë të informimit, strukturave këshilluese akademike dhe shërbimeve mbështetëse, të cilat synojnë lehtësimin e përshtatjes së studentëve me jetën universitare, orientimin e tyre akademik dhe profesional, si dhe parandalimin e vështirësive që mund të ndikojnë në ecurinë e studimeve.

Orientimi fillestar i studentëve realizohet që në ditën e parë të regjistrimit dhe të fillimit të mësimit, përmes sesioneve prezantuese dhe materialeve udhëzuese mbi:

programet e studimit

Programet: Diploma Profesionale
https://univlora.edu.al/programet/PP;
Programet: Bachelor
https://univlora.edu.al/programet/DNP;
https://univlora.edu.al/programet/PP;
Programet: Master Profesional
https://univlora.edu.al/programet/DND;
Programet: Master Shkencor

https://univlora.edu.al/programet/MSC;
Programet: Doktorale
https://univlora.edu.al/programet/PHD.
English-speaking programes
https://univlora.edu.al/programeten/JD
aktet rregullatore të brendshme dhe aktet ligjore e nënligjore
https://univlora.edu.al/legjislacioni,
të drejtat dhe detyrimet e studentëve.
E.4: Rregullore e UV, neni 106

Gjatë javës së parë të vitit akademik organizohen takime informuese me strukturat përkatëse, përfshirë edhe shërbimin e teknologjisë së informacionit (IT), ku studentët njihen me sistemet elektronike të universitetit, mënyrën e përdorimit të platformave digjitale dhe kanalet zyrtare të komunikimit.

E.185: Organizimi dhe informimi i studentëve ditën e parë të shkollës.
Takime me studentët ditën e parë të UV-së
https://univlora.edu.al/njoftime/takime-informuese-me-studentet-ne-diten-e-pare-ne-uv
https://www.facebook.com/share/p/1C8dHL7f2d/
Njoftim i Orarit mësimor për studentë e UV-së
https://www.facebook.com/share/p/1GViqQisZY/
Fletëpalosje informuese – guidë studenti
https://univlora.edu.al/njoftime/student-guide
https://univlora.edu.al/njoftime/bachelors-degrees
https://www.instagram.com/p/DUA9NUyDTs8/?igsh=eTYxbWU5MTZkbm8x
https://www.facebook.com/share/1AQ7BKzBaE/
Fletëpalosje për joint dhe double degree
https://univlora.edu.al/njoftime/joint-double-degrees
https://www.instagram.com/p/DUA69DMDUSp/?igsh=YnF1bmdrbDhxZno5
https://www.facebook.com/photo.php?fbid=937229002298235&set=pb.100080334315032.-2207520000&type=3
Fletëpalosje për programet master
https://univlora.edu.al/njoftime/masters-degrees
https://www.instagram.com/p/DUA9ZVyDcpz/?igsh=bzA4cHd6aGd2dDU5
https://www.facebook.com/photo.php?fbid=937203158967486&set=pb.100080334315032.-2207520000&type=3
Udhëzime për studentët
https://univlora.edu.al/studente
Manuali i përdorimit UNVIMAS për studentë 2026
https://univlora.edu.al/media/dokument/manual-perdorimi-unvimas-student-2026.pdf
Manual përdorimi për Google classroom
https://univlora.edu.al/manuale-per-google-classroom
Informacion për shërbimet për studentët
https://univlora.edu.al/fatura

Në vijim, këshillimi akademik ofrohet nga pedagogët këshilltarë dhe strukturat përkatëse të njësive akademike, të cilët ndihmojnë studentët në zgjedhjen e lëndëve, planifikimin e ngarkesës akademike dhe adresimin e problematikave që lidhen me procesin e të nxënit.

E.193: Vendime për emërimin e këshilltarëve akademikë

Këshillimi dhe tutoriati akademik në UV:
E.4: Rregullore e UV, neni 111

1. Pranë çdo departamenti që ofron programe mësimore funksionon Zyra e Këshilltarit Akademik të Departamentit, që është një strukturë për orientimin dhe këshillimin e studentëve nga rregjistrimi në programin mësimor deri në marrjen e liçencës për ushtrimin e profesionit.
2. Koordinatori për marrëdhëniet me studentin / Këshilltari akademik është anëtar i stafit akademik të njësisë bazë, i emëruar nga drejtuesi i njësisë bazë, për të koordinuar marrëdhëniet e departamentit me studentët çdo fillim viti akademik dhe e dërgon atë për publikim në të gjitha faqet e UV/njësisë kryesore/bazë.
3. Roli dhe misioni i udhëheqjes profesionale dhe akademike në UV është të këshillojë studentët ndërsa këta të fundit përpiqen të arrijnë qëllime akademike, synime të jetës apo të karrierës, si dhe përpilojnë plane për t'i arritur këto synime.
4. Këshilltarët akademikë të fakultetit janë në dispozicion në çdo departament për ndihmë në të kuptuarit e kërkesave të pranimit në programe të caktuara, limiteve në kuotat e pranimit, si dhe të kërkesave të UV dhe të programit të diplomimit.
5. Ndërsa studentët marrin ndihmë gjatë këshillimit orientues fillestar, ata duhen nxitur që të kërkojnë ndihmë individuale sa më herët që të jetë e mundur në programet e tyre, si dhe që nga ai moment të shkojnë e të takohen rregullisht me udhëheqësit e tyre akademikë.
6. Pas marrjes së emërimit, këshilltari akademik formon 'Grupin e Tutoriatit të Studentëve' me studentë të viteve të fundit të studimit.
7. Këshilltari akademik, bashkë me Grupin e Tutoriatit kontaktojnë me studentët që me paraqitjen e tyre për rregjistrim në sekretarinë mësimore të departamentit, në ditën e parë të fillimit të shkollës (në sallën e leksioneve) dhe në vazhdim sipas kërkesës së studentëve për këshillim.
8. Këshilltari akademik raporton tek Drejtuesi i Departamentit për mbarëvajtjen dhe problematikat e procesit.
9. Shumica e këshilltarëve akademikë takohen me studentët në mënyrë individuale nëpër orare të caktuara në marrëveshje me njëri-tjetrin, përveç periudhave të ngarkuara gjatë fillimit të sezonit të regjistrimeve, në të cilat ndihma e dhënë do të jetë më e kufizuar.

Institucioni ofron këshillim për zhvillimin personal dhe profesional të studentëve, duke i orientuar ata drejt praktikave profesionale, mundësive të punësimit, mobilitetit akademik dhe aktiviteteve jashtëkurrikulare:

Takime informuese dhe sensibilizuese me studentët e viteve të para
https://univlora.edu.al/njoftime/aktivitete-informuese-dhe-sensibilizuese-me-studentet-e-viteve-te-para-mbi-instrumentat-qe-uv-perdor-per-sigurimin-e-brendshem-te-cilesise-si-dhe-mbi-mundesite-e-shkembimit-studentor-ne-kuader-te-prog
Trajnim me Grupet e Vlerësimit të Brendshëm për fillimin e procesit të akreditimit të parë të programeve të studimit
https://univlora.edu.al/njoftime/trajnim-me-grupet-e-vleresimit-te-brendshem-per-fillimin-e-procesit-te-akreditimit-te-pare-te-programeve-te-studimit
Workshop: Studentët dhe Tregu i punës
https://univlora.edu.al/njoftime/workshop-me-teme-studentet-dhe-tregu-i-punes
https://univlora.edu.al/media/dokument/politikat-e-institucionit-per-sigurimin-e-brendshem-te-cilesise.pdf

Në Universitetin 'Ismail Qemali' funksionon Sektori i Këshillimit të Karrierës, Shërbimit ndaj Studentëve dhe Alumnit si dhe Sektori i Promocionit dhe Marrdhënieve me Publikun.

E.23: Detyrat funksionale të Sektorit të Karrierës, Shërbimit të Studentëve dhe Alumni fq.112-127

E.23: Detyrat funksionale të Sektorit të Promocionit dhe Marrdhënieve me Publikun fq.99-111

Të dy këta sektorë kanë pjesë të detyrave funksionale përhapjen, brenda dhe jashtë UV-së, të

informacionit mbi ofertën akademike, postuniversitare dhe ekstrakurrikulare të Universitetit 'Ismail Qemali':

- Zhvillimin e materialeve promovuese: Krijimi dhe koordinimi i materialeve promovuese dhe komunikatave për të informuar studentët, stafin dhe publikun e gjerë për politikat, arritjet dhe aktivitetet e institucionit.
- Konsulencën dhe orientimin për karrierën: Ofrimi i shërbimeve të konsulencës për studentët për t'i ndihmuar ata të bëjnë zgjedhje të informuara për karrierën, si dhe të kuptojnë mundësitë e mundshme në tregun e punës.
- Organizimin e aktiviteteve për zhvillimin e aftësive profesionale: Planifikimi i trajnimeve, seminareve dhe workshop-eve që ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësi të nevojshme për tregun e punës, si menaxhimi i kohës, komunikimi, të menduarit kritik dhe aftësitë e punës në grup.
- Mbështetjen në hartimin e CV-së dhe përgatitjen për intervista: Ofrimi i asistencës për përgatitjen e dokumenteve të aplikimit, si CV, letra motivimi dhe përgatitja për intervista pune.
- Organizimin e aktiviteteve të rekrutimit: Organizimi i panaireve të karrierës dhe takimeve me përfaqësues të kompanive, organizatave dhe agjencive rekrutimi për të mundësuar studentëve mundësi për të aplikuar në pozita pune, praktika dhe mundësi tjetër karriere.
- Ofrimin e mundësive për mentorim dhe këshillim: Aktivitetet për krijimin e mundësive për mentorim dhe këshillim të studentëve nga alumni, duke shfrytëzuar eksperiencën dhe njohuritë e tyre për t'i ndihmuar studentët në zhvillimin e karrierës.
- Mbështetjen për kërkimin e mundësive të financimit: Ofrimi i informacionit dhe asistencës për studentët dhe alumni për mundësitë e bursave, granteve dhe financimit për zhvillimin e karrierës.

Institucioni vë në dispozicion të studentëve dhe të të interesuarve jashtë UV-së materiale informuese të përditësuara, si broshura, guida orientuese dhe informacion në format elektronik, të cilat paraqesin programet e studimit, strukturën akademike, shërbimet në dispozicion dhe procedurat administrative. Këto materiale shpërndahen gjatë:

- aktiviteteve orientuese për punësim apo ngritje start-up,
- ditëve të hapura (UniVlora Open Days),
- takimeve informuese nëpër institucionet arsimore,
- daljeve mediatike të stafit të UV-së
- publikohen në faqen zyrtare të institucionit dhe në kanalet e komunikimit institucional.

E194: Raporte për oferta punësimi: shembuj nga FE, prezantim punësimi në banka dhe FSHTN, Departamenti i Shkencave Kompjuterike, prezantim për punësim IT
Ofertë Punësimi WIZAIR
https://univlora.edu.al/njoftime/wizz-air-ne-bashkepunim-me-univloren-organizon-nje-takim-informues-per-ti-dhene-mundesine-te-rinjve-te-aplikojne-ne-akademine-e-piloteve
https://univlora.edu.al/njoftime/takim-frymezues-me-wizz-air-pilot-academy
Green Coast Hotel (ACCOR – BALFIN Group)
https://univlora.edu.al/njoftime/-career-day-fakulteti-i-ekonomise
https://www.facebook.com/share/p/12MX8BT2Det/

Emision me Rektoren e UV-së për bilancin e vitit akademik
https://www.youtube.com/ëatch?v=d6Ar2rOpcËg
Emision me pedagogët e UV-së për ofertën akademike të UV-së
https://www.youtube.com/watch?v=EIWPIzyatMM
Emision me Rektoren e UV-së në RTSH

https://www.youtube.com/watch?v=9fwnivPdEWU
Prezantimi i Strategjisë së Zhvillimit të UV-së 2025-2030
https://www.youtube.com/watch?v=D1MAj6blhSQ
Emision: 'Zëri i studentëve'
https://www.youtube.com/watch?v=pbPtyjirNdM&list=PL1xZvVJM8wVTmljdYgVIt17tA2ta0UumE

Institucioni informon në mënyrë të vazhdueshme studentët për mundësitë e mobilitetit akademik, internshipeve, bursave dhe programeve të tjera mbështetëse, përmes strukturave përgjegjëse dhe kanaleve zyrtare të komunikimit. Krahas informimit, institucioni ofron mbështetje dhe lehtësim të procedurave të aplikimit dhe realizimit të këtyre mundësive, duke kontribuar në rritjen e përfshirjes së studentëve dhe përfitimin e eksperiencave akademike dhe profesionale.

E.4: Rregullore e UV-së, neni 115 (për përzgjedhjen e studentëve bursistë me financime jashtë UV-së)
Njoftime për mobilitetet Erasmus+ (https://univlora.edu.al/njoftimek/5)

Si përfundim, përmes bashkëpunimit ndërmjet njësive akademike, shërbimeve administrative dhe platformave digjitale të komunikimit, Universiteti 'Ismail Qemali' siguron akses të barabartë dhe të vazhdueshëm në shërbimet e orientimit dhe këshillimit.

Standardi V.6 Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta dhe aktivitete jashtëkurrikulare.

Politikat mbështetëse të UV-së për kategori të veçanta

Universiteti 'Ismail Qemali' zbaton një politikë gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse për kategori sociale të veçanta të studentëve, me qëllim garantimin e aksesit të barabartë në arsimin e lartë, përmirësimin e përvojës studentore dhe parandalimin e përjashtimit social. Kjo politikë bazohet në parimet e barazisë, mosdiskriminimit dhe përfshirjes sociale, duke u harmonizuar me kuadrin ligjor kombëtar dhe standardet ndërkombëtare për arsimin gjithëpërfshirës.

Mbështetja institucionale për kategori sociale të veçanta përfshin masa akademike, financiare, sociale dhe infrastrukturore, të cilat adresojnë nevojat e studentëve nga familje me të ardhura të ulëta, studentëve me aftësi të kufizuara, studentëve nga zona të thella apo të margjinalizuara, si dhe kategorive të tjera në nevojë.

Departamentet e UV-së planifikojnë sistematikisht kuota të posatshme për kategori të caktuara sociale në të gjitha programet e studimit.

Vendimet e SA: Kuotat për programet e studimit
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/04/Vendim-Nr.-10-Senati-Akademik-2024.pdf
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2022/02/Vendim-Senati-Nr.-5-date-02.02.2022-Per-miratimin-e-kuotave-te-pranimit-te-studenteve-ne-te-gjitha-ciklet-e-studimit-pe-2022-2023.pdf
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2021/02/Vendim-Nr.-2-Date-26.01.2021-Per-Miratimin-e-Kuotave-te-Pranimit-ne-Programet-e-Studimit-per-te-Gjitha-Ciklet-e-Studimit-per-Vitin-Akademik-2021-2022.pdf

Institucioni ndjek një politikë të qartë mbështetëse për studentët me aftësi të kufizuara, duke synuar krijimin e kushteve të përshtatshme për ndjekjen e rregullt të procesit mësimor. Në këtë kuadër, janë ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e aksesit fizik në ambientet universitare. Në godinën C dhe A janë ndërtuar rampa hyrëse, të cilat rrisin ndjeshëm

aksesueshmërinë për studentët me aftësi të kufizuara në lëvizje, duke u mundësuar atyre hyrje dhe qarkullim më të lehtë në ambientet e institucionit. Përveç masave infrastrukturore, institucioni ka përcaktuar edhe masa organizative për lehtësimin e ndjekjes së mësimit. Në rastet kur në programet e studimit ka studentë me aftësi të kufizuara, mësimi organizohet në ambiente të përshtatshme, kryesisht në katin e parë, për të shmangur pengesat fizike.

E.69: Inventar për rampa

Për studentët me aftësi të veçanta shqisore, si studentët shurdh-memecë apo studentët e verbër, stafi akademik ofron forma të përshtatura të vlerësimit të njohurive, duke zgjedhur mënyrën më të përshtatshme për secilin student. Këto masa synojnë garantimin e barazisë në vlerësim dhe respektimin e nevojave individuale, pa cënuar standardet akademike.

Institucioni zbaton politika mbështetëse për studentët që vijnë nga pakicat rome dhe ballkano-egjiptiane, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe parimet e barazisë, përfshirjes dhe mosdiskriminimit. Këta studentë përfshihen në kategoritë përfituese të masave mbështetëse financiare, si ulja apo heqja e tarifës së studimit, sipas akteve nënligjore përkatëse. Trajtimi i barabartë në proceset akademike dhe administrative kontribuon në rritjen e vazhdimësisë së studimeve dhe në uljen e braktisjes së mësimit për këto kategori studentësh.

Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për studentët që angazhohen në aktivitete sportive të niveleve të larta, duke vlerësuar rëndësinë e sportit si pjesë e zhvillimit personal dhe përfaqësimit institucional. Studentët që marrin pjesë në aktivitete sportive elitare mbështeten jo vetëm përmes promovimit të këtyre aktiviteteve, por edhe përmes krijimit të lehtësive të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve akademike. Me kërkesë të studentit dhe me miratimin e strukturave përkatëse akademike, përfshirë Dekanatin, studentëve u jepet mundësia të realizojnë vlerësimin e njohurive në një moment të ndryshëm nga ai i pjesës tjetër të klasës. Kjo politikë synon të sigurojë balancën ndërmjet angazhimeve sportive dhe atyre akademike, duke shmangur penalizimin e studentëve për shkak të përfaqësimit sportiv.

Bursat dhe honoraret për studentët

Universiteti 'Ismail Qemali', së bashku me Ministrinë e Arsimit ofron lehtësira në tarifat e studimit, përfitime nga skemat e bursave dhe mbështetje administrative.

- Mbështetja financiare nga Ministria e Arsimit:
  Bursa të plota për studentët ekselentë dhe kategoritë në nevojë
  Bursa të pjesshme për pjesën tjetër të studentëve
  Trajtim i veçantë financiar për studentët e programeve me prioritet kombëtar
- Mbështetje financiare nga Universiteti 'Ismail Qemali', prej Bordit të Administrimit
  Honorare për studentët fitues të konkurrimeve kombëtare
- Bursa dhe honorare për studentët e UV-së, të financuara nga palë të treta
  Fondacioni ALSAR
  Vlora Marinë
  E.4: Rregullore UV, neni 115
  E.195 Procedurë për dhënien e honorareve të studentëve fitues në konkurse ndërkombëtare
  E.196: Procedurë për përzgjedhjen e studentëve bursistë, financuar nga palë të treta

Aktivitetet ekstrakurrikulare në UV

Universiteti 'Ismail Qemali' ofron aktivitete të larmishme jashtëkurrikulare dhe përfshirje në jetën sociale universitare. Këto aktivitete propozohen gjerësisht si nga vet studentët, si nga struktura mbështetëse institucionale dhe në njësitë kryesore.

Aktivitete të propozuara nga Këshilli Studentor:

Marshim sensibilizues për Ditën e Shëndetit
https://univlora.edu.al/njoftime/dita-boterore-e-shendetit-2025

Koncert jubilare për Festën e Pavarësisë: 'Nëntori që flet'
https://univlora.edu.al/njoftime/aktivitet-festiv-nentori-qe-flet
Aktivitete ndëruniversitare
https://univlora.edu.al/njoftime/aktivitete-nderuniversitare
Vullnetarizëm në shërbim të komunitetit nga Këshilli Studentor
https://univlora.edu.al/njoftime/vullnetarizem-ne-sherbim-te-komunitetit-nga-keshilli-studentor
Organizime festive për Festat e Fundvitit
https://univlora.edu.al/njoftime/food-party-organizuar-me-studente-te-dgjh
Gëzuar Festat e Fundvitit 2025!
https://www.facebook.com/share/r/1DdRf6mRu2/

Aktivitete të propozuara nga strukturat e Fakulteteve dhe Sektori i Karrierës, Studentëve dhe Alumni:

Vizitë e Këshillit Studentor në Parlamentin Shqiptar
https://univlora.edu.al/njoftime/studentet-e-univlores-ne-kuvendin-e-shqiperise
Emisione 'Zëri i Studentëve', në bashkëpunim me BLUTV
https://www.youtube.com/watch?v=pbPtyjirNdM&list=PL1xZvVJM8wVTmljdYgVIt17tA2ta0UumE
Vizitë në Shtëpinë e të Moshuarve
https://univlora.edu.al/njoftime/studentet-e-fakultetit-ekonomik-ne-qendren-ditore-te-moshuarve
Shërbime shëndetësore komunitare
https://univlora.edu.al/njoftime/vullnetarizem-ne-sherbim-te-komunitetit-nga-keshilli-studentor
Aktivitete sensibilizuese në Ditët Ndërkombëtare të Shëndetit
https://univlora.edu.al/njoftime/dita-boterore-e-shendetit-2025
Gëzuar 28-29 nëntorin 2024!
https://univlora.edu.al/njoftime/gezuar-28-dhe-29-nentor-2024
Aktivitet i Departamentit të Kimisë për 103-vjetorin e Ditës Kombëtare të Shërbimit Pyjor
https://univlora.edu.al/njoftime/aktivitet-i-departamentit-te-kimise-per-103-vjetorin-e-dites-kombetare-te-sherbimit-pyjor
"Dhuro kohë dhe dashuri"
https://univlora.edu.al/njoftime/aktivitet-festiv-dhuro-kohe-dhe-dashuri

Ceremoni diplomimi:

https://univlora.edu.al/njoftime/diplomimi-2025---fakulteti-i-shkencave-humane
https://univlora.edu.al/njoftime/diplomimi-2025---fakulteti-i-shkencave-teknike-dhe-natyrore
https://univlora.edu.al/njoftime/diplomimi-2025---fakulteti-i-shendetit
https://univlora.edu.al/njoftime/diplomimi-2025---fakulteti-i-ekonomise

Aktivitete sportive dhe rekreative:

Maratona Studentore
https://univlora.edu.al/njoftime/maratona-univlora-2025
Kampioni ndërfakultetor i futbollit
https://univlora.edu.al/njoftime/kampionati-i-futbollit-univlora
Kampioni ndërfakultetor i beachvolley
https://univlora.edu.al/njoftime/beach-volley-univlora-2025

Aktivitetet estrakurrikulare të studentëve të UV-së përfshijnë konkurrime universitare

kombëtare e mbarëkombëtare, ku studentët e UV-së kanë marr pjesë me rezultate spektakolare, si dhe organizimin e konferencave studentore. Të gjitha këto evente janë realizuar nën tutorimin e stafit akademik dhe ndihmësakademik të UV-së:

Konkursi mbarëkombëtar Law Competition (Fondacioni Halimi)
https://univlora.edu.al/njoftime/departamenti-i-drejtesise---uv-fitues-ne-university-law-competition
Konkursi kombëtar UniDebate (Ministria e Rinisë)
https://univlora.edu.al/njoftime/konkursi-kombetar-i-debatit-per-universitetin
Konkursi kombëtar Debating Economics
https://univlora.edu.al/njoftime/universiteti-i-vlores-ne-krye-te-mendimit-kritik
Konferenca studentore e Fakultetit të Shëndetit
https://univlora.edu.al/njoftime/konferenca-e-dyte-studentore-e-organizuar-nga-departamenti-i-infermierise
Konferenca studentore ndërkombëtare ASEC, e zhvilluar në UV 2024
https://univlora.edu.al/njoftime/13th-asecu-youth-international-conference-and-summer-school

E.190: Aktivitete extrakurrikulare të propozuara dhe organizuara nga Këshilli Studentor: Kërkesa e KS dhe Raportimi i aktivitetit.

E.197: Aktivitete extrakurrikulare të propozuara nga Struktura e Karrierës, Shërbimit për Studentët dhe Alumnit: Kërkesa e SKSA dhe Raportimi i aktivitetit.

E.198: Shkresë e Administratorit për transport e Akomodim për vizitën e Këshillit Studentor në Parlamentin Shqiptar. Blerje kostumesh për Koncertin 28 Nëntor

E.199: Raporte të konkurseve kombëtare universitare: Raport i Law Competition. Raport i UniDebate. Raport i Debating Economics

Marrveshja me Federatën e Sporteve
https://univlora.edu.al/media/dokument/fshsu.pdf

Universiteti i kushton vëmendje të veçantë edhe dimensionit social dhe mirëqenies së studentëve, përmes shërbimeve që synojnë krijimin e një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe nxitës për zhvillimin personal dhe social. Universiteti 'Ismail Qemali' përdor në mënyrë të strukturuar dhe të qëndrueshme platformat e mediave sociale si instrument komunikimi dhe informimi në funksion të transparencës institucionale, promovimit të veprimtarisë akademike dhe forcimit të marrëdhënies me studentët dhe komunitetin. Aktualisht UV ka funksionale 3 media sociale:

- YouTube me 121+video, 36+ podcaste UniVlora;
- Instagram me 1398+ postime dhe 2500+ ndjekës:
- Facebook me 17K ndjekës

kanali YouTube i Universitetit 'Ismail Qemali':
https://www.youtube.com/@universitetiismailqemalivlore
faqja e Instagramit e Universitetit 'Ismail Qemali':
https://www.instagram.com/uni.ismail_qemali.vlore/profilecard/?igsh=dWpjcm5zc3ZrdXAz
faqja e Facebook e Universitetit 'Ismail Qemali':
https://www.facebook.com/people/Universiteti-Ismail-Qemali-Vlor%C3%AB-Faqe-Zyrtare/100080334315032/

Përmes kanaleve zyrtare në rrjetet sociale, universiteti shpërndan informacion të përditësuar mbi programet e studimit, aktivitetet akademike, shkencore dhe kulturore, shërbimet universitare, thirrjet publike dhe mundësitë për studentët, duke garantuar akses të gjerë dhe komunikim të drejtpërdrejtë me audiencat e interesit. Menaxhimi i përmbajtjes bazohet në parime të qarta komunikimi institucional dhe etikë profesionale, duke kontribuar në rritjen e dukshmërisë së universitetit, përfshirjen aktive të studentëve në jetën universitare dhe

përmirësimin e imazhit publik të institucionit.

E.14: Rregullore për Mediat Sociale të UV-së

Në Universitetin 'Ismail Qemali' funksionon Laboratori Multi-medial Universitar (LM-UniVlora), i cili nxjerr si prodhime origjinale UniVlora:

a. Podcast UniVlora,
b. Radio universitare UniVlora,
c. Gazetë studentore online UniVlora,
d. botime UniVlora digjitale press,
e. botime UniVlora print press,

Aktualisht, në fuksion të plotë është vetëm prodhimi i Podcasteve UniVlora me 36+ episode. Pjesa më e madhe e këtyre episodeve i është dedikuar zërit të studentëve, arritjeve dhe potencialeve të tyre të spikatura. Është pregatitur ambienti i dedikuar dhe janë duke u plotësuar paisjet edhe për Radion universitare dhe Gazetën studentore.

E.15: Rregullore LMM

Podcast UniVlora

https://univlora.edu.al/laboratori-mediatik
(https://www.youtube.com/@UniversitetiIsmailQemaliVlor%C3%AB/podcasts
https://www.youtube.com/watch?v=pbPtyjirNdM&list=PL1xZvVJM8wVTmljdYgVIt17tA2ta0UumE
https://www.youtube.com/watch?v=G8NDkTldVnc&list=PL1xZvVJM8wVTmljdYgVIt17tA2ta0UumE&index=28
https://www.youtube.com/watch?v=tym6hzc2UGo&list=PL1xZvVJM8wVTmljdYgVIt17tA2ta0UumE&index=14

Në Strategjinë e Zhvillimit 2025-2030, Skenari IV: UV si Qendër Zhvillimi Rajonal është përcaktuar si prioritet strategjik **fuqizimi i rolit të studentëve**:

Linja Strategjike	Objektiva Strategjike	Masat kryesore (Veprimet)
IV.2 Edukim dhe angazhim shoqëror i studentëve	IV.2.1 Fuqizimi i rolit të studentëve në komunitet dhe në vendimmarrje	▪ Rritja e kapaciteteve të Këshillit Studentor ▪ Trajnime mbi të drejtat dhe përgjegjësitë studentore ▪ Përfshirja e studentëve në komisione dhe borde universitare
	IV.2.2 Promovimi i qytetarisë aktive dhe vullnetarizmit	▪ Program vullnetarizmi universitar për projekte shoqërore ▪ Partneritete me bashki, OJF dhe institucione kulturore ▪ Fushata sensibilizuese për kauza sociale
	IV.2.3 Zhvillimi i kompetencave qytetare, sociale dhe ndërkulturore	▪ Integrimi i moduleve për etikë, diversitet dhe kompetenca sociale në kurrikula ▪ Organizim i forumeve, debateve dhe leksioneve publike me ekspertë ▪ Krijimi i klubeve studentore tematike
	IV.2.4 Zhvillimi i medias dhe zërit studentor	▪ Gazetë, podcast dhe radio studentore ▪ Trajnime për gazetarë të rinj dhe media literacy ▪ Përfshirja e studentëve në publikime dhe prodhime mediatike

	IV.2.5 Ndërtimi i një jete kampusi social, kulturor dhe sportiv	▪ Kalendar vjetor aktiviteteve sociale, kulturore dhe sportive ▪ Klube dhe ekipe sportive universitare ▪ Evente kulturore: festivale, koncerte, ekspozita

Standardi V.7 Institucioni ofron literaturë bazë dhe ndihmëse për studentët.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë siguron literaturë bazë dhe ndihmëse për studentët në funksion të realizimit të programeve të studimit dhe arritjes së rezultateve të të nxënit, në përputhje me misionin e institucionit dhe standardet e arsimit të lartë.

Literatura bazë e programeve të studimit në UV bazohet në tre burime kryesore:

- Tekste mësimore në gjuhën shqipe, të botuara nga akademikë të IAL-ve të tjera, kryesisht në Tiranë.
- Tekste mësimore dhe Cikle leksionesh në gjuhën shqipe, të botuara nga akademikë të UV-së.
- Leksione të digjitalizuara: pdf, të rregjistruara video-audio, të pregatitura nga akademikët e UV-së. Këto leksione u përcillen studentëve nëpërmjet platformave kompiuterike të UV-së: Google classroom UniVlora dhe UNVIMAS.
  E.162: Listë tekstesh mësimore nga akademikë të IAL-ve të tjera
  E.162 Listë tekstesh mësimore nga akademikë të UV-së
  https://classroom.google.com/w/NTc3Nzc5NTkwNzcz/t/all (akces i kufizuar)

Literatura ndihmëse u rekomandohet studentëve nga burimet e mëposhtme:

- Fondi i Bibliotekës Fallaski dhe bibliotekave të njësive kryesore.
  E.125: Relacion i Sektorit të Bibliotekës & Botimeve
  E.126: Fondi bibliotekar i digjitalizuar në sistemin Cobis. Fondi i blerjes së librave dhe lista e librave të blerë. Lista e librave të dhuruar: ALSAR, Fondi Lefter Çipa.
- Bibloteka online në dispozicion të studentëve të UV-së.

Studentët informohen mbi literaturën bazë dhe ndihmëse të rekomanduar për çdo kurs, procedurat e huazimit dhe burimet alternative të informacionit nga syllabyset e lëndëve dhe lektorët gjatë orës së parë të mësimit (**E.4:** Rregullore e UV-së, neni 64, pika 6). Ky orientim kontribuon në zhvillimin e aftësive të studentëve për kërkimin dhe përdorimin efektiv të burimeve akademike, duke i mbështetur ata në procesin e studimit dhe të kërkimit shkencor

Miratimi i literaturës në dispozicion të studentëve

Institucioni garanton për studentët e tij sigurimin e teksteve mësimore bazë dhe literaturës plotësuese të nevojshme, të cilat miratohen dhe rekomandohen nga departamentet përkatëse në përputhje me programet e studimit. Çdo fillim viti akademik departamentet miratojnë listën e literaturës bazë për çdo modul, sipas syllabyseve të propozuara nga titullarët e lëndëve.

E.4: Rregullore e UV-së, neni 63, pika 4.c
E.109: Procedurë miratimin e literaturës bazë nga departamenti ..... për vitin akademik ....

Miratimi i teksteve të reja për përdorim si literaturë bazë kalon procedura të mirëpërcaktuara në Rregulloren e UV-së.

E.4: Rregullore e UV-së, neni 64
E.161: Procedurë miratimin e tekstit mësimor

Strategjia e zhvillimit të UV për digjitalizimin e literaturës

Skenari III – Lider profesional, Linja strategjike III.1 – ESCO standart ka për Objektiv strategjik III.1.1 – Modernizimin e programeve dhe kurrikulave. Njëra nga masat që do të merren për plotësimin e këtij objektivi strategjik do të jetë Ofrimi i literaturës bazë digjitale dhe qasje në bibliotekën digjitale të UV-së. Në vitin 2030 e gjithë literatura bazë e moduleve të UV-së do të ofrohet për studentët jo vetëm në formë print, por edhe në formë digjitale. Kjo qasje do të zgjidhë përfundimisht:

3. problemin e ofertës sasiore të literaturës bazë në UV,
4. problemin e përditësimit të përvitshëm të literaturës bazë, që botimi print e ngadalëson.

E.35: Strategjia UV 2025-2030, skenari III, linja strategjike III.1, objektivi strategjik III.1.1

Bibliotekat në funksion të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë

Në Universitetin 'Ismail Qemali' funksionojnë Biblioteka Qendrore 'Nermin Vlora Fallaski' dhe bibliotekat e çdo njësie kryesore. Misioni i bibliotekës është të mbështesë personelin akademik, studentët dhe kërkuesit shkencorë me literaturë mësimore e shkencore.

E.124: Rregullore e Bibliotekës UV
https://univlora.edu.al/media/dokument/rregullore-biblioteka.pdf

Bibliotekat ofrojnë mjedise të përshtatshme për studim dhe konsultim të literaturës, duke siguruar kushte të favorshme për zhvillimin e procesit të të nxënit. Shërbimet e bibliotekës vihen në dispozicion të studentëve sipas orareve të miratuara nga institucioni, të cilat bëhen publike në ambientet universitare dhe në faqen zyrtare të institucionit (https://univlora.edu.al/biblioteka).

Përdorimi i bibliotekës realizohet përmes kartelës së regjistrimit të studentit, e cila shërben për administrimin e huazimit dhe përdorimit të literaturës, duke garantuar akses të rregullt dhe të barabartë për të gjithë studentët. Studentët orientohen për mënyrën e sigurimit të literaturës së nevojshme për ndjekjen e studimeve përmes bibliotekës, stafit akademik dhe strukturave përkatëse.

Fondi bibliotekar i universitetit mbështet të gjitha njësitë akademike dhe përditësohet periodikisht në bashkëpunim me fakultetet dhe stafin akademik, duke reflektuar nevojat specifike të programeve të studimit në të tre ciklet. Pasurimi i bibliotekës bëhet çdo vit mbi bazën e kërkesave të personelit akademik dhe propozimeve të përgjegjësit të bibliotekës, me miratimin e dekanatit. Bordi i Administrimit miraton çdo vit një fond të veçantë për blerjen e literaturës shkencore në gjuhën shqipe dhe të huaj. Gjithashtu, bibliotekat e UV-së kanë marrë në vazhdimësi donacione nga palë të treta për fonde librash të veçanta:

- Fondi Lefter Çipa
- Fondi ALSAR
- Fondi Bardhosh Gaçe

Literatura e inventarizuar e biblotekave digjitalizohet në sistemin Cobis dhe arkiva digjitale e literaturës së UV-së ndodhet në dispozicion të personelit dhe studentëve në të gjithë kompiuterat publikë të UV-së.

E.4: Rregullore e UV-së, neni 137

E.126: Fondi bibliotekar i digjitalizuar në sistemin Cobis. Fondi i blerjes së librave dhe lista e librave të blerë. Lista e librave të dhuruar: ALSAR, Fondi Lefter Çipa.

Sistemi Cobiss (https://al.cobiss.net/) është një sistem katalogimi ndërkombëtar i cili shërben për katalogimin e fondit bibliotekar, lehtësimin e qasjes dhe shfrytëzimit të fondeve të bibliotekave dhe gjithashtu promovimin kombëtar dhe ndërkombëtar të punës së autorëve. Në

këtë moment UNIVLORA ka dy specialistë biblioteke në proces trajnimi për përdorimin e sistemit Cobiss dhe një fond prej 1322 titujsh të kataloguar. Në këto tituj janë edhe të gjitha botimet e autorëve të UNIVLORA, artikujt si dhe buletinet.

Përsa i përket titujve të digjitalizuar ata janë të aksesueshëm në linkun https://bibliotek.al/. Janë rreth 250 tituj të digjitalizuar, ku përfshihen koleksioni i doreshkrimeve të Lefter Cipa, si dhe titujt më të kërkuar nga studentët.

Krahas literaturës fizike, studentët kanë akses edhe në burime elektronike dhe databaza shkencore të licencuara, të cilat mbështesin procesin e studimit, kërkimin shkencor dhe përgatitjen e punimeve akademike.

Bibliotekat kryesore dixhitale falas:
https://www.jstor.org/
https://archive.org/
https://www.gutenberg.org/
https://openlibrary.org/
https://scholar.google.com/
Burime të hapura arsimore:
https://openstax.org/
https://merlot.org/merlot/
https://oercommons.org/
https://ocw.mit.edu/
Burime specifike sipas temave:
https://pmc.ncbi.nlm.nih.gov
https://arxiv.org/
https://eric.ed.gov/
https://doaj.org/
Buletinet shkencore të UV-së:
https://univlora.edu.al/buletini-shkencor
https://uvjournals.univlora.edu.al/

Disa prej Buletineve shkencore, të botuara nga UV kanë publikuar studime shkencore të studentëve të UV-së, të punuara në kuadrin e temave të diplomës apo prezantimeve në konferenca të ndryshme shkencore, të organizuara nga Universiteti 'Ismail Qemali'.

https://univlora.edu.al/media/dokument/buletini-uv-nr-8-vol-2.pdf
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/02/Buletini-Shkencor-Numer-7-Vellimi-4-Special-Edition-2024.pdf
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/Buletini-Shkencor-Konference-e-Hapur-Studentore-2017.pdf
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/Buletini-Shkencor-Buletin-Studentor-2017.pdf
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/Buletini-Shkencor-Special-Edition-Vol.-3-2023.pdf
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/Buletini-Shkencor-Special-Edition-Vol.-2-2023.pdf

Standardi V.8 Institucioni favorizon punësimin e studentëve.

Universiteti "Ismail Qemali" ndjek një politikë aktive për favorizimin e punësimit të studentëve, duke e konsideruar integrimin e tyre në tregun e punës si një tregues të rëndësishëm të cilësisë së programeve të studimit dhe efektivitetit të misionit institucional. Në këtë kuadër, universiteti ndërmerr masa të strukturuara për të mbështetur zhvillimin e aftësive profesionale dhe ndërdisiplinore të studentëve, në përputhje me kërkesat e tregut të

punës në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Një pjesë e detyrave të Strukturës së Këshillimit të karrierës, Shërbimeve për Studentët dhe Alumni, që funksionon në përbërje të UV-së, fokusohet në:

- Konsulencë dhe orientim për karrierën: Ofrimi i shërbimeve të konsulencës për studentët për t'i ndihmuar ata të bëjnë zgjedhje të informuara për karrierën, si dhe të kuptojnë mundësitë e mundshme në tregun e punës.
- Organizimi i aktiviteteve për zhvillimin e aftësive profesionale: Planifikimi i trajnimeve, seminareve dhe workshop-eve që ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësi të nevojshme për tregun e punës, si menaxhimi i kohës, komunikimi, të menduarit kritik dhe aftësitë e punës në grup.
- Mbështetje në hartimin e CV-së dhe përgatitjen për intervista: Ofrimi i asistencës për përgatitjen e dokumenteve të aplikimit, si CV, letra motivimi dhe përgatitja për intervista pune.
- Organizimi i aktiviteteve të rekrutimit: Organizimi i panaireve të karrierës dhe takimeve me përfaqësues të kompanive, organizatave dhe agjencive rekrutimi për të mundësuar studentëve mundësi për të aplikuar në pozita pune, praktika dhe mundësi tjetër karriere.
- Koordinimi i mundësive për praktika dhe punësim: Sektori është përgjegjës për krijimin dhe menaxhimin e mundësive për praktika profesionale dhe mundësi pune për studentët. Kjo përfshin krijimin e partneriteteve me kompani dhe organizata që ofrojnë mundësi për studentët.
- Mbështetje për zhvillimin e profilit profesional: Krijimi i mundësive për studentët që të zhvillojnë një profil profesional të fortë dhe të rrisin mundësitë për të gjetur mundësi pune pas diplomimit.
- Raportimi i suksesit dhe realizimeve: Mbledhja dhe analizimi i të dhënave mbi suksesin e studentëve dhe alumni në karrierë dhe përgatitjen e raporteve që mund të përdoren për të përmirësuar shërbimet dhe strategjitë e zhvillimit të karrierës.

E.23: Detyrat funksionale të Sektorit të Karrierës, Shërbimit të Studentëve dhe Alumni fq.112-127

Favorizimi i punësimit realizohet përmes përfshirjes së praktikave profesionale, stazheve dhe formave të të nxënit në vendin e punës në strukturën e programeve të studimit, si dhe përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me institucione publike, subjekte private dhe organizata profesionale. UV nxit ndërveprimin e studentëve me punëdhënës potencialë përmes aktiviteteve orientuese, panaireve të karrierës, takimeve informuese dhe prezantimeve profesionale, duke krijuar ura lidhëse ndërmjet studimeve universitare dhe tregut të punës.

Marrëveshje bashkëpunimi (MoU) me institucione publike, biznese dhe organizata private për zhvillimin e praktikave
https://univlora.edu.al/marreveshjet-me-institucionet-brenda-vendit

E.116: Plan mësimor i programeve të studimit ku parashikohen praktika profesionale

E.114: Lista e studentëve të përfshirë në praktika/stazhe (procesverbale nga spitalet, bizneset)

E.111: Raporte vlerësimi të praktikës profesionale

E.200: Feedback nga punëdhënësit për përgatitjen profesionale të të diplomuarve (urdhri i infermierit – raporti i provimit të liçencës)

Paralelisht, universiteti mbështet zhvillimin e karrierës së studentëve përmes shërbimeve të këshillimit dhe orientimit profesional, informimit mbi mundësitë e punësimit dhe trajnimeve për aftësi të transferueshme, si hartimi i CV-së, përgatitja për intervista dhe zhvillimi i kompetencave digjitale dhe sipërmarrëse.

Evidenca të aktiviteteve të këshillimit profesional (workshop-e, sesione informuese)

E.201: Materiale udhëzuese për hartimin e CV-së dhe përgatitjen për intervista

E.202: Lista pjesëmarrësish të aktiviteteve të përbashkëta: studentë dhe punëdhënës

Njoftime dhe komunikime për mundësi punësimi dhe praktika me pagesë
https://univlora.edu.al/njoftime/pozicione-vakante-pune-ne-kompanine-vibtis
https://univlora.edu.al/njoftime/takim-frymezues-me-wizz-air-pilot-academy
https://univlora.edu.al/njoftime/-career-day-fakulteti-i-ekonomise

Panaire karriere, ditë informimi, prezantime nga punëdhënës
Studentët dhe Tregu i Punës
https://univlora.edu.al/njoftime/workshop-me-teme-studentet-dhe-tregu-i-punes
https://univlora.edu.al/media/dokument/politikat-e-institucionit-per-sigurimin-e-brendshem-te-cilesise.pdf
UniVlora OpenDay
https://univlora.edu.al/njoftime/-univlora-open-day
Dita Ndërkombëtare e Bankave
https://univlora.edu.al/njoftime/aktivitet-dita-nderkombetare-e-bankave
Valona Innovation Talent Activators
https://univlora.edu.al/njoftime/universiteti-ismail-qemali-vlore-organizon-eventin-vita
Dita Ndërkombëtare e Kontabilitetit
https://univlora.edu.al/njoftime/dita-nderkombetare-e-kontabilitetit-2025
Edukim Financiar me Raiffeisen Youth
https://univlora.edu.al/njoftime/raiffeisen-bank-albania-dhe-universiteti-i-vlores-bashke-per-edukimin-financiar-te-studenteve
Perspektivë ndërkombëtare mbi sfidat ekonomike dhe menaxhimin fiskal
https://univlora.edu.al/njoftime/takim-me-z-scott-miller-ekspert-ne-politike-fiskale-dhe-zhvillim-ekonomik

Mbështetja për kërkuesit e rinj: ndërmarrje e iniciativa vetjake të zbatimit të arritjeve të kërkimit shkencor, krijimin e start-up.

UV i mbështet ***start-up*** e studentëve në disa linja ndërveprimi:

- Universiteti 'Ismail Qemali' bën Lehtësuesin Start-up në dhënien e granteve nga fondi i alokuar prej Qeverisë Shqiptare për ngritjen e start-up në Rajonin e Jugut të Shqipërisë. Një nga detyrat e Specialistëve të Projekteve në SKSH&P është Ndjekja e procedurave të bashkëpunimit të UV si Lehtësues në partneritetet me bizneset dhe start-up jashtë UV (**E.23:** fq.83).
  E.173: Çertifikata e UV-së si lehtësuese start-up. Shkresa e Rektores për mbështetjen e start-up, 2024.
- Në bashkëpunim me partnerë europianë pedagogët e UV-së mentorojnë studentët për hartimin e planeve të zhvillimit të start-up dhe sigurimin e fondeve për mbështetjen e tyre.
  Workshopi ndërkombëtar *"Tourism Business Ideas for Vlora District"* në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Shkencave të Aplikuara, Kempten.
  https://univlora.edu.al/njoftime/workshop-i-studenteve-te-fe
  Podcast UniVlora: Sfidat drejt inovacionit në turizëm
  https://univlora.edu.al/njoftime/pod-cast-univlora-nr-35---studentet-e-ekonomise-ndajne-pervojen-erasmus-dhe-sfidat-drejt-inovacionit-ne-turizem
  E.174: Relacioni i Prof.Dr. Elenica Piero: Organizimet e grupeve studentore të Fakultetit Ekonomik për hartimin e planeve të zhvillimit për ngritjen e start-upeve.
- Mbështetjen publicitare në mediat sociale të UV-së për promocionin dhe rritjen e vizibilitetit të start-upeve të studentëve.
  Podcast UniVlora: Nga studentë në sipërmarrës – rrugëtimi për të ndërtuar një biznes

të suksesshëm
https://www.youtube.com/watch?v=UqKCc2n2Qb0&t=9s

Standardi V.9 Institucioni ruan lidhje të vazhdueshme me ish-studentët e tij.

Universiteti "Ismail Qemali" i kushton rëndësi të veçantë ruajtjes dhe forcimit të lidhjeve të qëndrueshme me ish-studentët, duke i konsideruar ata një aset të rëndësishëm për zhvillimin institucional, përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit dhe rritjen e punësueshmërisë së studentëve aktualë. Në këtë kuadër, universiteti ndjek politika dhe mekanizma komunikimi që synojnë mbajtjen e kontaktit të vazhdueshëm me të diplomuarit, si dhe përfshirjen e tyre aktive në jetën akademike dhe shoqërore të institucionit.

Alumnit e diplomuar gjatë periudhës 31 vjeçarë të funksionimit të Universitetit "Ismail Qemali" janë pjesë integrale e institucionit tonë akademik si:

- Pedagogë me kohë të plotë në UV (shumë prej tyre edhe në pozicione drejtuesish)
- Pedagogë me kohë të pjesshme në UV: lektorë, seminaristë dhe monitorues e tutorë të studentëve aktualë në institucionet e praktikës
- Personel ndihmës-akademik me kohë të plotë në UV
- Stakeholders në tryezat e përbashkëta të organizuara nga UV
- Aktorë kryesorë në projektet e realizuara nga UV.

Institucioni nxit pjesëmarrjen e ish-studentëve në aktivitete akademike, profesionale dhe promovuese, si leksione të hapura, konferenca, panele diskutimi dhe takime me studentët aktualë, duke kontribuar në ndarjen e përvojave profesionale dhe forcimin e lidhjes universitet–treg pune.

Konferenca, panele diskutimi, leksione të hapura me ish-studentë të ftuar

Dita Ndërkombëtare e Kontabilitetit
https://univlora.edu.al/njoftime/dita-nderkombetare-e-kontabilitetit-2025
Dita Ndërkombëtare e Bankave
https://univlora.edu.al/njoftime/aktivitet-dita-nderkombetare-e-bankave
Leksioni i hapur nga PhD. Juljana Xhindoli dhe Dr. Juliana Cuni**:** "Informimi, Parandalimi, Mbrojtja: Qasja Europiane ndaj Kancerit të Qafës së Mitrës dhe Roli i edukimit shëndetësor"
https://univlora.edu.al/njoftime/parandalimi-qe-ka-fuqine-te-shpetoje-jete
Career Day - Fakulteti i Ekonomisë
https://univlora.edu.al/njoftime/-career-day-fakulteti-i-ekonomise
Work-shop: "Eksplorimi i strategjive për reduktimin e Burnout-it tek studentët e Fakultetit të Shëndetit"
https://univlora.edu.al/njoftime/workshop-mbi-reduktimin-e-burnout-it-tek-studentet-e-fsh

E.203: Kontributi i ish-studentëve në mentorimin e studentëve aktualë (udhëheqës praktikash)

Lidhja me ish-studentët realizohet përmes strukturave dhe kanaleve të dedikuara të komunikimit, përfshirë databaza të të diplomuarve dhe platforma digjitale të cilat shërbejnë për informimin mbi aktivitetet institucionale, mundësitë e bashkëpunimit dhe zhvillimet akademike.

Procedura për mbledhjen dhe përditësimin e kontakteve të të diplomuarve

E.204: Kërkesë ISKSH për Statistika mbi punësimin e ish-studentëve

Faqja zyrtare e UV-së ka një sektor të posatshëm, të dedikuar për alumni

(https://univlora.edu.al/alumni), në të cilin gjendet:

- Rregullorja specifike e UV-së për mbajtjen e marrdhënieve me alumnin, https://univlora.edu.al/media/dokument/92025rregullore-alumni-2025.pdf
- Databazë e përditësuar e ish-studentëve sipas programeve dhe viteve akademike
- Rrjeti Alumni UV - formulari i aplikimit të alumnit për tu rregjistruar në database-n e Alumni UV,
  shtojca 1 - Formular Regjistrimi për Alumni
  https://univlora.edu.al/media/dokument/formular-alumni.pdf
- Alumni UV të suksesshëm, etj.
  https://univlora.edu.al/alumni

Përmes një qasjeje të strukturuar dhe bashkëpunuese, institucioni synon të konsolidojë një rrjet aktiv ish-studentësh, i cili kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm dhe imazhin publik të universitetit. Në aktet rregullatore të UV-së është e përcaktuar që:

1. *Databaza e alumnit* – wshtw baza kryesore për komunikim. Ajo mbahet nga SKSSA dhe Sektori i Kurrikulës dhe Statistikave dhe duhet të përmbajë:
   - Emrin dhe kontaktet (email, telefon),
   - Informacion profesional (puna, karriera, pozicioni aktual),
   - Preferencat për mënyrën e komunikimit.
2. Universiteti obligohet të krijojë dhe mirëmbajë një platformë online të dedikuar për alumnit, e cila do të përmbajë:
   - Regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave të alumnit.
   - Forum dhe grupe diskutimi për rrjetëzim dhe bashkëpunim.
   - Njoftime për ngjarje, trajnime, punësime dhe oferta të ndryshme.
   - Seksione për mentorim dhe këshillim karriere.

   Platforma do të jetë e aksesueshme falas për të gjithë alumnit.
3. Komunikimi bëhet nëpërmjet:
   - *Email-eve* me newsletter informative, ftesa për evente, oferta trajnimesh dhe punësimi,
   - *Rrjeteve sociale* (Facebook, LinkedIn, Instagram) me grupe dhe faqe zyrtare të alumnit,
   - *Website të UV* për alumnit në faqen e universitetit, i cili përmban informacione, njoftime dhe mundësi rrjetëzimi,
   - *Takimeve dhe eventeve fizike* (konferenca, seminare, tryeza, darka për alumnit),
   - *Telefonatave dhe mesazheve* për informacione urgjente ose të rëndësishme**.**
4. Përfaqësues të alumnit mund të përfshihen në komitete apo këshilla konsultative me Universitetin.

   Rregullore Alumni, neni 7,8
   https://univlora.edu.al/media/dokument/92025rregullore-alumni-2025.pdf

E.205*: Lista Alumni:* Lista e stafit akademik PAE alumni. Lista e stafit akademik PAK alumni. Lista e stafit joakademik alumni. Lista e alumni stakehoders: prefekte, kryeinfermiere, drejtorë bankash, pozicione drejtuese. Lista e alumni në grupe pune për projekte

PAE, PAK DHE PERSONEL NDIHMESAKADEMIK
(disa prej Alumini UV)

Nr.	PAE	PAK	Personel Ndihmësakademik	Stakeholders	Alumni në grupe pune në projekte
1	Dr. Emi Malaj	Msc. Irisi Selamaj	Anisa Bozhani	Evis Allushi	Daron Tozaj Projekti MARDS
2	Dr. Ilira Pulaj	Msc. Denis Demaj	Brunilda Liço	Marjola Muhaj	Rezarta Sinanaliaj Projekti MARDS

3	Prof. As.Elmira Kushta	Dr. Lindita Liçaj	Marsela Hajnaj	Matilda Brokaj	Elenica Pjerro Projekti MARDS
4	Dr. Ndriçim Sadikaj	Msc. Nikollaq Gjika	Deliana Mino	Besmira Arapashi	Evelina Bazini Projekti PHAREM
5	Dr. Blenard Xhaferaj	Dr. Ertil Meçaj	Florina Muho	Grigor Dede	Fatjona Kamberi Projekt VITALIZE
6	Dr. Dorjana Klosi	Dr. Aulona Haxhiraj	Erdeta Breshanaj	Ermal Pekmezi	Rezarta Lalo Projekti VITALIZE
7	Dr. Enida Pulaj	Dr. Evis Alushi	Ina Metaj	Nertila Përrallaj	Rezarta Sinanaliaj Projekti TANGRAM
8	Dr. Ledina Merkaj	Msc. Odeona Veizaj	Miranda Pajo	Pranvera Resulaj	Eloina Tozaj Projekti Cred4Teach
9	Dr. Denada Selfo	Msc. Ergisa Sulejmani	Romina Tahiraj	Irena Toshkallari	Vladimir Zahaj Projekt AKKSHI
10	Dr. Oljana Hoxhaj	Msc. Semiljana Xhaferraj	Belinda Dauti	Admir Malaj	Irena Toshkallari Projekt SMART City

Në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm, institucioni mbledh dhe analizon feedback-un e ish-studentëve mbi përgatitjen akademike dhe përvojën e tyre universitare, si dhe monitoron ecurinë e punësimit të të diplomuarve. Këto të dhëna përdoren për rishikimin e programeve të studimit, forcimin e shërbimeve të karrierës dhe rritjen e relevancës së ofertës akademike të UV-së.

Raport Alumni 2025
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/05/raport-Alumni-2025.pdf
Rekomandimet e raportit Alumni 2025
https://old.univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/05/REKOMANDIMET-PYETESOR-ALUMNI.pdf

Përfundimet dhe Vlerësimi

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka ndërtuar dhe zbaton një sistem funksional shërbimesh në mbështetje të studentëve, i cili mbulon në mënyrë të integruar informimin, orientimin dhe këshillimin akademik e profesional, mbështetjen sociale, përfshirjen në jetën institucionale dhe lehtësimin e kalimit drejt tregut të punës. Këto shërbime kontribuojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e përvojës studentore dhe rritjen e suksesit akademik.

Institucioni ofron mekanizma të strukturuar informimi dhe komunikimi për studentët, përmes platformave digjitale dhe shërbimeve universitare, si dhe politika të qarta për orientimin dhe këshillimin gjatë gjithë ciklit të studimeve. Aksesi në literaturë bazë dhe ndihmëse, infrastruktura mbështetëse dhe shërbimet bibliotekare janë funksionale dhe në përputhje me nevojat e programeve të studimit.

Universiteti ka ndërmarrë masa konkrete për favorizimin e punësimit të studentëve, përmes përfshirjes së praktikave profesionale në programet e studimit, bashkëpunimit me aktorë të tregut të punës, mbështetjes së start-up-eve dhe shërbimeve të orientimit të karrierës. Gjithashtu, ruajtja e lidhjeve me ish-studentët dhe përfshirja e tyre në aktivitete akademike dhe profesionale përbën një praktikë në zhvillim, e cila kontribuon në përmirësimin e programeve të studimit dhe në rritjen e punësueshmërisë së studentëve.

Arritjet më kuptimplotë të Universitetit 'Ismail Qemali' në fushën e mbështetjes ndaj studentëve, gjatë 5 vjeçarit të fundit janë:

- Krijimi i një kuadri rregullator institucional në mbështetje të mundësive akademike të studentëve: rregjistrime ndërkombëtare, mobilitete, fleksibilitet për plan mësimor të personalizuar, sistem të qartë ankimimi rezultatesh.
- Ngritja dhe funksionimi aktiv i Këshillit Studentor, i cili ka iniciuar një numër të

konsiderueshëm aktivitetesh socio-kulturore, me përfshirje të fortë mediatike.

- Rezultate të shkëlqyera e të pakonkurrueshme në ballafaqimin me studentë të IAL-ve të tjera brenda dhe jashtë vendit.
- Zhvillimi i medias dhe zërit studentor: Podcast, gazetë, dhe radio studentore UniVlora; Përfshirja e studentëve në publikime dhe prodhime mediatike.
- Ngritja e Rrjetit Alumni UV dhe marrja e feedback-ut nga studentët dhe alumnit për cilësinë e programeve mësimore dhe shërbimeve administrative, me procedura periodike, konfidenciale dhe të institucionalizuara.

Si fusha për zhvillim të mëtejshëm në Strategjinë e Zhvillimit të UV-së evidentohen zgjerimi edhe më tej i dixhitalizimit të shërbimeve studentore dhe literaturës digjitale në dispozicion të tyre, si dhe zgjerimi i partneriteteve institucionale me tregun e punës edhe përtej rajonit të Vlorës, drejt tregut europian të punës.

STANDARDI V - PËRMBUSHET PLOTËSISHT

PËRFUNDIMET DHE VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM

Raporti i vetëvlerësimit i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dëshmon një proces të strukturuar reflektimi institucional, të bazuar në analizë kritike, evidenca konkrete dhe orientim strategjik drejt përmirësimit të vazhdueshëm. Vlerësimi në raport me pesë standardet konfirmon progres të qëndrueshëm në konsolidimin e sistemit të sigurimit të cilësisë, forcimin e kapaciteteve akademike dhe kërkimore, si dhe në rritjen e rolit të universitetit në zhvillimin rajonal e kombëtar.

Potenciali i zhvillimit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë mbështetet në një sërë pikash të forta institucionale, të cilat përbëjnë bazën e konsolidimit dhe rritjes së tij në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar:

- ❒ **Strategji Zhvillimi 2025–2030**, e strukturuar mbi objektiva të qarta, të matshme dhe të mbështetura nga instrumente konkrete implementimi dhe monitorimi.
- ❒ **Oferta akademike e diferencuar**, që përfshin programe unike në territorin e Shqipërisë, programe të ofruara tërësisht në gjuhën angleze, si dhe programe të përbashkëta me institucione evropiane të arsimit të lartë.
- ❒ **Infrastrukturë didaktike sipas standardeve bashkëkohore**, me salla audio-vizive të mirëpajisura, laboratorë mësimorë funksionalë, struktura të dedikuara për mësim online, materiale didaktike të digjitalizuara dhe kabinet të posaçëm për mësimdhënie në distancë.
- ❒ **Bashkëpunime ndërkombëtare aktive**, përmes marrëveshjeve me universitete dhe institute evropiane, si dhe integrimit progresiv në rrjete kërkimore ndërkombëtare.
- ❒ **Laboratorë kërkimorë të standardeve evropiane**, të orientuar drejt kërkimit shkencor blu dhe të gjelbër, me profil unik në kontekstin shqiptar.
- ❒ **UniVlora Scientific Journal**, si platformë e institucionalizuar për publikime shkencore, peer-reviewed, numër identifikimi DOI: dhe detektim plagjiature me sistemin Ithenticate.
- ❒ **UniVlora Institutional Repository**, që garanton akses të hapur dhe transparencë në prodhimin shkencor të stafit dhe studentëve.
- ❒ **Digjitalizim i avancuar i shërbimeve akademike dhe administrative**, duke rritur efikasitetin dhe transparencën institucionale.
- ❒ **Sistemi i menaxhimit të informacionit studentor dhe akademik (UNVIMAS)**, si një ndër sistemet e informacionit më fleksibël dhe full-option në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri.
- ❒ **Prezencë e fuqishme në median digjitale**, përmes një rrjeti aktiv në YouTube, Facebook, Instagram dhe TikTok, me informim të vazhdueshëm në kohë reale.
- ❒ **Laborator Multimedial (podcast, gazetë, radio)**, që krijon hapësira të strukturuara për zhvillimin e aftësive krijuese, komunikative dhe profesionale të studentëve.

Arritjet më kuptimplotë të Universitetit 'Ismail Qemali' gjatë 5 vjeçarit të fundit janë:

- ➢ Ngritja e një kuadri rregullator shterrues dhe një strategjie zhvillimore, që synon ta çojë performancën e UV-së drejt standarteve të një universiteti 4.0.
- ➢ Fuqizimi i aktivitetit të Sektorit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Zhvillimin e proceseve online të vlerësimeve institucionale dhe studentore për cilësinë e programeve të studimit dhe shërbimeve të ofruara nga UV dhe pasqyrimin transparent të tyre në faqen zyrtare të saj.
- ➢ Krijimi i një sërë mekanizmave mbështetës për zhvillimin e kapaciteteve të stafit akademik dhe administrativ: programe trajnuese me personel akademik shqiptar, ndërkombëtar dhe diasporë.

- Zhvillimi sinjifikativ i kapaciteteve infrastrukturore të njësive kryesore: akademike dhe kërkimore, kryesisht me financime të siguruara jashtë UV-së. Shtimi i disa laboratorëve kërkimorë dhe didaktikë. Nisja e procedurave të akreditimit të laboratorëve kërkimorë.
- Rritja e financave të grumbulluara prej institucionit, të ardhura prej rritjes së numrit të studentëve dhe zgjerimit të shërbimeve UV.
- Rikonstruksioni tërësor i faqes zyrtare të UV-së, ngritja e disa platforma të tjera plotësuese, zgjerimi i mediave online, që pasqyrojnë gjithë veprimtaritë e zhvilluara në UV.
- Patentimi i sistemit të brendshëm të informacionit UNVIMAS (UNiversity VIrtual MAnagement System).
- Zgjerim spektakolar të marrdhënieve të partneritetit me mbi 120 IAL ndërkombëtare, mbi 15 IAL mbarëkombëtare dhe mbi 50 institucione rajonale dhe kombëtare, bashkëpunimi me të cilat ka bërë të mundur rritjen e vizibiliteti dhe konkurrueshmërisë ndërkombëtare të UV-së.
- Hapja e:
  - programeve ndërkombëtare joint dhe double degree;
  - programeve në gjuhën angleze për studentë ndërkombëtarë,
  - programeve unikale në territorin e Shqipërisë: Inxhinieri Armatimi, Arkitekturë në trashëgimi, Navigacion, Inxhinieri Navale, Mbrojtje&Menaxhim i Mjedisit Detar.
  - riorganizimi i programeve me njohje automatike në BE (fusha: infermieri, arkitekturë),
  - ka nisur puna me një grup të përbashkët pune me Universitetin e Pavias për të hapur joint degree në Medicine and Surgery.
- Mësimdhënie me profesorat të përzjerë ndërkombëtarë. Studentë ndërkombëtarë, për periudha afatshkurtra dhe afatgjata. Numër i konsiderueshëm mobilitetesh, i vlerësuar edhe në klasifikime ndërkombëtare. Vendi i parë në klasifikimin WURI Ranking 2024 për "Student Mobility and Openness", fal zgjerimit të partneriteteve ndërkombëtare në programet Erasmus+.
- Rritja e numrit të studentëve të rregjistruar në UV. Rezultate të shkëlqyera e të pakonkurrueshme në ballafaqimin me studentë të IAL-ve të tjera brenda dhe jashtë vendit.
- Ofrimi i shërbimeve akademike për të tretët (programe trajnimi për mësuesit, Shkolla e Drejtorëve). Ofrimi i programeve LLL me mikrokredenciale (mësues, punonjësit e shëndetit).
- Modernizimi i teknologjive mësimdhënëse dhe rritja e orëve të praktikës profesionale në institucionet vendore. Të gjitha programet e UV-së zhvillojnë praktika profesionale në një rrjet institucionesh rajonale (Fier, Vlorë, Lushnje), nën mentorimin e ekspertëve të këtyre institucioneve.
- Partneritete me homologë të IAL ndërkombëtare: gjermane, norvegjeze, italiane etj., që orientojnë në vazhdimësi natyrën dhe standardet e kërkimit shkencor në laboratorët kërkimorë të UV-së.
- Numër i lartë pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare, kombëtare dhe financim në rritje nga UV për to. Produktet e këtyre projekteve janë prezantuar në vazhdimësi në komunitet, shoqatat e biznesit dhe qeverisjen vendore.
- Përmirësim në vazhdimësi i infrastrukturës laboratorike, me financim në rritje, të huaj dhe UV. Akreditim e licencim të laboratorëve kërkimorë.
- Ngritja e strukturave mbështetëse për Start-up studentor dhe Spin-off për produkte UniVlora. Patentim të sistemit kompiuterik të informimit UNVIMAS.
- Publikime të konsiderueshme me faktor impakti, SCOPUS dhe WoS, të cilat nëse vlerësohen për numër pedagogësh PAE, mund të përbëjnë koeficentin më të lartë të botimeve në gjithë universitetet shqiptare.

- Publikimin e UniVlora Scientific Journal, të strukturuar sipas standarteve më cilësore bashkëkohore: gjuhë angleze, indeksim DOI:, përbërje editoriale ndërkombëtare, double blind-review, detektim plagjiature me sistemin iThenticate.
- Ngritja dhe funksionimi aktiv i Këshillit Studentor, i cili ka iniciuar një numër të konsiderueshëm aktivitetesh socio-kulturore, me përfshirje të fortë mediatike.
- Zhvillimi i medias dhe zërit studentor: Podcast, gazetë, dhe radio studentore UniVlora (Laboratori Multimedial); Përfshirja e studentëve në publikime dhe prodhime mediatike.
- Ngritja e Rrjetit Alumni UV dhe marrja e feedback-ut nga studentët dhe alumnit për cilësinë e programeve mësimore dhe shërbimeve administrative, me procedura periodike, konfidenciale dhe të institucionalizuara.

Instrumentet kryesore që i japin përparësi Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës në kontekstin e hapësirës së arsimit të lartë kombëtar përfshijnë:

- ✓ planifikimin strategjik të strukturuar,
- ✓ sistemet e brendshme të sigurimit të cilësisë,
- ✓ platformën institucionale të publikimeve shkencore,
- ✓ orientimin drejt inovacionit dhe spin-off,
- ✓ lidhjen e drejtpërdrejtë me zhvillimin rajonal dhe tregun e punës.

Si fusha për zhvillim të mëtejshëm në Strategjinë e Zhvillimit të UV-së evidentohen:

- *Akreditimi ndërkombëtar i UV-së dhe më pas përfshirja e UV-së në rankime të rëndësishme ndërkombëtare – strategji, që do të rrisë kredibilitetin e UV-së dhe do të zgjerojë hapjen e saj ndaj studentëve ndërkombëtarë.*
- *Zgjerimi i mëtejshëm i bashkëpunimeve ndërkombëtare drejt aleancave universitare*
- *Investime të qëndrueshme në kërkimin shkencor, inovacionin dhe partneritetet me sektorin publik dhe privat.*
- *Rritja në vazhdimësi e numrit të programeve të ofruara në gjuhën angleze*
- *Modernizimi në vazhdimësi i programeve dhe kurrikulave (Universitet 4.0):*
- *Rritja e qëndrueshme e burimeve financiare për kërkimin shkencor,*
- *Akreditimi dhe licencimi i gjithë laboratorëve kërkimorë, forcimi i mekanizmave të transferimit të teknologjisë,*
- *Institucionalizimi i start-up-eve dhe spin-off-eve akademike.*
- *Zgjerimit të partneriteteve në projekte të përbashkëta me institucione të arsimit të lartë të vendeve të OECD-së*
- *Zgjerimi edhe më tej i dixhitalizimit të shërbimeve studentore dhe literaturës digjitale në dispozicion të tyre,*
- *Zgjerimi i partneriteteve institucionale me tregun e punës edhe përtej rajonit të Vlorës, drejt tregut europian të punës.*

Vlerësimi i përgjithshëm

Në tërësi, Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës paraqet një institucion në zhvillim të qëndrueshëm, me një qasje të qartë strategjike dhe me kapacitete në rritje për përmbushjen e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë. Procesi i vetëvlerësimit ka evidentuar jo vetëm arritjet, por edhe fushat e planifikuara strategjikisht për zhvillim të mëtejshëm, duke reflektuar një kulturë institucionale të orientuar drejt transparencës, reflektimit kritik dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

Universiteti mbetet i angazhuar në konsolidimin e standardeve të cilësisë, në rritjen e konkurrueshmërisë akademike dhe kërkimore, si dhe në forcimin e rolit të tij si institucion

publik me përgjegjësi shoqërore dhe vizion afatgjatë zhvillimi drejt standarteve të një Universiteti 4.0.

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë i PËRMBUSH PLOTËSISHT standartet e të gjitha fushave të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë në Shqipëri.

LISTA E EVIDENCAVE MBËSHTETËSE TË UV-SË

E.1: Statuti i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë
E.2: Statuti UV 2019
E.3: Vendimi për miratimin e strukturës organizative të UV-së (organigramë institucionale). Vendimi i Senatit Akademik për miratimin/ndryshimin e Statutit. Vendimi i Bordit të Administrimit për miratimin/ndryshimin e Statutit. Miratimi i Statutit UV nga MA
E.4: Rregullorja e përgjithshme e UV-së
E.5: Rregullorja e funksionimit të SA
E.6: Vendime për emërimin e drejtuesve akademikë (dekanë, zëvendësdekanë, përgjegjës departamenti), sipas procedurave statutore.
E.7: Rregullore financiare e UV-së
E.8: Rregullore e funksionimit të Bordit të Administrimit të UV-së
E.9: Rregullore për krijimin dhe rregjistrimin e dokumentave
E.10: Rregullore UNVIMAS
E.11: Rregullore për shërbimet ndaj të tretëve
E.12: Rregullore Erasmus+
E.13: Rregullore për studentët ndërkombëtarë
E.14: Rregullore për mediat sociale të UV-së
E.15: Rregullore për Laboratorin Multimedial UniVlora
E.16: Rregullore e Revistave Shkencore të UV-së
E.17: Rregulloren e Etikës së Kërkimit Shkencor dhe Publikimit në UV
E.18: Rregullore për projektet PKZHUV
E.19: Rregullore për organizimin e zgjedhjeve në UV-së
E.20: Rregullore për akordimin e titullit Profesor Emeritus
E.21: Rregullore për përdorimin e programeve kompiuterike për detektimin e plagjiaturës
E.22: Udhëzues etik për AI në UV-së
E.23: Detyrat funksionale të strukturës së brendshme të UV-së
E.24: Ngritja dhe funksionimi i Këshillit të Etikës: VSA për Këshillin e Etikës, Procedurë vendimmarrjeje e KE
E.25: Ngritja dhe funksionimi i BA: Shkresa e MA për ngritjen e BA, Vendim SA për ngritjen e BA., Administrator.
E.26: Procedurë aprovimi Buxheti vjetor: Kërkesat buxhetore departament, fakultet, rektorat; Shkresa e Administratorit për SA dhe BA, VSA për buxhetin, VBA për buxhetin, shkrese MA.
E.27: Urdhra dhe udhëzime të Rektorit, që synojnë përmirësimin e eficiencës në administrim.
E.28: Planet strategjike të sektorëve institucionalë të UV-së, me objektiva të qarta menaxheriale: SSBCA.
E.29: Planet strategjike të sektorëve institucionalë të UV-së, me objektiva të qarta menaxheriale: SKSA.
E.30: Dokumentacion mbi përdorimin e platformave elektronike për shërbimet ndaj studentëve dhe stafit: student, pedagog, SSBCA, Zyra e studentit
E.31: Formulari i Vlerësimit të Performancës, i miratuar nga SA.Vlerësim performance.
E.32: Strategjia mbi barazinë gjinore në Universitetin 'Ismail Qemali',
E.33: Strategjia mbi ndërkombëtarizimin në Universitetin 'Ismail Qemali',
E.34: Strategjia mbi kërkimin shkencor në Universitetin 'Ismail Qemali',
E.35: Strategjia e Zhvillimit të UV-së 2025-2030

E.36: Strategjia e Zhvillimit të UV-së 2018-2024
E.37: Procedura e miratimit të Strategjisë UV 2025-2030
E.38: Procedurë e plotë miratimi programi: Bsc në "Computer engineering"
E.39: Procedurë miratim kuotash Fakulteti Ekonomik
E.40: Procedurë e plotë kritere pranimi 2026-2027 në UV
E.41: Procedurë prioritetesh strategjike të kërkimit shkencor me mbledhje departamenti i Shkencave Kompjuterike deri në SA
E.42: Procedurë e ndryshimit të pozicionit të specialistes në laborante tek QKSH, FSHTN
E.43: Aprovimi i MA për procedurat e ndjekura nga UV: Miratim programesh nga MA, Miratimi i Statutit dhe Organigramës UV .
E.44: Emaile me njoftimin e axhendës dhe materialeve për diskutim në mbledhjet SA, BA.
E.45: Procesverbale të mbledhjeve të Senatit Akademik, ku dokumentohen diskutime dhe vendime.Procesverbale të mbledhjeve të Bordit të Administrimit, ku dokumentohen diskutime dhe vendime. Procesverbale të dekanateve dhe departamenteve, që përfshijnë diskutime mbi çështje akademike dhe organizative. Vendime dhe raportime të Këshilli të Etikës, procesverbale të mbledhjeve të Këshillit të Studentëve, ku dokumentohen diskutime dhe vendime.
E.46: Vlerësim i shërbimeve ndihmës-akademike dhe administrative prej studentëve: Vendim SA për miratimin e formatit të Pyetësorit të Vlerësimit të Cilësisë së Shërbimeve të ofruara prej stafit ndihmës-akademik të UV-së
E.47: Procedurë për dhënie dokumentash jashtë UV-së
E.48: Procedurë e riorganizimit të programit të studimit Bsc në "Infermieri e Përgjithshme"
E.49: Vendim për miratimin e Titullarëve në programet e Ciklit të dytë në DI dhe Literaturës në programin Bsc në Infermieri të Përgjithshme.
E.50: Raporte vjetore të departamenteve dhe fakulteteve me Analizën e rezultateve të provimeve dhe notave të studentëve.
E.51: Raporte akreditimi të programeve: Bsc në Teknologji Informacioni
E.52: Raporte të departamenteve mbi implementimin e rekomandimeve të dala nga vlerësimi i programeve.
E.53: Plan masa Alumni
E.54: Raport aktivitetesh SSBCA: (Takim informues mbi SSBCA me studentët e vitit të parë,Work shop Optimizimi i programeve të studimit të mësuesisë & Sfidat për një edukim cilësor afatgjatë)
E.55: Procedurë punësimi PAE, PAK, personel ndihmësakademik, personel administrativ.
E.56: Procedurë punësimi: Pedagog i ftuar, Pedagog i huaj
E.57: Komunikimi elektronik me njësitë bazë për diskutimin e rregullores së përgjithshme të UV-së.
E.58: Procedurë rimbursimi artikuj shkencore, konferenca, tituj akademik.
E.59: Ngritja e grupeve të punës për procedurat institucionale: Urdhër i Rektorit për ngritjen e grupeve të punës për akreditimin institucional; Vendime Dekani mbi ngritjen e GVB të programeve; Urdhër i Rektorit për ngritjen e grupit të punës për organizimet e 30-vjetorit të UV-së.
E.60: Komisione ad-hoc me përbërje të personelit akademik: punësimi; Erasmus+; hartime programesh të reja; pranime studentësh; ekuivalentimi modulesh.
E.61: *Vendimi i Rektoratit nr. 22, datë 24.10.2024 dhe relacion 6-mujor*, për skedën informuese. Skedë informuese për aktivitete për rritje kapacitetesh nga staf akademik; Skedë informuese për aktivitete për rritje kapacitetesh nga staf joakademik; Skedë informuese pas mobiliteteve nga staf akademik; Skedë informuese pas mobiliteteve nga staf joakademik
E.62: Regjistrimi i studentëve me kuota të veçanta.

E.63: Procesverbal per vendosjen e rampeve.
E.64: Kërkesë për punësim me analizën e ngarkesës mësimore të programeve të FSH
E.65: *Kontrata punësimi*: kontratë pune me kohë të caktuar; kontratë pune me kohë të pacaktuar.
E.66: Ngarkesa mësimore e DKSH
E.67: *Infrastruktura*, planimetria e godinave, objekte ndërtesa, akt miratimi higjeno-sanitar, çertifikatë shërbimi sanitar; plane mirëmbajtjeje dhe investime infrastrukturore; kartele pronesie; kontrate qiraje;
E.68: *Raport i Administratorit për rikonstruksion të ambienteve*. Plani buxhetor me fonde për lyerje dhe restaurim godinash; Procedurë prokurimi për kondicionerë; Kontrata dezinfektimi; Foto të shkallëve dhe sinjalistikës së emergjencës; ruajtjen e godinave.
E.69: *Paisje infrastrukturore:* Inventar gjenerator dhe depozita uji; Inventar për shkallë emergjence; Inventar për rampe; Inventar për depozita uji;
E.70: *Pajisje audiovizive dhe teknologjike për mësimdhënie*: Inventar videoprojektorësh, kompiuterash, printerash; Prokurim për smartboard, kompjutera.
E.71: *Listë pajisjesh të laboratorëve didaktikë dhe kërkimorë*: Qendra Simulatore për Profesionistët e Shëndetit, Laboratorit kërkimor të FSHTN, kabinetit të mësimdhënies në distancë; Prokurim për sallën C 500; Kërkesë për laborator FSHTN; VKM godina e Apelit;
E.72: *Foto* - Hapësira rekreative dhe sportive në ambjentet e universitetit; Hapësira parkimi; Hapësira shërbimi (mensë/bar);
E.73: *Kërkesë për vënie në dispozicion të ambienteve*; ceremoni diplomimi.
E.74: *Blerja e pajisjes për skanimin e dokumentacionit*. Certifikimi i regjistrit të korrespodencës; Dosje të punuara në arkivë digjitale;
E.75: *Regjistra*: Regjistër bazë; Regjistër notash. Regjistër të dhënash diplomimi;
E.76: Program mësimor në BSc në Biologji.
E.77: Procedura e patentimit të UNVIMAS.
E.78: *Procedurë për miratimin e shërbimeve ndaj të tretëve*: VSA dhe VBA për shërbimet ndaj të tretëve (shembuj)
E.79: Akt Rakordim i të Ardhurave, për vitin 2024, çelje e grantit të vitit 2024.
E.80: *Marrëveshje për program të përbashkët dhe të dyfishtë*: BSc në "Shkenca Arkitekturore për Trashëgiminë"; BSc në "Inxhinieri Elektrike"; MSc në "Inxhinieri Armatimi me profil "Aviacioni" dhe "Navale""; MSc në "Mbrojtje dhe menaxhim i mjedisit detar".
E.81: Dokumentacion mbi mentorimin dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.
E.82: Procedurë mobiliteti Erasmus+ personel akademik, personel joakademik; Vërtetim mobiliteti për personel hyrës.
E.83: Procedurë mobiliteti Erasmus+ student; Dokumentacion për njohjen e krediteve të fituara jashtë vendit; Vërtetim mobiliteti për student hyrës
E.84: Studimet e tregut të punës për program mësimore DP Operator turistik.
E.85: Raporte mbi integrimin e studentëve në tregun e punës përmes praktikave, FE.
E.86: Program studimi Bsc në Inxhinieri Elektrike ishte-bëhet
E.87: Riorganizim i Programit Bsc në Infermieri të Përgjithshme sipas VKM-së nr. 823, datë 28.12.2023 për "Disa Shtesa dhe Ndryshime në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë") në përputhje të plotë me strukturën e kurrikulave homologe të BE.
E.88: Lista e pedagogëve të huaj në UV
E.89: Program studimi DP në Akuakulturë dhe Higjenë e Produkteve të Peshkimit, Bsc në Biologji, MP në Arsimin e Mesëm në Biologji me profil minor në Kimi, të të njëjtës fushë-Biologji

E.90: Pasurimi, mirëmbajtja dhe zgjerimi i infrastrukturës mësimore: Inventari i laboratorit të Biologjisë. Blerje paisjesh laboratorike. Blerje materialesh laboratori Biologji. Blerje smartbordesh, kompiuterash, kondicionerësh. VKM e Godinës së Apelit.
E.91: Raporti i kapaciteteve institucionale 2025
E.92: Plani mësimor DP në Asistencë Geriartrike, Bsc në Infermieri të Përgjithshme, MP në Infermieri Kirurgjikale
E.93: Syllabys 'Pediatri' (cikli I), Syllabys 'Pediatri e avancuar' (cikli II).
E.94: Program studimi Bsc në "Gjuhë Shqipe dhe Letërsi", MSc në "Mësimdhënie e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë", PhD në "Studime Gjuhësore, Letrare e Kulturore"
E.95: Modul çertifikimi për formimin e vazhduar në fushën psiko-pedagogjike + plani mësimor DE-FSHH; shkolla e Drejtorëve FSHH
E.96: Trajnim IT për mësuesit e shkollave të mesme (Petro Sota - Fier)
E.97: Modele të vlerësimit të aktiviteteve
E.98: Çertifikata të ndryshme nga aktivitetet LLL
E.99: Listë pjesëmarrësish në aktivitetin LLL, ku evidentohet vendi i punës.
E.100: Dokumentacion për angazhimin vjetor të personelit akademik të huaj për mësimdhënien e gjuhës dhe kulturës italiane
E.101: Raportimi i leksioneve me personalitete ndërkombëtare
E.102: Procesverbal notash me përqindjen e kalueshmërisë dhe notës mesatare të studentëve kalues.
E.103: Program mësimor i riorganizuar MSc në Drejtësi. Program mësimor i riorganizuar BSc në Infermieri Mami
E.104: Program mësimor i riorganizuar MSc në "Shkenca Kompjuterike" (moduli i Inovacionit)
E.105: Programi mësimor double degree BSc në Inxhinieri Elektrike
E.106: Program mësimor i riorganizuar BSc në Ekonomiks
E.107: Urdhri i Rektores për suportin e pedagogëve doktorantë
E.108: Pajisjet e laboratorëve simulatorë: Inventari i Laboratorit të Navigacionit. Inventari i Qendrës Simulatore për Profesionistët e Shëndetit
E.109: Module blended me qasje interaktive: Metodologjia e Kërkimit Shkencor; Menaxhim i Burimeve Njerëzore në Administrim Publik.
E.110: Plani mësimor MP në Infermieri Kirurgjikale
E.111: Praktika e mësuesisë – vertetim
E.112: Syllabysi i modulit të Praktikës Profesionale në programin Cikli i Ulët
E.113: Projekt klase në programin BSc në Shkenca Kompjuterike
E.114: Vlerësimi i Praktikës Profesionale: Procesverbal vlerësimi i vazhduar në praktikë; Vërtetimi i shefave të pavioneve për periudhën e praktikës në programet master; Procesverbal vlerësimi në provimin e praktikës profesionale, Tezë provimi e praktikës profesionale.
E.115: Procedurë diplomimi me temë diplome: Banda e temave të diplomës; Lista e temave: titull, student, udhëheqës; leje etike; temë diplome: abstrakt; vendim komisioni.
E.116: Procedurë diplomimi me provim diplome
E.117: Plan mësimor, ku evidentohen orët e praktikës dhe projekteve BSc në "Infermieri Mami", MP në "Infermieri Pediatrike", (syllabuse)
E.118: Vlerësimi i njohurive të studentëve: Projekte të pavaruar të studentëve Informatike; Punë në grup të studentëve Pedagogji e specializuar; Prezantime në kuadër të modulit 'Metodologjia e kërkimit shkencor'; Tezë provimi e praktikës profesionale Pedagogji e Specializuar.
E.119: Lista e studentëve të rregjistruar në BSc in Architecture Sciences for Heritage; MSc in Maritime Environment Protection and Management – MEP&M
E.120: Dosje e diplomimit të një studenti

E.121: Formate diplomash DP, BSC, MP, MSC, double degree
E.122: Vërtetim diplome
E.123: Procedura për akreditimin e laboratorëve (Qendra Kërkimore Shkencore – FSHTN)
E.124: Raporte mbi projektet dhe kërkimin e realizuar në laboratorë
E.125: Relacion i Sektorit të Bibliotekës & Botimeve
E.126: Fondi bibliotekar i digjitalizuar në sistemin Cobis. Inventari i literaturës në bibliotekë.
E.127: Plan vjetor i kërkimit shkencor dhe vendim miratimi në nivel njësie
E.128: Raport vjetor i Sektorit të Kërkimit Shkencor 2025
E.129: Trajnime UV për rritjen e kapaciteteve në kërkim shkencor
E.130: Prof. Dr.Ralf Bernd Klösgen, Gjermani, Institute of Biology – Plant Physiology, Martin Luther University Halle-Wittenberg
E.131: Tabela e investimeve 2021-2025 - Sektori Financës;
E.132: Investimi në infrastrukturën laboratorike me financim të brendshëm/ të jashtë (FSHH+ FSH)
E.133: Integrimi i temave të diplomës në zbatimin e prioriteteve të kërkimit shkencor të departamentit:(FSHTN, FSH, FSHH)
E.134: Dosje e plotë e një projekti PKZHUV – thirrja, aplikimi, vlerësimi, raportimi dhe pagesat (FSHTN)
E.135: Mbështetja për rrjete ndërkombëtare – pagesa dhe marrëveshje bashkëpunimi CMU
E.136: Kërkesa e Këshillit Studentor dhe raporti/realizimi i aktivitetit.
E.137: Thirrje për aplikim PKZHUV 2026
E.138 Vlerësim projekti PKZHUV në nivel njësie kryesore
E.139: Vendim emërimi të dekanit për drejtuesit e grupeve mësimore dhe kërkimore: (FSHH, FSH)
E.140: Kërkesa dhe propozime të departamenteve për organizimin e aktiviteteve shkencore konferencave, seminareve dhe workshopeve shkencore;
E.141: Projekt aplikim PKZHUV i iniciuar nga departamenti.
E.142: Analiza vjetore e Qendres Kerkimore Shkencore e Shendet Publik mbi veprimtarinë mësimore dhe kërkimore;
E.143: Procesverbale të mbledhjeve të departamentit shkenca kopmjuterike dhe gjuhe shqipe dhe letersise për miratimin e objektivave kërkimore; Vendime fakulteti për objektivat vjetore të kërkimit
E.144: Praktikë shpërndarjeje fondesh për kërkim – Fakulteti i Shëndetit
E.145: Kërkesa zyrtare të iniciuara nga departamentet për bashkëpunim me partnerë të jashtëm - Marrëveshje bashkëpunimi (MoU) të propozuara nga departamentet dhe të miratuara institucionalisht;
E.146: Projekt aplikime të iniciuara nga departamenti (HORIZON- fq 1-13, PKZHUV- fq 14-28, PIKSH-AKKSHI- fq 29-54);
E.147: Marrëveshje për organizimin e kohës vjetore të punës së personelit akademik.
E.148: Procedure per miratimin e lejes akademike në studime doktorale (Marrëveshje UV–NTNU Norvegji) Procedure per miratimin e lejes akademike në studime doktorale (Marrëveshje UV–NTNU Norvegji)
E.149: Programi dhe diploma i mini-kursit ndërkombëtar për Data Sciences and AI, maj 2025
E.150 Praktikë komunikimi zyrtar: përfshirja e studentëve në aktivitet kërkimor/akademik jashtë vendit në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional
E.151: Pjesëmarrja e studentëve në "3rd Winter School of ASECU Youth"
E.152: Programi individual i doktoranteve te Ciklit të III-të
E.153: Raport ngjashmërie dhe përdorimi të AI: Shembuj raportesh antiplagjiaturë brenda dhe jashtë UV (anonim)

E.154: Kontrata me AKKSHI e projekteve 2025
E.155: Raport vjetor i bibliotekës universitare
E.156: Shkresë për ngritjen e Komitetit Shkencor të FSH
E.157: Vendim Rektori nr137/2025: Për përcaktimin e personave përgjegjës për operimin teknik të programeve kompjuterike për detektimin e plagjiaturës në veprimtarinë kërkimore dhe botuese në UV dhe për palët e treta.
E.158: Procedurë e plotë e botimit të artikujve shkencorë në UVSJ
E.159: Kontrata dhe dokumentacion rinovimi licence Turitin
E.160: Pjesëmarrje e stafit në COST Actions
E.161: Procedurë miratimi teksti mësimor
E.162: Lista e teksteve mësimore nga akademikë të IAL-ve të tjera. Lista e teksteve mësimore nga akademikë të UV-së
E.163: Procese anëtarësimi të UV-së: Dokumentacion për procesin e anëtarësimit në UNIMED. Kërkesë për anëtarësim të UV-së në EURAS
E.164: Mbështetje financiare për angazhimin e keynote speakers (NRA-CSIT)
E.165: Lista e stafit incoming Erasmus+ dhe shembuj profesor të huaj të ftuar në UV.
E.166: Grupe pune, që përfshijnë pedagogë të huaj: Aplikimi projekti ndërkombëtar
E.167: Marrëveshja GIZ / EU4Innovation /Dokumentacion bashkëpunimi me Dr. Adelajda Matuka (University of Bologna)
E.168: Raport vjetore të SMJ
E.169: Korrespondencë zyrtare me institucionet partnere; syllabus i kursit ndërkombëtar "Adult Health Behaviour"; certifikatë nga Tallinn Health Care College; lista e pjesëmarrësve dhe vlerësimi me ECTS; evidenca nga platforma Moodle dhe webinaret Zoom
E.170: Rregullore për prganizimin e ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë" në "Studime Gjuhësore, Letrare e Kulturore"
E.171: Raporte të ecurisë vjetore të studentëve doktorantë
E.172: Çertifikime ekspert në Organizata Ndërkombëtare Prof. asoc. F.Kamberi
E.173: Çertifikata e UV-së si lehtësuese start-up.
E.174: Relacioni i Prof.Dr. Elenica Piero: Organizimet e grupeve studentore të Fakultetit Ekonomik për hartimin e planeve të zhvillimit për ngritjen e start-upeve.
E.175: Kërkesa për prodhimin e vajrave esencialë UniVlora, Departamentit të Kimisë.
E.176: Procedurë e plotë për përzgjedhjen e studentëve BSc në programet e FSH: shkresa MA, vendim për ngritjen, relacion IT, vendim komisioni, shkresa përcjellëse për Rektorat, QSHA.
E.177: Procedurë e plotë për përzgjedhjen e studentëve MSc në Financë: shkresa MA, aplikimet, vendim për ngritjen e komisionit, vendim komisioni, shkresa përcjellëse për Rektorat, QSHA.
E.178: Procedurë e plotë për përzgjedhjen e studentëve Doktorantë në "Doktoratë në Studime Gjuhësore, Letrare e Kulturore": shkresa MA, aplikimet, vendim për ngritjen e komisionit, vendim komisioni, shkresa përcjellëse për Rektorat, QSHA.
E.179: Procedurë e plotë për përzgjedhjen e studentëve të transferuar ne programin e studimit BSc në "Shkenca Kompjuterike": shkresa MA, aplikimet, vendim për ngritjen e komisionit, vendim komisioni, shkresa përcjellëse për Rektorat, QSHA.
E.180: Procedurë e plotë për përzgjedhjen e studentëve për program të dytë studimi në BSc në "Infermieri të Përgjithshme": shkresa MA, aplikimet, vendim për ngritjen e komisionit, vendim komisioni, shkresa përcjellëse për Rektorat, QSHA.
E.181: Procedurë e plotë për ripranimet e studentëve në programet e studimit të Ciklit të Parë në Departamentin e Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare: aplikimet, vendim për ngritjen e komisionit, vendim komisioni, shkresa përcjellëse për Rektorat, QSHA
E.182: Procedurë e plotë për studentët Erasmus+ hyrës

E.183: Procedurë e plotë për përzgjedhjen e studentëve ndërkombëtarë
E.184: Shkresa e Bashkisë për kartat e studentit
E.185: Organizimi dhe informimi i studentëve ditën e parë të shkollës.
E.186: Librezë elektronike studenti
E.187: Vendimi i zgjedhjes së Këshillit studentor
E.188: Vendimi i KIZ për Senatin Akademik
E.189: Procesverbal mbledhjeje për rizgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Studentor. Procesverbal mbledhjeje e Këshillit Studentor
E.190: Aktivitete extrakurrikulare të propozuara dhe organizuara nga Këshilli Studentor: Kërkesa e KS dhe Raportimi i aktivitetit: "Nëntori që Flet" (Procedurë e plotë shkresore)
E.191*: Grupe pune me pjesëmarrje studentësh:* Urdhri për grupin e punës për harimin e raportit të vetvlerësimit të brendshëm institucional të UV-së. Urdhri për grupin e punës për harimin e raportit të vetvlerësimit të programit. Urdhri për grupin e punës për harimin e Strategjisë së Zhvillimit UV 2030 (Suarti student doktorate në UV)
E.192: *Procedurë përzgjedhjeje e studenti Erasmus+ me përfshirje studentësh në vendimmarrje:* Propozimi për studentin e komisioneve Erasmus+; Shkresa e Rektorit për ngritjen e komisioneve; Vendim i firmosur i komisionit ad hoc Erasmus+
E.193: Vendime për emërimin e këshilltarëve akademikë
E194: Raporte për oferta punësimi: shembuj nga FE, prezantim punësimi në banka dhe FSHTN, Departamenti i Shkencave Kompjuterike, prezantim për punësim IT
E.195 Procedurë për dhënien e honorareve të studentëve fitues në konkurse ndërkombëtare
E.196: Procedurë për përzgjedhjen e studentëve bursistë, financuar nga palë të treta
E.197: Aktivitete extrakurrikulare të propozuara nga Struktura e Karrierës, Shërbimit për Studentët dhe Alumnit: Kërkesa e SKSA dhe Raportimi i aktivitetit.
E.198: Shkresë e Administratorit për transport e Akomodim për vizitën e Këshillit Studentor në Parlamentin Shqiptar. Blerje kostumesh për Koncertin 28 Nëntor
E.199: Raporte të konkurseve kombëtare universitare: Raport i Law Competition. Raport i UniDebate. Raport i Debating Economics
